

ASLLAN HAMITI

SHTJELLIME  
GJUHËSORE

Shkup, 2020

**Redaktor:**

Prof. dr. Haki Imeri

**Recensues:**

Prof. dr. Ajten Qamili

Prof. dr. Ismet Osmani

Përpunimi teknik:

Shtëpia botuese:

Tirazhi: 500 copë

© Autori

Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë mjet apo në asnjë formë (as me fotokopje), pa lejen me shkrim të autorit.

CIP

Shtjellime gjuhësore (Лингвистички толкувања)



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

MINISTRIA **ЈУАЈ** E KULTURËS

Libri u botua me përkrahjen financiare të Ministrisë së Kulturës të  
Republikës së Maqedonisë së Veriut

<b>PARATHËNIE .....</b>	<b>5</b>
<b>I. PLANIFIKIMI I SHQIPES DHE POLITIKA GJUHËSORE .....</b>	<b>8</b>
1. Nevoja e përmirësimit dhe e përditësimit të standardit.....	8
2. Kongresi i alfabetit njësoi shkrimin e shqipes dhe bashkoi kombin.....	18
3. Kongresi i Manastirit përcaktoi bazën fonologjike të shqipes standarde .....	23
4. Puna 70-vjeçare e Katedrës së Gjuhës dhe e Letërsisë.....	28
Shqiptare në Universitetin e Shkupit.....	28
5. Diglosia në Maqedoninë e Veriut dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe .....	35
6. Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	42
7. Redaktimi profesional dhe gjuhësor i përkthimeve.....	50
8. Dita ndërkombëtare e gjuhës amtare .....	64
<b>II. KULTURË GJUHE, DIDAKTIKË .....</b>	<b>69</b>
1. Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoninë e Veriut .....	69
2. Sistemi rasor i shqipes dhe përdorimi i emrave të përveçëm të huaj..	80
3. Përdorimi dhe mbrojtja e shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut	86
4. Gjuha e teksteve shkollore të kimit të arsimit fillor në Maqedoni .....	99
5. Niveli metodologjik i gramatikave të gjuhës shqipe të arsimit fillor në Maqedoni.....	105
6. Programi mësimor i gjuhës shqipe në arsimin fillor për nxënësit e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	112
7. Ndryshime rrënjësore në gjithë sistemin arsimor.....	130
<b>III. DIALEKTOLOGJI E ONOMASTIKË.....</b>	<b>140</b>
1. Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe – vepër kolektive me rëndësi kombëtare .....	140
2. Atlasët krahinorë çojnë përpara gjeografinë gjuhësore të shqipes.....	147
3. Rrjeti i pikave të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut për atlasin e sintaksës dialektore të shqipes.....	153
4. Tiparet sintaksore të së folmes së Karadakut të Shkupit .....	170
5. Si të përcaktojmë inventarin e fonemave zanore të një të folmeje të caktuar.....	187
6. Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike.....	193

7. Dukuri morfonologjike në të folmet e gegërishtes .....	200
8. Ndhimesa e studiuësve të maqedonisë së veriut në fushën e dialektologjisë shqiptare.....	213
9. Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme.....	222
10. Mikrotoponimet dhe antroponimet e katundit Goshincë të Kumanovës .....	229
11. Mikrotoponimet e katundit brezë të Malit të Zi të Shkupit.....	240
12. E folmja dhe mikrotoponimet e katundit Goden të Gjilanit .....	253
13. Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoninë e Veriut - dëshmi e autoktonisë.....	269

## PARATHËNIE

Libri “Shtjellime gjuhësore” përmban trajtesa të përzgjedhura, ndonjë sosh edhe në bashkautorësi, të prezantuara në konferenca shkencore ndërkombëtare albanologjike, të mbajtura në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut; punime të botuara në revista shkencore në shqip e në maqedonisht gjatë një periudhe të gjatë kohore.

Një punë e tillë e përzgjedhjes së artikujve dhe e botimit të tyre në një libër ka qenë, është e do të jetë praktikë e nevojshme dhe e dobishme jo vetëm për të pasqyruar veprimtarinë hulumtuese të dikujt, por edhe për t’ia paraqitur e sistemuar lexuesit në një vend shtjellimet tematike, për ta njoftuar atë me përpjekjet kërkimore, përshirë jo vetëm atë që është thënë, por duke sjellë edhe ndonjë prurje të re në zhvillimin e mendimit shkencor. Ndonjëherë edhe në punime të shkurtra mund të lexojmë gjëra të vlefshme.

Mendimi shkencor nuk ecën përpara duke mësuar e pranuar të gatshme e në mënyrë absolute çfarë është thënë deri më tani, por pasi të njihemi me arritjet e deritashme në një çështje a fushë të caktuar, duhet bërë përpjekje e pasur guximin për të vërtetuar, plotësuar, zgjeruar, thelluar e çuar mëtej njohuritë. Në këtë kuptim, shkon mirë urtia (fjala e urtë) popullore: Gur, gur bëhet mur.

Në këtë përmbledhje trajtesash kemi sjellë 28 punime të ndara në tri fusha: 1. Planifikimi i shqipes dhe politika gjuhësore; 2. Kulturë gjuhe, didaktikë; dhe 3. Dialektologji e onomastikë.

Në kreun e parë kemi përfshirë tetë tema, si: nevoja e përmirësimit dhe e përditësimit të standardit; Kongresi i Manastirit jo vetëm që njësoi shkrimin e shqipes dhe bashkoi kombin, por përcaktoi edhe bazën fonologjike të shqipes standarde. Ndihtesë të madhe në arsimin, shkencën e kulturën shqiptare me punën 70-vjeçare ka dhënë Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare në Shkup. Veprimtarisë së këtij Departamenti ia kemi kushtuar një artikull. Në përdorimin zyrtar të shqipes në Maqedoninë e Veriut ka disa përparime, sidomos me themelimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve, por ende ka jo pak probleme të natyrave të ndryshme. Për disa

nga to kemi bërë fjalë në artikujt diglosia në Maqedoninë e Veriut dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe; sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut; redaktimi gjuhësor dhe profesional i përkthimeve etj.

Interesimin tonë profesional dhe shqetësimin për kulturën e dobët të gjuhës dhe shqipen e gjymtë në tekstet shkollore të përkthyer në Maqedoninë e Veriut e kemi shprehur nëpërmjet shtatë punimeve: gjuha në mjetet e informimit publik, sistemi rasor i shqipes dhe përdorimi i emrave të përveçëm të huaj, përdorimi dhe mbrojtja e shqipes standarde të ne, gjuha e teksteve shkollore të kimisë të arsimit fillor në Maqedoninë e Veriut. Këtë tufë tematike e kemi shtuar edhe me çështje të didaktikës, duke shtjelluar nivelin metodologjik të gramatikave të gjuhës shqipe të arsimit fillor, programin mësimor të Gjuhës shqipe në arsimin fillor për nxënësit e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për ta përmbyllur me nevojën, dobinë dhe domosdoshmërinë e ndryshimeve rrënjësore në gjithë sistemin tonë arsimor (parauniversitar e universitar).

Kapitullin e tretë ia kemi kushtuar dialektologjisë shqiptare dhe onomastikës. Këtu përzgjedhëm trembëdhjetë tema që kanë të bëjnë me punën madhore të gjuhëtarëve tanë të mëdhenj me botimin e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, me mundësinë dhe nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të gjeografisë gjuhësore të shqipes, përkatësisht hartimin e një atlasit të sintaksës popullore të shqipes, të atlasëve krahinorë të shqipes etj. Në këtë hulli hyjnë edhe propozimet tona për rrjetin e pikave të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut për Atlasin e sintaksës dialektore të shqipes dhe një skicë për tiparet sintaksore të së folmes së Karadakut të Shkupit.

Në disa nga monografitë përshkruese të të folmeve shqipe, veçmas të të folmeve të gegërishtes, del në pah mospërcaktimi i fonemave zanore. Për t'u dalur në ndihmë dialektologëve të ardhshëm, kemi dhënë disa udhëzime themelore të dobishme se si të përcaktojmë inventarin e fonemave zanore të një të folmeje të caktuar. Sigurisht se tingujt duhet vështruar jo vetëm nga pikëpamja fonetike, por edhe në këndvështrimin fonologjik. Në këtë drejtim, fonemat duhet vështruar nga pikëpamja e kundërvënies fonologjike në çifte minimale fjalësh, që të dalë në pah vlera kuptimore e gramatikore që ka secila zanore në mikrosistemin dialektor, duke marrë parasysh gjatësinë dhe hundorësinë e tyre. Vlerësojmë se kureshtjen e lexuesit do ta ngjallin edhe trajtesat për dukuritë morfonologjike në të folmet e gegërishtes, ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë së Veriut në fushën e dialektologjisë shqiptare si dhe sistemi i zanoreve të të folmes së Rekës së Dibrës.

Punimet e fundit të këtij kapitulli shtjellojnë mikrotoponimet e tre katundeve: Goshincës, Brezës dhe Godenit që i përkasin krahinës së Karadakut (të Kumanovës, të Shkupit e të Gjilanit). Nga vëzhgimi etimologjik i emërvendeve të kësaj krahine kemi konstatuar se pothuajse të gjitha janë me prejardhje iliro-shqiptare, ndërsa fare pak të huaja (latine, sllave, turke). Shtrirja hapësinore e shqipes në Gadishullin Ilirik si dhe emrat gjeografikë e personalë dëshmojnë bindshëm autoktoninë e pamohueshme, vazhdimësinë territoriale (të ngushtuar), historike, gjuhësore e kulturore Ilire-Arbërore-Shqiptare. Lidhur me këtë, në përmbledhjen e punimeve të këtij libri kemi përfshirë edhe artikullin toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoninë e Veriut – dëshmi e autoktonisë.

Trajtesat e sjella në këtë përmbledhje punimesh i kemi rilexuar, ripunuar, plotësuar e përditëdësuar. Besojmë se lexuesit e interesuar mund të gjejnë të dhëna, shpjegime, tëhollime e shtjellime gjuhësore të dobishme jo vetëm për ngritjen e tyre profesionale, për zgjerimin dhe thellimin e njohurive paraprake; por edhe për veprimtarinë e tyre kërkimore-hulumtuese në fushë të studimeve albanologjike. Shpresojmë se temat e trajtuara do të ngjallin kërshtërinë për studime të mëtejme.

Falënderoj gjithë ata që ndihmuan botimin e kësaj vepre: redaktorin, recensentët, përpunuesin teknik e shtëpinë botuese. Jam mirënjohës Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbështetjen financiare të botimit të librit.

Autori

## I. PLANIFIKIMI I SHQIPES DHE POLITIKA GJUHËSORE

### 1. NEVOJA E PËRMIRËSIMIT DHE E PËRDITËSIMIT TË STANDARDIT<sup>1</sup>

Asgjë në botë nuk është absolute, e paprekshme, e papërmirësueshme, e pandryshueshme. Pikërisht edhe zhvillimi i teknikës e i teknologjisë, i shkencës dhe i njerëzimit në përgjithësi mbështetet në përpjekjet që arrijtjet e brezave të mëparshëm t'i përsosë, t'i përkryejë, t'i mbindërtojë e t'i përditësojë. Çdoherë njeriu ka qenë, është dhe do të jetë në kërkimin e së mirës, së përkryerës, së dobishmes. Nëse gjërat që jepen një herë, nuk ndryshohen kurrë, atëherë jeta dhe çdo veprimtari e njeriut do të ishte e pakuptimtë.

Fatmirësisht shqipja është gjuhë e gjallë, në lëvizje e në zhvillim, e aftë t'i plotësojë nevojat e kombit, por që duhet bërë përpjekje ta bëjmë edhe më të aftë të përballet me gjuhët më të zhvilluara të botës. Rrjedhimisht, edhe normat e standardit të saj nuk duhet të jenë "rreptësisht të ndaluara". Vetëm për gjuhët e vdekura nuk ka nevojë të harmonizohet norma me stadin e zhvillimit të saj, sepse tek ato më nuk ka lëvizje.

Koha ka dëshmuar se zgjidhjet e Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1972) përgjithësisht janë të pranueshme nga shqiptarët. Por, mbyllja vetëm në "guaskën" e asaj që është parashikuar si normë para afër 50 vjetësh, mbështetur në treguesit e atëhershëm, sot, në dritën e disa trysnive që na sjellin zbatimet (në fakt moszbatimet) e ditëpërditshme do të ishte jodobiprurëse. Ka ardhur koha që të diskutohen normat e shqipes standarde nga specialistët e gjuhësisë, duke shqyrtuar e parë jo vetëm ç'është thënë e zgjidhur mirë, po edhe ndonjë gjë që duhet rishikuar për të gjetur zgjidhje më të mirë, porse ato nuk kanë të bëjnë më me themelin e gjuhës letrare të njësuar e të vetme për të gjithë.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Kumtesë e prezantuar dhe e botuar: Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, Konferenca Shkencore Mbarëshqiptare "Shqipja në etapën e sotme dhe politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit", Durrës, 15-17 dhjetor 2010. Në këtë version kemi bërë pak ndryshime.

<sup>2</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2, 2000, Tiranë, f. 39-40.



Në Parimin e 5-të të përgjithshëm të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (Prishtinë, 1974, f. 36) shkruan: *“Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe kurorëzon një etapë të gjatë përpjekjesh për formimin e një gjuhe letrare të vetme e të përbashkët për gjithë popullin shqiptar dhe çel rrugën për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare.”*<sup>3</sup>

Në parim problemet kudo që hetohen, duhet zgjidhur me dashamirësi, me mençuri, qetë e shtruar. Po të anashkalohen e të mos zgjidhen në kohën dhe në mënyrën e duhur, ato do të shtohen aq shumë saqë çdo përpjekje për zgjidhjen e përnjëhershme “me shkopin magjik” të të gjitha problemeve të grumbulluara prej vitesh mund të dështojë.

Pikësynimi ynë duhet të jetë që shqipen standarde ta bëjmë të pranueshme e të lehtë për gjithë shqiptarët, pavarësisht nga përkatësia territoriale. Atë duhet ta përvetësojnë me lehtësi jo vetëm gjuhëtarët, por edhe mësuesit, gazetarët, nëpunësit, politikanët, nxënësit e moshave të ndryshme etj. Do të duhej ta bëjmë të lehtë e joshëse për ta mësuar edhe të huajt. Në këtë kuptim, nuk kemi nevojë të përmbysim atë që është arritur deri më tani e të fillojmë nga e para, por të shohim mundësinë e përmirësimit të saj, duke vënë re sidomos problemet e zbatimit, në fakt të moszbatimit të normës.

Në Rezolutën e miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit (Tiranë, 1972) pohohet: *“Kongresi porosit që, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, rregullave të drejtshkrimit t’u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura.”*

*“Kongresi shpreh besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahet me entuziazëm dhe do të frymëzojë arsimtarët, shkrimtarët, punonjësit e shkencës dhe të kulturës, gjithë inteligjencën dhe të gjitha masat punonjëse, që me veprimtarinë e tyre krijuese ta zhvillojnë, ta pasurojnë e ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën tonë letrare kombëtare.”*<sup>4</sup>

Prirja për gegëzimin e shqipes standarde nga njëra anë dhe për hipertoskëzimin e standardit nga ana tjetër janë dy kahe të kundërta, të dëmshme, prapakthyesë e të rrezikshme për unitetin e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar.

Pothuajse të gjithë intelektualët shqiptarë përkrahin mendimin se duhet bërë përmirësimin e mëtejshëm të Rregullave të Drejtshkrimit, duke synuar sidomos mënjanimin e përjashtimeve jo të pakta, që shoqërojnë shpesh rregullat e përgjithshme.<sup>5</sup> E dëshirueshme është që rregullat e

<sup>3</sup> IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 35-36.

<sup>4</sup> IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 27.

<sup>5</sup> Këtë mendim e shprehën të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” mbajtur në Tiranë më 11 dhe 12 nëntër 2002, si: Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve të shqipes*

Drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, sa më përgjithësuese e sa më të lehta në përdorim, që nuk kërkojnë shumë mund e energji në përvetësim.

Në vazhden e planifikimit gjuhësor me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” (Tiranë, 11-12 nëntor 2002), ndërsa më 27 tetor 2004 u themelua dhe organizoi disa takime pune Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe.

Dihet mirëfilli se nga pikëpamja e burimit, shqipja standarde ka për bazë variantin letrar tosk. Por, sistemi i gjuhës standarde paraqitet si një sistem mbidialektor, më i gjerë nga baza e tij dialektore. Ai është shumë më i pasur në elemente dhe funksionet e tij nuk mund të krahasohen me funksionet e asnjërit prej dialekteve kryesore të shqipes. Krahas elementeve të përbashkëta të të dy dialekteve dhe elementeve të veçanta të secilit dialekt, gjuha standarde ka edhe elemente që i ka krijuar vetë, që e bëjnë këtë sistem shumë më të pasur nga cilido prej dialekteve të shqipes. Duke mos qenë sistem i ngrirë dhe i mbyllur, ajo vijon të pasurohet dita-ditës, nga njëra anë, me njësi e gjedhe të reja që i krijon me mjetet e veta, dhe, nga ana tjetër, me elemente që hyjnë në të drejtpërdrejt nga të folmet e shqipes si dhe nga gjuhët e huaja.<sup>6</sup>

Një ndër problemet a shkaqet e moszbatimit të normës letrare është edhe shkaku se jo pak fjalë që janë marrë si normative si në përbërjen fonemore ashtu edhe në format morfologjike kanë përhapje të kufizuar dialektore, kryesisht në të folmet toske. Rrjedhimisht, vetëm folësit e asaj izoglose nuk kanë vështirësi në përdorimin normativ, ndërsa praktika gjuhësore e deritashme na tregon se gjithë folësit e tjerë që nuk i përkasin atij territori të caktuar shprehin pakënaqësi dhe me vështirësi i përvetësojnë këto forma.

Në kontributin tonë, për të përmirësuar standardin do të propozojmë disa zgjidhje të reja të formave normative të përbërjes fonemore dhe të formave morfologjike të një numri jo të vogël fjalësh, veçmas të shumësit të disa emrave. Për të përcaktuar formën fonetike dhe morfologjike standarde të të njëjtës fjalë, mendojmë se detyrimisht duhet merret në konsideratë edhe përhapja dialektore e saj. Parimisht, përzgjedhja e drejtë, afatgjate, fatlume dhe më e pranueshme e formës standarde të fjalës duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me shtrirjen gjeografike të saj. Me fjalë të tjera, atëherë kur kemi dy e më tepër forma fonemore e morfologjike të të njëjtës fjalë, duhet përzgjedhur atë që ka shtrirje më të madhe gjeografike. Një pasqyrë të përgjithshme të izoglosave

---

*standarde*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 41; Emil Lafe, Gjovalin Shkurtaç, Enver Hysa etj.

<sup>6</sup> Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, f. 12-13.

të dukurive fonetike-fonologjike, morfologjike e të shtrirjes së jo pak fjalëve fatmirësisht tani më na jep Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (I, II, Napoli, 2007, 2008). Kjo vepër madhore mund të na shërbejë edhe si udhërrëfyes për përcaktimin e drejtë e përbashkues të fjalëformave normative.

### 1) Mosshkrimi i <ë>-së fundore tek emrat e gjinisë mashkullore

Zanorja /ë/ në shqipen standarde ka denduri të madhe përdorimi, ajo zë vendin e parë me afro 10% (9.86%) të shkronjave në një tekst të lidhur. Mund të gjendet në pozitë të theksuar ose të patheksuar. Në shqiptimin e tyre ka dallim. Kur është e theksuar, zanorja /ë/ shqiptohet me forcë më të madhe, është më e qartë dhe më e gjatë sesa kur është e patheksuar. Vetëkuptohet se /ë/-ja e patheksuar shqiptohet si më e dobët, më e errët dhe më e shkurtër.

Një nga problemet më të ndërlikuara të drejtshqiptimit (po edhe të drejtshkrimit) të gjuhës sonë paraqet zanorja /ë/ e patheksuar. Sipas studimeve që kanë bërë gjuhëtarët tanë në fushën e fonetikës së sotme të shqipes, /ë/-ja e patheksuar është e shkurtër, përkatësisht, e reduktuar (e quajtur edhe gjysmëzanore); gjysmë e hapur, qendrore dhe hyn në grupin e zanoreve që quhen të lëvizshme, të paqëndrueshme. Në pozitë të theksuar, kjo zanore ruhet mirë. Por, kur është e patheksuar, në përgjithësi ruhet deri diku në ligjërimin libror dhe në të folurit e ngadalshëm, ndërsa në ligjërimin bisedor dhe në të folurit e shpejtë rrudhet (tkurret, reduktohet) në shkallë të ndryshme. Kjo zanore ka denduri përdorimi shumë të madhe në dialektin jugor, ndërsa përdorim të rrallë në dialektin verior. Dihet se të folmet gege nuk kanë fonemë /ë/ në rrokje të theksuar (meqë historikisht kanë një /ã/ ose më rrallë një /ê/ hundore), ndërsa në rrokje të patheksuar nuk e gjejmë as në fillim e as në fundin absolut të fjalës, rrallëherë në pozitë mesore. Kjo shprehi shqiptimore dialektore pasqyrohet jo vetëm në ligjërimin e shkujdesshëm, por shpeshherë edhe në ligjërimin libror të pjesëtarëve të të dy dialekteve të shqipes.

Shumica e gjuhëtarëve shprehin nevojën e rishqyrtimit të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit të [ë]-së së patheksuar, për të ndjekur prirjen e sistemit grafik të shqipes për barazimin ndërmjet shkronjës e tingullit, d.m.th. prirja për të mos pasur shkronja parazitare, siç është [ë]-ja në disa pozita të patheksuara, p.sh. mosshkrimi i [ë]-së fundore tek emrat e gjinisë mashkullore (tani: *djalë, burrë, gjumë, kalë, lëmë, lumë, brumë, djathë, drithë, dyllë, dhjamë, grurë, gjalpë, mjaltë, ujë, ballë, atë* e ndonjë tjetër).<sup>7</sup> Tashti edhe toskët nuk i shqiptojnë më me -ë ato fjalë, prandaj edhe në praktikën shkrimore të sotme, gjithandej po shtohen “gabimet” drejtshkrimore pikërisht për kategori të tilla. Pra, mbështesim zgjidhjen të

<sup>7</sup> Enver Hysa, *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike 3-4, 2000, Tiranë, f. 76-80.

shkruhen pa -ë fundore emrat *burr, djal, gjum, kal, lum, ball, brum, djath, drith, dyll, dhall, dhjam, gjalp, mjalt* etj. meqë <ë>-ja fundore nuk dëgjohe fare as në shqiptimin letrar.

## 2) Shkrimi i disa fjalëve të huaja jo me <rr> po me <r>

Ngjashmëria nyjetimore dhe ngarkesa e vogël funksionale ka mundësuar rrafshimin e kundërvënieve fonologjike të bashkëtingëlloreve /r/ dhe /rr/ përgjithësisht në arealin toskë dhe në shumë të folme të gegërishtes jugore. Këto bashkëtingëllore dridhëse ruhen mirë në gegërishten veriore. Edhe në shqipen standarde merren si dy fonema të veçanta, gjë që provohet me çifte minimale fjalësh të tilla, si *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë, deri ~ derri, rimë ~ rrimë* etj.<sup>8</sup>

Një nga parimet bazë të statistikës gjuhësore thotë se sa më komplekse të jenë fonemat në nyjetim, aq më pak përdoren. Statistika gjuhësore jep të dhënat se fonema /r/ ka denduri të madhe përdorimi (6,28%), ndërsa /rr/-ja ka denduri të vogël përdorimi (0,50%); /r/-ja përdoret 12,56 herë më shumë se /rr/-ja.<sup>9</sup> Dyfishimi i bashkëtingëllores /r/ që ka krijuar /rr/-në ndonjëherë është bërë për shkaqe ekspresive e afektive të gjuhës, si *derr, zjarr, tmerr, gaforre, horr* etj.

Në shqipen standarde, drejtshkrimi me drejtshqiptimin e këtyre dy fonemave njëdridhëse e shumëdridhëse përputhen pothuajse plotësisht, meqenëse bashkëtingëlloret /r/ dhe /rr/ në ato fjalë ku shqiptohen edhe shkruhen (rrafsh, rregull, rreth, rrip, rrugë; arrë (pemë), furrë, hirrë, karrige, korrik, kurriz, urrej; kurrë, derr, ëndërr, kokërr) etj.

Duke u mbështetur në shqiptimin e sotëm, për të njësuar shqiptimin me shkrimin, mendojmë se më fatlume do të ishte të heqim dorë nga parimi historik i shkrimit të disa fjalëve me <rr> dhe të pranojmë për normative format me <r> të disa huazimeve kryesisht nga gjuhët romane: jo *korridor, korrigoj, terracë, territor, korrespondencë* etj., por *koridor, korigoj, teracë, teritor, korespodencë* etj.

## 3) Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i disa emrave vetjakë sllavë me /l/ ose /ll/ varësisht nga shqiptimi burimor

Bashkëtingëlloret /l, ll/ në shqipe dhe në rusishte funksionojnë si dy fonema të ndryshme, sepse dallojnë çifte të veçanta fjalësh, si *lak ~ llak, plakë ~ pllakë, mal ~ mall* etj. Por, në disa gjuhë të tjera, si në anglishte,

<sup>8</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 154.

<sup>9</sup> Anastas Dodi, *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996, f. 759-765.

frëngjishte, maqedonishte, bullgarishte, serbishte etj., ato janë dy realizime kombinatorë të së njëjtës fonemë. Në maqedonishte fonema /л/ shfaqet në dy variante kombinatorë: [l] dhe [ll]. Fonema dhe shkronja <л> e alfabetit cirilik (në maqedonishte, e bullgarishte) në pozitë para zanoreve të përparme /i, e/ (në alfabetin cirilik и, е), përfshirë edhe emrat e mbiemrat sllavë, lexohet e shqiptohet ngjashëm me [l]-në e shqipes, si: лист 'list', ливада 'livada', леб 'leb', Емилија 'Emilija', Билјана 'Biljana', Алекса 'Aleksa' etj.; ndërsa në pozitë para zanoreve /а, о/ (maq. а, о) shqiptohet ngjashëm me [ll]-në e shqipes, si: лав 'lav', ламба 'lamba', Славица 'Sllavica', Блаже 'Bllazhe', Младенов 'Mlladenov'; локум 'lokum', лозје 'lozje', Милорад 'Millorad', Милош 'Milosh', Павлов 'Pavllov' etj. Në pozicion para /у/-së përdoret fonema e shkronja /љ/, që artikullohet si [lj] (љубов 'ljubov', Љуботен 'Ljuboten'), që ka denduri të vogël përdorimi, përkatësisht shfaqet vetëm në pak fjalë.<sup>10</sup>

Edhe përkundër kësaj, Drejtshkrimi i shqipes ka ngritur në normë (në Shënim, f. 105) "Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave, pavarësisht nga mënyra e shqiptimit të [l]-së në këto gjuhë, të shkruhen përgjithësisht me <l>: si *Blagojev, Milan, Milorad, Milosh, Mladenov, Pavlov, Vladimir* etj."

Si njohës të disa gjuhëve sllave, veçmas të maqedonishtes, duke qenë në kontakt të përditshëm me emrat e mbiemrat sllavë, sidomos me antroponimet e maqedonasve, mendojmë se kur të njëjat fjalë maqedonasit, rrjedhimisht edhe ne shqiptarët e të tjerët i artikulojmë me /ll/ ose me /l/, atëherë edhe në Drejtshkrim do të ishte mirë të ndryshohej ky rregull dhe të ngritej në normë shkrimi i tyre me <l> ose me <ll> varësisht nga nyjetimi në gjuhën e burimit, si p.sh.: *Bllagoja, Millan, Millorad, Milosh, Mlladenov, Pavllov, Vlladimir, Bllazhe, Nikolla, Radosllav, Mirosllav, Llazar* etj., ndërsa disa të tjerë me <l>, si *Lubisha, Liljana, Lubomir, Emilija, Aleksa, Aleksandra, Ilja, Elena, Nikolina, Biljana* etj.

Rrjedhimisht, rregulli se: "Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave, pavarësisht nga mënyra e shqiptimit të [l]-së në këto gjuhë, të shkruhen përgjithësisht me <l>: si *Blagojev, Milan, Milorad, Milosh, Mladenov, Pavlov, Vladimir* etj.", propozojmë të ndërrohet me përkufizimin: "Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave që kanë fonemën /л/ të alfabetit cirilik, në shqipen të shkruhen e të shqiptohen me /l/ ose me /ll/, varësisht nga mënyra e nyjetimit të tyre në gjuhën përkatëse. Mendojmë se ky rregull mund të përkufizohet edhe kështu: Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave që me alfabetin cirilik shkruhen me <л>, në shqipen transkriptohen me /l/ ose me /ll/, varësisht nga mënyra e nyjetimit të tyre në gjuhën e burimit, si: *Lubisha, Liljana, Lubomir, Emilija, Aleksa, Aleksandra, Ilja, Elena, Nikolina,*

<sup>10</sup> Ирена Савицка – Људмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997, f. 70-86.

*Biljana; Bllagoja, Millan, Millorad, Millosh, Mlladenov, Pavllov, Vlladimir, Bllazhe, Nikolla, Radosllav, Mirosllav, Llazar etj.*

#### **4) Shumësi i disa emrave jo me prapashtesën -ë, -e, -ër; por me -a; jo me -nj, -inj, -enj, por me -j, -ij, -ej.**

Duhet t'i bëjmë udhë shtimit të shumësit me *-a* (gishta, prifta, jetima...) që vjen nga arealja gege, që ka një shtrirje të gjerë territoriale e që është një shumës më i qartë ndaj formave përkatëse me *-ë*, që këshillon norma e sotme morfologjike e drejtshkrimore, ndonjë prej tyre edhe me dy prapashtesa *-ër + -inj*: *gisht-ër-inj, prift-ër-inj*.

Bashkëtingëllorja /nj/ në të folmet shqipe nuk përdoret kudo njësoj. Kështu, në të folmet gege /nj/-ja ka denduri të rrallë përdorimi (krahasuar me shqipen standarde), meqë në të shumtën e rasteve në pozitë fundore, mesore e më rrallë edhe në pozitë nistore zëvendësohet me [j]-në ose më rrallë me [n]-në. Gjuha standarde shqipe, duke pasur mbështetje përdorimin e këtij tingulli në sistemin gjuhësor dialektor të toskërishtes, e ka ngritur në normë ruajtjen e kësaj bashkëtingëllorjeje në të gjitha pozitat e fjalës: në pozitë nistore, mesore dhe fundore. Zgjidhja e deritashme që në fillim të fjalës, bashkëtingëllorja /nj/ të përdoret në rastet si: *një, njëri, njeri, e njoh, i njohur, njoftim, i njomë, njëzet, njollë, nja* (pesë a gjashtë) dhe në fjalë të tjera të formuara prej këtyre është e pranueshme. I diskutueshëm është përdorimi i *nj-së* në pozitë fundore, përkatësisht shumësi i emrave me prapashtesën *-nj* ose në variantet *-inj, -enj*.

Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 100-101 thuhet se "Prapashtesën *-nj* e marrin vetëm emrat mashkullorë që mbarojnë me një zanore të theksuar (me përjashtim të fjalëve *bri, dre, dhe, fre, sy, tra, zë*). Shumicën e përbëjnë emrat që gjatë lakimit në njëjës nxjerrin bashkëtingëlloren *-r-* para mbaresës *-i*: *hu - huri - hunj, kalli - kalliri - kallinj* etj. Emrat që e formojnë shumësin me *-nj* nuk janë shumë: *barinj, drunj, çiliminj, fajdexhinj, florinj, gdhenj, gjinj, heronj, kërcinj, kërthinj, kushërinj, minj, mullinj, penj, shalqinj, turinj, zanatçinj* etj. Pas këtij rregulli shkojnë edhe disa emra që mbarojnë me togun zanor *-ua*, si: *ftua - ftonj, thua - thonj, potkua - potkonj, lingua - langonj* (bën përjashtim emri *krua - kroje*). Prapashtesën *-enj* e marrin një numër tepër i vogël emrash mashkullorë: *lumë - lumenj, lëmë - lëmenj, përrua - përrenj, budalla - budallenj, fukara - fukarenj, maskara - maskarenj, qerrata - qerratenj*.

Me prapashtesën *-inj* e formojnë temën e shumësit pak emra mashkullorë: *drapër - drapërinj, gjarpër - gjarpërinj, shkëmb - shkëmbinj, shkop - shkopinj, thelb - thelpinj*.

Në Drejtshkrim thuhet se "në pozicion fundor /nj/-ja përdoret te trajtat e shumësit të disa emrave e mbiemrave, si p.sh.: *arinj, barinj, kallinj, kushërinj, mullinj, sharrëxhinj, turinj, ullinj; heronj, thonj, ftonj, budallenj, drunj, hunj, gjarpinj* ose *gjarpërinj, përrenj, lëmenj, lumenj, priftërinj,*

*shkëmbinj; (i ri) të rinj, i zi (të zinj) etj. Bëjnë përjashtim dhe sipas normës drejtshkrimore dalin me -j në shumës këto fjalë: kufi - kufij, i keq, e keqe - të këqij, të këqija, krua - kroje.”*

Shumësi me *-nj, -inj, -enj* paraqet vështirësi drejtshkrimore e drejtshqiptimore për një pjesë të madhe të shqiptarëve, përkatësisht për folësit gegë. Rrjedhimisht, ndoshta do të ishte më mirë që shumësi i këtyre emrave në shqipen standarde të formohet me *-j, -ij, -ej* e jo me *-nj, -inj, -enj*; si *arij, barij, kallij, kushërij, mullij, sharraxhij, turij, ullij; heroj, thoj, ftoj, budallej, druj, huj, gjarpërij, përrej, lëmej, lumej, shkëmbij; (i ri) - të rij, i zi - të zij* etj.

Në këtë kuptim, forma e shumësit të disa emrave mashkullorë që tani konsiderohen si normative kanë përhapje të ngushtë territoriale, ndërsa përhapje më të gjerë kanë disa forma të tjera. Si rrjedhojë do të kemi thjeshtimin e formave të shumësit të emrave mashkullorë, si:

Zgjidhja e tashme		Propozim për përmirësimin e standardit		ADGjSh
<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>	
gisht	gishtërinj	gisht	gishta	harta 167, f. 237
kushëri	kushërinj	kushëri	kushërij	harta 163, f. 233
mi	minj	mi	mij	harta 163, f. 233
jetim	jetimë	jetim	jetima	harta 155, f. 225
lëmsh	lëmshe	lëmsh	lëmsha	harta 169, f. 239
bosht	boshte	bosht	boshta	harta 164, f. 234
thelb	thelpinj	thelb	thelba	harta 165, f. 235
drapër	drapërinj	drapër	drapra, drapij	harta 166, f. 236
flamur	flamurë	flamur	flamuj	harta 172, f. 242
gjysh	gjyshër	gjysh	gjysha	harta 156, f. 226
traktorist	traktoristë	traktorist	traktorista	harta 158, f. 228
doktor	doktorë	doktor	doktora	harta 150, f. 220
jorgan	jorganë	jorgan	jorgana	harta 154, f. 224
prift	priftërinj	prift	prifta	harta 168, f. 238
grusht	grushte	grusht	grushta	harta 160, f. 230
përrua	përrenj	prrua	prroj	harta 170, f. 240
pe	penj	pe	pej	harta 162, f. 232

### 5) Si të shmangim leximin e dyfishtë të dyshkronjëshave (takimi i <d>-së, <s>-së, <t>-së ose i <z>-së me <h>-në)

Fjalët e prejardhura ose të përbëra, të cilat takohet <d>-ja, <s>-ja, <t>-ja ose <z>-ja me një <h> që vjen pas tyre, sipas *Drejtshkrimit të gjuhës shqipe* shkruhen pa ndonjë shenjë ndarëse midis pjesëve përbërëse (por ruhet shqiptimi i veçuar i shkronjave të mësipërme), si: *i herëpashershëm,*

*meshollë, moshapje, moshyrje, disharmoni; shtathedhur; brezhumbur, gazhedhëse* etj. Po kështu shkruhen edhe emrat e përveçëm ku ka takime të tilla: *Bethoven, Ethem, Mithat* etj. Shikuar nga këndi i nevojës së rishqyrtimit të disa çështjeve të normës drejtshkrimore, përsosjes, thjeshtimit dhe përcjelljes së zhvillimit të shqipes standarde, mendojmë se për t'u ruajtur shqiptimi i veçuar i pjesëve përbërëse të dyshkronjëshave dhe për t'iu shmangur leximit të gabueshëm si njëshkronjësh, ka mundësi që pjesët përbërëse të digrafeve të ndahen me apostrof. Kështu, fjalët e mësipërme do të shkruheshin: *i herëpas'hershëm, mes'hollë, mos'hapje, mos'hyrje, dis'harmoni; shtat'hedhur; brez'humbur, gaz'hedhëse; Bet'hoven, Et'hem, Mit'hat* etj.

## **6) Shkrimi ndaras i mbiemrave numërorë (dikur të quajtur numërorë rreshtorë)**

Drejtshkrimi (f. 126, 127) ka kodifikuar që mbiemrat numërorë (në tekst numërorët rreshtorë), pavarësisht nga numri i pjesëve përbërëse të tyre të shkruhen bashkë, si: (i, e) pesëdhjetegjastë, (i, e) pesëqindgjashtëdhjetekatërt, (i, e) njëmijekatërqindpesëdhjetegjastë, (i, e) njëmilionpesëqindmijekatërqindgjashtëdhjetetretë etj.

Shkrimi i tillë i pandërprerë krijon vështirësi teknike, pamore, identifikuese e lexuese. Shkrimi bashkë i të gjitha pjesëve përbërëse të mbiemrave numërorë nënkupton edhe shqiptim të pandërprerë (pa ndonjë pauzë artikuluese). Një nyjetim i tillë është shumë i vështirë, bile edhe i pamundur për shkak të sasisë së kufizuar të ajrit që del nga mushkëritë gjatë procesit të të folurit. Nga ana tjetër, kjo bie ndesh me rregullin e përgjithshëm se fjalët në gjuhën shqipe janë 1-7 rrokëshe. Fjalë me më shumë se shtatë rrokje pothuajse shqipja nuk ka. Për këto arsye, mendojmë se do të ishte më mirë që mbiemrat numërorë të shkruhen si edhe numërorët themelorë, përkatësisht kufi ndarës të shërbejë lidhëza e: *(i, e) pesëdhjetë e gjashtë, (i, e) pesëqind e gjashtëdhjetë e katërt, (i, e) një mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë, (i, e) një milion e pesëqind mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tretë* etj.

## **7) Emrat e festave fetare të shkruhen me shkronjë të madhe**

Në kreun VI të Drejtshkrimit, në f. 154 si përjashtim të shkrimit të emrave të përveçëm me shkronjë të vogël thuhet se “emrat e festave fetare shkruhen me shkronjë të vogël: *bajrami, kërshëndellat, mevludi, nata e mirë, pashkët, e premtja e zezë, ramazani, rrëshajat, ujët e bekuar* etj.” Kjo zgjidhje e atëhershme për ligjet me frymën komuniste e ateiste, por praktika gjuhësore dëshmon se kjo zgjidhje nuk qe dorëmbarë. Pas demokratizimit të Shqipërisë dhe të shteteve të tjera përreth ku jetojnë shqiptarët e sot e gjithë ditën festat fetare po shkruhen me shkronjë të madhe. Pra,



propozojmë që emrat e festave fetare të shkruhen me shkronjë të madhe, si *Bajrami, Kërshëndellat, Mevludi, Nata e Mirë, Pashkët, E Premtja e Zezë, Ramazani, Rrëshajat, Ujët e Bekuar* etj.

Për t'u përballuar sfidave të mospërfilljes së normave, madje edhe të kontestimit të përgjithshëm të shqipes së sotme standarde<sup>11</sup> dhe të globalizimit, gjuha standarde shqipe nuk duhet të lihet në mëshirën e fatit, por nevojitet një planifikim kombëtar gjuhësor me ndërhyrje të institucioneve shkencore e shtetërore në zhvillimin e saj. Mbështetjen duhet ta ketë në traditën e shkrimit, gjuhën e përpunuar të letërsisë, por edhe në gjuhën e gjallë popullore, sepse thesari i saj është i pashtershëm.

Epoka jonë është epokë e ngritjes historike të popullit shqiptar, e pasurimit dhe e forcimit të identitetit kombëtar e gjuhësor. Ta ruajmë e ta modernizojmë gjuhën tonë standarde, sepse ashtu do ta ruajmë e do ta pasurojmë identitetin kombëtar në këtë botë të globalizimit, që aq fort i kërcënon të veçantat etnike kulturore, që, megjithatë, përfaqësojnë pasurinë e planetit.<sup>12</sup>

#### Literatura:

Dodi, Anastas, *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996.

Dodi, Anastas – Gjinari, Jorgji, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, I, Fonetika* (maket), Tiranë, 1983.

Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Sak-stil, Shkup, 2005; 2011.

*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.

Shkurtaç, Gjovalin, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2, Tiranë, 2000.

Савицка, Ирена – Спасов, Људмил, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997.

Gjinari, Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.

Hysa, Enver, *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike 3-4, Tiranë, 2000.

Qosja, Rexhep, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, SF nr. 3-4, Tiranë, 2002.

<sup>11</sup> Në këto rrethana, mendimi i shprehur nga disa intelektualë për t'u kthyer prapa në gjendjen e dikurshme të dy varianteve letrare të gjuhës shqipe, del i papërligjur e, për më tepër, do të ngjallte frymën e përçarjes në një kohë, kur kombi shqiptar ka nevojë më shumë se kurrë për bashkim. Shih: Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 38-42.

<sup>12</sup> Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, SF nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 36.

Demiraj, Shaban, *Rreth disa çështjeve të shqipes standarde*, Studime filologjike 3-4, Tiranë, 2002.

## **2. KONGRESI I ALFABETIT NJËSOI SHKRIMIN E SHQIPES DHE BASHKOI KOMBIN<sup>13</sup>**

I nderuari Rektor i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, zoti Ali Jashari!  
Të respektuar rektorë, zëvendësrektorë, dekanë e përgjegjës departamentesh!  
Të dashur pedagogë, studiues, studentë!  
Të nderuar dashamirë të shkronjave shqipe e të kulturës shqiptare!

Jemi mbledhur sot tok, në këtë sallë të bukur, në Konferencë Shkencore Mbarëkombëtare kushtuar 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, me një organizim të shkëlqyeshëm e me një mikëpritje vëllazërore, jo vetëm për të shënuar, përkujtuar e nderuar kolosët e shkronjave e të letrave shqipe; por edhe për të hedhur dritë e për të sjellë të dhëna, pikëpamje e prurje të reja. Kjo ngjarje e rëndësishme do të shtjellohet në tri fusha kryesore: a) nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, b) nga aspekti i edukimit dhe i kulturës si dhe c) nga këndvështrimi historik.

Përgjithësisht është e njohur se planifikimi gjuhësor përfshin tri faza kryesore: a) alfabetizimin e gjuhës, b) standardizimin dhe c) modernizimin e saj. Në Kongresin e Manastirit (14-22 nëntor 1908) u bë standardizimi i alfabetit të shqipes, hapi i parë i domosdoshëm për të standardizuar atë (në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 20-25 nëntor 1972) si dhe për të kaluar tani në stadin e sotëm të modernizimit që nuk përfundon kurrë, të cilin e karakterizon përpjekja për ta bërë shqipen të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të shoqërisë sonë dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës.

Nëse shpikja e alfabetit merret si një ndër zbulimet më të mëdha të njerëzimit, atëherë Kongresi i Manastirit mund të vlerësohet si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të popullit shqiptar. Njësimi i alfabetit çoi në rrugë të drejtë të gjitha zhvillimet e mëvonshme për ngritjen e vetëdijes dhe formimin e kombit, shuarjen e ndasive krahinore e fetare, hapjen e shkollave në gjuhën amtare, botimin e librave si dhe përhapjen e dijes e të kulturës.

Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe që për shqiptarët një kusht i domosdoshëm për t'u bërë ballë ndikimeve asimiluese të gjuhëve dhe të

---

<sup>13</sup> Referat i lexuar në seancën plenare (si folës kryesor) në Konferencën Shkencore Mbarëkombëtare kushtuar 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit (1908-2018), Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, 22. 11. 2018.

kulturave të huaja. *“Një gjuhë që s’shkruhet e s’këndohet, - thoshte Samiu, - nuk zihet gjuhë”*. Të folurit dhe të shkruarit në gjuhën amtare është mjet i domosdoshëm për të mbijetuar një komb.

Pajtohem me konstatimin e përgjithshëm se për ne shqiptarët njësimi i alfabetit, njësimi i gjuhës dhe njësimi i kulturës sollën natyrshëm bashkimin e kombit. Unifikimi i alfabeteve që parakusht për bashkimin kombëtar. Me këtë u dobësua ndikimi i politikës asimiluese, u zgjua dhe u fuqizua vetëdija kombëtare si dhe u përcaktua e ardhmja jonë. Me Kongresin e Manastirit shqiptarët dëshmuan pjekuri kulturore e politike dhe mbi të gjitha se jemi një komb, që kemi një histori, një gjuhë dhe një alfabet.

Siç dihet, shkrimi i shqipes ka një traditë mbi 550-vjeçare (nga Formula e Pagëzimit, 1462 e deri më tani). Deri para Kongresit të Manastirit, shqipja u shkrua me abc-ë të ndryshme, kryesisht me katër alfabete: me alfabetin latin të përshtatur sipas autorësh e krahinash; me alfabetin arab, me alfabetin grek dhe me alfabetin cirilik. Veriu, përkatësisht shkrimtarët e vjetër përdornin alfabetin latin (të plotësuar me disa shkronja cirilike). Bejtexhinjtë përdornin alfabetin arab (si Muhamet Çami, Dalip e Shahin Frashëri etj.). Në jug përdorej alfabeti grek (Thimi Mitko, Konstantin Kristoforidhi), por ka edhe pak shkrime shqipe me alfabet cirilik (Gjergj Pula e të tjerë). Ka pasur raste edhe kur i njëjti autor ka përdorur dy alfabete: bie fjala Konstantin Kristoforidhi kur shkruante toskërisht përdorte alfabetin grek, ndërsa në shkrimet në gegërishte përdorte alfabetin latin.

Ky shkrim i shumëllojshëm i shqipes përbënte problem serioz: veprat e shkruara lexoheshin vetëm nga një grup i kufizuar njerëzish që dinin të këndonin atë shkrim. Procesin e izolimit, të ndarjes krahinore e gjuhësore; të gërshetuara edhe me ndikimet e huaja fetare e kulturore dhe përgjithësisht të përpjekjes për asimilimin e shqiptarëve, po e përshpejtonte edhe larmia grafike e shqipes.

Duke e hetuar këtë rrezik të zhbërjes kombëtare, mendjet e ndritura përgatitën, thirrën e mbajtën me shumë sukses një Kongres mbarëkombëtar në Manastir, me të cilin u ndërpre procesi i divergjencës ndër shqiptarët dhe u fuqizua përgjithmonë procesi i konvergencës.

Kongresi u shndërrua në një manifestim politik i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, sidomos në dy ditët e para (14-15 nëntor 1908). Në këtë mbledhje u mbajtën fjalime patriotike për bashkimin e gjithë shqiptarëve, gegë e toskë, të krishterë e myslimanë e si rrjedhojë e kësaj edhe për njësimin e alfabetit.

Pasi miratoi vendimin për alfabetin, Kongresi tri ditët e fundit (më 20, 21 e 22 nëntor 1908) ua kushtoi çështjeve politike, ekonomike, kulturore e kombëtare. Ai u shndërrua në një tubim masiv ku u veçuan domosdoshmëria e bashkimit të shqiptarëve, çlirimit nga perandoria

Osmane etj. Më 22 nëntor delegatët miratuan dy rezoluta, që kishin të bënin me çështjen organizative të lëvizjes kulturore kombëtare.

Para këtij Kongresi janë mbajtur disa të tjerë, që kanë pasur të njëjtin qëllim, pra hartimin e një alfabeti të përbashkët. Por, ata kishin karakter regjional dhe nuk arritën që të përhapnin një alfabet të gjithë shqiptarët. Në dallim nga Kongreset e tjera, Kongresi i Manastirit ishte i pari me karakter mbarëkombëtar, meqë morën pjesë 50 delegatë që përfaqësonin 23 qytete, shoqëri dhe klube të ardhur nga të gjitha trojet tona, si dhe nga kolonitë shqiptare, pjesëtarë të të tri besimeve fetare më të mëdha ndër shqiptarët (muslimanë, katolikë e ortodoksë).

Komisioni i abc-së shqipe punoi tri ditë me dyer të mbyllura, me anëtarë që mbronin tri alfabetet më të përhapura: alfabetin e Stambollit, alfabetin e “Bashkimit” dhe atë të “Agimit”. Siç dihet, të tre kishin për bazë alfabetin latin, por që ndryshonin në disa shkronja si dhe në vlerën shënjuese a fonematike të tyre. Të gjithë u pajtuan që bazë e alfabetit të shqipes të jetë alfabeti latin. Gjergj Fishta pasi foli për punën dhe alfabetin e shoqërisë së tij “Bashkimi” tha: *“Unë nuk kam ardhur të mbroj ndonjërin nga këto alfabete, por kam ardhur të bashkohem me ju dhe të adaptoj atë alfabet, të cilin do ta vendosë Kongresi si më të dobishmin për ngritjen e popullit”*. Fjalët e Fishtës prekën zemrat e 300 a 400 të pranishmëve aq sa nuk mund t’i mbanin lotët.

Në punën e mundimshme triditëshe të komisionit, por të frytshme u shqyrtuan tri mundësi:

- a) të përshtatej njëri nga tri alfabetet më të përhapura në atë kohë: alfabeti i Stambollit, i shoqërisë “Bashkimi” ose i shoqërisë “Agimi”;
- b) të bëhej kombinimi i këtyre tri alfabeteve, dhe
- c) të hartohej një alfabet i ri, duke lënë mënjanë alfabetet ekzistuese.

Pas shumë diskutimesh, u zgjodh varianti i tretë: të përpilohej një alfabet të ri për shqipen. Zgjedhja e alfabetit latin për shkrimin e shqipes ishte edhe një element i emancipimit kulturor të shqiptarëve. Në Kongresin e parë për kodifikimin e alfabetit u përcaktua që shqipja të ketë shkrimin më të përsosur, më të përhapur, më të lehtë e më praktik; pra shkrimin fonetik, më mirë të themi fonologjik. Në këtë lloj shkrimi çdo fonemë jepet me një shkronjë të veçantë, kështu që numri i shenjave është i vogël.

Me gjithë pikëpamjet e ndryshme dhe mbrojtjes së alfabeteve të veçanta si dhe me ndërhyrjet e drejtpërdrejta apo të tërthorta të disa qarqeve të huaja, falë vendosmërisë, atdhedashurisë e largpamësisë u kapërcyen vështirësitë. Delegatët që morën pjesë, sidomos Komisioni 11 anëtarësh për hartimin e alfabetit, ishin personalitete të njohura të kohës, patriotë e largpamës, me përgatitje të shkëlqyeshme teorike e praktike, të aftë për të zgjidhur këtë problem shumë të vështirë, përkatësisht për të shuar larmitë grafike të deriatëhershme me traditë katër a pesëshekullore

dhe për të mbjellë një abc-ë të vetme të pranueshme për të gjithë shqiptarët, atëherë të ndarë e të përçarë, të ndrydhur e të persekutuar, të shpërndarë nëpër botë, të helmuar me gjuhë e kultura të ndryshme të huaja.

Kjo zgjidhje e këtillë e grafisë gjen mbështetje edhe në praktikën e shtypshkrimit të tekstit shqip. Alfabeti i thjeshtë latin është homogjen për nga karakteri i shkronjave, i lehtë për t'u shkruar dhe shumë i volitshëm në shtyp.

### **Në Kongres u miratua edhe një program kombëtar**

Pas përfundimit të Kongresit, delegacioni ndërmori një udhëtim nëpër Shqipëri, që zgjati deri në dhjetor të vitit 1908. Kudo që shkoi, punoi për përhapjen e ideve kombëtare, për përhapjen e dijes e të kulturës. "Njësimi i alfabetit, shkruante Mit'hat Frashëri, është pema e parë e Kongresit. Por ka edhe një pemë tjetër, akoma më të madhe dhe më të bukur dhe kjo është bashkimi i shqiptarëve."

Lëvizja kulturore kombëtare e vitit 1908, që vazhdoi deri më vitin 1912, karakterizohet nga një program i përbashkët politik e kulturor, u formulua në Kongresin e Manastirit dhe u pranua në kongreset e njëpasnjëshme, të cilat shqyrtonin çështjet e kulturës e të arsimit kombëtar dhe problemet politike të kohës.

Programi kombëtar i miratuar në Kongresin e Manastirit përbëhej prej 18 pikësh, ndër të cilat:

- njohja zyrtare e gjuhës shqipe dhe e kombit shqiptar,
- përdorimi i shqipes në shkolla, hapjen e shkollave,
- themelimi i një universiteti shqiptar,
- emërimi i nëpunësve shqiptarë në vilajetet shqiptare,
- shkurtimi i shërbimit ushtarak nga 2 vjet e gjysmë në 2 vjet dhe për ta kryer atë në shtetin amë,
- zhvillimi ekonomik i vendit dhe përmirësimi i infrastrukturës si dhe disa kërkesa të tjera.

Kongresi i Manastirit pati rëndësi të madhe jo vetëm për alfabetin dhe për shqipen e përbashkët, për arsimin e për kulturën në veçanti, por edhe për çështjen kombëtare shqiptare në përgjithësi.

Vendimet e Kongresit, që ishin kurorëzim i veprimtarisë së shumë brezave lëvruesish të shqipes dhe i përpjekjeve të pandërprera për afrimin e njësimin e gjuhës shqipe e të kombit shqiptar, u pritën me gëzim dhe u vunë menjëherë në zbatim.

Brenda pak vitesh alfabeti latin i hartuar nga Kongresi, që është alfabeti ynë i sotëm, u përhap shpejt dhe u bë alfabeti i vetëm i shqipes. Ai është kurorëzimi i përpjekjeve disashekullore të mendjeve më të ndritura të kombit.

Alfabeti i përbashkët dhe i përpiluar drejt hapi rrugën për një emancipim kulturor, për një drejtshkrim të përbashkët dhe për një gjuhë standarde për të gjithë shqiptarët, siç e kemi sot.

Kujdes të madh ndaj gjuhës kanë treguar Pararilindësit e Rilindësit tanë. Ky kujdes është shtuar e thelluar edhe më vonë e vazhdon të jetë i gjallë edhe sot. Një plejadë mësuesish e dashamirësh të gjuhës e të kombit (shqiptarë e të huaj), shkrimtarësh, gjuhëtarësh e intelektualësh të tjerë kanë shprehur interesimin e kujdesin e tyre, duke dhënë ndihmesë të madhe në shkrimin e shqipes, hapjen e shkollave, hartimin e teksteve mësimore, të gramatikave normative; në studimin sinkronik e diakronik, në pastrimin dhe pasurimin, në planifikimin, standardizimin e së fundmi edhe në modernizimin e shqipes.

Këtë shqipe, të folur e të shkruar, të fituar me gjak e me djersë jo vetëm që duhet ta ruajmë edhe ne, por dhe t'ua lëmë trashëgim pasardhësve tanë, si elementin më të rëndësishëm të qenies sonë kombëtare. Po të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi ndaj paraardhësve tanë si dhe obligimin që kemi ndaj brezave që vijnë, do të dimë çfarë qëndrimi duhet të kemi e çfarë duhet të bëjmë. Nëse nuk mund të bëjmë më shumë për shqipen, atëherë së paku të mos e harrojmë, shpërfillim, përziejmë, shtrembërojmë, ndotim e prishim.

Tani kur festojmë 110-vjetorin e alfabetit, 106-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe 46- vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit mund të krenohemi edhe me vlerat e letrave shqipe. Në shqipen janë shkruar qindra e mijëra vepra letrare zhanresh të ndryshme, monografi shkencore, gramatika normative, historike, përshkrime dialektore, fjalorë shpjegues, dygjuhësh e shumëgjuhësh, tekste mësimore e shumë e shumë shkrime të tjera që s'kanë të mbaruar.

Le të shërbejë edhe ky takim yni si një nxitje e thirrje për gjithë intelektualët, pedagogët, studiuesit e gjuhës shqipe, shkrimtarët, gazetarët, nxënësit, studentët dhe gjithë folësit e shkruesit e shqipes që me veprimtarinë e tyre të punojnë për ta studiuar, pasuruar e lëvruar shqipen.

### 3. KONGRESI I MANASTIRIT PËRCAKTOI BAZËN FONOLOGJIKE TË SHQIPES STANDARDE<sup>14</sup>

Kongresi i unifikimit të alfabetit të gjuhës shqipe, i mbajtur në Manastir tanimë para 112 vjetësh (1908) është një nga monumentet më të rëndësishme të gjuhës, të historisë e të kulturës shqiptare jo vetëm të fillimit të shekullit XX, por edhe të shekujve të mëhershëm e të kohës së mëvonshme.

Zgjedhja e sistemit të shkrimit është problem simbolik. Shndërrimi i gjuhës në simbolizëm është një detyrë shumë e vështirë. Në shkrimin e gjuhëve, grafemat paraqesin fonemat apo tingujt themelorë të ligjërit.

Tërësia e fonemave zanore e bashkëtingëllore të një gjuhe përbën inventarin vokalik dhe konsonantik të saj. Inventari i fonemave dhe kundërvëniet (opozicionet) që kanë ndërmjet tyre formojnë sistemin fonologjik të gjuhës përkatëse. Sistemet fonologjike të gjuhëve, dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve dallojnë midis tyre jo vetëm nga numri i fonemave që përfshihen në to dhe nga raportet që vendosen mes fonemave të një sistemi, por edhe nga substanca fonetike e tyre. Inventari i fonemave zanore përcaktohet në bazë të zanoreve në rrokje të theksuar.

Siç dihet, fonemat ekzistojnë në formën e varianteve kombinatorë, pozicionale, krahinore, individuale e stilistike. Puna e parë dhe shumë e vështirë për alfabetizimin e gjuhës është përcaktimi i inventarit fonologjik të saj. Hartuesit e abëcësë së sotme të shqipes me punën e tyre dëshmuar se kanë pasur përgatitje të lartë gjuhësore (linguistike). Struktura fonologjike e shqipes standarde me 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore u përcaktua në thelb që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit dhe u ruajt me alfabetin e Manastirit. Ata me 36 shkronjat përcaktuan njëkohësisht edhe inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes standarde (36 fonema), prandaj mund të thuhet se njëkohësisht vunë edhe gurthemelin e gjuhës standarde shqipe.

Në këtë kumtesë (në bashkautorësi) do të trajtojmë mënyrën e zgjidhjes së drejtë të disa çështjeve fonetike, fonologjike e shkrimore me të cilat u përcaktua baza fonologjike e shkrimore e shqipes standarde. Pra, me standardizimin e shkrimit u standardizua edhe baza fonetike e fonologjike e shqipes standarde.

1. Kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve të gegërishtes nuk u normëzua, d.m.th. u pranua vetëm gjatësia fonetike e zanoreve, duke e shënuar çdo zanore vetëm me një shenjë, pavarësisht nga gjatësia e tyre.

2. Fonemat zanore hundore (që përdoren në shumicën e të folmeve geqe, për shkak të kundërvënies kuptimore ose gramatikore të zanoreve

---

<sup>14</sup> Asllan Hamiti – Ismet Osmani, Referat i lexuar në Konferencën Shkencore Mbarëkombëtare kushtuar 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, 22. 11. 2018.

gojore me gjegjëset e tyre hundore te disa çifte fjalësh) nuk u normuan si veçori fonologjike e standardit, rrjedhimisht edhe nuk krijuan shkronja të posaçme për to.

3. Mbështetje të drejtë gjuhësore u gjet edhe në dallimin ndërmjet fonemave dhe varianteve kombinatorë e pozicionale të tyre. Për fonema u morën vetëm tingujt themelorë që kanë vlerë fonologjike, gjegjësisht vlerë kuptimore ose gramatikore në ligjërime.

4. Në Kongresin e Manastirit u përcaktuan edhe shkronjat <rr> e <h> për të shënuar fonemat /rr/, /h/ edhe pse në të folmet e toskërishtes bashkëtingëllorja e parë ishte dhe është zbutur në /r/, ndërsa /h/-ja ka përdorim të kufizuar; ndërkaq në të folmet e gegërishtes këto dy fonema ruhen mirë.

Në vazhdim do të përpiqemi të japim disa shpjegime për të arsyetuar konstatimet e mëparshme:

**1. Nuk u krijuan shkronja të veçanta e as shenja diakritike për të shënuar gjatësinë e zanoreve, duke ngritur në normë gatësinë fonetike të zanoreve.** Siç dihet, për nga gjatësia toskërishtja ka vetëm një seri fonemash zanore, ndërsa gegërishtja ka dy: zanore të shkurtra dhe zanore të gjata.

Kongresi i Manastirit nuk normëzoi kundërvënien fonologjike të gjatësisë së zanoreve të gegërishtes, d.m.th. u mor për bazë vetëm gjatësia fonetike e zanoreve, duke e shënuar çdo zanore vetëm me një shenjë, pavarësisht nga gjatësia e tyre. Të kihet para sysh se autorët e Veriut në shkrimet e tyre përdornin shenja diakritike për të shënuar këtë gjatësi: ose duke shënuar një vizë mbi zanoren ose duke dyzuar të njëjtën zanore (ā, aa). Me fjalë të tjera, me Kongresin e Manastirit u vendos që gjuha standarde shqipe të ketë vetëm një seri zanoresh gojore të përbërë nga shtatë fonema, të cilat shkruhen me shtatë shkronja të posaçme njëshe: <a, e, ë, o, i, y, u>; kurse të gjitha të folmet e dy dialekteve kanë pasur e kanë bashkërisht një inventar prej 22 fonemash zanore.

Kur i krahasojmë të folmet e dy dialekteve të gjuhës shqipe vërejmë se të folmet gege kanë inventar më të pasur fonemash zanore (deri më 19) sesa të folmet toske (prej 6-7), sepse të parat kanë tri seri: zanore të shkurtra, zanore të gjata dhe zanore hundore, ndërsa të dytat kanë vetëm serinë e zanoreve gojore.

Në të vërtetë, edhe në të folmet e gegërishtes mbizotëron gjatësia fonetike e tingujve, por në një numër të konsiderueshëm fjalësh ende ruhet gjatësia fonologjike. Gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzierje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë fonetike.

**2. Fonemat zanore hundore nuk i pranuan si veçori fonologjike e gjuhës letrare, rrjedhimisht edhe nuk krijuan shkronja të posaçme**



**për to.** Dihet se të gjitha të folmet e të dy dialekteve bashkërisht kanë 22 fonema zanore (8 të shkurtra, 9 të gjata dhe 6 zanore hundore). Në arealet e shqipës numri i tyre sillet prej 6 deri më 17 fonema zanore. Edhe përkundër kësaj, në Kongres u caktua që gjuha shqipe letrare të ketë vetëm një seri zanoresh gojore të përbërë nga shtatë fonema. Edhe në sistemin bashkëtingëllor numri i fonemave në të folmet e shqipës është e larmishme, përkatësisht në të folme të veçanta numri i tyre sillet prej 30 deri më 26 fonema. Mirëpo, sipas shkronjave del se në Kongresin e Alfabetit u përcaktua që shqipja letrare të ketë 29 fonema bashkëtingëllore.

**3. Zgjidhje të drejtë gjuhësore në Kongresin e Alfabetit pati edhe dallimi ndërmjet fonemave dhe varianteve kombinatorë e pozicionale të tyre.** Për fonema u morën vetëm tingujt themelorë që kanë vlerë fonologjike, gjegjësisht vlerë kuptimore ose gramatikore në komunikim.

Përgjithësisht, në funksionin dallues mbështetemi për të përcaktuar fonemat e një gjuhe. Dy tinguj shërbejnë si fonema të ndryshme, nëse dallojnë veshjet tingullore të dy fjalëve të ndryshme; në rast të kundërt, këta dy tinguj janë realizime të së njëjtës fonemë. P.sh. /l/ dhe /ll/ në shqipe janë dy fonema të ndryshme, sepse dallojnë çifte të veçanta fjalësh, si *lak ~ llak, plakë ~ pllakë, mal ~ mall* etj. Por në gjuhë të tjera ël] dhe ët] janë realizime të ndryshme të një foneme të vetme. P.sh., në anglishte [l] del para zanoresh, si te *lake* [leik] “liqen”, kurse [ɫ] para bashkëtingëlloresh dhe në fund të fjalës: *milk* [miɫk] “qumësht”, *hill* [hiɫ] “kodër”.<sup>15</sup> Edhe në maqedonishte [l] dhe [ɫ] (l) janë variante kombinatorë të një foneme të vetme, sepse [l] përdoret para zanoreve të përparme [e, i] (khs. *лето, лесен; лист, ливада* - leto, lesen; list, livada), ndërsa [ɫ] në rrethime të tjera fonetike (përveç para [u]-së ku përdoret [ɫ]), si *ламба, лов; пор љубов* [ɫjubov].<sup>16</sup>

Duke u mbështetur në kundërvëniet fonologjike me të drejtë janë përcaktuar si fonema më vete, rrjeshimisht duke i shënuar me shkronja të posaçme zanoret /i/ ~ /y/, mbështetur në kundërvënien e mungesës ~ pranisë së buzorëzimit në disa çifte minimale fjalësh, të tipit *si ~ sy, ti ~ ty, mik ~ myk, rimë ~ rrymë* etj.

**4. Studimet dialektologjike dëshmojnë se gegërishtja e ruan kundërvënien fonologjike të bashkëtingëlloreve dridhëse /r/ ~ /rr/, ndërsa toskërishtja këtë kundërvënie e ka rrafshuar.** Së këndejmi, mund të thuhet se Komisioni hartues i Alfabetit me të drejtë fonemën /rr/ kanë vendosur ta shënojë me shkronjë të veçantë, duke u mbështetur në

<sup>15</sup> Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 97-99.

<sup>16</sup> Shih: Ирена Савицка – Људмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997 (Irena Savicka – Ljudmill Spasov, *Fonologija na sovremeniot makedonski standarden jazik*, Skopje, 1997), f. 70-86.

statusin e fonemës së veçantë që ka kjo shumëdrdhëse në sistemin fonologjik të gegërishtes. Kjo më së miri mund të vërehet në çifte minimale fjalësh, si: *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, var ~ varr* etj. (Shih hartën 22 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

**Në të folmet e dialektit Verior [h]-ja dëgjohe mirë, ndërsa në ato të Jugut shqiptohet si më e dobët ose nuk dëgjohe fare.** Bashkëtingëllorja glotale, shtegore, e shurdhët [h] dëgjohe mirë në të folmet e gegërishtes (përveç në të folmen e Dibrës e në ndonjë tjetër), ndërsa në të folmet e toskërishtes shqiptohet me frymëtim (aspirim) më të dobët shkallësh të ndryshme ose nuk dëgjohe fare, me gjithë kufizimet në përndarjen e saj (diku nuk shqiptohet në asnjë pozitë të fjalës, diku nuk shqiptohet në fund e diku në mes të fjalës). P.sh: *ëna* 'hëna', *a* 'ha'; *undë* 'hundë', *laet* 'lahet', *gjua* 'gjuha', *i ftot* 'i ftohtë'; *kra* 'krah', *pleh* 'ple', *sho* 'shoh', *njo* 'njoh' etj. (Shih hartat 21, 114, 115, 116, 117 122, 123 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007). Pra, edhe shkronjën <h> hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes kanë shumë të drejtë që e kanë përfshirë në sistemin shkrimor të shqipes.

### Si përfundim

Gjuha shqipe për shkrimin e saj përdor alfabetin latin të përshtatur sipas inventarit fonematik vetanak. Alfabeti i latinishtes u bë bazë e alfabeteve të shumë gjuhëve. Gjuha e më se 36 popujve të Evropës dhe i shumë të tjerëve jashtë këtij kontinenti shkruhet me alfabetin latin të përshtatur në mënyra të ndryshme.<sup>17</sup> Siç dihet, disa gjuhë, si anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja etj., kur paraqesin alfabetin e tyre, rendisin 26 shkronjat e alfabetit latin, por kombinimet e grafemave për të shënuar fonema të veçanta nuk numërohen si shkronja më vete.<sup>18</sup> Gjuha standarde shqipe ka 36 fonema, të cilat i shkruajmë me 36 shkronja.

Kështu, po të vlerësojmë sistemin grafik të shqipes nga pikëpamja e parimeve të përgjithshme, mund të thuhet se ai është nga më të thjeshtët (krahasuar me abc-ënë e gjuhëve të tjera) dhe ka zgjedhur mjaft drejt problemin e shkrimit të gjuhës sonë: 36 fonemat e shqipes shënohen me 36 shkronjat e alfabetit, që përbëhen nga 25 shenja të thjeshta, 9 dyshkronjësja dhe dy shkronja me shenja diakritike. Nga kjo pikëpamje në vija të përgjithshme është respektuar parimi themelor i grafisë, që e njëjta fonemë të paraqitet në të gjitha rastet vetëm me një shkronjë të veçantë (të thjeshtë ose dyshkronjësh). Shkrimi fonologjik bazohet në parimin e bashkëlidhjes së një fonemeje me vetëm një shkronjë, por ky është vetëm ideal, sepse në realizim asnjë sistem konvencional i shkrimit nuk është konsekuent dhe plotësisht fonematik.

<sup>17</sup> *Opća enciklopedija* 5, Zagreb, 1979, f. 43.

<sup>18</sup> Emil Lafe, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit i vështruar nga koha e sotme*, Studime filologjike 1-2, Tiranë, 1999, f. 12.

Përdorimi i shkronjave dyshe ka të mirat e veta, ngase me një numër më të vogël shenjash, përkatësisht me 27 shenja të thjeshta (kuptohet dhe me 9 çiftet e tyre) paraqiten 36 fonemat e gjuhës sonë. Por, kjo ka edhe të meta, sepse: 1) dyshkronjëshat zgjatin tekstin e shkruar; 2) krijojnë mundësi që disa çifte shkronjash të lexohen në dy mënyra, d.m.th. si digrafe dhe si shkronja të veçanta që vijnë njëra pas tjetrës, p.sh. *lagje*, *lagja* ose *lag'je*, *lag'ja*; *rënje*, *rënja* ose *rën'je*, *rën'ja* (në rastet e këtilla për t'u lexuar drejt, për fonemën /j/ shkruhet <i>); *Mithat* ose *Mit'hat*; *meshollë* ose *mes'hollë*, *gazhedhës* ose *gaz'hedhës* etj.

Në sistemin grafik të gjuhës shqipe grafemat janë të njëvlerëshme, sepse tregojnë gjithnjë të njëjtën fonemë. Shkronja <i> mund të thuhet se është e vetmja me dy vlera në sistemin grafik të shqipes: me të përgjithësisht jepet fonema /i/, por në raste të caktuara edhe fonema /j/. Jo vetëm në rastet *djegje*, *zënie*, *pedagogia* etj. (ku shkruhet <i>, ndërsa lexohet [j]), po edhe në një varg fjalësh të huaja që shkruhen me grupet <ia, ie, io, iu> (si *variant*, *malaria*, *aksion*, *stadium* etj.) ajo shqiptohet si [j].<sup>19</sup> Në një numër të vogël fjalësh, kryesisht të burimit latin, <u>-ja e ka vlerën e një gjysmëzanoreje (të ngjashme me shqiptimin e [v]-së, respektivisht v-së dyfishe [w] në anglishte), si *kolokujum*, *akuarium*, *kuadër*, *kuarc*, *kuotë* etj., duke formuar diftong me zanoren tjetër fqinje.

Me shkronjat e alfabetit tonë u përcaktua edhe baza fonologjike e shqipes së përbashkët kombëtare, dikur që quhej gjuhë letrare e tani shqipe standarde. Alfabeti i përbashkët dhe i ndërtuar drejt hapi rrugën për një emancipim kulturor, për një drejtshkrim të përbashkët dhe për një gjuhë standarde për të gjithë shqiptarët, siç e kemi sot.

### Literatura:

- Demiraj, Shaban – Prifti, Kristaq, *Kongresi i Manastirit*, ASHSh, Instituti i Historisë, Tiranë, 2004.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983.
- Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2011.
- Hamiti, Asllan, *Alfabeti i gjuhës shqipe*, Vjetari i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski”, libri 33, Shkup, 2007.
- Lafe, Emil, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit i vështruar nga koha e sotme*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.
- Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
- Nushi, dr. Pajazit, *Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptivë e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988.
- Silić, dr. Josip, *Opća enciklopedija* 5, Zagreb, 1979.
- Rosandić, dr. Dragutin, *Osnove fonetike i fonologije hrvatskog književnog jezika*, Zagreb, 1977.

<sup>19</sup> Emil Lafe, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit i vështruar nga koha e sotme*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 51-56.

Ymeri, Haki, *Për një sistem grafik më ekonomik të gjuhës së sotme shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.

#### **4. PUNA 70-VJEÇARE E KATEDRËS SË GJUHËS DHE E LETËRSISË SHQIPTARE NË UNIVERSITETIN E SHKUPIT<sup>20</sup>**

##### **Shkurtime**

Në këtë trajtesë do të përshkruajmë historikun e veprimtarisë së suksesshme arsimore, shkencore e kulturore gati 70-vjeçare të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit, duke paraqitur edhe problemet dhe nevojat e kohës. Do të japim disa të dhëna të rëndësishme për ciklin e parë, të dytë e të tretë të studimeve, ndihmesën e dhënë të mësimdhënësve të kësaj Katedre në shkencën albanologjike, në hartimin e teksteve parauniversitare e universitare etj.

Përveç mësimdhënësve të rregullt, në këtë Departament kanë ligjëruar edhe profesorët: dr. Latif Mulaku, dr. Shefqet Pllana, dr. Olivera Jashar - Nasteva, dr. Imri Badallaj, dr. Sadik Bejko, dr. Thoma Dhima etj. Herë pas here Katedrën e kanë nderuar me ligjërata edhe personalitete të shquara të shkencës e të kulturës shqiptare, si: prof. Eqrem Çabej, prof. Anastas Dodi, prof. Jani Thomai, prof. Shaban Demiraj, prof. Rexhep Ismajli, ndërsa si mentorë dhe anëtarë komisioni për mbrojtjen e doktorateve kanë marrë pjesë jo pak albanologë, si prof. Emil Lafe, prof. Xhevat Lloshi, prof. Rami Memushaj, prof. Gjovalin Shkurtaç, prof. Shaban Sinani, prof. Imri Badallaj etj.

Katedra edhe pse është njëra ndër institucionet më të moçme të arsimit të lartë të shqiptarëve, jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por edhe në rrafshin kombëtar, nuk e gëzon përkrahjen e nevojshme të organeve përkatëse shtetërore. Ajo përballlet me shumë probleme, por më të mëdha janë tri nga to: mungesa e kuadrit si pasojë e mospranimit të asnjë mësimdhënësi në këto pesëmbëdhjetë vitet e fundit, mungesa hapësirave të nevojshme, kufizimi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe etj.

---

<sup>20</sup> Asllan Hamiti, Kumtesë e prezantuar në Seminarin për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare, Prishtinë, 24. gusht 2017 me titull "Puna mbi 60-vjeçare e Katedrës së Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit." Meqë tani po mbushen 69 vjet, punimin e kemi titulluar si më lart, duke e rrumbullakësuar dhe përditësuar funksionimin e Katedrës në 70 vjet. Një version të ngjashëm të këtij punimi kemi botuar edhe kur Katedra shënonte 60-vjetorin jubilar të themelimit, në temën: *Veprimtaria 60-vjeçare e Katedrës së Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit*, Edukologjia 5/2011, Prishtinë, 2011, f. 38-49.

## 1. Historiku i Katedrës

Të përmbledhësh historikun 70-vjeçar të një institucioni të lartë arsimor në pak faqe tekst nuk është punë e lehtë. Por, si punonjës shumëvjeçar i këtij institucioni, ku kam studiuar e punoj që 35 vjet,<sup>21</sup> përgjegjës i Katedrës në dy mandate (2007-2011) dhe përgjegjës i studimeve të doktoratit të Degës së Gjuhësisë në Fakultetin e Filologjisë në Shkup (2011-2015) e pashë të udhës të flas për punën arsimore, shkencore e kulturore të këtij institucioni.

Fakulteti i Filologjisë në Shkup është themeluar më 16 dhjetor 1946 në kuadrin e Fakultetit të Filozofisë që është bërthamë e universitetit të sotëm publik "Shën Kirili e Metodi." Nga kjo datë, Fakulteti i Filologjisë, tani "Bllazhe Koneski" që nga viti 1974 ekziston si institucion i pavarur. Nga 3-4 grupet nismëtare, Fakulteti i sotëm i Filologjisë në Shkup u zgjerua në 11 Katedra me 13 grupe studimore dhe kombinime të shumta programore, ku studiohen më shumë se 20 gjuhë dhe letërsi ballkanike e botërore dhe një Departament për mësimdhënien e gjuhëve të huaja në fakultetet joamë.

Më vitin 1951 në Fakultetin e Filozofisë të Shkupit u hap lektorati i gjuhës shqipe,<sup>22</sup> i cili më vitin shkollor 1959/60 u ngrit në Seminar të gjuhës shqipe, ndërsa që nga viti 1971/72 në Katedër të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare. Themelues i Katedrës është profesori dhe veprimtari i shquar, dr. Petro Janura, i cili për 20 vjet rresht ishte i vetmi mësimdhënës nga themelimi (1951) e deri në transformimin në Departament (1971). Më pas janë pranuar edhe disa mësimdhënës (profesorë e asistentë), si dr. Remzi Nesimi, dr. Xhevat Gega, dr. Zeqirija Neziri, dr. Zihni Osmani, dr. Haki Ymeri, dr. Avzi Mustafa dhe lektor Qani D. Memeti. Profesorët tanë të nderuar Remzi Nesimi, Xhevat Gega e Qani Memeti tani janë të ndjerë; ndërsa prof. Avzi Mustafa e Zeqirja Neziri janë pensionuar.

Në Katedër në vitin akademik 2019/2020 ligjërojnë 11 profesorë me marrëdhënie të përhershme pune: dr. Nehas Sopaj, dr. Agim Poloska, dr. Asllan Hamiti, dr. Mirlinda Krifca, dr. Mirushe Hoxha, dr. Valbona Toska, dr. Agim Leka, dr. Ajten Qamili, dr. Ismet Osmani; docentet Farketa Dibra - Zeqiri e Luljeta Adili – Çeliku; ndërsa për bibliotekën kujdeset Blerant Memeti. Pedagogët e kësaj Katedre, përveç në Shkup, kanë magjistruar e doktoruar edhe në qendra të tjera albanologjike, si në Rumani e Itali (Petro Janura), Beograd (Xhevat Gega, Remzi Nesimi), Zagreb (Zeqirija Neziri, Avzi

---

<sup>21</sup> Përveç që kreu studimet themelore, magistraturën (një në Prishtinë e një në Shkup) e doktoratin, në këtë Departament kam kaluar nëpër të gjitha fazat e avancimit: praktikant (1986), asistent i ri (1988), asistent (1994), docent – profesor asistent (1999), profesor inordinar – profesor i asocuar (2004), profesor ordinar – profesor i rregullt (2009) e në vazhdim.

<sup>22</sup> Ky institucion i shkollimit sipëror të shqiptarëve është ndër më të moçmit. T'ju rikujtojmë se Universiteti Shtetëror i Tiranës u themelua më vitin 1957, Universiteti i Prishtinës më 1969, ndërsa universitetet e tjera janë më të reja.

Mustafa, Qani D. Memeti), Prishtinë (Remzi Nesimi, Zihni Osmani, Haki Ymeri, Asllan Hamiti), Tiranë (Haki Ymeri) etj.

Për nevojat mësimore të Katedrës kanë ligjëruar edhe akademik Olivera Jashar-Nasteva, prof. Latif Mulaku, prof. Shefqet Pllana, prof. Imri Badallaj, prof. Sadik Bejko, prof. Agim Vinca, prof. Thoma Dhima, prof. Thoma Dhima, prof. Agim Vinca etj. Për të mbuluar fondin e orëve, Katedra ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm, kryesisht nga Maqedonia e Veriut, si dr. Izaim Murtezanin, dr. Afrim Rexhepin, dr. Zekirija Ibrahimin, dr. Mustafa Ibrahimin, dr. Vebi Kadriun, dr. Ismail Hamitin, dr. Blerina Starova – Zllatkun, mr. Dritan Osmanin, mr. Jordana Shemkon, Xhabir Ahmetin, Rolanda Prevala – Kadriun etj. Herë pas here Katedrën e kanë nderuar me ligjërata edhe personalitete të shquara të gjuhësisë e të shkencës shqiptare: prof. Eqrem Çabej, prof. Anastas Dodi, prof. Jani Thomai, prof. Shaban Demiraj, akad. Rexhep Ismajli, akademik Bahri Beci, ballkanologu Viktor Fridman, ilirologu Aleksandër Stipçeviq, prof. Sadik Bejko, prof. Ali Jashari, ndërsa me udhëheqje shkencore (mentorim) dhe pjesëmarrjen si anëtarë komisioni për mbrojtjen e magistraturave e doktorateve na kanë nderuar prof. Emil Lafe, prof. Xhevat Lloshi, prof. Rami Memushaj, prof. Gjovalin Shkurtaç, prof. Refik Kadrija, prof. Imri Badallaj, prof. Begzad Baliu, akad. Shaban Sinani, akad. Ali Aliu; po edhe kolegë tanë nga dhjetë katedrat e tjera të Fakultetit të Filologjisë në Shkup, nga Fakulteti i Filozofisë, Fakulteti Pedagogjik “Klimenti i Ohrit”, nga Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore etj.

## **2. Katedra ka tri cikle studimore: studime themelore, të masterit e të doktoraturës**

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare i Universitetit “Shën Kirili e Metodi” në Shkup është njëri ndër institucionet më të mëdha të arsimit të lartë të shqiptarëve, jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por edhe në rrafshin kombëtar. Në studimet themelore kemi tri programe studimore:

- a) Gjuhë dhe Letërsi Shqiptare (drejtimi arsimor);
- b) Përkthim dhe Interpretim nga Maqedonishtja në Shqip (për studentë që shqipen e kanë gjuhë amtare) dhe
- c) Përkthim dhe Interpretim nga Shqipja në Maqedonisht (për studentë që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare).

Veç kësaj, për grupet e tjera të Fakultetit të Filologjisë mbajmë lëndën e Gjuhës shqipe 1, 2, 3, 4. Interesimi i studentëve joshqiptarë për të ndjekur kurset e gjuhës shqipe është tejet i madh, përkatësisht këto kurse i ndjekin rreth 200 studentë në çdo vit akademik.

Në vitin e parë të studimeve rëndom regjistrojmë nga 100 studentë të rregullt dhe përgjithësisht nga viti I-IV kemi diku rreth 300 studentë. Deri më tani kanë diplomuar mbi 2.000 studentë dhe shumica janë

dëshmuar mjaft të suksesshëm në punën e tyre si pedagogë të gjuhës e të letërsisë shqiptare, si përkthyes e interpretues, publicistë etj., por disa prej tyre janë ngritur në studiues, shkrimtarë, punëtorë shoqëror, politikanë e personalitete të shquara në veprimtarinë arsimore, shkencore, politike e kulturore.

Që nga viti shkollor 1993/1994 organizohen edhe studime pasuniversitare, më parë studime dyvjeçare të magistraturës, tani studime njëvjeçare të masterit në dy grupe: a) Gjuhë Shqipe dhe b) Letërsi Shqiptare. Deri më tani kanë magjistruar dhjetëra kandidatë në tema që lidhen me gjuhën, folklorin, letërsinë e kulturën shqiptare, por edhe me tema krahasuese ndërmjet gjuhësh e letërsish ballkanike e botërore. Disa sosh janë botuar, por ka edhe të tilla që ende ruhen në dorëshkrim në fondin e bibliotekës së Departamentit.

Në Universitetin “Shën Kirili e Metodi”, përkatësisht në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup në kuadrin e studimeve filologjike ka edhe studime të ciklit të tretë në fushën e gjuhësisë shqiptare si dhe të letërsisë shqipe. Interesimi i kandidatëve nga Maqedonia e Veriut, Kosova e Shqipëria për të ndjekur këto studime është i madh. Të drejtën e regjistrimit e kanë studentët që në ciklin e parë e të dytë kanë notë mesatare mbi tetë si dhe të kenë mbaruar studimet e shkallës I e II në fushën përkatëse (në filologji).

Numri i studentëve për regjistrim kushtëzohet nga udhëheqësit shkencorë (mentorët), që nuk kanë të drejtë të mentorojnë më shumë se tre kandidatë njëkohësisht. Mentori duhet të jetë i akredituar për të fituar të drejtën të udhëheqë kandidatë për doktorat. Licenca fitohet nëse profesori plotëson kriteret e parapara nga Komisioni për Akreditim i Rektoratit të Universitetit e më pas nëse këtë e miraton edhe Komisioni për Akreditim i Ministrisë së Arsimit.

### **3. Ndihmesa e mësimdhënësve të Katedrës për standardizimin, ruajtjen dhe kultivimin e shqipes**

Siç dihet, delegatë të ftuar nga Maqedonia në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe (Tiranë, 1972) ishin veprimtarët tanë të nderuar Petro Janura, Remzi Nesimi e Sefedin Sylejmani. Përveç këtyre tre delegatëve, në Kongres ishin ftuar dhe morën pjesë edhe tetë përfaqësues të tjerë nga Maqedonia: Ali Aliu, Kimete Agai, Mahmut Hysa, Emin Pustina, Xhevat Gega, Hamza Reka, Shahe Jegeni - Sulejmani, Hatixhe Nesimi, gazetare e Radio Shkupit. Këta intelektualë më në zë të kohës, si edhe gjithë masa e gjerë në Maqedoni, kanë përkrahur idenë për një gjuhë standarde të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Jo rastësisht prof. Remzi Nesimi moto të referatit të lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit,<sup>23</sup> me titull “Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni” kishte vënë thënieën e prof. Aleksandër Xhuvanit: “*Njësia e gjuhës është njësia e kombit.*” Në këta rreshta me vlerë na njofton me rrjedhën e zhvillimit të shqipes letrare në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore e më pas. Ai me të drejtë konstaton se: “*Që në vitet e para pas çlirimit të ne u krijuan dy qendra kulture: Prishtina në Kosovë dhe Shkupi në Maqedoni. Në të dyja këto qendra u zhvillua edhe një veprimtari botuese. Përveç shumë teksteve shkollore, në Shkup filloi të dalë “Flaka e vëllazërimit”, në Prishtinë “Rilindja” e më vonë edhe revista e botime të tjera...*” Qëndrimin e delegatëve të Kongresit si edhe të të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë për njësimin e shqipes, që atëherë Nesimi e shpreh haptas se: “**Parimi themelor i intelektualëve tanë gjithnjë ka qenë që të ndiqet ajo ortografi dhe bile edhe ajo gjuhë që përdoret në vendin amë.**”

Profesorët bashkë me të diplomuarit në këtë Katedër janë ndër veprimtarët më të dalluar të arsimit, të shkencës dhe përgjithësisht të kulturës shqiptare në Maqedoninë Veriut. Ata janë pedagogë të mirë, hartues tekstesh shkollore, albanologë, themelues të institucioneve të larta arsimore, të gazetave e të revistave shkencore në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore Katedra ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoninë Veriut dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në veçanti nga elementet sllave.

Me veprimtarinë e shumanshme arsimore, shkencore, shoqërore e kulturore ata kanë dhënë e po japin ndihmesë të madhe në përhapjen e dijes, në ngritjen e vetëdijes kombëtare si dhe në përparimin e përgjithshëm të popullit shqiptar në trojet tona.

#### **4. Veprimtaria hulumtuese, shkencore, letrare e hartimi i teksteve shkollore**

Mësimdhënësit e Katedrës janë mjaft të suksesshëm edhe me pjesëmarrjen aktive në seminare, simpoziume dhe konferenca shkencore albanologjike që mbahen në Shqipëri, Kosovë, në Maqedoninë e Veriut si dhe në vende të tjera. Disa profesorë tanë kanë qenë edhe bartës e realizues të suksesshëm të projekteve shkencore në fushën e gjuhësisë e të letërsisë shqiptare. Anëtarët e Katedrës deri më tani kanë marrë pjesë në

---

<sup>23</sup> Mr. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.



qindra konferenca shkencore, kanë hartuar jo pak tekste mësimore për arsimin fillor, të mesëm dhe universitar, kanë botuar dhjetëra monografi me vlerë, vepra letrare (poezi, prozë e dramë – Nehas Sopaj), përkthime veprash, qindra artikuj e studime të vlefshme.

Në fushën e gjuhësisë shquhen monografitë për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut: e folmja e Tetovës dhe e Dervenit (Remzi Nesimi), e folmja e Kumanovës dhe e Karshiakës (Haki Ymeri), e folmja e Prespës dhe e Manastirit (Zihni Osmani), leksiku dialektor i të folmes së Prespës (Agim Poloska), e folmja e Karadakut të Shkupit (Asllan Hamiti), e folmja e Strugës (Ajten Qamili). Punonjësit e Katedrës janë marrë edhe me hartimin e fjalorëve shqip-maqedonisht e anasjelltas: Haki Ymeri - Petar Atanasov - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht*, Dav Mari, Kumanovë, 1997. Haki Ymeri - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Logos-A, Shkup, 2000. Haki Ymeri - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Menora, Shkup, 2008. Haki Ymeri - Bina, *Fjalor shqip-maqedonisht*, Logos-A, Shkup, 2012.

Nuk janë të pakta edhe studimet e fushave të tjera: Interpretime linguistike (Shkup, 2002, Agim Poloska); Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit (Shkup, 2005), E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit (Shkup, 2014) nga Asllan Hamiti; Ndërrime morfonologjike në gegërishte nga Ismet Osmani, *Perla gjuhësore* (Shkup, 2018) nga Ajten Qamili etj.

Në fushën e letërsisë prijnë monografitë për autorët shqiptarë: “Meshari” i Buzukut, Vjershërimi i Varibobbës (Zeqirja Neziri); Individualitete letrare 1 – Beqir Musliu, Individualitete letrare 2 – Teki Dërvishi (Nehas Sopaj); Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit (Vatra, Shkup, 2000), Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave botërore (Fakti, Shkup, 2005), Me sagën ballkanike të Luan Starovës (Albas, Tetovë, 2019) nga Mirlinda Krifca – Beqiri; Psikologjia e teatrit (Shkup, 2009) nga Mirushe Hoxha; Semantika e dramës shqipe, Letërsi e huaj 1 (Tetovë, 2012) nga Agim Leka etj. I njohur si poet, romancier e dramaturg është Nehas Sopaj.

Nga fusha e arsimit shqip dhe e metodikës shquhen monografitë: Figura mësuesish shqiptarë, Maqedonishtja në shkollat fillore shqipe, Edukimi dhe arsimimi nëpër shekuj, Zhvillimi i shkollimit fillor në gjuhën shqipe në Maqedoni nga viti 1945 deri më 1975 nga Avzi Mustafa etj.

Shumë pedagogë të kësaj Katedre për nevojat e studentëve kanë hartuar tekste universitare, si: Epika gojore shqiptare, Lirika gojore shqiptare (Zeqirja Neziri), Letërsia për fëmijë (Nehas Sopaj), Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar, Metodologjia e kërkimeve shkencore në fushë të filologjisë (Avzi Mustafa), Kultura e të shprehurit (Shkup, 2007, Agim Poloska), Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe (në shqip e në maqedonisht), Kultura e gjuhës për të gjithë (Asllan Hamiti),

Dialektologjia e gjuhës shqipe (Asllan Hamiti, Ajten Qamili), Gramatika e gjuhës shqipe (në maqedonisht) nga Ismet Osmani; Gjuhësi shqiptare nga Ajten Hajdari - Qamili.

Pothuajse të gjithë kolegët e Katedrës janë marrë edhe me përkthimin e veprave letrare e gjuhësore nga shqipja në maqedonisht e anasjelltas. Po përmendim me këtë rast vetëm përkthimin në maqedonisht të Gjuhësisë ballkanike të prof. Shaban Demirajt që e bëri Haki Ymeri.

Me artikujt gjuhësorë e letrarë mësimdhënësit e Katedrës, bashkë me intelektualë të tjerë, kanë furnizuar 6 numrat e revistës shkencore “Shqyrtime albanologjike”, që u botua rregullisht nga viti 1994-1999 dhe fatkeqësisht dalja e saj në dritë u ndërpre për shkaqe financiare.

Disa vite me radhë (1996-2000) studentët e Katedrës botuan disa numra të revistës studentore për gjuhë, letërsi dhe kulturë shqiptare “Rrezja”, por edhe kjo veprimtari u ndërpre në mungesë të mjeteve financiare. Katedra ka një bibliotekë me 10.000 libra dhe 800 revista.

Megjithë rezultatet e arritura në fushën e arsimit, të shkencës e të kulturë, tani Katedra përballlet me shumë probleme, por më të mëdha janë tri nga to: mungesa e kuadrit si pasojë e mospërtëritjes e të mospranimi të kuadrit edhe pas pensionimit të mësimdhënësve; mungesa e sallave të pajisura me teknologji informative për mbajtjen e ligjëratave, kufizimi i përdorimit e gjuhës shqipe në punimet dhe mbrojtjet e magistraturave e të disertacioneve të doktoratit.

Si përfundim, ndihmesa e Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare për arsimin universitar shqiptar është shumë e madhe. Duke qenë institucioni i vetëm i arsimit të lartë të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, për më shumë se një gjysmëshekulli ka bartur barrën kryesore të përgatitjes e të pajisjes me dije dhe njohuri universitare, kryesisht të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, por jo vetëm, sepse në bankat e saj kanë studiuar edhe studentë nga Kosova, Mali i Zi, Presheva e Bujanoci. Ka luajtur një rol të rëndësishëm në arsimimin e brezave, pajisjen me njohuri jo vetëm të ruajtjes e kultivimit të kulturës gjuhësore e letrare shqiptare, si dhe të praktikimit të tyre në jetën arsimore, por edhe me njohuri të përgjithshme të kulturës historike kombëtare të nevojshme për mësuesit e gjuhës e të letërsisë shqiptare.<sup>24</sup>

### **Bibliografia:**

Fakulteti i Filologjisë, *25 vjet gjuhë shqipe në Fakultetin Filologjik të Shkupit 1951-1976*, Shkup, 1977.

*Годишен зборник на Филолошкиот факултет “Блаже Конески”, книга 32, I, Shkup, 2006.*

<sup>24</sup> Zeqirja Neziri, [www.koha.mk/kategoria/ndryshe-me](http://www.koha.mk/kategoria/ndryshe-me)

*Shqyrtime albanologjike 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; Shkup, 1994-1999.*

*Монографија – 60 години на Филолошки факултет “Блаже Конески” 1946-2006, Скопје, 2006.*

Nesimi, Remzi (Shkup), *Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni*, IAP, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974.

Neziri, Zeqirja, [www.koha.mk/kategoria/ndryshe-me...](http://www.koha.mk/kategoria/ndryshe-me...)

Hamiti, Asllan, *Ndihmesa e studiuësve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010.

Hamiti, Asllan, *Veprimtaria 60-vjeçare e Katedrës së Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit*, Edukologjia 5/2011, Prishtinë, 2011.

[www.flf.ukim.edu.mk/Bibliografia 2006-2016.](http://www.flf.ukim.edu.mk/Bibliografia%202006-2016)

## **5. DIGLOSIA NË MAQEDONINË E VERIUT DHE PROBLEMI I PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE<sup>25</sup>**

### **Shkurtime**

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut përgjithësisht njohin dhe përdorin varietetin territorial të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), shqipen standarde (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e informimit publik) si dhe maqedonishten standarde (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Në këtë kumtesë do të shtjellojmë këto çështje kryesore:

- Si është rregulluar me dispozitat ligjore përdorimi i gjuhëve në Maqedoninë e Veriut?,
- Padrejtësi në zgjedhjet dhe në format e tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve,
- Si është rregulluar përdorimi i gjuhëve në pushtetin vendor?,
- Kufizime në përdorimin e shqipes në administratë, në shëndetësi, në arsim etj.,

---

<sup>25</sup> Kumtesë e prezantuar dhe e botuar me të njëjtin titull në Kumtesat nga Konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës 2012”, mbajtur në Prishtinë, më 16-19. 05. 2012, f. 187-190.

- Propozim për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut.

**Gjuha është elementi kryesor dallues i kombit.** Çdo komb që respekton vetveten, duhet të ketë një gjuhë të njësuar, një gjuhë letrare kombëtare dhe ajo duhet përdorur në formën e folur dhe në formën e shkruar, në përdorim jozyrtar e zyrtar. Gjuha standarde është formë gjuhësore mbikrahinore, gojore dhe e shkruar, e ligjësuar historikisht dhe e institucionalizuar, që i nënshtrohet gjerësisht normimit dhe përhapet e kontrollohet nga institucionet e nga mediet publike.

Gjuha është tipar i rëndësishëm që bashkon njerëzit në kombe. Gjuha, si dukuri shoqërore, është "pronë" e përbashkët e një kombi, prandaj ajo është një tipar i rëndësishëm që e dallon një komb ose një shtet nga kombe a shtete të tjera. Ajo ka ndihmuar dhe ndihmon zhvillimin e vazhdueshëm të shoqërisë. Sa më e zhvilluar dhe më e njësuar të jetë një gjuhë, aq më mirë realizohet komunikimi ndërmjet njerëzve të një bashkësie dhe aq më lehtë bëhet organizimi i veprimtarisë shoqërore. Këtë rol më së miri e luajnë gjuhët e njësuar letrare (standarde).

**Planifikimi gjuhësor** si çështje sociolinguistike nënkupton alfabetizimin e gjuhëve, problemet e caktimit të gjuhëve zyrtare, standardizimin e gjuhëve kombëtare dhe modernizimin e tyre. I fundit vjen stadi i modernizimit, që karakterizohet nga përpjekjet për ta bërë gjuhën tashmë të standardizuar të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës. Në kuadrin e planifikimit e të politikës gjuhësore pa dyshim se duhet përfshirë edhe çështjet e përhapjes, kultivimit dhe zbatimit praktik të shqipes si dhe përdorimit zyrtar të saj në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi e gjetiu.

Planifikimi gjuhësor duhet parë si pjesë e planifikimit shoqëror. Ashtu si planifikimi shoqëror, që në përgjithësi është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave të zhvillimit për një shtet të caktuar, edhe planifikimi gjuhësor është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave gjuhësore për një bashkësi të dhënë.<sup>26</sup>

Nëse një gjuhë nuk praktikohet, ekziston rreziku i zhdukjes së saj! Linguisti Dejvid Harison nga Instituti për gjuhë të rrezikuara ka bërë një kërkim dhe ka ardhur në përfundime të habitshme. Prej 7 000 gjuhëve, aq sa fliten sot në botë, gjysma e popullatës përdorin vetëm 83 sosh, ndërsa shumë gjuhëve të vogla u kanoset zhdukja. Në këtë mënyrë deri në fund të këtij shekulli mund të zhduken deri më gjysma e gjuhëve. Vetëm dhjetë për qind e popullatës botërore flasin rreth 3 500 gjuhë. Kush e di se sa të

<sup>26</sup> Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 325-326.

përdoret një gjuhë në rrethin e më të afërmve (familjes dhe farefisit), megjithatë kjo nuk është garanci e mjaftueshme se gjuha do të mbijetojë dhe do të bartet prej gjenerate në gjeneratë. Siguri më e madhe e ruajtjes së gjuhës ekziston kur ajo përdoret edhe në nivel zyrtar si e drejtë e garantuar e përdorimit nga ana e qytetarit dhe nëse shteti ka obligim të mundësojë përdorimin e saj. Përdorimi i gjuhës, në veçanti përdorimi i drejtë si gjuhë zyrtare, nuk paraqet vetëm të drejtë, por edhe obligim për të gjitha subjektet!

Në jetën politike e akademike në Republikën e Maqedonisë çështja e përdorimit të gjuhës është aktuale. Shqiptarët e Maqedonisë përgjithësisht njohin dhe përdorin *varietetin territorial* të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), *shqipen standarde* (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e informimit publik) si dhe *maqedonishten standarde* (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) shpeshherë ndodhin përzierje kodesh, situatë në të cilën asnjë gjuhë e përdorur vetëm, nuk do të ishte e mjaftueshme.<sup>27</sup> Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor – pak fjalë nga shqipja e pak fjalë nga maqedonishtja, pastaj kthehen tek e para me disa fjalë më shumë (me huazime), me shprehi nyjëtimore të shqipes kur flasin maqedonisht, sidomos në theksimin e fjalëve; me një morfologji e sintaksë të ndërmjetme (herë sipas natyrës së shqipes e herë sipas asaj të maqedonishtes).

Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip. Përkthimet lëngojnë sidomos në zëvendësimin e formave rasore të shqipes me forma analitike: parafjalë + emër, meqë maqedonishtja nuk ka lakim emrash.

Sidoqoftë dukuritë e tilla janë me interes e për gjuhët në kontakt dhe ndikimin ndër-gjuhësor e përgjithësisht për sociolinguistikën. Por, në këtë kumtim vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në problemet praktike që janë pasojë e përdorimit të maqedonishtes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut, pra si “gjuhë e lartë” dhe të shqipes si “gjuhë e ulët.”

### ***Si është rregulluar me dispozitat ligjore përdorimi i gjuhëve në Maqedoninë e Veriut?***

<sup>27</sup> R. A. Hudson, *Sociolinguistika*, Kumanovë, 2007, f. 52.

E drejta e përdorimit të gjuhëve të bashkësive në Maqedoninë e Veriut rregullohet me Kushtetutë dhe me disa ligje. Pas një debati shumëvjeçar, në qershor të vitit 2008, Kuvendi solli një Ligj të përgjithshëm për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut dhe në njësitë e pushtetit vendor.

Në periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 2006 janë sjellë 30 amendamente.<sup>28</sup> Amendamenti më i rëndësishëm ku rregullohet përdorimi i gjuhëve është amendamenti V dedikuar përdorimit të gjuhëve, i cili thotë:

“Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare me alfabetin e saj. Edhe pse popullatë me mbi 20% në Maqedoni janë vetëm shqiptarët, hartuesit e ligjeve qëllimisht iu kanë shmangur emërtimit “gjuhë shqipe”, duke përdorur me dinakëri shprehjen perifrastike “gjuha që e flasin mbi 20% e qytetareve.”

Tani, dokumentet personale të qytetarëve shqiptarë (letërnjoftimi, pasaporta) jepen në maqedonisht e anglisht, me kërkesën e palës edhe në shqip. Por, shqipja kufizohet në përdorim, përkatësisht maqedonishtja ka shtrirje të përgjithshme, ndërsa shqipja mund të përdoret vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë. Kjo në zbatimin praktik do të thotë se në ato bashki ku shqiptarët nuk arrijnë 20% nuk e gëzojnë të drejtën që me organet bashkiake të komunikojnë në gjuhën shqipe. Fjala vjen, në qytetin e Shkupit, përveç maqedonishtes si e domosdoshme, vetëm në komunën e Çairit lejohet përdorimi publik i shqipes në institucionet e pushtetit vendor, në mbishkrime rrugësh, firmash etj. Nga ana tjetër, maqedonishtja mbrohet me ligj, me gjopa të parapara prej 2500 deri më 3 000 euro për thyerjen e normave të saj, ndërsa shqipja nuk mbrohet me ligj e as që ndëshkohet shkelja e normave.

### **Padrejtësi në zgjedhjet dhe në format e tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve**

Në ç’gjuhë shkruhet fletëvotimi? Fletëvotimi shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik. Në komunat, ku së paku 20% e qytetarëve flasin shqip, fletëvotimet shtypen në maqedonisht e në shqip.

Me këto dispozita shqiptarëve nuk u mundësohet të deklarohen në gjuhën amtare në ato vendbanime ku përqindja në numrin e përgjithshëm të banorëve, sipas përkatësisë etnike nuk arrin 20 për qindëshin. Për

---

<sup>28</sup> Amendamentet paraqesin formën përmes së cilës kryhen ndryshime të caktuara dhe plotësime të Kushtetutës. Numri më i madh i amendamenteve janë sjellë në vitin 2001 si rezultat i arritjes së Marrëveshjes kornizë dhe obligimeve që dolën prej saj.

shembull, fletëvotimi për zgjedhjet parlamentare në komunën e Strugës, do të shkruhet maqedonisht e shqip, por në komunat fqinje të Ohrit dhe Vevčanit vetëm në gjuhën maqedonase edhe pse në këto vendbanime numri i shqiptarëve mund të arrijë në 19%.

### ***Si është rregulluar përdorimi i gjuhëve në pushtetin vendor?***

**Rregulla kryesore** – në komunat dhe qytetin e Shkupit, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

**Gjuhë tjetër zyrtare** – gjuhë zyrtare në komunat dhe qytetin e Shkupit, krahas gjuhës maqedonase me alfabetin e saj cirilik, është edhe gjuha dhe alfabeti të cilën e përdorin së paku 20% e banorëve të asaj komune.

**Përdorimi i gjuhëve të bashkësive të tjera** – për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve që e flasin më pak se 20% e banorëve të asaj komune, vendos Këshilli i komunës, respektivisht Këshilli i qytetit të Shkupit.

Edhe në pushtetin vendor lindin probleme të zbatimit praktik të gjuhëve: p.sh. Në cilat gjuhë duhet të shënohen tabelat rrugore në komunën e Gazi Babës në Shkup? Në cilat gjuhë duhet të shënohet tabela para Urës së Gurit në Shkup? Së pari duhet shkruar gjuha e bashkësisë gjuhësore shumicë në atë vend apo maqedonishtja?

Kufizimi territorial i përdorimit të shqipes lidhet drejtpërdrejt edhe me kufizimin e përdorimit të simboleve kombëtare jomaqedonase. Nëse një kolonë dasmorësh niset nga skaji verior dhe duhet të arrijë në pjesën jugore të Shkupit me flamurin kombëtar shqiptar, fjala vjen nga Haraçina (bashki me 99% shqiptarë) për krushqi në Saraj (bashki me mbi 20% shqiptarë) duhet të kalojë nëpër komunën e Gazi Babës, Qendrës e Karposhit (bashki me më pak se 20% shqiptarë) a duhet të valojë flamuri gjatë gjithë rrugëtimit vajtje – ardhje, apo kur krushqit në vendbanimet me më pak se 20% shqiptarë flamuri duhet ulur, mbështjellë e futur brenda në makinë?

Ky përdorim i kufizuar territorial i shqipes: jo në gjithë Maqedoninë e Veriut, por vetëm në bashki të caktuara të quajtura edhe si “komuna shqiptare” apo “maqedonase” ose “rome” (kjo e fundit një komunë e qytetit të Shkupit e quajtur Shuto Orizare) bën që të kemi zhvendosje popullore nga një vendbanim me përkatësi etnike heterogjene në vende me përkatësi homogjene. P.sh. Manastiri pothuajse mbeti pa shqiptarë, ndërsa zëri i shqiptarëve po shurdhohet edhe në Ohër. Shqiptarët e Shkupit parapëlqejnë të jetojnë në komunën shqiptare të Çairit, në Tetovë, në Gostivar ose gjetiu ku përbëjnë mbi 20% të popullatës së përgjithshme.

Këtë getuizim e segregacion etnik të dëmshëm e me pasoja të paparashikueshme, përveç faktorëve të tjerë, po e ndihmon edhe lejimi apo ndalesa për përdorim të gjuhëve të etniteteve jomaqedonase që kushtëzohen drejtpërdrejt me përqindjen etnike të popullsisë.

Pikërisht nga mosbesimi i ndërsjellë dhe nga droja e përqindjes së popullatës sipas përkatësisë etnike, veçmas e raportit maqedonas - shqiptarë, dështoi dhe nuk u përfundua regjistrimi i popullsisë, familjeve, banesave dhe i pronave në Maqedoninë e Veriut.

### **Kufizime në përdorimin e shqipes në arsim**

Arsimi fillor dhe i mesëm është bërë i domosdoshëm për të gjithë banorët e Maqedonisë së Veriut. E drejta e shkollimit në gjuhën amtare për bashkësitë etnike joshumicë në komunat me mbi 20% jomaqedonas jetësohet më me pak vështirësi, por probleme ka në vendet ku numri i shqiptarëve është i vogël. Edhe sot e kësaj dite ka shqipfolës që në arsimin fillor e të mesëm detyrohen të mësojnë në maqedonisht. Rastin më të ri të këtillë e patëm në fshatin Jabollçishtë të Velesit. Një kohë të gjatë, para 2001 edhe dokumentet pedagogjike (ditari, librezat, dëftesat e nxënësve, përfshirë edhe plankonspektet) duhej të shkruheshin vetëm në maqedonisht, ndërsa tani në dy gjuhë: maqedonisht e shqip.

### ***Në cilat universitete në Maqedoninë e Veriut mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe?***

Në arsimin universitar mësimi zhvillohet në maqedonisht. Në institucionet private të arsimit sipëror mësimi mund të zhvillohet edhe në gjuhët e bashkësive që nuk janë shumicë në Maqedoninë e Veriut ose në gjuhët botërore. Shqip ligjërohet në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe në Universitetin e Evropës Juglindore. Në Universitetin “Shën Kirili e Metodi” në Shkup mësimi mbahet në gjuhën maqedonase, përveç në Fakultetin e Mësuesisë dhe pjesërisht në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare.

### **Problemet:**

Kolegët tanë të dy universiteteve të Tetovës administratën e kanë në shqip, ndërsa ne të Shkupit vetëm në maqedonisht. Po e tregojmë një shembull tipik me të cilin përballemi shumë shpesh. Sipas rregullores së Universitetit të Shkupit, përfshirë edhe rregulloren e Fakultetit të Filologjisë, pjesë e së cilës është edhe Katedra e Shqipes, punimet e magistraturës, masterit e të doktoratit shkruhen e mbrohen në maqedonisht ose në njërin nga gjuhët botërore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht), por kurrsesi shqip. Pra, kandidati detyrimisht punimin duhet ta dorëzojë në maqedonisht, referati të shkruhet në maqedonisht. Edhe në rastet kur tema lidhet ngushtë me gjuhën, letërsinë apo kulturën shqiptare, komisioni recensuese dhe të gjithë të pranishmit në sallë janë shqiptarë, ne detyrohemi procedurën e mbrojtjes dhe bisedën me kandidatin ta zhvillojmë në maqedonisht. Ky është një absurd i llojit të vet.



### **Propozim për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë Maqedoninë e Veriut:**

Në këtë paraqitje përmendëm disa nga kufizimet juridike të përdorimit të shqipes në Maqedoninë e Veriut, përkatësisht lejimin për përdorim vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë dhe mospërdorimit të saj në shumë institucione shtetërore, me disa shembuj konkretë për problemet e zbatimit praktik të saj, duke nxjerrë si përfundim nevojën për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut, krahas maqedonishtes, në tërë shtetin.

Gjuha luan rol të dyfishtë. Nga njëra anë homogjenizon, respektivisht shërben si kanal për komunikim ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve. Nga ana tjetër, diversifikon, respektivisht i ndan qytetarët sipas vijës etnike, kulturore dhe politike.

Dihet se nëse një gjuhë nuk praktikohet vazhdimisht dhe pa kufizime, ajo gradualisht do të tkurret e do të ndikohet nga gjuha që ka përdorim më të gjerë. Përdorimi i shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë Maqedoninë e Veriut nuk është vetëm një nevojë dhe domosdoshmëri, por edhe obligim për të gjitha subjektet.

Modele të përdorimit zyrtar të dy e më tepër gjuhëve gjejmë në disa shtete shumetnike e shumëgjuhësore.

Pra, në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut mund të përcaktohet shkurt e qartë se: gjuhë zyrtare në Maqedoninë e Veriut janë maqedonishtja dhe shqipja. Në Kosovë,<sup>29</sup> bie fjala, ku vetëm 4% janë serbë, gjuhë zyrtare në tërë shtetin janë shqipja dhe serbishtja. Ndërsa afër 1/3 e popullatës në Maqedoninë e Veriut flasin shqip, pra mbi 30% janë shqiptarë.<sup>30</sup>

Avancimi i statusit të shqipes në përdorim zyrtar nga një gjuhë e dytë vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë në gjuhë zyrtare shtetërore nuk do të shkojë në dëm të askujt, por është në të mirën e të gjithë qytetarëve të këtij vendi.

---

<sup>29</sup> Sipas të dhënave statistikore të fundit, në Kosovë 92% janë shqiptarë, 4% serbë, 2% boshnjakë dhe goranë, 1% turq dhe 1% romë.

<sup>30</sup> Sipas regjistrimit të vitit 2002, në Maqedoni 66% janë maqedonas, 22.7% shqiptarë, 4% turq, 2.2% romë, 2.1% serbë dhe 2.4% të tjerë.

## 6. SFIDAT E PËRKTHIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT<sup>31</sup>

Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të shumta. Po të vështrojmë tekstet e përkthyer nga shqipja në gjuhë të tjera si dhe nga gjuhët e tjera në shqip po edhe interpretimet (simultane, konsektive) shpërfaqen shumë probleme të natyrave të ndryshme. Në një paraqitje të shkurtër është e pamundur të përmenden të gjitha. Por, me këtë rast ne do të përpiqemi t'i përmendim vetëm disa nga problemet madhore që i kemi hetuar në përkthimet maqedonisht-shqip e anasjelltas:

### 1. Arsimi jocolësor parauniversitar e universitar në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Konstatim i përgjithshëm është se ne kemi arsim jocolësor. Për këtë gjendje të pamirë fajtor jemi të gjithë. Këtu mund të përfshihen planet e programet mësimore jo të përshtatshme për nxënësit e studentët e kohës sonë, tekste të dobëta shkollore, kushtet jo të mira hapësinore dhe mospasja e mjeteve mësimore, pagat e ulëta të mësimdhënësve, punësimet jo sipas kriterit të cilësisë, mungesa e shprehisë për të lexuar tekste e vepra me vlerë që sjell kufizime në kulturën e përgjithshme të rinisë sonë si dhe në kulturën e dobët gjuhësore, duke mbjellë analfabetizmin funksional dhe jorrallë duke prodhuar analfabetë me diplomë. Thjesht, të rinjtë e të rejtat tona nuk janë të motivuar për të nxënë dituri që më pas të merren me punë intelektuale, por shpresojnë të dalin jashtë vendit për një jetë materiale më të mirë. Si përfundim, sistemi i keq arsimor prodhon kuadro të dobëta, përfshirë edhe përkthyesit.

### 2. Mosnjohja e mirë e gjuhës amtare

*“Gjuha më mirë se gjithçka tjetër jep shpesh dritën ose mjerimin e një kohe.”* Janë këto fjalët e Ismail Kadaresë që të ftojnë të reflektosh rreth asaj që po ndodh me gjuhën shqipe, e përkufizuar si pasqyra e kulturës dhe e kombit tonë.

Shpërfillja e shqipes është vetëm njëri nga problemet e shumta serioze të shoqërisë shqiptare. Konstatim i përgjithshëm është se në Maqedoninë e Veriut kemi pak njerëz që dinë ta flasin e ta shkruajnë shqipen ashtu si duhet. Problemi më i madh në përdorimin e shqipes

---

<sup>31</sup> Kumtesë e referuar në panelin shkencor me temë “Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Përkthimit nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, Shkup, 01 tetor 2019. Ky tekst u botua edhe në gazetën “Koha” më 30. 09. 2019; <https://www.koha.mk/sfidat-e-perkthimit-ne-republiken-e-maqedonise-se-veriut/> shkarkuar më 26. 06. 2020.

standarde lidhet me kulturën e dobët gjuhësore, sidomos e brezit të ri. Mosnjohja e mirë e gjuhës amtare, ka të bëjë me mangësi të rënda në arsimin bazë, por edhe me mungesën e leximit, krahas me mospërpjekjen për të pasuruar ligjërimin dialektor, ndikimin e gjuhëve të huaja dhe krijimin e brezave dy- a tregjuhësh.

Për të përmirësuar këtë gjendje të pamirë duhet kushtrimuar të gjithë: institucionet arsimore, nxënësit, prindërit, mësindhësit, mjetet e informimit dhe e gjithë shoqëria. Propozim i përgjithshëm i gjuhëtarëve është që lëndë të kulturës së gjuhës të mësohen si të domosdoshme në të gjitha fakultetet në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut. Ai (mjeku, ekonomisti, gjykatësi, gazetari, përkthyesi, ...) që flet e shkruan mirë, ka shumë sukses në jetën dhe në punën e tij.

Në dallim nga ligjërimi i shkujdesur dhe bisedor, që përvetësohen lehtë nga komunikimi i përditshëm; ligjërimi libror kërkon një përgatitje paraprake arsimore e kulturore si dhe një përvojë të nevojshme gjuhësore. Nuk mund të kemi përkthyes të mirë me njohjen e ligjërimin të shkujdesur e atë bisedor, pa njohjen e ligjërimin libror.

Shqipja e sotme, si edhe çdo gjuhë tjetër e gjallë, është tërësi: a) variantesh historike, b) variantesh territoriale, c) variantesh stilistike dhe ç) variantesh shoqërore. Përkthyesi duhet të njohë mirë të gjitha këto larmi gjuhësore të dy gjuhëve të punës. Ai, si edhe çdo intelektual tjetër, duhet të njohë mirë gjuhën standarde, që është varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të qytetërimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar.

Gjuha standarde jeton e vepron në trajtën e stileve funksionale. Funkzioni dhe përshtatja e ligjërimin sipas veprimtarive njerëzore është kriter për dallimin e pesë stileve funksionale: stili i veprimtarisë shkencore e teknike, shtetërore e administrative, shoqërore e politike, stili i veprimtarisë letrare artistike dhe stili i veprimtarisë fetare. *Përkthyesi duhet të dijë karakteristikat e stilit të tekstit që përkthen.* Fjala vjen, po të dojë të përkthejë një tekst që i takon stilit shkencor, përkthyesi duhet të ketë parasysh se stili shkencor karakterizohet nga të shprehurit e drejtë logjik, nga saktësia e përdorimit të termave, nga qartësia e thënies etj. Tipike për të janë informacioni, logjika, objektiviteti dhe saktësia.

### 3. Mosrespektimi dhe mosnjohja e tjetrit

Maqedonia e Veriut është shtet shumënational e shumëgjuhësor, por etnitetet janë shumë të mbyllur në vete, kanë paragjykime për tjetrin që shprehet gjithkund, si në tekestet mësimore, në mjetet e informimit, në jetën e përditshme etj. Përkthyesi duhet të ketë njohuri të përgjithshme, të njohë shumë mirë gjuhën burimore dhe gjuhën e synuar së bashku me

kulturat që lidhen me to si dhe njohuri të thelluara në fushën që përkthen (ekonomi, drejtësi, letërsi, art, sport etj.).

Mbyllja vetëm në guackën e vet sjell izolim, mosnjohje të mjaftueshme të kulturës së tjetrit që ka për pasojë edhe probleme të shumta e të pakëpërçueshme përkthimore. Në këtë kuptim, nxënësit shqiptarë maqedonishten e kanë lëndë të domosdoshme dhe fillojnë ta mësojnë që nga klasa e tretë e deri në studime, ndërsa shqipja për joshqiptarët në R. e Maqedonisë së Veriut ka statusin e gjuhës fakultative vetëm në tri vitet e arsimit fillor (nga klasa VI-IX).

Të paktë janë joshqiptarët që përcaktohen të mësojnë shqipen (në shkollë, në kurse apo edhe në fakultet). Njohësit e mirë të shqipes me gjuhë amtare maqedonishten do të ishin më të suksesshëm në përkthimet nga shqipja në maqedonisht.

Do të ishte mirë që të ndiqen edhe te ne modelet më të mira të vendeve shumëgjuhësore, përkatësisht gjuha shqipe të jetë lëndë mësimore e domosdoshme edhe për joshqiptarët në arsimin parauniversitar.

#### **4. Mosnjohja e teorisë së përkthimit dhe mosmbështetja në praktikën e deritashme të përkthimit**

Të paktë janë ata përkthyes në Maqedoninë e Veriut që njohin si duhet teorinë dhe teknikën e përkthimit e të interpretimit, veglat teknike dhe aplikacionet ndihmëse. Zaten, nuk kemi as specialistë për të trajnuar studentët për këtë fushë. Nga ana tjetër, përkthimi e interpretimi nga shqipja në maqedonisht e në kahjen tjetër ka një traditë disavjeçare. Për shumë fjalë e terma tani më janë gjetur gjegjëset përkatëse, prandaj përkthyesit e sotëm duhet lexuar e parë për të zgjidhur mëdyshjet a hezitimet për ndonjë variant përkthimi.

Pra, për të lehtësuar punën, për të siguruar njëtrajtësinë e për të ndihmuar standardizimin e njërit nga variantet e mundshme përkthimore nga gjuha A në gjuhën B, përkthyesi duhet të mbështetet në praktikën përkthimore jo vetëm nga një gjuhë në shqip, po edhe nga gjuhët e tjera jo të punës.

#### **5. Mosinteresimi i institucioneve për të siguruar përkthyes të mirë**

Në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, kemi një katedër përkthimi e interpretimi me gjuhët e mundshme kombinimi: maqedonisht, anglisht, frëngjisht; si edhe në grupet përkatëse me programe të veçanta përkthimi. Në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare, ku edhe jam pedagog, kemi Grupin e përkthimit shqip-maqedonisht për a) studentë që shqipen e kanë gjuhë amtare dhe për b) studentë që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare.

Si punonjës i këtij institucioni lirisht mund të them se organet përkatëse nuk kanë bërë asnjë investim për të siguruar kushtet e nevojshme për punë të suksesshme: mungojnë pajisjet teknike, laboratorit i interpretimit, mospunësimi i kuadrit të specializuar, mungesa e literaturës së nevojshme, probleme të organizimit të punës praktike për përkthim e interpretim në institucionet përkatëse si dhe shumë probleme të tjera.

Problemet e përgjithshme në arsim, mosinvestimi e mosinteresimi i institucioneve përkatëse për traduktologjinë në Maqedoninë e Veriut, mungesa e programeve të mirëfillta të përkthimit, puna stihike pa planifikim e pa strategji zhvillimi ka sjellë shumë zbrazëtira në përgatitjen e studentëve që të integrohen në tregun e punës pas përfundimit të studimeve.

## **6. Mungesa e konsultimit dhe e punës ekipore në procesin e përkthimit**

Në praktikën e deritashme të përkthimit e të interpretimit shqip-maqedonisht e anasjelltas ka munguar konsultimi profesional si dhe puna ekipore. Kanë përkthyer shumëkush për arsye komerciale, me nguti, ndonjëherë pa e rilexuar e përmirësuar përkthimin, pa përvojën e kompetencën e nevojshme gjuhësore, pa konsultimin me profesionistë të fushës; pra përgjithësisht pa respektuar fazat e nevojshme të procesit të përkthimit. Kemi vetëm pak përkthyes të mirë shqip-maqedonisht e anasjelltas, por edhe më pak interpretues. Shumica e teksteve të përkthyer janë botuar e po botohen pa redakturë profesionale, redakturë gjuhësore, lekturë apo korrekturë.

Zaten, edhe teksti i shkruar në gjuhën amtare, qoftë edhe nga njohësit e mirë të gjuhës apo edhe shkrimtarët, duhet të rimerret disa herë për ta sjellë atë në nivelin e kënaqshëm. Në ligjërimin e shkruar ka kohë të gjatë të mendohet ajo që thuhet, të zgjidhet forma e shprehjes, të rishikohet ajo që është thënë, të ndreqet e të rregullohet.

Kontrollimi përfundimtar shërben si një provë e cilësisë së përkthimit, në veçanti nëse teksti është i qartë, i shkruar në shqipen standarde dhe që lexohet sikur të ishte hartuar fillimisht në gjuhën shqipe. Në të gjitha rastet kur përkthyesi ka dyshime të caktuara, ai duhet ta përgatisë një listë pyetjesh për redaktorët gjuhësorë dhe për ekspertët e fushës. Edhe pse të tre pjesëmarrësit kryesorë (përkthyesi, eksperti i fushës, redaktori gjuhësor) punojnë veç e veç në procedurën e përkthimit, rezultatet më të mira arrihen kur ka ndërveprim ndërmjet tyre.

## **7. Mosnjësimi (jostandardizimi) i shumë termave në shqipen**

Siç dihet, gjuhët kanë fjalë të përdorimit të përgjithshëm si dhe fjalë të specializuara në fusha të caktuara të veprimtarisë njerëzore, përkatësisht

terme (si p.sh. në mjekësi, jurispodencë, ekonomi, fizikë, matematikë, astronomi, art, sport,...). *Pjesa e leksikut të përgjithshëm mund të bjerë deri përgjysmë. Gjysma tjetër i takon leksikut shkencor.* Bërthamën e leksikut shkencor e përbëjnë termat. Ato kanë dallime nga fjalët e zakonshme, pasi në vend të kuptimeve (kuptimet janë një përgjithësim nga përvoja njerëzore dhe përcaktohen brenda sistemit gjuhësor) shënojnë nocione (nocionet janë rezultat i njohjes shkencore dhe përcaktohen në sistemin e secilës disiplinë).

Fjalët e përgjithshme, kur kthehen në terma, ripërkufizohen, si p.sh. uji për gjeologjinë është *mineral i lëngët, vetëtimat* ose *rrufetë* në gjuhën teknike njihen me termin *shkarkim elektrik*, shfaqje të elektricitetit; *ngjeshja* apo *fërkimi* i trupit në mjekësi njihet me *masazhë, verdhëza* në mjekësi emërtohet me *hepatit C, ndezja e mushkërive* me *bronhit e asmë, dhëmbi* në mjekësi njihet me termin *dentes, buzët* janë *labia*; në mjekësi thuhet *i sëmurë psikik* dhe në asnjë mënyrë *i çmendur, spital neuropsikiatrik* dhe jo *çmendinë* etj. Një pjesë e madhe e termave janë nga terminologjia ndërkombëtare.

Përkthyesit gjenden shumë më lehtë me leksikun e përgjithshëm, por kanë vështirësi të mëdha në përdorimin e termave. Terminologjia shqipe në disa fusha të veçanta ende nuk është konsoliduar sa duhet apo edhe nuk është standardizuar. Për shkak të specifikave të sistemit juridik, administrativ etj. në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut përdoren edhe terma të ndryshme që kanë kuptim të ngjashëm a të përafërt. Përkthyesi përballet edhe me këtë vështirësi të larmisë së përdorimit të termave, përkatësisht të mosstandardizimit të tyre në nivelin kombëtar. Njësimi i termave në shqipen mbetet si një ndër detyrat më të rëndësishme të planifikimit dhe të politikës gjuhësore mbarëkombëtare.

## 8. Mungesa e fjalorëve terminologjikë

Procesi i përkthimit kalon nëpër tri faza kryesore: faza e parë është leximi dhe analiza e tekstit; faza e dytë është evidentimi dhe paraqitja e termave dhe e nocioneve të panjohura, dhe faza e tretë është kërkimi i barasvlerësve. Studentëve dhe përkthyesve të rinj u rekomandohet që të ndjekin këtë rend pune dhe të mos nisin përnjëherë përkthimin mekanik. Përdorimi i termave është sfida më e madhe e përkthyesve.

Deri më tani janë hartuar disa fjalorë të leksikut të përgjithshëm shqip-maqedonisht e anasjelltas, ku mund të gjejmë të shënuar edhe ndonjë term. Janë botuar edhe disa fjalorë terminologjikë gjuhë e huaj-shqip e anasjelltas, por mungojnë fjalorët e mirë terminologjikë shqip-maqedonisht ose në kahjen tjetër. Për më tepër, përkthyesit nuk duhet të mendojnë se do të gjejnë gjithçka në fjalorë. Një fjalor i mirë duhet t'u përgjigjet kriterëve të besueshmërisë, dobisë dhe të jetë sa më shterues. Fjalorët e tillë janë të rrallë ndër ne.

Në kushte të tilla, përkthyesi duhet të jetë i përgatitur t'i përballojë problemet e reja e të shumta dhe nocionet e pahasura më parë. Përkundër përpjekjeve modeste të bëra në hartimin e fjalorëve terminologjikë për fusha të caktuara nga disa autorë, nuk ka përpjekje institucionale për hartimin e fjalorëve të këtij lloji në shqip. Hartimi i fjalorëve terminologjikë të shqipes është detyrë tjetër e rëndësishme në përballjen e shqipes me gjuhët e tjera dhe në sfidat që sjell procesi i globalizimit.

## **9. Na mungojnë përkthyesit e specializuar**

Si në çdo fushë të veprimtarisë, edhe në përkthim ka a) përkthyes të përgjithshëm dhe b) përkthyes të specializuar për një lëmi të caktuar (për fushën juridike, ekonomike, artistike, letrare, ...), që mund të jenë specialistë, ekspertë dhe mjeshtër përkthimi.

Është e udhës që përkthyesit të specializohen në një fushë ose në disa fusha të përafërta dhe të formojnë grupet e tyre të ngushta të komunikimit me ekspertë të fushës dhe me gjuhëtarë, në mënyrë që përkthimi të jetë cilësor dhe që të parandalohen problemet e mëvonshme që mund të shkaktohen nga një përkthim i pasaktë.

Aftësitë kryesore të një eksperti përkthyes janë: të qenët analitik, të ketë aftësinë e të menduarit kritik, të lexuarit ndërmjet rreshtave, të zotërojë mjetet gjuhësore të nevojshme për t'u shprehur saktë dhe drejt në secilën nga gjuhët e punës, mundësia për të kuptuar zhargonin dhe terminologjinë e përdorur në tekstin në gjuhën burimore dhe në gjuhën e synuar etj. Mjeshttrat përbëjnë grupin e elitës, gjykimet e të cilëve përcaktojnë rregullat, procedurat, standardet ose idealet.

## **10. Ngritja e një qendre për trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të shqipes**

Punën e lektorit të shqipes deri më tani e kanë kryer ata që kanë mbaruar fakultetin e gjuhës e të letërsisë shqiptare. Praktika ka dëshmuar se jo të gjithë kandidatët që marrin diplomën e këtij fakulteti janë edhe lektorë të mirë. Nuk kemi asnjë qendër për dhënien e licencës për lektor as në Shqipëri, as në Kosovë e as në Maqedoni. Për licencimin e lektorëve të maqedonishtes ka një qendër të tillë në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup. Lektorët e shqipes do të duhet të punojnë në çdo institucion ku përdoret shqipja ose së paku çdo shkrim në shqip, përfshirë edhe përkthimet, duhet doemos të kalojë nëpër duart e lektorit të licencuar.

## **11. Përkthyesit e mirë do të jenë shumë të kërkuar**

Në epokën tonë të telekomunikacioneve dhe të internetit, komunikimi shumëgjuhësh është përditshmëri jona. Globalizimi dhe përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për t'u bërë pjesë e NATO-s dhe e

Bashkimit Evropian, e bëjnë profesionin e përkthyesit shumë të kërkuar. Përkthimi nga maqedonishtja në shqip e anasjelltas është zgjeruar mjaft dhe do të zgjerohet edhe më tej me Ligjin për Zbatimin e Gjuhëve, me vajtje-ardhjet Shqipëri, Kosovë - Maqedoni, komunikimin dhe bashkëpunimin institucional të Maqedonisë së Veriut me Shqipërinë e Kosovën. Andaj, edhe pse tani përballen me shumë vështirësi, përkthyesit dhe interpretuesit e mirë do të jenë mjaft të kërkuar në tregun e punës.

Për të siguruar përkthime cilësore, përballjen e shqipes me gjuhët e tjera më të lëvruara do të na duhet shumë punë për të bërë. Këtë shqipe të fituar me gjak e me djersë duhet ta ruajmë edhe ne, si dhe t'ua lëmë trashëgim pasardhësve tanë, si elementin më të rëndësishëm të qenies sonë kombëtare. Po të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi ndaj paraardhësve tanë si dhe obligimin që kemi ndaj brezave që vijnë, do të dimë çfarë qëndrimi duhet të kemi e çfarë duhet të bëjmë për gjuhën shqipe. Nëse nuk mund të bëjmë më shumë për shqipen, atëherë së paku të mos e harrojmë, shpërfillim, përziejmë, shtrembërojmë, ndotim e prishim.

Kemi trashëgimi të pasur materiale e shpirtërore, të cilat duhet t'i ruajmë, t'i kultivojmë, t'i pasurojmë e t'i përditësojmë. Meqë kemi tokën tonë shumë pjellore (shqipen), të trashëguar për mijëra vjet nga paraardhësit tanë, atë duhet ta lëvrojmë, ta ujisim, mirëtrajtojmë e mirëmbajmë dhe toka jonë (shqipja) do t'i plotësojë të gjitha nevojat tona. Atë që do të na mungojë (e nuk mundemi pa të) do ta marrim nga të tjerët.

Do të jemi të hapur me të gjithë popujt, gjuhët e kulturat e botës. Për sa i përket terminologjisë, thotë prof. Gjovalin Shkurtaç, të gjitha gjuhët marrin terma e fjalë nga gjuhët e tjera, sidomos nga anglishtja dhe gjuhët e mëdha të Evropës, porse *shqipja po merr më shumë*. Një pastrim patjetër që mund dhe duhet të bëhet.

Në gjuhë, p.sh. përparësi duhet t'u japim elementeve anase të shqipes, mandej ndërkombëtarizmave si dhe huazimeve që tani më janë mishëruar në shqipen. Ka edhe shumë fjalë të huaja që nuk e kanë fituar ende statusin e qytetarisë (shtetësisë) në shqipen e që lehtësisht mund të zëvendësohen me fjalë që i ka ose me fjalëkrijime të reja.

Në gjuhësi janë të njohura rrugët e pasurimit të leksikut: nga leksiku popullor, nga veprat letrare, nga mundësia e pashtershme e krijimit të fjalëve të reja me brumin e vetë gjuhës e me mënyra të shumta fjalëformimi (me parashtesim, prapashtesim, parashtesim e prapashtesim njëherazi, nyjëzim, kompozim, përngjitje etj.). *Edhe përkthyesit e mirë mund ta pasurojnë shqipen me fjalë, shprehje, terma, frazeologji librorë e me struktura të reja sintaksore*.

Përkthyesi duhet ta bëjë punën në mënyrën më të mirë të mundshme, me shumë vullnet, përkushtim, ndërgjegje, kujdes e përgjegjësi. Përkthimi i keq sjell keqkuptim, mosmarrëveshje dhe e prish gjuhën;



ndërsa përkthimi i mirë sjell komunikim korrekt, mirëkuptim, harmoni e paqe midis njerëzve dhe e pasuron gjuhën.

Do të bëhen mjeshtër përkthimi ata që flasin dy gjuhë që në fëmijëri, do të përcaktohen që në rini për profesionin e përkthyesit, do të kenë arsim cilësor, do të arrijnë nivel të lartë kompetence gjuhësore të të dy gjuhëve, do të lexojnë e studiojnë me përkushtim, do ta duan këtë profesion fisnik, do ta kenë të zhvilluar të menduarit kritik e krijues, do të zotërojnë aftësinë e shkrimit akademik dhe do të jenë të gatshëm të përballen me të gjitha sfidat e kësaj veprimtarie intelektuale.

### **Literatura e konsultuar:**

Hajdari – Qamili, Ajten, *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018.

Hamiti, Asllan, *Leksikografia shqip-maqedonisht e anasjelltas*, Albanologjia 1-2/2014, Tetovë, 2014.

Hamiti, Asllan, *Niveli metodologjik i gramatikave të gjuhës shqipe*, Seminari XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2011.

Hamiti, Asllan, *Gjuha e teksteve shkollore të kimit të arsimit fillor në Maqedoni*, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë – Shkup, 3-4 tetor 2011.

Hamiti, Asllan, *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni*, Scupi 2, “Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare (Konferencë Shkencore, Shkup, 13. 06. 2012), Shkup, 2012.

Hamiti, Asllan, *Diglosia në Maqedoni dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe*, Kumtesat nga Konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës 2012”, mbajtur në Prishtinë, më 16-19. 05. 2012.

Hamiti, Asllan – Osmani, Ismet, *Për standardizimin e termave juridike e administrative në gjuhën shqipe*, Takimi XI vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca, Tiranë, 1-2 shtator, 2016.

Hamiti, Asllan, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Shkup, 2018.

Shkurtaç, Gjovalin, *Kultura e gjuhës*, ShBLU, Tiranë, 2006.

Shkurtaç, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip*, Toena, 2008.

Shkurtaç, Gjovalin, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, ShBLSh, Tiranë, 1988.

Shkurtaç, Gjovalin, *Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur*, ShBLSh, Tiranë, 1998.

Shkurtaç, Gjovalin, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003.

Shkurtaç, Gjovalin, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2, Tiranë, 2000.

Shkurtaç, Gjovalin, *Urgjenca gjuhësore*, Naimi, Tiranë, 2017.

Probleme aktuale të përdorimit të shqipes në “Argument” - 19.11.2019 në Televizionin e Maqedonisë TVM2, Programi në gjuhën shqipe.

## 7. REDAKTIMI PROFESIONAL DHE GJUHËSOR I PËRKTHIMEVE<sup>32</sup>

Dihet se procesi i përkthimit të tekstit, të redaktimit profesional dhe gjuhësor është punë intelektuale e vështirë dhe me përgjegjësi. Ky art i krijimit të tekstit në gjuhën e synuar (B) nga gjuha e burimit (A) duhet të kalojë nëpër tri faza kryesore: a) përkthimin, b) redaktimin profesional dhe c) reaktimin gjuhësor.

Me të drejtë thuhet se përkthyesi është krijues i dytë. Përkthimi i dobët e largon lexuesin nga vepra dhe nga autori. Redaktimi ashtu si edhe përkthimi është art më vete. Këtë veprimtari duhet ta bëjnë njerëzit profesionistë me bashkërendimin e punëve individuale ose punës në grup. Trajtesat e ndryshme të teorisë dhe të praktikës përkthimore, në lidhje me qëllimin kryesor të përkthyesit, në shumicën e rasteve, janë të një mendjeje se “përkthimi duhet të krijojë tek lexuesit e tekstit të përkthyer efekt sa më të afërt me atë të tekstit në origjinal.”<sup>33</sup>

Në këtë kumtesë, duke u mbështetur edhe në përvojën personale, do të shtjellojmë punën serioze e me përkushtim që duhet të bëjnë jo vetëm përkthyesi, por edhe redaktori profesional e ai gjuhësor. Prodhimi përfundimtar do të jetë cilësor nëse përkthimi do të kalojë nëpër të gjitha fazat e përpunimit të tekstit deri në botim.

Sa më i mirë të jetë përkthimi, aq më pak do të ketë nevojë për përmirësime redaktoriale dhe rrjeshimisht versioni përfundimtar i tekstit të përkthyer do të jetë i një niveli të lartë. Një përkthim i dobët vështirë se mund të ndreçet e të shndërrohet në tekst cilësor. Fjala vjen, Klodian Briçi është njëri ndër përkthyesit më të mirë në Shqipëri, me mbi 40 tituj letrarë të përkthyer nga anglishtja në shqip, shumica e të cilave janë kryevepra botërore, edhe pse ai gjatë punës nuk shfrytëzon fare teknologjinë informative. Në pyetjen e gazetares: A ka ndonjë teknikë apo strategji që e përdorni gjatë përkthimit dhe cilat janë mjetet kryesore që i duhen një përkthyesi mbi tavolinë për të bërë një përkthim?; ai përgjigjet: “Unë përdor shumë fjalorë anglisht-shqip (në të vërtetë të gjithë fjalorët e botuar). Kam tërë fjalorët për pastërtinë e gjuhës shqipe dhe disa fjalorë

---

<sup>32</sup> Kumtesë e prezantuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare në temën boshte “Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV”, Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve, Shkup, 20-23 shkurt 2020. Punimi është dorëzuar për botim në përmbledhjen e punimeve të Konferencës. Atë e gjeni edhe në <https://www.koha.mk/redaktimi-profesional-dhe-gjuhesor-i-perkthimeve/>

<sup>33</sup> Prof. Asoc. Dr. Viktor Ristani, *Comparative Translation*, University of Tirana, Tiranë, 2011.

([https://www.academia.edu/5840199/Krahasim\\_Perkthimi?auto=download&email\\_work\\_card=download-paper](https://www.academia.edu/5840199/Krahasim_Perkthimi?auto=download&email_work_card=download-paper)), shkarkuar më 15 shkurt 2020.

elektronikë anglisht-shqip, anglisht-anglisht... Një përkthyes s'është i tillë nëse ndërkohë s'lexon letërsi të përkthyer apo autoktone (vendase), pra duhet kulturë leximi. Duhet shfletuar edhe fjalorë shqip-shqip, fjalorë sinonimikë etj."

Në pyetjen: Çfarë këshillash mund t'ju jepni përkthyesve më të rinj?, Klodiani u përgjigj: "Këshilla për përkthyesit e rinj është: mësoni, studioni dhe jini vëzhgues të mirë. Përkthimi kërkon përkushtim, ndaj mos jini përtacë, por të papërtuar, kini dëshirën për të mësuar gjithnjë, sepse vetëm duke e parë veten nxënës të përjetshëm do të arrini të bëni punë. **Bashkëpunoni ngushtësisht me redaktorët** (dëgjojuani këshillat) se vetëm kështu mund të rriteni profesionalisht dhe para se të përktheni thojini vetes: Kjo vepër është në gjuhë të huaj, por unë duhet ta sjell në atë mënyrë sikur autori të jetë shqiptar dhe t'u flasë zemrave të shqiptarëve. Nganjëherë drejtojini pyetjen vetes kur përktheni: a shkon kjo shqip, a themi kështu?"<sup>34</sup>

Çdo shqiptar që di shkrim-lexim hutohet, nuk kupton, brengoset e nevrikoset kur lexon shkrime me shqipe të keqpërdorur e të gjymtuar si më poshtë:

*Tjhirrje publike në tre gazeta ditore dheil njëjti do të jet i hapur deri më 31 maj 2014. Për kohëzgjatjen e publikimit, së paku dy herë do të ketë lajmërim për punliku.*

*Ministria e Ekonomisë do të jep lajmërim , li cili do botohet në tre gazeta ditore, dh në televizionin kombëtar ,në këtë mënyrë të gjithë kërkesit do të ftohen,...*<sup>35</sup>



<sup>34</sup> Klodian Briçi: *Përkthimi kërkon përkushtim, ndaj mos jini përtacë, por të papërtuar, kini dëshirën për të mësuar gjithnjë, sepse vetëm duke e parë veten nxënës të përjetshëm do të arrini të bëni punë*, <https://tradita.org/2020/05/27/tradita-org-wp-a-phppost5087actionedit3/> Intervistoi: Besarta Ramadani, 27. 05. 2020, Kulturë, Shqipëri.

<sup>35</sup> Qamuran Ismaili, *Niveli i zbatimit të shqipes standarde në administratën publike në Shkup* (punim magjistrature i pabotuar, fondi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski"), Shkup, 2015, f. 71.



maqedonisht	shqip
ЛИЗГАВ ПОД	PLAKAT RRSHASIN
ЧЛЕН (во законот)	ANËTARI (për neni)
МАКЕДОНСКА ОПЕРА И БАЛЕТ	MAQEDONISHT OPERËS DHE BALETIT <sup>36</sup>
ЧУВАЈТЕ ГО ОВА МЕСТО ЧИСТО	MBAJTUR KËTË ZONË TË PASTËR
ФИЛИП II МАКЕДОНСКИ	FILIP I II-TË I MAQEDONISË
ПОПРАВАМЕ ЈАЗИЧНИ ГРЕШКИ	PËRMIRSOJM GABIME XHUHSORE <sup>37</sup>

Niveli gjuhësor i librave shkollorë të përkthyer nga maqedonishtja në shqip është mjaft i ulët. Përkthehen pothuajse të gjitha librat e arsimit fillor dhe të mesëm, përveç librave të gjuhës shqipe. Në pjesën dërmuese të këtyre librave gjejmë gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme, si:

- përkthim të fjalëpërfjalshëm me sintaksë të maqedonishtes;

<sup>36</sup> Ajten Hajdari - Qamili, *Perla gjuhësore*, Sak-stil, Shkup, 2018, f. 23.

<sup>37</sup> Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-stil, Shkup, 2018, f. 211.

- përdorimin e larmishëm, të panjësuar e të gabueshëm të termave;
- mospërdorimin me vend të emrave në rasa;
- përdorimin e shumë fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe;
- gabime kuptimore, aq sa në tekste shkollore mund të gjejmë edhe fjali me kuptime të errëta ose periudha të gjata e të pakuptueshme;
- po kështu, gjejmë edhe gabime të shumta drejtshkrimore, të natyrës fonetike e morfologjike, veçmas në përdorimin e ë-së, rr-së, y-së, q-së, gj-së etj.<sup>38</sup>

### **Edhe përkthyesi duhet të zotërojë artin e të të shkruarit**

Procesi i të përkthyerit është kompleks dhe secila fazë ka peshën e duhur dhe të pashmangshme. Përkthyesi është krijues i dytë i një vepre në bazë të një modeli. Për të qenë i suksesshëm ai duhet të ketë disa predispozita: të ketë kulturë të pasur leximi, kulturë të lartë gjuhësore, të jetë mendjemprehtë, kreativ, të njohë fushën që përkthen si dhe të zotërojë artin e të shkruarit. Praktika përkthimore në Maqedoninë e Veriut shfaqet me përplot probleme, parregullsi e anarki. Nuk dihet kush çfarë përkthen, si përkthen, me çfarë standardesh përkthehet, sa paguhet shërbimi?! ...

Standardi Evropian i Përkthimit EN 15038 është një praktikë profesionale shekullore në përkthim. Edhe në përkthimet që bëhen te ne nga shqipja në maqedonisht e anasjelltas medoemos duhet respektuar ky standard. Në të përshkruhet tërë procesi i përkthimit, me çka mundësohet ndjekja e procesit dhe sigurimi i cilësisë së përkthimit. Me dispozita të veçanta janë saktësuar kriteret dhe siguron identifikimin e ofruesve të vërtetë të shërbimeve cilësore të përkthimit (individë dhe persona juridikë).

Në të përcaktohen disa hapa në procesin e përkthimit:

- përkthimin,
- kontrollin nga përkthyesi,
- kontrollin nga një person tjetër (redaktor gjuhësor i përkthimit),
- redaktimin profesional të përkthimit shkencor apo redaktimin e përkthimit letrar, dhe
- verifikimin përfundimtar.

### **Procesi i redaktimit profesional dhe gjuhësor**

Redaktimi profesional është një kontroll njëgjuhësor për përshtatshmërinë e përkthimit me qëllimin e tij. Redaktori profesional kontrollon përshtatshmërinë e terminologjisë, regjistrin dhe respektimin e konventave në fushën përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, propozon masa korrigjuese.

<sup>38</sup> Asllan Hamiti, *Gjuha e teksteve shkollore të kimisë të arsimit fillor në Maqedoni*, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, 3-4. 10. 2011, Tetovë – Shkup, f. 47-51.

Puna e përkthyesit është e krahasueshme me punën e shumë profesionistëve të tjerë: ai bën kopje të origjinalit me material tjetër, ai është imitues. Bie fjala, përkthyesi ngjan me një rrobaqepës që qep një pallto me stofë tjetër, duke parë një pallto të gatshme që ka bërë dikush tjetër; sikur artari që ndreq një unazë floriri me ar tjetër sipas një unaze model. Kuptohet se i pari nuk mund të qep duke parë një model pa qenë rrobaqepës, i dyti nuk mund të ndreq unazë ari nëse nuk është artar ...

Përgjithësisht, procesin e kopjimit të origjinalit, të riprodhimit të tekstit në një gjuhë tjetër gjithnjë e shoqëron rreziku i shkrimit të tekstit sipas gjedhës së gjuhës nga e cila përkthejmë, veçmas nën ndikimet morfosintaksore dhe drejtshkrimore. Në përkthime, nga gjuha A në gjuhën B, bashkë me shumë huazime leksikore, barten edhe disa trajta gramatikore, renditja joshqipe e fjalëve në fjali dhe e fjalive në periudha, tejbarten shenjat e pikësimit, forma të huaja drejtshkrimore etj.

Shkalla e ndikimit të gjuhës së përkthimit në gjuhën e përkthyer është e ndryshme. Në përvojën e deritashme të redaktorit gjuhësor na ka qëlluar të lexojmë jo pak përkthime nga maqedonishtja në shqip. Ndonjë sosh përafrohej me natyrën e shqipes dhe s'do mend se duhej bërë më pak përmirësime; por na kanë rënë në dorë edhe përkthime të fjalëpërfjalshme, deri sa edhe grumbull fjalësh të pakuptueshme, aq sa na është dashur doemos ta konsultonim origjinalin, ndonjëherë madje edhe të përkthenim rishtas pjesë të caktuara. Ndonëse, sa herë që më është dashur të redaktoj gjuhësisht punën e një përkthyesi apo edhe të një teksti si krijim origjinal, jam menduar mirë përpara se të bëj ndonjë ndryshim. Gjatë redaktimit duhet respektuar motoja: „Nëse nuk është gabim, mos e ndrysho.“

Kjo është faza e ndarjes nga teksti origjinal dhe përafrimi me tekstin e synuar d.m.th. përkthimin. Faza e redaktimit është e domosdoshme për të gjitha llojet e teksteve, madje edhe për ato më të shkurtra dhe më të lehta për përkthim. Redaktimi përfshin ndreqjen dhe përpunimin e një shkrimi apo përkthimi për t'i dhënë trajtën përfundimtare para se të publikohet apo të botohet ai. Redaktimi mund të bëhet nga vetë përkthyesi ose nga individë të tjerë që janë ekspertë të njërës apo tjetrës gjuhë, apo njohës të dy gjuhëve.

Në radhë të parë, që redaktimi të jetë efikas, nëse bëhet nga vetë përkthyesi, nevojitet që të mbahet një distancë kohore nga teksti sapo i përkthyer, të lexohet sikur ta ketë shkruar dikush tjetër. Ekzistojnë edhe forma të tjera të distancës, që arrihen duke kaluar nga teksti i ekranit në tekstin në letër, duke e lexuar me zë të lartë, duke ia lexuar dikujt tjetër etj.<sup>39</sup>

<sup>39</sup> Ismail Hamiti, *Bazat e përkthimit dhe të interpretimit*, Art Print Studio, Shkup, 2020, f. 120.

Redaktimi është një proces rishikimi që ka të bëjë me anën gjuhësore dhe përmbajtjesore të një shkrimi. Redaktimi që ka të bëjë me anën shkencore, është *redaktim shkencor* dhe kryhet nga specialistë të fushës së cilës i përket shkrimi. Kjo është arsyeja pse duhet që shkrimin t'ia japim një kolegu më me përvojë (edhe të teksteve të shkruara në gjuhë burimore). Rishikimi i anës gjuhësore quhet *redaktim gjuhësor* dhe bëhet nga gjuhëtarë që duhet të jenë njohës shumë të mirë të gjuhës, me horizont të gjerë kulturor dhe me përvojë në fushën e letrave. Pas fazës së redaktimit, teksti duhet të kalojë edhe në *korrektim teknik* dhe *gjuhësor*. Korrektimi teknik ka si detyrë të kontrollojë paraqitjen pamore të shkrimit, ndërsa korrektimi gjuhësor ka si qëllim ndreqjen e gabimeve gjuhësore që kanë shpëtuar gjatë redaktimit ose gjatë thyerjes teknike të tekstit para botimit.<sup>40</sup> Me qëllim që ndreqjet e bëra në letër nga redaktori ose korrektori të kuptohen, duhet të përdoren disa shenja korrektimi të kuptueshme prej kujt do që hedhe ndreqjet në kompjuter, qoftë autori i shkrimit, qoftë dikush vjetër.<sup>41</sup>

Në redaktimit e përthimeve dallohen tre tipa redaktorësh. Të tre njësorj të vlefshëm. Në radhë të parë, redaktori i cili gjuhë amtare e ka gjuhën e tekstit burimor, por ka edhe njohuri të mira të gjuhës së tekstit të përkthyer: ky vë re struktura të tekstit nistor, për të cilat përkthyesi nuk ka treguar kujdes, i kap në ajër shprehjet frazeologjike edhe ato më pak të përdorurat, kupton pa vështirësi aludimet kulturore më pak të qarta.

Në radhë të dytë, redaktori, për të cilin gjuha amtare është ajo e tekstit mbërritës, por ka edhe njohuri të mira mbi gjuhën e tekstit burimor, dhe që mundësisht është vetë përkthyes. Ai i njeh mirë gabimet tipike, në të cilat bie përkthyesi dhe di të sugjerojë alternativa të tjera.

Në fund, por jo më pak i rëndësishëm, është redaktori që njeh vetëm gjuhën e tekstit mbërritës dhe nuk është përkthyes. Ky do të përqendrohet vetëm mbi produktin final të punës së përkthyer dhe do të dijë të dallojë pikat e errëta dhe hapat e vështirë të tekstit. Në këtë rast, teksti i korrigjuar nga redaktori i tipit të tretë i kthehet përkthyesit, që më pas ai të gjykojë dhe të vendosë nëse është i drejtë korrigjimi.<sup>42</sup>

Pikërisht për shkak të punës së vështirë që ka redaktori gjuhësor për të pastruar tekstin nga kjo ndikueshmëri e madhe e gjuhës së synuar (B) nga gjuha e përkthimit (A), me të drejtë thuhet se redaktimi është më i vështirë sesa përkthimi. Redaktimi duhet bërë për ndreqjen e tekstit deri në shkallën e përsosmërisë, në nivelin sikur teksti i përkthyer të jetë

---

<sup>40</sup> Rami Memushaj, *Shqipja standarde – Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Infbotues, Tiranë, 2017, f. 32.

<sup>41</sup> Shenjat më kryesore të korrektimit i gjeni te libri i sapocituar i prof. Rami Memushajt nga f. 33-36.

<sup>42</sup> Ismail Hamiti, *Bazat e përkthimit dhe të interpretimit*, Art Print Studio, Shkup, 2020, f. 121.

shkruar në atë gjuhë. Me fjalë të tjera, përkthimi duhet shqipëruar, d.m.th. teksti i përkthyer në shqip duhet sjellë në nivelin sikur ta ketë shkruar një autor shqiptar për lexuesin shqiptar.

Redaktorët gjuhësorë me përvojë përvijojnë disa hapa në procesin e redaktimit të tekstit, qoftë ai i përkthyer apo i shkruar në atë gjuhë. Në procesin e redaktimit është mirë që vëmendja të përqendrohet në disa çështje e veçmas:

Së pari, redaktori duhet të lexojë tekstin në tërësi. Ky lexim i parë i veprës e ndihmon redaktorin të hyjë në temë, të njihet me mënyrën dhe nivelin e përkthimit, të mirat apo mangësitë e tekstit, rrjedhshmërinë e mendimit, termet e përdorura, stilin etj.

Pasi të jetë lexuar gjithë vepra, gjatë redaktimit teksti duhet kundruar:

- 1) në pikëpamje kuptimore (semantike);
- 2) në pikëpamje gjuhësore dhe
- 3) në pikëpamje stilistike.

Nuk e shohim të arsyeshme në këtë kumtesë të shpjegojmë më hollësisht punën që duhet bërë për çdo fazë, por do të përmendim vetëm disa pika përqendrimi:

1) *Ana kuptimore:*

- a) pakuptueshmëria, keqinterpretimi, mungesë apo tepricë fjalësh e fjalish, periudha të ngatërruara e të gjata – periudha të kuptueshme e të shkurtra);
- b) përkthimi i gabueshëm i fjalëve (fjalë e qëlluar – fjalë e paqëlluar, sinonime, fjalë e huaj – fjalë shqipe, përdorimi i termave etj.).

2) *Ana gjuhësore* (morfosintaksore dhe drejtshkrimore):

- a) gabimet morfologjike: përdorimi i gabuar/me vend i rasave, kohëve të foljeve, shumësit të emrave, përshtatjes së gjymtyrëve të fjalisë, përdorimi i përemrave, mungesa apo përsëritja e panevojshme, ndikime morfologjike nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar etj.;
- b) gabimet sintaksore: lidhja e fjalëve në fjali, e fjalive në periudha e në paragrafë, ndërlidhja midis tyre; shmangia e sintaksës së huaj dhe zbatimi i rregullave të sintaksës së shqipes;
- c) përmirësimi i gabimeve drejtshkrimore: zbatimi a moszbatimi i rregullave të drejtshkrimit të shqipes, përdorimi i shkronjava të mëdha e të vogla, i shenjave të pikësimit, shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; por edhe mënjanimi i ndikimit ortografik të gjuhës nga e cila është përkthyer teksti.

3) *Ana stilistike:* teksti i përkthyer doemos duhet të tejbartë po atë stil që ka teksti i origjinalit. Fjala vjen, teksti që i përket stilit shoqëror-politik



duhet të përkthehet me të njëjtin stil; një vepër letrare përkthehet me stilin letrar artistik etj. Duke ngatërruar regjistrin e ligjërimit dhe stilin në një përkthim nga maqedonishtja në shqip na ka qëlluar të lexojmë përkthimin e termit 'член' me fjalën 'anëtar' në vend të termit 'nen'. Vërtet kur një maqedonas thotë 'член на семејството', të barasvlerëshme me këtë shqiptari e thotë 'anëtar i familjes' në ligjërimit bisedor e në ndonjë tjetër; por në stilin shtetëror-administrativ termi 'член' = 'nen' (neni x i Ligjit ...). Punë shumë e vështirë stilistike shfaqet sidomos në përkthimet dhe redaktimet letrare, veçmas të poezisë.<sup>43</sup>

Sigurisht, për vepra të vëllimshme e të rëndësishme është e udhës të formohen grupe punuese me përkthyes dhe redaktorë. P.sh. gazeta prestigjioze franceze "Le Monde" është e njohur për këtë. Përpara botimit gazeta kalon në shtatë grupe redaktoriale. Ndonjëherë mund të ketë mospajtime mendimesh lidhur me ndonjë çështje të caktuar. Në raste të tilla, përmes diskutimit, grupi i një niveli redaktorial arrin në një konsensus të përbashkët përse i përket terminologjisë, regjistrin të përdorur nga autori etj. dhe pastaj materiali i kalohet grupit të dytë e kështu me radhë. Redaktorët punojnë edhe duke e ndarë veprën në bazë të tematikës ku ata ndjehen më mirë. Ndarjen e punës e bën përgjegjësi sipas aftësive. Gjithsesi, çdo vepër e përkthyer duhet të ketë një përgjegjës a redaktor gjuhësor dhe redaktor profesional.

Në librin "Bazat e përkthimit dhe të interpretimit" Ismail Hamiti jep disa këshilla të vlefshme për të gjithë redaktorët aktualë dhe të ardhshëm:

*Kur bëni redaktim gjuhësor, duhet të keni parasysh:*

- që përkthimi të ketë kuptim;
- që të ketë rrjedhshmëri të natyrshme;
- që të jetë i shkruar në gjuhën e standardizuar, sipas rregullave gramatikore, me shprehje frazeologjike dhe fjalë të përshtatshme me situatat. Zakonisht, kjo bëhet duke u larguar nga teksti nistor, duke lexuar përkthimin sikur të mos ekzistonte origjinali;
- që versioni përfundimta i tekstit mbërritës t'i ngjajë tekstit burimor, por jo të jetë kalk i tekstit burimor, i shkruar në "përkthimisht", një lloj gjuhe e tretë;

<sup>43</sup> Funkzioni dhe përshtatja e ligjërimit sipas veprimtarive njerëzore është kriter për dallimin e pesë stileve funksionale: 1) *stili i veprimtarisë shkencore e teknike*, ku funksion mbizotërues është kumtimi; 2) *stili i veprimtarisë shtetërore e administrative*, ku funksioni i kumtimit bashkohet me funksionin parashkrues; 3) *stili i veprimtarisë shoqërore e politike*, ku funksioni i kumtimit gërshetohet me atë ndikues; 4) *Stili i veprimtarisë letrare artistike*, ku mbizotëron funksioni estetik; 5) *Stili i veprimtarisë fetare*.

- të bëni rishikimin e përkthimit, duke bërë kujdes për rrjedhshmërinë dhe natyrshmërinë e tij. Në këtë fazë teksti duhet t'i ngajë sa më shumë të jetë e mundur një teksti origjinal;
- në fazën e rishikimit, edhe pse është i domosdoshëm krahasimi midis origjinalit dhe tekstit të përkthyer për evidentimin e gabimeve eventuale, nevojitet që të rregullohet edhe këndvështrimi në gjuhën mbërritëse, dhe në fund;
- përkthimi i mirë, nuk duhet të duket si përkthim, por si krijim origjinal.

Për sa i përket kontrollit ortografik apo të drejtshkrimit, tani me përdorimin e kompjuterëve kjo gjë bëhet në mënyrë automatike me aktivizimin e këtij aplikacioni. Kjo gjë e ka lehtësuar shumë punën e korrektorit gjuhësor, por redaktimi gjuhësor e profesional i tekstit të përkthyer nga profesionistët edhe më tej mbetet i dobishëm, i nevojshëm dhe i domosdoshëm.<sup>44</sup>

### **Redaktimi gjuhësor dhe profesional është i domosdoshëm**

Jo vetëm teksti i përkthyer, por edhe shkrimet origjinale në gjuhë amtare duhet rilexuar, ndrequr e përmirësuar për ta sjellë në formën e duhur përfundimtare. Shumëkush mendojnë gabimisht se shkrimtarët apo përkthyesit janë njerëz që kanë prirje të madhe për të shkruar, prandaj nuk hasin në kurrfarë vështirësish gjatë hartimit a përkthimit të veprave. Mirëpo, ata që kanë pasur mundësi të gjurmojnë punën krijuese të shkrimtarëve, flasin ndryshe. Për kujdesin dhe mundin e tyre dëshmojnë shënimet e shumta që na kanë lënë shkrimtarët dhe versionet e shumta të veprave, deri në formën përfundimtare të tyre.

Të gjithë ata që kanë provuar të hartojnë madje edhe një tekst prej 5-6 rreshtash, qoftë edhe një shkresë të thjeshtë administrative, artikull gazetaresk, apo një punim të shkurtër do të pohojnë se nga forma e parë shkrimore e deri në formën përfundimtare duhet bërë shumë punë me përkushtim. Një praktikë e përmirësimit të veprave edhe pas botimit ndiqet me ribotime (deri më dhjetëra herë), duke përmirësuar ato jo vetëm në përmbajtje, por edhe në gjuhë e stil, duke hequr gjërat e panevojshme, përditësuar e ngritur cilësinë e veprës. Gjërat jo të mira mund të ndreqen, gjërat e mira mund të bëhen edhe më të mira.

Prof. Xhevat Lloshi në librin *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999 na sjell të dhëna shumë domethënëse për këtë çështje. Sipas këtij albanologu "Shumica e shkrimtarëve kanë mbajtur shënime në fletore të

---

<sup>44</sup> Ismail Hamiti, *Bazat e përkthimit dhe të interpretimit*, Art Print Studio, Shkup, 2020, f. 122-123.

veçanta, duke regjistruar me kujdes fjalë e fraza të ndryshme, të cilat i kanë dëgjuar në popull ose i kanë gjetur të shkruara nëpër libra, revista, gazeta etj., që dëshmojnë zellin e tyre në lëvrimin e gjuhës. Kështu, siç dihet, Maksim Gorki nuk e kishte dorëzuar një tregim në shtyp në kohën e paraparë derisa iu kujtua një fjalë e nevojshme që assesi nuk i kujtohej. Floberi shkruan se “po mbushet gati një muaj qyshkur po përpiqem të gjej katër fraza të shkreta që po më nevojiten.”

Balzaku në një letër pohon se “secilën faqe e kam shkruar nga 50 deri më 60 herë. Nuk ka asnjë tabak shtypi ndër veprat e mia, që të mos e kam korrigjuar nga 17, 18 apo 19 herë“. Gogoli, duke folur për punën e vet krijuese, shprehet se “së pari duhet të hudhen në letër që të gjitha, ashtu siç i bien ndërmend njeriut, qoftë edhe keq, turbull dhe duhet harruar ajo fletore. Pas një a dy muajsh, herë-herë edhe më tepër lipset të merret dhe të lexohet ajo që është shkruar: Do të shihni se shumë sende nuk qëndrojnë ashtu, se ka shumë gjëra të tepërta, e që aty-këtu mungon diçka. Bëni korrigjimet dhe vërejtjet në marginë dhe përsëri lëreni fletoren. Pas një kohe, këtë version kopjojeni me dorën tuaj. Gjatë kësaj pune vetvetiu do të lindin mendime të reja, shkurtime, shtesa, pastrimi i stilit, ndërmjet fjalëve të mëparshme do të lindin fjalë të reja, të cilat e kanë vendin aty medoemos, por që, nuk e di pse, nuk shfaqen menjëherë...”<sup>45</sup>

Shembujt e sjellë nga puna e kujdesshme që kanë bërë disa nga shkrimtarët më të mëdhenj botërorë na bëjnë shumë të qartë se sa herë që shkruajmë, qoftë tekste origjinale apo të përkthyer, duhet me patjetër që punën tonë ta rishikojmë disa herë, përkatësisht ta lexojmë me syrin kritik, ta rilexojmë sa më shumë aq më mirë, ta përmirësojmë e të shkrijmë gjithë dijen tonë.

Me fjalë të tjera, teksti i përkthyer së pari duhet të redaktohet nga vetë përkthyesi. Kuptohet se gjatë redaktimit, përkthyesi duhet të shfrytëzojë programin kompjuterik për përmirësimin e gabimeve drejtshkrimore, të konsultojë materiale të tilla a të ngjashme të botuara, të konsultojë nëse është nevoja edhe kolegë e profesionistë të fushës, fjalorë shpjegues, drejtshkrimorë, terminologjikë, dygjuhësh e shumëgjuhësh, fjalorë enciklopedikë etj.

Pasi ta ketë kryer me kujdes redaktimin të tekstit të përkthyer, materiali duhet lexuar, kontrolluar e përmirësuar nga një profesionist i fushës së lëmit të tekstit të përkthyer. Redaktori profesional është mirë të jetë specialist i fushës, ai që njeh mirë gjuhën e specializuar, përkatësisht termat përkatës. Fjala vjen, për një tekst të përkthyer nga maqedonishtja në shqip që i përket stilit shkencor, fushës së Të drejtës ndërkombëtare, redaktori profesional duhet të ishte jo vetëm jurist, por specialist i Të drejtës ndërkombëtare; për një tekst mësimor të përkthyer për shkolla të

<sup>45</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.

mesme të mjekësisë – redaktori profesional duhet të jetë së paku mjek etj. Të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore kanë ligjërimin profesional me përplot emërtesa. Vetëm specialisti njih mirë gjuhën e specializuar, përkatësisht termat. Siç kanë konstatuar stilistët, në stilin shkencor pjesa e leksikut të përgjithshëm mund të bjerë deri përgjysmë. Gjysma tjetër i takon leksikut shkencor.<sup>46</sup> Këtë leksik shkencor e njih mirë vetëm profesionisti i fushës. Sa parimore do të ishte kur mjeku flet për mjekësi, bujku për bujqësi, teologu për teologji...!<sup>47</sup>

Në praktikën e deritashme të përkthimit në Maqedoninë e Veriut përgjithësisht na ka munguar redaktimi profesional. Mendojmë se në të ardhmen tekstet e përkthyer medoemos duhet të kalojnë nëpër glosarin terminologjik të redaktorit profesional.

Pas redaktimit profesional, tekstit të përkthyer si edhe çdo teksti tjetër, duhet bërë një redakturë gjuhësore, shpeshherë të quajtur edhe lekturë ose korrekturë. Redaktori gjuhësor apo siç e quajnë edhe “rojtar” i rregullave gjuhësore<sup>48</sup> e ka për detyrë tekstin e përkthyer ta shqipërojë, përkatësisht ta sjellë në formën sikur të jetë shkruar drejtpërdejt në shqip. Ai duhet t’i bëjë të gjitha përmirësimet e nevojshme si dhe të kujdeset për tekstin edhe pas përpunimit teknik e deri në botimin përfundimtar. Gjuha e tekstit duhet kundruar e rregulluar në çdo pikëpamje: kuptimore, leksikore, morfosintaksore, stilistike, drejtshkrimore dhe se teksti i përkthyer është barasvlerës me origjinalin.

Praktikën e redaktimit profesional e gjuhësor e zbatojnë edhe shtetet e tjera të Evropës, përfshirë edhe vendet ballkanike. Po mjaftohemi me këtë rast të përmendim praktikën e kujdesit që tregojnë individët dhe institucionet për përdorimin e maqedonishtes standarde.

Këshilli për gjuhën maqedonase, që funksionon në kuadrin e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut në dhjetor të 2019 ka hartuar dhe dorëzuar për miratim po të njëjtit institucion një Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e maqedonishtes.<sup>49</sup>

Ligji i propozuar parashikon angazhimin ose punësimin e detyrueshëm të lektorëve të gjuhës maqedonase në të gjitha institucionet shtetërore e publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si në Qeveri, në

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> [http://infrastrukturerrugore.weebly.com/uploads/2/5/9/7/25973304/shkrimi\\_akademik\\_leksione.pdf](http://infrastrukturerrugore.weebly.com/uploads/2/5/9/7/25973304/shkrimi_akademik_leksione.pdf)

<sup>48</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip (Baza të shkrimit akademik, botimi III)*, Tiranë, 2013, f. 117-118.

<sup>49</sup> Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e maqedonishtes mund ta gjeni në linkun: [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=56281&fbclid=IwAR07k9k65M\\_W-PPGLigSDsq9NPOK6mGt7twxsUogVaqHBTB1sjwgQChMM8E](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=56281&fbclid=IwAR07k9k65M_W-PPGLigSDsq9NPOK6mGt7twxsUogVaqHBTB1sjwgQChMM8E)

Kuvend, në të gjitha ministritë, institucionet e qeverisjes lokale, universitetet, institucionet shkencore, shkollat e mesme dhe filloret, mediet dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera të jetës shoqërore të vendit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Me këtë propozim-ligj edhe mësimi i maqedonishtes është i detyrueshëm në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në dy semestra, që nuk ishte praktikë deritashme. Për herë të parë parashihen edhe ndarjen e bursave për studentët e gjuhës dhe letërsisë maqedonase në tri ciklet e arsimit të lartë (në studime themelore, master e doktorat) dhe në të gjitha universitetet e vendit.<sup>50</sup>

Me ndryshimet e propozuara ngritet, shtrihet, përforcohet e fuqizohet edhe më tej përdorimi i maqedonishtes standarde. Me këtë rast nuk e shohim të udhës të interpretojmë këtë ligj, por po sjellim vetëm disa përgjithësime që na u dukën më të rëndësishme për temën që po shtjellojmë:

- çdo tekst i shkruar me karakter publik (ligjet, shkresat, formularët, shtypi, propagandat, reklamata, shkrimi në ambalazhin e produkteve, mbishkrimet, tabelat, udhërrëfyesit, shenjat e trafikut, librat, punimet e magjistraturës, tezat e doktoratit e çdo gjë që ta sheh syri, qoftë edhe një fjalë apo një fjali e vetme) duhet shkruar në maqedonishten standarde dhe domosdoshmërisht duhet lekturuar;<sup>51</sup>

---

<sup>50</sup> Предлог закон: Лектори по македонски јазик во сите институции и задолжителен предмет на факултетите.

<https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelen-predmet-na-fakultetite>, 29. 12. 2019.

член 8<sup>51</sup>

(1) Задолжително се лекторираат на македонски стандарден јазик:

- рекламите на производите и услугите и плакатите на правните лица;
- називите и упатствата на производите, лекарствата, етикетите, фактурите, уплатниците и слично;
- сметките, потврдите и други информации на амбалажата на производите, лекарствата и слично;

(2) Во областите од ставот (1) на овој член, во кои македонскиот јазик се употребува истовремено со друг јазик, прво се употребува македонскиот јазик. Другиот јазик се употребува со иста големина и фонт како и македонскиот јазик.

член 9

(1) Македонскиот стандарден јазик се употребува во називите на улиците, плоштадите, мостовите и другите инфраструктурни објекти, патоказите, топонимите и сообраќајните знаци, називите на меморијалните споменици и спомен-обележјата, како и во натписите во средствата за јавен превоз и во јавните објекти.

- lekturimin duhet ta bëjnë lektorët e licencuar;
- në 20 vitet e fundit, që kur ka filluar zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Maqedonishtes, janë licencuar mbi 432 lektorë;
- Në këtë Ligj (me nenin 37) janë paraparë edhe gjoba për ata që nuk respektojnë dispozitat e tij. Përkatësisht, dënim në vlerë prej 500 deri më 2 000 eurosh në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit juridik, nëse:
  - nuk e përdor maqedonishten standarde;
  - nëse publikon tekst të palekturuar, ose
  - publikon tekst të lekturuar që nuk përmbush standardet e lekturimit.<sup>52</sup>

### **Përfundim me rekomandime**

Për të siguruar në të ardhmen tekste më cilësore të shkruara në shqipen standarde, përkthesit duhet ta bëjnë punën më me seriozitet, përkushtim e profesionalizëm. Tekstin e përkthyer duhet ta rimarrin disa herë për të dhënë një prodhim sa më të mirë.

Tekstet e përkthyer që i përkasin një fushe të specializuar të veprimtarisë njerëzore me patjetër duhet të kalojnë nën thjerrëzën e redaktorit profesional.

Të gjitha shkrimet në shqip me karakter publik (originale apo të përkthyer), doemos duhet lekturuar nga njohës të mirë të normave të shqipes standarde.

Për të siguruar këtë, si dhe përgjithësisht zbatimin Ligjin për përdorimin e shqipes në Maqedoninë e Veriut (në formën e shkruar dhe të folur) në çdo institucion, përveç përkthyesve nga shqipja në maqedonisht e anasjelltas, duhet punësuar lektorë të shqipes. Në mungesë të lektorëve të licencuar për shqipen (sepse nuk kemi institucion që jep licencë të tillë) detyrën e lektorit mund ta kryejnë të diplomuarit në Gjuhë e letërsi shqiptare (me notë mesatare mbi 8), po edhe magjistra e doktorë të gjuhësisë shqiptare.

### **Literatura e konsultuar:**

---

(2) Во називите од став (1) на овој член, називот на македонскиот јазик и неговото кирилско писмо се пишува прв, пред јазикот и писмото што го зборуваат најмалку 20 % од граѓаните во Република Северна Македонија, односно друг меѓународно прифатен јазик.

(3) Другиот јазик што се употребува истовремено со македонскиот јазик се употребува со иста големина и фонт како и македонскиот јазик.

(4) Називите од став (1) на овој член задолжително се лекторираат на македонски стандарден јазик.

<sup>52</sup> Влада на Северна Република Македонија, Министерство за култура на СРМ, Предлог на закон за употреба на македонскиот јазик, Скопје, декември 2019 г.

- Hajdari - Qamili, Ajten, *Perla gjuhësore*, Sak-stil, Shkup, 2018.
- Hamiti, Asllan, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-stil, Shkup, 2018.
- Hamiti, Asllan, *Gjuha e teksteve shkollore të kimsë të arsimit fillor në Maqedoni*, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë – Shkup, 3-4. 10. 2011.
- Hamiti, Ismail, *Bazat e përkthimit dhe të interpretimit*, Art Print Studio, Shkup, 2020.
- Ismaili, Qamuran, *Niveli i zbatimit të shqipes standarde në administratën publike në Shkup* (punim magjistrature i pabotuar, fondi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski”), Shkup, 2015.
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- Memushaj, Rami, *Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Infbotues, Tiranë, 2017.
- Shkurtaç, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip (Baza të shkrimit akademik, botimi III)*, Tiranë, 2013.
- Влада на Северна Република Македонија, Министерство за култура на СРМ, *Предлог на закон за употреба на македонскиот јазик*, Скопје, декември 2019 година.

### **Burime nga interneti:**

- <https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelien-predmet-na-fakultetite/>  
29. 10. 2019.
- Prof. Asoc. Dr. Viktor Ristani, *Comparative Translation*, University of Tirana, Tiranë, 2011. ([https://www.academia.edu/5840199/Krahasim\\_Perkthimi?auto=download&email\\_work\\_card=download-paper](https://www.academia.edu/5840199/Krahasim_Perkthimi?auto=download&email_work_card=download-paper))  
zbritur nga interneti 15 shkurt 2020.
- Klodian Briçi: *Përkthimi kërkon përkushtim, ndaj mos jini përtacë*, Tradita.org, <https://tradita.org/2020/05/27/tradita-org-wp-admin-post-phppost5087actionedit3/> Intervistoi: Besarta Ramadani, 27. 05. 2020, Kulturë, Shqipëri.
- [http://infrastrukturerrugore.weebly.com/uploads/2/5/9/7/25973304/shkrimi\\_akademik\\_leksione.pdf](http://infrastrukturerrugore.weebly.com/uploads/2/5/9/7/25973304/shkrimi_akademik_leksione.pdf)
- Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e maqedonishtes mund ta gjeni në linkun:  
[https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_re\\_g\\_detail&itemid=56281&fbclid=IwAR07k9k65M\\_W-PPGLigSDsq9NPOK6mGt7twxsUogVaqHBTB1sjwgQChMM8E](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_re_g_detail&itemid=56281&fbclid=IwAR07k9k65M_W-PPGLigSDsq9NPOK6mGt7twxsUogVaqHBTB1sjwgQChMM8E)
- Предлог закон: Лектори по македонски јазик во сите институции и задолжителен предмет на факултетите.
- [https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelien-predmet-na-fakultetite,](https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelien-predmet-na-fakultetite/)  
29. 12. 2019.

## 8. DITA NDËRKOMBËTARE E GJUHËS AMTARE<sup>53</sup>

Më 21 shkurt është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare. Çdo vit në mbarë botën mbahen manifestime për të promovuar nevojën e ruajtjes së gjuhëve amtare, vlerat e larmisë gjuhësore, kulturore dhe të shumëgjuhësisë. E drejta e përdorimit të gjuhës amtare, e shkollimit në këtë gjuhë, e ruajtjes nga zhdukja është një nga të drejtat themelore të njeriut. Por, për fat të keq, ne shqiptarët në përgjithësi, e veçmas në Maqedoni nuk ndërmarrim asgjë për të shënuar këtë ditë të rëndësishme, për të parë ç’kemi bërë, ç’po bëjmë e çfarë duhet të bëjmë në të ardhmen për gjuhën tonë amtare, që lidhet drejtpërdrejt me ardhmërinë tonë.

Siç dihet, gjuha amtare ka rëndësi për ruajtjen e identitetit kombëtar, për ruajtjen e historisë, të kulturës dhe përgjithësisht të trashëgimisë materiale e shpirtërore të kombit.

Bukuria e jetës është në larminë që ajo ka. Shumëllojshmëria e gjuhëve është e krahasueshme me shumësinë e gjuhëve. Ashtu si natyra që ka bukurinë e saj me lule llojesh të ndryshme, me mijëra ngjyrash, formash e aromash; ashtu edhe ligjërimi i njerëzimit ka bukurinë në varietetet gjuhësore e kulturore. Në këtë kuptim, gjuha amtare duhet mësuar, kultivuar e ruajtur. Nevoja e komunikimit me popuj e kultura të tjera e shtyn njeriun që të mësojë edhe gjuhë të huaja, por vendin e parë e zë gjuha amtare. Nga ana tjetër, sa më mirë e njohim gjuhën amtare, kulturën tonë; aq më mirë do të mësojmë gjuhët dhe kulturat e tjera.

### **Procesi i globalizimit rrezikon gjuhët e popujve të vegjël për t’u zhdukur**

Gjuhët janë si qeniet e gjalla. Ato lindin, zhvillohen, jetojnë, ndikojnë njëra në tjetrën e hyjnë në konkurrencë me gjuhët e tjera, disa përhapen e disa ngushtohen, të voglat mund të rrezikohen nga gjuhët e mëdha e të fuqishme, mund të humbin identitetin, të asimilohen e në fund edhe të shuhen krejtësisht. Më të rrezikuara janë gjuhët e etniteteve të vogla, që nuk formën e shkruar, që nuk kanë varietetin standard, që janë të kufizuara në përdorim e nuk janë gjuhë zyrtare a kombëtare.

Procesi i globalizimit (që nga forcat e mëdha çmohet si shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të lirë dhe për shoqërinë e hapur, për zbatimin e parimeve të demokracisë dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përmasa botërore), po bëhet rrezik për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë

<sup>53</sup> Artikull kushtuar Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, 21 shkurtit. Botuar në Faktinews.com, 21. 02. 2016, shkarkuar më 26. 06. 2020.



edhe më tej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Ajo edhe tani si gjuhë zyrtare ose gjysmëzyrtare përdoret në më shumë se 60 shtete, kurse vend të posaçëm zë edhe në 20 vende të tjera.

E gjithë bota e kulturuar kujdeset të mësojë anglishten; nga sasia e përgjithshme e informatave në kujtesën e sistemeve elektronike, 80% janë në anglisht. Nën ndikimin e anglishtes shkombëzohen gjuhë amtare. Mund të parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël. Sipas UNESCO-s mund të zhduken rreth 2.500 gjuhë nga 6.000 deri më 7.000 gjuhë që fliten në botë. Në 90 vitet e kaluara janë zhdukur rreth 200 gjuhë, ndërsa 199 i flasin më pak se dhjetë njerëz. Humbja e një gjuhe nënkupton në të njëjtën kohë edhe varfërimin e botës për një variant jetese: zhdukjen e një identiteti etnik, e një kulture, e një tradite gojore dhe përgjithësisht varfërimin e qytetërimit të përgjithshëm botëror. Dëmi nga zhdukja e gjuhëve për qytetërimit mund të krahasohet me dëmin e zhdukjes së specieve për biologjinë.

### **A rrezikohet shqipja për t'u zhdukur?**

Globalizimi dhe përhapja e anglishtes rrezikojnë shumë kultura dhe gjuhë të popujve të vegjël që të zhduken. Fatmirësisht, shqipja është gjuhë e gjallë. Ajo në vazhdimësi tokësore flitet nga miliona njerëz në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Preshevë e Bujanovc; në ngulimet shqiptare në Itali e Greqi si dhe në vendet e tjera të Evropës dhe pothuajse në gjithë botën, që kanë vetëdije të lartë kombëtare dhe që dinë rëndësinë e shqipes për ruajtjen e identitetit kombëtar. Shqipja ka variantin e folur dhe të shkruar, variantin dialektor e standard, me traditë shkrimi mbi 550-vjeçare, me arritje të lakmueshme në krijimtarinë letrare dhe përdorim zyrtar në rrafshin kombëtar. Ajo ka një strukturë fonetiko-fonologjike e gramatikore të qëndrueshme e të dallueshme nga gjuhët e tjera dhe leksik anas të pasur, të pasuruar edhe me shumë fjalë të huaja. Shqipja standarde ka arritur një shkallë të lartë të përpunimit e të modernizimit, e aftë për t'u përballur me gjuhët e tjera më të lëvruara.

Andaj, shqipja aktualisht nuk është futur në grupin e gjuhëve të rrezikuara. Përrjashtim bëjnë variantet arvanitase në Greqi, të cilat janë futur në kategorinë e "gjuhëve pothuajse të shuara" dhe variantet e arbëreshëve të Italisë, të cilat konsiderohen si "gjuhë të rrezikuara".

Megjithëkëtë, shqiptarët, gjuha shqipe në përgjithësi dhe shqipja standarde në veçanti janë përfshirë në procesin e globalizimit, në procesin e garimit, të ripozicionimit e të përshtatjes në rrethana të reja politike, ekonomike e kulturore në tri rrafsh: në rrafshin vendor, në rrafshin rajonal dhe në rrafshin global. Ndikimi i gjuhëve të huaja në takim, veçmas i anglishtes ndaj shqipes është shumë i madh. Trysni të mëdha mbi shqipen bëhen sidomos në fjalës, me futjen e fjalëve të huaja të panevojshme dhe në nxjerrjen nga përdorimi i fjalëve anase si dhe përdorimin e strukturave të

dëmshme sintaksore. Parimisht, sa më pak fjalë e struktura të huaja të përdorim në ligjërimin tonë, do të ishte aq më mirë.

Kjo na bën me dije se nuk duhet të rrimë duarkryq, por gjithnjë të punojmë për ruajtjen e pastërtisë së shqipes e të mbrojtjes së saj nga të gjitha rreziqet e mundshme të sotme dhe të planifikojmë për të ardhmen e saj.

Ashtu siç kemi strategji e politikë në të gjitha veprimtaritë njerëzore, si në fushën e ekonomisë, të shëndetësisë, të mjedisit etj., duhet të kemi edhe politikë e planifikim gjuhësor në të gjitha nivelet e organizimit shoqëror: në nivelin kombëtar, në nivelin krahinor, rajonal e deri në nivelin komunal e individual.

Planifikimi gjuhësor duhet parë si pjesë e planifikimit shoqëror. Ashtu si planifikimi shoqëror, që në përgjithësi është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave të zhvillimit për një shtet të caktuar, edhe planifikimi gjuhësor është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave gjuhësore për një bashkësi të dhënë.

### **Shqipja standarde duhet pasuruar, pastruar e modernizuar**

Gjuha shqipe në 34 vjetët e fundit ka shtuar rreth 40 mijë fjalë të reja. Kuptohet se këto fjalë të reja duhet përfshirë në fjalor. Duhet të thellohet puna për pasurimin, njësimin dhe kodifikimin e terminologjisë në të gjitha fushat. Në çështjen e normave drejtshkrimore lipset të përditësohen disa rregulla dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme, duke synuar njësimin dhe shmangien e përjashtimeve të shumta.

Në nxënien e shqipes në shkollë, në të gjithë hapësirën shqiptare, po shfaqen vështirësi dhe probleme, ndaj gjithandej propozohet të ngritet kultura e gjuhës, të përmirësohen programet mësimore, tekstet shkollore, të përdoren metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të bëhet aftësimi i mëtejshëm i mësuesve të gjuhës amtare etj.

### **Në Maqedoni na mungon planifikimi gjuhësor për shqipen**

Ajo po anashkalohet e po keqpërdoret nga institucionet e nga individë të caktuar. Kujtoj se është e udhës që te ne të zbatohen jo vetëm politika stimuluese, por edhe ndëshkuese. Pra, të rregullohet me ligj ndëshkimi i keqpërdorimit të shqipes.

Shqiptarët e Maqedonisë përgjithësisht njohin dhe përdorin *varietetin territorial* të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), *shqipen standarde* (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e informimit publik) si dhe *maqedonishten standarde* (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) shpeshherë ndodhin përzierje kodesh, situatë në të cilën asnjë gjuhë e përdorur vetëm, nuk do të ishte e mjaftueshme. Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor. Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen të ne nga maqedonishtja në shqip.

### **Masat që duhen ndërmarrë**

Për të përmirësuar këtë gjendje të pamirë, me pasoja të rënda për ardhmërinë tonë, duhet kushtrimuar të gjithë: familja, shkolla, institucionet shtetërore dhe gjithë shoqëria jonë. Çfarë masash duhet ndërmarrë:

1. prindërit duhet të kujdesen më shumë për arsimin e fëmijëve, për kulturën gjuhësore si dhe për kulturën e tyre të përgjithshme;
2. mësimdhënësit duhet të punojnë më me përkushtim, me zell dhe me metoda të reja ndërvepruese (interaktive) dhe të zbatojnë normat letrare;
3. të motivohen nxënësit e studentët për të lexuar sa më shumë vepra letrare me vlera;
4. të sigurohen tekste mësimore cilësore;
5. mjetet e informimit të jenë më të kujdesshme në zbatimin e normës gjuhësore, të emetojnë më shumë programe arsimore e edukative;
6. nga organet kompetente, të investohet më shumë në arsim;
7. të themelohet një Këshill për gjuhën shqipe që do të mbikëqyr, japë këshilla e sugjerime për problemet e zbatimit praktik të shqipes standarde;
8. të angazhohen njerëz kompetentë, lektorë të aftë e të zellshëm në organet e administratës shtetërore e publike, në redaksitë e mjeteve të informimit etj.;
9. kultura e gjuhës të jetë lëndë e domosdoshme në programet mësimore të të gjitha fakulteteve;
10. të organizohen seminare, takime pune, punëtori e kurse me arsimtarët, gazetarët, administratorët për të vetëdijësuar, përmirësuar e ngritur kulturën e tyre gjuhësore;
11. të ngrihet statusi zyrtar i shqipes nga gjuhë me përdorim të kufizuar në komunat me mbi 20% në gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë;
12. të rregullohet me ligj ndëshkimi i shkeljes së normës gjuhësore;
13. të ngrihet vetëdija jonë se ruajtja e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës, zbatimi i saj në praktikë është jo vetëm detyrë individuale e çdo shqiptari, por edhe detyrë kombëtare, sepse pastërtia e gjuhës është treguesi më i mirë i ruajtjes së pastërtisë së kombit. Nëse e ruajmë gjuhën, do ta ruajmë

edhe identitetin kombëtar. Po ta ndotim gjuhën, do ta ndotim edhe kombin. Po ta humbim gjuhën, do ta humbim edhe kombin.

Epoka jonë është epokë e ngritjes historike të popullit shqiptar, e pasurimit dhe e forcimit të identitetit kombëtar e gjuhësor. Ta ruajmë e ta modernizojmë gjuhën tonë, sepse ashtu do ta ruajmë e do ta pasurojmë identitetin kombëtar në këtë botë të globalizimit, që aq fort i kërcënon të veçantat etnike kulturore, që, megjithatë, përfaqësojnë pasurinë e planetit.

## II. KULTURË GJUHE, DIDAKTIKË

### 1. GJUHA NË MJETET E INFORMIMIT PUBLIK NË MAQEDONINË E VERIUT<sup>54</sup>

Kultura gjuhësore është pjesë përbërëse e kulturës së përgjithshme shoqërore dhe individuale. Shqipja standarde ka marrë një rrugë të mbarë të përsosjes së përhershme, pasurimit, herrjes dhe zhvillimit të hovshëm. Gjuha, siç dihet, është pasqyrë e kulturës dhe e të arriturave të gjithmbarshme të një populli, por edhe e çdo pjesëtari të tij. Ajo pëson ndryshime, zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Por, ky zhvillim i gjuhës varet prej njerëzve që e flasin atë. Gjuha standarde shqipe në Maqedoni po përdoret në institucionet arsimore, në mjetet e informimit, në veprat letrare e shkencore, në tekstet shkollore etj.

Mjetet e informimit, si shtypi ashtu edhe radioja e televizioni, kanë rëndësi të madhe jo vetëm si medime më masive të informimit publik, por edhe si mjete e burime për formimin gjuhësor të lexuesve, dëgjuesve dhe të teleshikuesve, meqë drejtpërdrejt ndikojnë për përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare të gjithë popullata shqiptare në Maqedoni e më gjerë. Prandaj, gjuha e gazetave, e radios dhe e televizionit duhet t'u përgjigjet rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore të shqipes standarde.

Marrë në tërësi, norma e shqipes standarde dukshëm po zbatohet në shkollat shqipe, në mjetet e informimit publik etj. Megjithkëtë, jemi dëshmitarë se në praktikën gjuhësore shpeshherë po thyhen normat në të gjitha rrafshet, si në rrafshin leksikor, sintaksor (si pjesë më të lëvizshme të gjuhës e më të eksponuara ndaj ndikimeve të huaja), në rrafshin morfologjik, fonetik e fonologjik etj. Disa gazetarë, redaktorë gjuhësorë, përkthyes, lektorë, korrektorë etj., nga pakujdesia, puna e ngutshme, joserioziteti në punë, papërgjegjësia ose nga mosnjohja e mjaftueshme e normave të shqipes standarde, bëjnë gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme.

#### **Shkaqet e thyerjes së normës drejtshkrimore e drejtshqiptimore**

---

<sup>54</sup> Punim i botuar në revistën shkencore Scupi 2, "Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare" (Konferencë Shkencore, Shkup, 13. 06. 2012)), ITShKSh, Shkup, 2012, f. 71-86.

Thyerja e normës ka shumë shkaqe. Gabimet rrjedhin ngaqë nuk njihen rregullat drejtshkrimore dhe fjala shkruhet sipas shqiptimit vetjak të individit. Ata që pohojnë pamjaftueshmërinë e strukturës dhe varfërinë leksikore të shqipes standarde, në të vërtetë nuk e njohin atë dhe parapëlqejnë një arsyetim të tillë. Përveç padijes e injorancës, ndër shkaqet kryesore të thyerjes së normës së shkrimit dhe të shqiptimit letrar janë:

- a) *veçoritë dialektore të folësit,*
- b) *ndikimi i gjuhëve të huaja në leksikon dhe në gramatikën e folësve,*
- c) *ligjërimi i shkujdesur, dhe*
- ç) *shqiptimi shkronjë për shkronjë i fjalëve të gjuhës së shkruar.<sup>55</sup>*

Për gjendjen e sotme të shqipes standarde shkaku i parë përbën problemin kryesor për vendosjen e normave të drejtshqiptimit dhe paraqet vështirësi më të mëdha për t'u kapërcyer.

Veçoritë dialektore të shqiptimit folësi zakonisht i mëson që në fëmijëri, prandaj duhet një punë e gjatë dhe këmbëngulëse për të shmangur ato dhe për të përvetësuar shprehitë e shqiptimit letrar. Te shumica e shqiptarëve ndihet nënshtresa e së folmes krahinore; për fat të keq disa as që bëjnë përpjekje për të njohur e zbatuar rregullat e shqiptimit letrar.<sup>56</sup> Pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972) e deri më tani u pa shumë qartë se si gjuha standarde shqipe, sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja gege, mëton ta zbatojë gjuhën letrare, porse me *një ngjyresë fonike gegizuese* (p.sh. shqiptimi i /ë/-së si /ê/: *bêj, nê:n, bêra, rêra, zêri* etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë "qethje" sado të pjesshme të bëra nga "Rregullat e drejtshkrimit", tërheq nga *hipertokizmi* (p.sh. shqiptimi me /ë/ të prapme i fjalëve me /e/: *vënt, kuvënd, mëndje, mëndoj, qëndër, fëmër, zëmër* etj).<sup>57</sup>

Përgjithësisht, në masën e gjerë të popullit shqiptar në Maqedoni ruhet mjaft mirë varianti dialektor, disa flasin një gjysmëdialekt, ndërsa pakkush në familje përdor shqipen letrare. Rëndom, në shkollë, në libra, në gazeta, në radio e televizion relativisht me sukses respektohen rregullat e gjuhës së sotme letrare shqipe, megjithëqë aty-këtu dëgjohej edhe një gjuhë gjysmëletrare. Por, jashtë institucioneve edhe disa të shkolluar në ligjërimin bisedor apo në të folurit e rëndomtë normës i kushtojnë pak vëmendje a flasin në mënyrë të shkujdesur. Në këtë stil tingujt shpeshherë rrëgjohen, shkurtohen, shkrihen, ndërrohen me ndonjë tingull tjetër apo

<sup>55</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia ...*, Shkup, 2005, 2011; f. 59.

<sup>56</sup> Emil Lafe, *Gjuha e medias sot – probleme ...*, f. 15.

<sup>57</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë, f. 39.

nuk shqiptohen fare.<sup>58</sup> Prandaj duhet një punë e gjatë dhe këmbëngulëse për të përvetësuar bazën nyjetimore të shqiptimit letrar.

Siç dihet, pjesa më e madhe e të folmeve shqipe në Maqedoni i takojnë grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore, me jo pak tipare fonetike-fonologjike, morfologjike e veçori të tjera të dallueshme nga gjuha e sotme letrare shqipe. Nga ana tjetër, edhe pse pranohet përgjithësisht se shtresën kryesore të shqipes standarde e përbëjnë elementet gjuhësore që janë të përbashkëta për të dy dialektet,<sup>59</sup> ajo në bazën e vet ka tiparet fonetike, fonologjike e morfologjike më qenësore të toskërishtes veriore, ndonëse nuk përputhet plotësisht me të, sepse ka tipare edhe të gegërishtes jo vetëm në sistemin leksikor, ku ato janë të shumta, por edhe në sistemin morfologjik e fonetik.<sup>60</sup>

Marrë në përgjithësi, baza nyjetimore e të folmeve të individëve pasqyrohet edhe në stilin letrar të ligjërimit të tyre. Në një shtjellim përmbledhës, siç është ky yni, nuk mund të përshkruhen të gjitha këto, por po përmendim disa që mendojmë se janë më të shprehura:

a) Zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/: *di* (< dy), *si* (sy), *ill* (< yll), *arsie* (< arsye), *ngji:r* (< ngjyrë), *indir* (< yndyrë), *gjism* (< gjysmë), *qimir* (< qymyr) etj. Format me diftongje dytësore rëndom nuk pasqyrohen as në ligjërimit letrar të folësve të Maqedonisë.

b) Humbja e opozicionit fonologjik ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëse /r/: Ngjashmëria nyjetimore dhe ngarkesa e vogël funksionale ka mundësuar rrafshimin e kundërvënieve fonologjike të bashkëtingëlloreve /r/ dhe /rr/ në disa të folme tona. Mirëpo, këto bashkëtingëllore në gjuhën shqipe janë dy fonema të veçanta, gjë që provohet me çifte minimale fjalësh të tilla, si *ara ~ arra*, *ruaj ~ rruaj*, *rasë ~ rrasë*, *deri ~ derri*, *rimë ~ rrimë* etj. Marrë në tërësi, si në gazeta, ashtu edhe në radio e televizion përdoren fjalë vetëm me /r/ edhe pse sipas rregullave duhej të kishin /rr/, si: *rafsh*, *ri*, *rit*, *rjedh*, (*i*, *e*) *rallë*, *reth e rotull*; *karige*, *përall(ë)*, *qere*, *haroj*, *ndëroj*, *ngatëroj*; disa huazime kryesisht nga gjuhët romane: *barikad(ë)*, *karier(ë)*, *korekt*, *koridor*, *teritor*; *andër*, *kokër*, *mor*, *obor*, *vjehër*, *zjar* etj.

<sup>58</sup> Në gjuhën letrare dallohen dy stile shqiptimi: stili i plotë dhe stili jo i plotë. Stili i plotë është karakteristik për ligjërimit letrar libror. Përdoret në rastet kur përpiqemi të flasim me përpikmëri sipas normave të gjuhës standarde (p.sh. në shkollë, në kongrese, në konferenca, në mjetet e informimit etj.). Ky stil shqiptimi, i cili lidhet drejtpërdrejt me gjuhën e shkruar, karakterizohet nga artikulimi i mirëfilltë i tingujve, nga shqiptimi i tyre i plotë, pa i rrëguar, pa i shkurtuar, pa i ndërruar dhe pa i shkrirë ata.

<sup>59</sup> *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, I, Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 145.

<sup>60</sup> Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 199.

c) Mospërdorimi i glotales [h], si në fjalët *ple* (< pleh), *aër* (< ahur) etj. Kjo dukuri shprehet edhe në emrat e njerëzve: *Isen* (< Hysen), *Asan* (< Hasan), *Alit* (< Halit), *Raman* (< Rrahman), *Memet* (< Mehmet) etj.

ç) Mosshqiptimi i [ë]-së së patheksuar fundore dhe në trup të fjalës.

d) Shqiptimi i pavend i [ë]-së fundore te disa gazetarë. Për arsye të ndryshme, veçmas nga prirja për një korrektësi të tepruar, kryesisht duke i prapavënë çdo fjale nga një [ë] fundore ose nën ndikimin e ligjërimeve dialektore toske në disa raste shqiptohet dhe shkruhet gabimisht një [ë] e tepërt, e panevojshme. Khs. *Kamë shkuarë në qytetë dhe kamë parë një shfaqje në teatrinë...* Kjo [ë] fundore as nuk duhet shqiptuar dhe as nuk duhet shkruar.

dh) Përveç përdorimit të tepruar të [ë]-së, rëndom duke e shqiptuar atë në fundin e çdo fjale, shkrimi e shqiptimi i gabuar i [ë]-së vihet re edhe: tek emrat që në shumësin e pashquar dalin me bashkëtingëlloret *-/q/* ose *-/gj/* të prirë nga një zanore, si *zogjë,-t*, *zogjësh*, *fiqë,-t*, *fiqësh*, *pleqë,-t*, *pleqëve*, *pleqësh* etj. (ndërsa duhet shkruar e shqiptuar *zogj,-të*, *zogjsh*; *fiq,-të*, *fiqsh*; *pleq,-të*, *pleqve*, *pleqsh* etj.); tek emrat që në shumësin e pashquar dalin më *-/j/*, *-/nj/*: nganjëherë shkruhen e shqiptohen gabimisht fjalët *bijë,-t*, *bijëve*, *bijësh*, *ftonjë,-t*, *ftonjëve*, *ftonjësh*, *heronjë,-t*, *heronjëve*, *heronjësh*, *thonjë,-t*, *thonjëve*, *thonjësh* etj. (kurse duhet shkruar e shqiptuar: *bij,-të*, *bijve*, *bijsh*; *ftonj,-të*, *ftonjve*, *ftonjsh*; *heronj,-të*, *heronjve*, *heronjsh*; *thonj,-të*, *thonjve*, *thonjsh* etj.).

e) Nën ndikimin e shqiptimit dialektor, ndonjëherë përdoret një [ë] metatetike: në vend që të përdoret sipas normës me *-të*, përdoret me *-ët*; apo sipas rendit të duhur *-më*, shqiptohet a shkruhet në interverzion me *-ëm*: *cjepët* (< cjeptë), *deshët* (< deshtë), *djemët* (< djemtë), *dhenët* (< dhentë), *qenët* (< qentë) etj.

ë) Shqiptimi më i përparmë e ndonjëherë edhe afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh]: *çaf* (< qafë), *çilim* (< qilim), *çiri* (< qiri), *çi:ll* (< qiell); *xhak* (< gjak), *xha:sht* (< gjashtë), *xhu:m* (< gjumë) etj.

f) Këmbimi i [h]-së me [f]-në në grupin *ht*: *ftoft* (< ftohtë), *i ftoft* (< i ftohtë), *i ngroft* (< i ngrohtë) etj.

g) Ndërrimi i [nj]-së në [j], si p.sh. *zo:j* (< zonjë), *pej* (< penj), *e ejte* (< e enjte), *i shtre:jt* (< i shtrenjtë) etj.

gj) Monoftongimi i grupeve të zanoreve */ie/* dhe */ue/* në */i:/*, respektivisht */u:/* të gjata: *di:ll* (< diell), *mi:ll* (miell), *kam punu:* (< kam punuar) etj.

h) Në mediumet e shkruara hetohet ndarja e gabueshme e fjalëve në fund të rreshtit, saqë shpeshherë edhe dyshkronjëshat i gjejmë të ndara.



i) Trajta e shkurtër e bashkuar e kallëzores *ma* (më + e) ndonjëherë ndahet me apostrof (m'a), ndërsa ato që duhet të ndahen me apostrof: *m'i* dhe *t'i* shpeshherë shkruhen bashkë.

**Jo rrallë hetohen edhe shkelje të normës morfologjike e sintaksore (normës morfosintaksore).** Si p.sh.:

a) emrat e huaj vetjakë, si *Tramp, Ollbrajt, Bler* etj. po përdoren në formë të ngurosur, edhe pse funksioni i tyre sintaksor në shqipen kërkon që të jenë në formë të caktuar rasore (në trajtën e pashquar ose në trajtën e shquar): *u takua me Trampin*;

b) mosdallimi i gjinisë së përemrave vetorë të vetës së tretë të numrit shumës *ata* dhe *ato*: *ata burra* dhe *ata gra* ose *ato burra* dhe *ato gra* (për të dy gjinitë);

c) përdorimi i formës së shumësit pa /ë/ fundore, si *shqiptar* (në vend *shqiptarë*), *arsimtar* (në vend *arsimtarë*) etj.;

ç) në vend të përemrave vetorë *ne, ju* përdoren trajtat e tyre të dhanores *neve, juve* (*neve* kemi punuar, *juve* jeni të zellshëm);

d) gabime në përdorimin e nyjës së rasës gjinore: Ministri i Punëve të jashtme *të* Maqedonisë (në vend *i* Maqedonisë);

dh) përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë që e formojnë shumësin me *-e* dhe *-ra* etj.

Folja, pas emrit, është një nga klasat më të mëdha të fjalëve në leksikun e gjuhëve. Emri në shqipen zakonisht na del në 8 forma paradigmatiche (në numër, shquarsi, rasë: laps, lapsi, lapsit, lapsin, lapsa, lapsat, lapsash, lapsave). Folja në shqipen shfaqet në 251 forma paradigmatiche (në mënyrë, kohë, vetë, numër, diatezë). Në këtë pikëpamje shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve që ka jo vetëm sasi të madhe foljesh, por edhe forma të shumta, aq sa vështirë se ia gjen shoqen. Ky numër shumë i madh i foljeve dhe sidomos paradigma foljore shumë e pasur në forma e bëjnë shumë të vështirë një administrim të rreptë të këtij sistemi prej folësve.<sup>61</sup> Prandaj, shpeshherë lexojmë ose dëgjojmë forma jostandarde foljesh, sidomos forma krahinore e dialektore të folësit. Ndër përdorimet e tilla jonormative më të shpeshta te ne janë:

e) përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën *të* (*do lexoj, do punoj*; në vend *do të lexoj, do të punoj*).

<sup>61</sup> Rami Memushaj, *Studime gjuhësore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, IGjL, Tiranë, 2017, f. 47.

ë) e pakryera veprorë e foljeve ndonjëherë dëgjohet e shkruhet në formë sigmatike (punojshna, punojshe, punojke, punojshmi, punojshi, punojshin) në vend të formës standarde josigmatike (punoja). Nën ndikimin e formave dialektore të gegërishtes edhe në ligjërimin letrar po përdoret jorrallë e pakryera analitike e formës pësore (u lajshna, u lajshe, u lajke) në vend të formës sintetike (lahesha, leheshe, lahej). Herë-herë mund të dëgjojen e lexohen pjesoret e foljeve të gegërishtes, siç quhen format e cinguara, pa mbaresa: (kam) *lexu:, shku:, shkru:* etj.

f) në analogji me foljet e zgjedhimit të parë, edhe foljet e zgjedhimit të tretë disa herë si në të folurit ashtu edhe në të shkruarit përdoren jo sipas rregullave gramatikore (pa mbaresa vetore në numrin njëjës në kohën e tashme të mënyrës dëftore), por me mbaresa në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit, si (ti, ai, ajo) *din, pin, han, flen* (< di, pi, ha, fle) etj.

g) në gjuhën e sotme letrare shqipe ka disa fjalë me rrënjë të përbashkët që përdoren herë si mbiemra të nyjshëm e herë si ndajfolje. Në të shkruar mbiemrat përdoren me /ë/, ndërsa ndajfoljet pa /ë/, si *i drejtë - drejt, i shpejtë - shpejt, i plotë - plot, i lartë - lart, i kotë - kot* etj. Mbiemrat dhe ndajfoljet e tilla dallohen edhe në shqiptim, meqë zanoret e theksuara te mbiemrat gjithnjë shqiptohen si më të gjata sesa zanoret përkatëse te ndajfoljet. Në ligjërimin e mjeteve të informimit në Maqedoni këto forma fjalësh shpeshherë ngatërrohen, duke u përdorur njëra në vend të tjetrës. P.sh. Ai është njeri *i drejt* dhe flet *drejtë* (< Ai është njeri *i drejtë* dhe flet drejt). Ajo punë është *e kot*, prandaj mos u mundo *kot* (< Ajo punë është *e kotë*, prandaj mos u mundo *kot*) etj.

gj) Siç dihet, është rregull që disa përemra pronorë të përdoren pa nyjë të përparme në të gjitha trajtat, ndërsa disa të tjerë me nyjë të përparme [e (të) mi, e (të) tu, e (të) tua, i (e, të) tij, i (e, të) saj, i (e, të) tyre, i (e, të) tyre, i (e, të) vet]. Përemrat pronorë *im, ime, yt, jote, ynë, jonë, juaj* sipas rregullave nuk marrin asnjëherë nyjë të përparme. Trajatat me nyjë të përparme që shkruhen e dëgjojen herë-herë janë forma dialektore. Pra, duhet shkruar e thënë: *libri im* (dhe jo: libri i im), *ky libër është imi* (jo: ky libër është i imi), *flatorja ime* (jo: fletorja e ime), *kjo fletore është imja* (jo: kjo fletore është e imja), *djali yt* (jo: djali i yt), *yti është ky laps* (jo: i yti është ky laps) etj.

h) Mjaft shpesh gabohet në përdorimin e formës standarde të lidhores, sepse ose në vend të /ë/-së përdoret /e/-ja ose pjesëza të + forma e mënyrës dëftore e kohës të tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh. (duhet) *të shkoje* ose *të shkon, të punoje* ose *të punon, të mësoje* ose *të mëson* (< duhet të shkojë, të punojë, të mësojë) etj.

i) Në prirjen për rrafshimin e formave edhe foljet apofonike (me këmbimet e fonemave /a/ ose /je/ në /o/) në kohën e kryer të thjeshtë dhe

në pjesore shpeshherë përdoren gabimisht. Bie fjala, forma jonormative janë: *mjel - mjela - (kam) mjelur*; forma normative janë: *mjel - mola - (kam) mjelë*; jonormative: *vjel - vjela - (kam) vjelur*; normative: *vjel - vola - (kam) vjelë*; jonormative: *mbjell - mbjella - (kam) mbjellur*; normative: *mbjell - mbolla - (kam) mbjellë*; jonormative: *sjell - sjella - (kam) sjellur*; normative: *sjell - solla - (kam) sjellë* etj.

Ndonjëherë vërehen **ndikime të sintaksës së huaj** në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku pështjellohet mendimi deri në moskuptim.

Shkelje të normave të shqipes standarde paraqet edhe përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja. Siç dihet, varësisht nga shtrirja gjeografike, përkatësia administrative nëpër disa shtete ballkanike, kontakti shumëshekullor përfshirë lidhjet historike, ekonomike, kulturore me gjuhë të tjera etj., ka laramani sasiore të huazimeve leksikore nëpër të folmet shqipe. Thënë ndryshe, si në shqipen me vazhdimësi tokësore e gjuhësore, ashtu edhe në shqipen e diasporës diku ka më pak e diku më shumë fjalë të huaja: greke, turke, sllave, neolatine etj.

Disa nga këto fjalë të huaja janë mishëruar thellë në të folmet e shqipes, kanë përhapje të përgjithshme në tërë shqipen dialektore. Një numër i konsiderueshëm fjalësh të tilla janë bërë edhe pjesë e leksikut të gjuhës standarde shqipe. Këto më vështirë zëvendësohen me fjalë të shqipes, edhe pse ekziston një mundësi e tillë. Por, ka edhe të tilla që kanë përhapje të ngushtë territoriale (në një krahinë, në një grup të folmesh, në disa të folme, në një të folme). Fjalët e këtilla nuk janë të pranueshme për normën leksikore letrare. Përveç ndikimit të vijueshëm të italishtes (sidomos në Shqipëri), kohët e fundit në shqipen letrare vërehet një ndikim gjithnjë e më i madh i anglishtes. Rritja e numrit të fjalëve nga anglishtja dhe në përgjithësi e fjalëve të huaja është thyerje e normës leksikore e stilistikore të shqipes.<sup>62</sup> Parimisht, sa më pak fjalë të huaja të përdorim në ligjërimin tonë, do të ishte aq më mirë.

Për ta parandaluar përmytjen e shqipes me fjalë e me gjedhe të huaja, duhet të kushtrimohen të gjithë përdoruesit e kësaj gjuhe, në radhë të parë gazetarët, publicistët, shkrimtarët, shkencëtarët, profesorët, arsimtarët, studentët, nxënësit etj., që t'u vënë pritë fjalëve të huaja të panevojshme dhe formimeve të tjera të çoroditura... Në shqipen e sotme të intelektualizuar veprojnë dy forca çekuilibruese: folësi ka prirje të përdorë sa më shpesh fjalë të huaja dhe të përsërisë të njëjtat fjalë, kurse dëgjuesi si

<sup>62</sup> Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 92-100.

rregull i përgjithshëm, kërkon qartësi sa më të madhe dhe variacion sa më të madh të fjalorit.<sup>63</sup>

Procesi i globalizimit (që nga forcat e mëdha çmohet si shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të lirë dhe për shoqërinë e hapur, për zbatimin e parimeve të demokracisë dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përpjesëtime botërore), po bëhet rrezik për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë edhe mëtej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Ajo edhe tani si gjuhë zyrtare ose gjysmëzyrtare përdoret në më shumë se 60 shtete, kurse vend të posaçëm zë edhe në 20 vende të tjera. E gjithë bota e kulturuar kujdeset të mësojë anglishten; nga sasia e përgjithshme e informatave në kujtesën e sistemeve elektronike, 80% janë në anglisht. Nën ndikimin e anglishtes shkombëzohen gjuhë amtare. Mund të parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël.<sup>64</sup>

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut janë dygjuhësorë: përveç gjuhës amtare dinë edhe maqedonisht e ndokush edhe turqisht ose ndonjë gjuhë tjetër. Maqedonishtja ka qenë dhe sot e kësaj dite është gjuhë zyrtare, gjuhë e shkollimit sipëror të një numri të konsiderueshëm shqiptarësh, gjuhë që krahas gjuhës amtare zhvillohet në shkollat fillore e të mesme që nga klasa e tretë. Ajo ka përhapje shumë më të madhe se gjuha shqipe në mjetet e informimit, në jetën publike, shoqërore, sportive, administrative e shoqërore. Në këtë gjendje diglosie janë huazuar shumë sllavizma, konstrukte fjalësh, janë krijuar kalke e sintaksa e ligjërimit shqip në Maqedoni është vërshuar nga renditja e natyrës sllave. Edhe pse parimisht shumica e gazetarëve shqiptarë përpiqen ta ruajnë natyrën e shqipes, duke respektuar parimin sa më pak fjalë e ndërtime të huaja në ligjërimit tonë, është aq më mirë; megjithkëtë ndikime nga maqedonishtja hetohen mjaft shpesh.

Një dukuri shumë e përhapur në gjuhën e mjeteve të informimit në Maqedoni është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i disa fjalive, togfjalëshave e shprehjeve, me fjalë e shprehje sipas gjedhës së huaj. Në pjesën më të madhe të rasteve përdoret gabimisht ndonjë fjalë në vend të fjalës përkatëse që përdoret në mbarë shqipen, si “zbardh” në vend “ndriçoj”: *Duhet të zbardhet rasti* (< Duhet të ndriçohet rasti) nga maq. Treba da se obellodeni sluçajot. *Thirrem* në vend “mbështetem”: *Duke u thirrur në...* në vend Duke u mbështetur, duke u bazuar, në bazë të, sipas etj. Po kështu, e

<sup>63</sup> Dr. Qemal Murati, *Gramatika e gabimeve - Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*, Shkup, 2000.

<sup>64</sup> Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 31-36.

gabueshme është edhe shprehja “*ndaj mendimin me ...*” në vend “pajtohem me mendimin e ...”

Një dukuri e shpeshtë në mjetet e informimit në gjuhën shqipe në Maqedoni është shprehja “*vjen deri te*” që është kalk nga maqedonishtja e serbishtja “*doagja do*” si në fjalinë *Nëse vjen deri te lufta në Irak*, për Nëse sulmohet Iraku. Një ndikim tipik është edhe përdorimi i ndajfoljes “*gjatë kohë*” kalk nga “*dollgo vreme*” në vend të shprehjes “për një kohë të gjatë”. Formë e papranueshme është edhe kalku “*në pyetje është*” nga “*maq. vo prashanje e*” në vend që të thuhet “*fjala është për, bëhet fjalë për*” ose *kjo është pyetje e rëndësishme* nga “*maq. ova e značajno prashanje*” në vend që të thuhet “*kjo është çështje e rëndësishme.*”

Një shkak tjetër i shmangies nga shqiptimi letrar lidhet me shkrimin. Mendimi se shqiptimi i drejtë përputhet plotësisht me shkrimin dhe rregullat e tij drejtshkrimore nuk është i drejtë. Siç dihet, drejtshkrimi i gjuhës sonë, përveç parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhen siç shqiptohen, mbështetet edhe në parimin morfologjik e historik, kështu që shkrimi nuk përputhet gjithnjë me shqiptimin. P.sh., sipas rregullave të drejtshkrimit shkruajmë *pjesëtoj, ditëlindje, dhjetëvjetor, kallëzot, kallëzore* etj., por zanoren [ë] të këtyre fjalëve zakonisht nuk e shqiptojmë. Drejtshkrimi i [ë]-së në këto raste mbështetet në parimin morfologjik dhe historik-tradicional. Nga ana tjetër, të gjitha zanoret, pa marrë parasysh a janë në pozitë të theksuar a të patheksuar, shkruhen njësoj, por ato nuk shqiptohen njësoj. Dihet se zanoret e patheksuara nyjëtohen të rrëguara në gjatësi dhe në cilësi. Por edhe te të tillat ka dallim: nga të gjitha zanoret e patheksuara të shqipes rrëgjim më të madh në gjatësi pëson /ë/-ja. Ky rrëgjim shkon gjer në zhdukjen e saj të plotë në shqiptim. P.sh. /ë/-ja e patheksuar fundore dy rrokje larg theksit në shqipen e sotme nuk shqiptohet. Këtë dukuri e ka pasqyruar edhe Drejtshkrimi, që ka vendosur të shkruhet *i hekurt* (por i gurtë), *i katërt* (por i dytë), *pjesëz* (por vezë) etj. Nuk dëgjohet <ë>-ja as në shqiptimin letrar në fjalët e përbëra dhe të përngjitura, si *botëkuptim [botkuptim], pikëpamje [pikpamje], mirëdita [mirdita], mirëmëngjes [mirmëngjes], bukëpjekës [bukpjekës]* etj., megjithëqë drejtshkrimi ndjek parimin morfologjik, d.m.th. i ruan format e fjalëve edhe gjatë bashkimit të tyre për formimin e një fjale të re.

Edhe në disa raste të tjera drejtshkrimi i <ë>-së mbështetet në parimin historik-tradicional. Fjalëformat drejtshkrimore të tilla si *dëllir, këqyr, kërrus, bërryl* etj. nga pikëpamja e normës së sotme të shqiptimit janë historike. Këtu do të përfshiheshin edhe emra të tillë si *atë (ati), ballë, djalë, kalë, dyllë, drithë, brumë* etj., ku <ë>-ja fundore nuk dëgjohet fare as në shqiptimin letrar. Fonema /ë/ në gjuhën shqipe ka shumë larmi timbresh, në rrokje të theksuar nuk e gjejmë në gegërishte, ndërsa në pozicion të patheksuar shtrihet në tërë arealin e shqipes. Në shqiptimin letrar është zanore e mesme gjysmë e hapur. Disa modifikime të saja të nyjëtimimit (pak

më e hapur ose pak më e mbyllur) janë të lejueshme. Në shkrim, grafema <ë> sidomos fundore është një shenjë që tregon se zanorja e rrokjes para saj nuk duhet shqiptuar e shkurtër. Kështu, p.sh. shqiptimi i fjalës së shkruar <bukë> si *buk* (me [u] të shkurtër) cilësohet i papranueshëm, *bu.k* (me [u] të mesme) i tolerueshëm, ndërsa *buk<sup>ë</sup>* do të përfaqësonte shqiptimin normativ.<sup>65</sup>

Për t'u shmangur leximi si një fonemë e vetme (/gj ose nj/), Drejtshkrimi kërkon që fjalët e këtij tipi të shkruhen me <i>, por shqiptohen me /j/, si p.sh.: *djegie* [djeg-je], *lagie* [lag-je], *biologia* [biolog-ja]; *kundërthënie* [kundërthënje], *parathënie* [parathënje], *shkupjania* [shkupjanja] etj. Edhe fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia, -ie, -io, -iu* me /i/ të patheksuar në trup të tyre, shkruhen kështu, por shqiptohen përgjithësisht me *-ja, -je, -jo, -ju*: *material* [materjal], *ambicie* [ambicje], *agresion* [agresjon] etj.

Mospërputhje të normave drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore vërehen edhe në ndërlidhje fjalësh (sand'hi). Gjuha e folur respekton fonetikën sintaksore, duke i ndarë fjalët grupe-grupe, sipas ritmikës së fjalisë, ndërsa drejtshkrimi respekton ndarjen morfologjike të fjalëve. Gjatë lidhjes së fjalëve në fjali ose gjatë fjalëformimit disa fjalë bëhen të patheksuara (*në-shtëpi*), ndonjë shqiptohet me theks të dobët (*rratull* shtëpisë) e ndonjë me theks dytësor (*bótë+kuptím=bqtëkuptím*). P.sh. shkruhet ndaras *E mora librin për të lexuar*, ndërsa thuhet *Emora librin/përtëlexuar//* Kur hyjnë në lidhje të ngushtë me fjalë të tjera për të formuar një sintagmë, zakonisht fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, nyjet, trajtat e shkurtra etj.) e humbin theksin (zanoret rrëgohen) dhe lidhen me fjalën e theksuar. Këtyre ndryshimeve u nënshtrohen edhe fjalët emërtuese. Khs. sintagmat *ai djalë* [aidjalë], *im bir* [imbir], *një lis* [njëlis], *mish qengji* [mishqengji] etj.

Ndonjëherë, duke dashur të respektojë me një korrektësi të tepruar formën e shkruar, ndonjë lexues nuk i respekton rregullat e tilla të fonetikës sintaksore, por bën shqiptim të fjalëpërfjalshëm, pa i bashkëlidhur si duhet ato në njësi më të mëdha.

Për t'u përballuar sfidave të mospërfilljes së normave, madje edhe të kontestimit të përgjithshëm të shqipes së sotme standarde<sup>66</sup> dhe të globalizimit, gjuha standarde shqipe nuk duhet të lihet në mëshirën e fatit,

<sup>65</sup> Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike 3-4, 2002, Tiranë, f. 12.

<sup>66</sup> Në këto rrethana, mendimi i shprehur nga disa intelektualë për t'u kthyer prapa në gjendjen e dikurshme të dy varianteve letrare të gjuhës shqipe, del i papërligjur e, për më tepër, do të ngjallte frymën e përçarjes në një kohë, kur kombi shqiptar ka nevojë më shumë se kurrë për bashkim. Shih: Shaban Demiraj, *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 38-42.

por nevojitet një planifikim gjithëkombëtar gjuhësor me ndërhyrje të institucioneve shkencore e shtetërore në zhvillimin e saj. Mbështetjen kryesore duhet ta ketë në gjuhën e gjallë popullore, sepse thesari i saj është i pashterrshëm.

Detyrë jona është gjithnjë të përpiqemi të flasim e të shkruajmë sipas rregullave ekzistuese, edhe pse ato me një pajtueshmëri të përbashkët kombëtare, sipas nevojës dhe për të mirën e të gjithëve mund të ndryshohen, përkryhen e thjeshtohen. Pavarësisht nga baza jonë dialektore, duhet ta ngrisim vazhdimisht kulturën tonë gjuhësore, ta kultivojmë e pasurojmë gjuhën e sotme standarde shqipe dhe të tregojmë kujdes të përherëshëm për të. Duke e ditur peshën e madhe të ligjërimit të shkruar e të folur në mjetet e informimit, punonjësit e këtyre mediave duhet të jenë të vetëdijshëm për punën dhe misionin e tyre të shumëfishtë, jo vetëm për informimin objektiv të masës së gjerë, por edhe për ngritjen e kulturës gjuhësore të popullit shqiptar në përgjithësi. Detyrë e shenjtë është që të mos e bastardhojmë gjuhën tonë të bukur, prandaj duhet të kemi kujdes sesi flasim e shkruajmë.

#### **Literatura e konsultuar:**

- Demiraj, Shaban (2002). *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*. Studime filologjike nr. 3-4. Tiranë.
- Grup autorësh (1983). *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, I, Fonetika (maket)*. Tiranë.
- Gjinari Jorgji - Shkurtaç, Gjovalin (1997). *Dialektologjia*. Tiranë.
- Hamiti, Asllan (2011). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*. Sak-stil. Shkup.
- Hamiti, Asllan (2018). *Kultura e gjuhës për të gjithë*. Sak-stil. Shkup.
- Lafe, Emil (2002). *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*. Studime filologjike 3-4. Tiranë.
- Memushaj, Rami, *Studime gjuhësore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, IGjL, Tiranë, 2017.
- Murati, Dr. Qemal (2000). *Gramatika e gabimeve – Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*. Shkup.
- Qosja, Rexhep (2002). *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*. Studime filologjike nr. 3-4. Tiranë.
- Shehu, Hajri (2002). *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*. Studime filologjike nr. 3-4. Tiranë.
- Shkurtaç, Gjovalin (2000). *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*. Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë.

## 2. SISTEMI RASOR I SHQIPES DHE PËRDORIMI I EMRAVE TË PËRVEÇËM TË HUAJ<sup>67</sup>

Në këtë kohë të lëvizjeve gjithnjë e më të shpeshta të njerëzve, të përhapjes shumë të shpejtë të informatave në formë të shkruar dhe gojore ndërndikimet gjuhësore po bëhen gjithnjë e më të vrullshme. Gjuhët e popujve të vegjël po rrezikohen nga gjuhët me ndikim në botë jo vetëm në sistemin leksikor e sintaksor, por edhe në sistemin fonologjik e morfologjik. Fajtor kryesor për një ndikim të tillë në një gjuhë të caktuar janë vetë folësit e asaj gjuhe.

Dihet se gjuhët ndryshojnë në rrjedhë të kohës. Ato hapërojnë me ndryshimet shoqërore: ndërrohen njerëzit që i flasin ato si dhe kushtet në të cilat jetojnë. Leksiku lëviz më shpejt (ky ndryshim mund të vërehet edhe midis gjeneratave të gjalla: dalin nga përdorimi disa fjalë, krijohen e huazohen fjalë të reja, fjalët marrin kuptime të reja etj.), ndërsa sistemi fonologjik e morfologjik ndryshon shumë më ngadalë. Krahas ndryshueshmërisë, gjuha ka edhe qëndrueshmërinë e saj, sepse pa këtë të fundit nuk do të mund të realizonte funksionin kryesor, komunikimin. Vështruar nga kjo pikëpamje, duhet pasur një baraspeshë ndërmjet ndryshueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së gjuhës.

Siç dihet, shqipja është gjuhë sintetike-analitike sepse kuptimet gramatikore dhe lidhjet sintaksore midis gjymtyrëve të fjalisë shprehen me anë formash sintetike të ndërtuara nga mbaresat (rasore e vetore), nëpërmjet ndërrimeve morfonologjike dhe supletivizmit; por është edhe analitike sepse krahas formave rasore të emrave, përdor edhe parafjalë. Ajo ka pesë rase në katër paradigma lakimi (2 në njëjës dhe 2 në shumës: në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar), por nuk ka forma të veçanta për të pesë rasat. Në të shumtën e rasteve emërorja me kallëzoren dhe dhanorja me rrjedhoren dalin me formë të njëjtë. Rrjedhimisht emri në gjuhën shqipe del me tetë forma të dallueshme rasore.

Për të shprehur marrëdhënie sintaksore me fjalët e tjera në fjali, para emrave të rasës kallëzore (në, me, për, pa, më, mbi, nën, ndër, nëpër), rrjedhore (prej, ndaj, për, sipas, me anë, në mes), emërore (nga, te(k)), gjinore (me anë, me anën, në drejtim, për punë, në sajë, për shkak) mund të përdoren edhe parafjalë. Meqenëse sistemi i mbaresave të emrit është thjeshtuar mjaft dhe forma rasash të ndryshme shpesh paraqiten njësoj, parafjalët luajnë një rol të rëndësishëm për të shprehur shumë lloje marrëdhëniesh sintaksore. Këto kuptime nuk i shpreh vetëm parafjala, po krejt togu i formuar nga parafjala së bashku me formën rasore.

---

<sup>67</sup> Kumtesë imja lexuar në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 13-24. 08. 2007.



Gjatë zhvillimit të gjuhës shqipe numri i parafjalëve ka ardhur duke u shtuar. Përdorimi i gjerë i parafjalëve ka shtuar tiparet analitike të sistemit gramatikor të shqipes së sotme.<sup>68</sup> Në përcaktimin rasor të një trajte, veç formës, merret parasysh edhe funksioni sintaksor e kuptimi.

Dihet se emri në fjali përdoret në funksione të ndryshme sintaksore, në rolin e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Ai në fjali përdoret si kryefjalë, si pjesë plotësuese e kryefjalës ose e kallëzuesit, kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë, përcaktor, rrethanor, ndajshtim etj. Në varësi nga funksioni që ka, ndryshon edhe forma e tij.

Emrat e përveçëm në gjuhën shqipe zakonisht përdoren në trajtën e shquar. Në këtë pikë shqipja dallohet nga shumë gjuhë të tjera. Në trajtën e pashquar ata hasen vetëm në disa funksione të pakta sintaksore, ku edhe emrat e përgjithshëm dalin gjithashtu të pashquar.<sup>69</sup>

Nga vetë funksioni i tyre, emrat e përveçëm, qofshin anas apo të huaj, janë të dalluar kuptimisht, kështu që përdorimi i tyre në trajtë të shquar ose të pashquar nuk ka vlerë kuptimore. Por, në përputhje me natyrën e shqipes si gjuhë me eptim (lakim dhe zgjedhim), këta emra duhet t'u nënshtrohen gjedheve të saj të lakimit, ashtu si dhe emrat e përgjithshëm. Ka disa rregulla që përcaktojnë kur emri i përveçëm përdoret i shquar dhe kur i pashquar. Përgjithësisht, emrat e përveçëm përdoren në trajtë të pashquar:

a) në funksionin e thirrorit:

- *O, Bujar! Ma jep lapsin.*

- *Dëgjo, Ilir!*

b) në lista emërore apo në tekste të lidhura emri përdoret në trajtë të pashquar, ndërsa mbiemri familjar në të shquarën: *Besnik Tahiri, Gjergj Gjoni, Lirie Berisha...*, me disa praktika të tjera kur emri i gjinisë femërore po përdoret në trajtë të shquar, si *Teuta Kryeziu, Shpresa Hasani* etj. Në gjithë funksionet e tjera, emrat vetjakë të përveçëm përdoren në trajtë të shquar.

Në shtyp dhe në ligjërimitin e folësve të radiove e të televizioneve, emrat e përveçëm dhe mbiemrat e familjeve me burim të huaj shpeshherë po përdoren në trajtë të pashquar, gjë që bie në kundërshtim me natyrën e shqipes si gjuhë me lakim të zhvilluar. Emrat e përveçëm të huaj shkruhen në përputhje me shqiptimin në gjuhën e burimit, por duke iu përshtatur sistemit fonologjik dhe morfologjik të shqipes. Ata që ndeshen për herë të parë, sidomos në shkrimet shkencore në kllapa shënohet edhe trajta origjinale e tyre nëse përdorin alfabetin latin, si p.sh. Noam Çomski (Noam Chomsky), Xhon Lajëns (John Lyons), Xhenaro Kierkia (Gennaro Chierchia) etj.<sup>70</sup>

<sup>68</sup> AShSh, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 383.

<sup>69</sup> Po aty, f. 126.

<sup>70</sup> Rami Memushaj, *Shqipja standarde (si ta flasim dhe ta shkruajmë)*, Toena, Tiranë, 2005, f. 57, 58, 148.

Në mediumet e shkruara dhe elektronike në gjuhën shqipe në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri e gjetiu shpeshherë hetohen shkelje të normës gramatikore (morfologjike e sintaksore). Një ndër gabimet më të shpeshta vërehet në mospërshtatjen e emrave të huaj në rasë. Në morfologjinë e gjuhës standarde shqipe çështja e lakimit të emrave është përcaktuar qartë. Në të thuhet se **në gjuhën shqipe lakohen të gjithë emrat, pa përjashtim, cilido qoftë burimi i tyre.**<sup>71</sup>

Emrat e huaj të përveçëm po përdoren në formë të ngurosur, zakonisht në trajtë të pashquar, edhe pse funksioni i tyre sintaksor kërkon që të jenë në trajtë të shquar dhe në një formë të caktuar rasore. P.sh.:

Gabimisht:	Drejt:
<i>Papulias falënderon Moisiun</i> (Lajm, 19-20. 05.2007, f. 13.)	Papulias <b>i</b> falënderon Moisiun <b>Kush</b> falënderon <b>kë</b> ?
<i>Bush hedh poshtë propozimin e demokratëve</i> (Koha, 21. 05. 2007, f. 15.)	Bush <b>i</b> hedh poshtë propozimin e demokratëve <b>Kush</b> hedh poshtë propozimin e demokratëve?
<i>Meshkov nuk i vëren shqiptarët</i> (Fakti, 28-29. 07. 2007, f. 6.)	Meshkov <b>i</b> nuk i vëren shqiptarët <b>Kush</b> nuk i vëren shqiptarët?
<i>Milan kërkon një ekstra-sulmues</i> (Lajm, 21. 05. 2007, f. 24.)	Milan <b>i</b> kërkon një ekstra-sulmues <b>Kush</b> kërkon ...?
<i>Juventus rikthehet në seria A</i> (Koha, 21. 05. 2007, f. 28.)	Juventus <b>i</b> rikthehet në serin <b>ë</b> A <b>Kush</b> rikthehet? <b>Ku</b> ?
<i>Kam kontaktuar me Frank Sinatra</i> (Koha, 21. 05. 2007, f. 19.)	Kam kontaktuar me Frank Sinatr <b>ën</b> <b>Me kë</b> ?
<i>Kjo gazetë pohon se avokatët e Abramovich</i> (Lajm, 16. 05. 2007, f. 25.)	Kjo gazetë pohon se avokatët e Abramovi <b>qit</b> <b>Avokatët e kujt</b> ?
<i>Ikën Hargrevs, vjen Ruben</i> (Koha, 22.05. 2007, f. 27)	Ikën Hargrevs <b>i</b> , vjen Ruben <b>i</b> <b>Kush</b> ikën, <b>kush</b> vjen?
<i>Ka nënshkruar kontratë 4-vjeçare me Mançester Junited</i> (Koha, 22.05. 2007, f. 27.)	Ka nënshkruar kontratë 4-vjeçare me Mançester Junited <b>in</b> <b>Me kë</b> ?
<i>Real kërkon Bufon dhe Ibrahimoviç</i> (Lajm, 19-20. 05. 2007, f. 25.)	Real <b>i</b> kërkon Bufon <b>in</b> dhe Ibrahimovi <b>qin</b> <b>Cili</b> kërkon <b>kë</b> dhe <b>kë</b> ?
<i>Ndër kandidatët e mundshëm për ta përforcuar mbrojtjen e Milan është edhe Alex</i> (Lajm, 19-20. 05. 2007, f. 24.)	Ndër kandidatët e mundshëm për ta përforcuar mbrojtjen e Milan <b>it</b> është edhe Aleks <b>i</b> <b>Kush</b> përforcon mbrojtjen <b>e cilit</b> ?

<sup>71</sup> ASHSh, IGjL, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 105.

<i>Nadal "hakmerret" ndaj Andrev</i> (Lajm, 21. 05. 2007, f. 24.)	Nadali hakmerret ndaj Andreevit ose Nadali i hakmerret Andreevit <b>Kush i hakmerret kujt?</b>
<i>Petrov ka keqpërdorur pozitën</i> (Koha, 21, 05. 2007, f. 3)	Petrovi ka keqpërdorur pozitën <b>Kush ka keqpërdorur pozitën?</b>
<i>Bush hedh poshtë propozimin e demokratëve</i> (Koha, 21. 05. 2007, f. 15.)	Bushi hedh poshtë propozimin e demokratëve <b>Kush hedh poshtë...?</b>
<i>A e meritojnë Gjukanoviq dhe Maroviq ...</i> (Lajm, 22. 05. 2007, f. 12.)	A e meritojnë Gjukanoviqi dhe Maroviqi <b>A e meritojnë kush?</b>
<i>... ka thënë Putin</i> (Fakti, 28-29. 07. 2007, f. 16.)	... ka thënë Putini <b>Kush ka thënë?</b>
<i>Edhe pse ende nuk e kemi realizuar atë që kishim planifikuar, tha Solstrom, procesi është duke vazhduar ...</i> (Fakti, 28-29. 07. 2007, f. 16.)	Edhe pse ende nuk e kemi realizuar atë që kishim planifikuar, tha Solstromi, procesi është duke vazhduar ... <b>Kush tha?</b>
<i>Të përkujtojmë edhe një herë se para meçit kryesor ndërmjet Albert Selimit dhe Predrag Pashiq, në program janë paraparë ...</i> (Fakti, 28-29. 07. 2007, f. 20.)	Të përkujtojmë edhe një herë se para meçit kryesor ndërmjet Albert Selimit dhe Predrag Pashiqit, në program janë paraparë ... <b>Meçit ndërmjet kujt?</b>
<i>... ka luajtur në tandem me Bojan Kërkiq dhe Dos Santos.</i> (Fakti, 28-29. 07. 2007, f. 21.)	... ka luajtur në tandem me Bojan Kërkiqin dhe Dos Santosin. <b>Me cilët?</b>
<i>Liverpul në vitin 2010 me stadium të ri</i> (Fakti, 28-29. 07. 2007, f. 22.)	Liverpuli në vitin 2010 me stadium të ri <b>Cili?</b>
<i>Betinez mund të bëhet trajneri i dytë pas Bob Peizli</i> (Koha, 22. 05. 2007, f. 28.)	Betinezi mund të bëhet trajner i dytë pas Bob Peizlit <b>Kush pas kujt?</b>

Ky përdorim i tillë i emrave të përveçëm të huaj vetëm në formë të ngurosur është rrjedhojë e mendimit të gabuar të disave se emrat e tillë duhet të përdoren vetëm në formën origjinale, pra në trajtë të pashquar, me grafi autentike dhe pa mbaresa rasore ose me fjalë të tjera që emrat e huaj nuk duhet t'i përshtaten natyrës së shqipes apo nuk duhet "shqipëruar", sepse kjo është në modë dhe kështu e kërkuaka "bota e qytetëruar". Nga ana tjetër, shkurtimi fonologjik e morfologjik i tyre, përkatësisht mospërdorimi i formave rasore të nevojshme mund të konsiderohet edhe si një ekonomi gjuhësore e dëmshme me pasoja rrënuese të sistemit rasor të shqipes. Edhe në rrafshin e morfologjisë duket qartë kundërshtia e

përhershme midis nevojave komunikatave të njeriut dhe prirjes së tij për ta rrudhur sa më shumë veprimin mendor dhe fizik. Të gjitha njësimet në eptimin emëror, mbiemëror, përemëror dhe foljor janë rrjedhoja të përpjekjeve për t'u çliruar nga sforcime të kujtesës; nga përpjekja për ta çliruar atë nga lidhja e kuptimeve me larmi formash.<sup>72</sup>

Në qoftë se emrat e përveçëm të huaj i shkruajmë vetëm me grafi autentike e pa mbaresa rasore bëjmë tri krime gjuhësore:

- a) cenojmë alfabetin e shqipes për ta shpërbërë atë nga një bashkësi shenjash grafike të përcaktuara me 36 shkronja (27 të thjeshta dhe 9 dyshkronjësja) në një shumësi shkronjash të të gjitha gjuhëve të botës;
- b) shkatërrojmë sistemin rasor për ta shndërruar shqipen nga tipi sintetik-analitik (gjuhë me rasa dhe me parafjalë) në gjuhë analitike (gjuhë pa rasa);
- c) prishim rregullat sintaksore dhe errësojmë kuptimin e fjalive.

Për ta parandaluar përmbytjen e shqipes me fjalë e me gjedhe të huaja, duhet të kushtrimohen të gjithë përdoruesit e kësaj gjuhe, në radhë të parë gazetarët, publicistët, shkrimtarët, shkencëtarët, mësimdhënësit, studentët, nxënësit etj. Të folurit ose të shkruarit shqip e disa publicistëve më shumë po ngjason në anglishte, italishte, frëngjishte, gjermanishte apo sllavishte sesa në natyrën e shqipes.

Nëse nuk ndihmojmë për ta lartësuar kullën e shqipes së përbashkët, së paku të mos e përdhosim dhe të mos e rrënojmë atë tempull që deri më tani është ngritur me shumë mund nga të tjerët.

## Përmbyllje

Dihet se emri (qoftë anas apo i huaj) në fjali përdoret si kryefjalë, si pjesë plotësuese e kryefjalës ose e kallëzuesit, kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë, përcaktor, rrethanor, ndajshtim etj. Në varësi nga funksioni që ka, ndryshon edhe forma e tij.

Në mediumet e shkruara dhe elektronike në gjuhën shqipe në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri e gjetiu shpeshherë hetohen jo vetëm shkelje të normave fonetike e fonologjike, por edhe të rregullave gramatikore (morfologjike e sintaksore). Një ndër gabimet më të shpeshta vërehet në mospërshtatjen e emrave të huaj në rasë, si pasojë e ndikimit të gjuhëve të huaja. Fajtor kryesor për ndikimin e gjuhëve të huaja në një gjuhë të caktuar janë vetë folësit e asaj gjuhe.

Emrat e huaj të përveçëm po përdoren në formë të ngurosur, zakonisht në trajtë të pashquar edhe pse funksioni i tyre sintaksor kërkon

<sup>72</sup> Ethem Likaj, *Raporte të ekonomisë gjuhësore dhe të kulturës së gjuhës*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006, 25/1, f. 195.

që të jenë në një formë të caktuar rasore, si p.sh.: *Juventus rikthehet në seria A*. (duhet: Juventus, serinë). *Kam kontaktuar me Frank Sinatra* (duhet: Sinatrën). *Kjo gazetë pohon se avokatët e Abramovich* (duhet: Abramoviqit). *Ikën Hargrevs, vjen Ruben* (duhet: Hargrevsi, Rubeni). *Real kërkon Bufon dhe Ibrahimoviç* (duhet: Reali, Bufonin, Ibrahimoviqin). *Nadal "hakmerret" ndaj Andrev* (duhet: Nadali i hakmerret Andreevit) etj. Në morfologjinë normative thuhet qartë se **"në gjuhën shqipe lakohen të gjithë emrat, pa përjashtim, cilido qoftë burimi i tyre."**

Përdorimi i emrave të përveçëm të huaj vetëm në formë të ngurosur dhe me grafi autentike mund të shpjegohet me mendimin gabuar të disave se "kështu e kërkuaka bota e qytetëruar" dhe si një zbatim i dëmshëm i ekonomisë gjuhësore. Në qoftë se emrat e përveçëm të huaj i shkruajmë vetëm me grafi autentike e pa mbaresa rasore bëjmë tri krime gjuhësore:

a) cenojmë alfabetin e shqipes për ta shpërbërë nga një bashkësi shenjash grafike të përcaktuara në një shumësi shkronjash të të gjitha gjuhëve të botës;

b) shkatërrojmë sistemin rasor për ta shndërruar shqipen nga tipi sintetik-analitik (gjuhë me rase dhe me parafjalë) në gjuhë analitike (gjuhë pa rase);

c) prishim rregullat sintaksore dhe errësojmë kuptimin e fjalive.

Për ta parandaluar përmbytjen e shqipes me fjalë e me gjedhe të huaja, duhet të vetëdijsohen të gjithë përdoruesit e kësaj gjuhe, në radhë të parë gazetarët, publicistët, shkrimtarët, shkencëtarët, mësimdhënësit, studentët, nxënësit etj. Të folurit ose të shkruarit shqip e disa "intelektualëve" më shumë po ngjason në anglishte, italishte, frëngjishte, gjermanishte apo sllavishte sesa në natyrën e shqipes.

Nëse nuk ndihmojmë për ta lartësuar kullën e shqipes së përbashkët, së paku të mos e përdhosim dhe të mos e rrënojmë atë tempull që deri më tani është ngritur me shumë mund nga të tjerët.

### **Literatura e konsultuar:**

AShSh, IGjL (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. Tiranë.

Likaj, Ethem (2006). *Raporte të ekonomisë gjuhësore dhe të kulturës së gjuhës*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 25/1. Prishtinë.

Memushaj, Rami (2005). *Shqipja standarde (si ta flasim dhe ta shkruajmë)*. Toena, Tiranë.

### 3. PËRDORIMI DHE MBROJTJA E SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONINË E VERIUT<sup>73</sup>

Gjuha standarde shqipe në Maqedoninë e Veriut po përdoret në institucionet arsimore, në mjetet e informimit, në veprat letrare e shkencore, në tekstet shkollore etj. Jemi dëshmitarë se në praktikën gjuhësore shpeshherë po thyhen normat në të gjitha rrafshet, si në rrafshin leksikor, sintaksor (si pjesë më të lëvizshme të gjuhës e më të eksponuara ndaj ndikimeve të huaja), në rrafshin morfologjik, fonetik e fonologjik si dhe në të gjitha fushat e tjera.

Moszbatimi i normave gjuhësore të shqipes standarde në Maqedoni ka qenë temë trajtimi e shumë gjuhëtarëve. Punime e vepra me vlerë në fushën e kulturës së gjuhës, të planifikimit gjuhësor e të politikës gjuhësore kanë sjellë albanologë të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut si dhe të vendeve të tjera.

Problemi më i madh në përdorimin e shqipes lidhet me kulturën e dobët gjuhësore, sidomos e brezit të ri. Mosnjohja e mirë e gjuhës amtare, që me sa duket ka të bëjë me mangësi të rënda në arsimin bazë, por edhe me mungesën e leximit tek të rinjtë, krahas me përvetësimin e gjuhëve të huaja dhe krijimin e brezave dy- a tregjuhësh, ka sjellë edhe zëvendësimin e fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese shqipe, tashmë të panjohura për të rinjtë, me fjalë e shprehje të gjuhëve të huaja, qoftë të marra drejtpërdrejt, qoftë të përkthyer ose kalkuara në shqip sipas modelit të huaj.

Vërshimi pa kriter i fjalëve të huaja është një problem, por shohim edhe përdorime të gabuara në drejtshkrimin, në morfologjinë dhe në sintaksën e shqipes; çka flet për mangësi të formimit gjuhësor gjatë shkollimit. Mungesa e kulturës gjuhësore shkon krahas me varfërinë kulturore të përhapur masivisht; mjafton të shohësh gabimet që bëhen në shtypin e përditshëm që pasqyrojnë mungesë kulturore të theksuar.<sup>74</sup>

Profesor Gjovalin Shkurtajt një gazetar ia parashtrori pyetjen: *Si e shikoni rolin e shtypit dhe të medieve në këtë problematikë që parashtroni? Studiuesi e pedagogu i njohur u përgjigj:*

“Disa herë në artikuj e kumtesa, si dhe në librat e ligjëratat e mia, kam thënë, stërthënë dhe prapë po e shpreh se ne sot, si popull e si komb shqiptar, kemi shumë djem e vajza me shkollë, që i dinë aq mirë gjuhët e huaja të Europës e të botës, sidomos anglishten, italishten, frëngjishten dhe

<sup>73</sup> Asllan Hamiti, Kumtesë (e përditësuar) e lexuar në panelin shkencor “Gjuha shqipe në Maqedoni – histori dhe perspektiva” mbajtur në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, në Shkup, më 18. 06. 2018. Botuar në: Scupi 22, Shkup, 2018, f. 47-63.

<sup>74</sup> Anila Omari, *Problemi më i madh sot, kultura e dobët gjuhësore*, <http://www.forumishqiptar.com>; shkarkuar më 23. 07. 2020.

gjuhë të tjera, kohët e fundit edhe greqishten për arsye të emigracionit në atë vend fqinj e traditashumë. Kam pohuar, përsëritur dhe prapë po e shqiptoj se kjo përbën një gëzim e kënaqësi për nivelin e mirë të arsimit dhe kulturimit të tyre.

Edhe MASH-i i Shqipërisë, këto vitet e fundit, madje me vendim ministror e në formë detyruese ka shtruar domosdoshmërinë e të nxëniet të anglishtes si lëndë mësimore parësore në shkollat tona të mesme. Edhe kjo, kam thënë e po e stërthem, ka qenë e mirë, pa asnjë dyshim vetëm e mirë. Porse, ndërkaq, sa herë kam folur e shkruar për kulturën e gjuhës, nuk kam reshtur s'u ankuari e së pohuari edhe faktin e trishtuar se, ne, si komb e si popull shqiptar, për fat të keq kemi aq pak njerëz që dinë ta flasin e ta shkruajnë shqipen ashtu si duhet; sa herë kam folur për mediat e folura e të shkruara, me dashamirësi e zemër të hapur, ua kam vlerësuar rolin e tyre ndikues, peshën dhe modelin kulturor e shoqëror që koha e sotme u ka dhënë atyre, si "Pushteti i Katërt" që janë, porse, ndërkaq, gjithmonë kam theksuar edhe rolin e tyre modeldhënës: përkatësisht të radios e të televizionit, përfshirë aty edhe shumëçka tjetër të komunikimit elektronik të kohëve të reja, për gjuhën e folur dhe të gazetave e revistave, bashkë me librat, për drejtshkrimin dhe përgjithësisht për kahun e mëtejshëm të shqipes.

Më se një herë, për të mos gabuar, por edhe pse më është dukur vetja herë-herë edhe disi i vetmuar e pa mbështetjen e duhur nga shteti e shoqëria e sotme, i jam drejtuar për ndihmë e mbështetje, herë Naim Frashërit, Gjergj Fishtës, Ndre Mjedës që lëvdojnë huret e shqipes e me ato cilësime ndjellin dashurinë e shqiptarëve për gjuhën shqipe, herë Faik Konicës dhe kam parafrazuar madje fshikullimin e tij të ashpër ndaj gjuhëprishësve, që ai i quante "**analfabetë me diplomë**", ashtu sikundër, m'u duk e udhës ta përdor në përgjigjen time të sotme urtësinë dhe porosinë e vyer të poetit Kristo Floqi (...).<sup>75</sup>

Shqiptarët e Maqedonisë përgjithësisht njohin dhe përdorin *varietetin territorial* të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), *shqipen standarde* (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e informimit publik) si dhe *maqedonishten standarde* (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) shpeshherë ndodhin përzierje kodesh, situatë në të cilën asnjë gjuhë e përdorur vetëm, nuk do të ishte e mjaftueshme. Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor – pak fjalë nga shqipja e pak fjalë nga maqedonishtja, pastaj kthehen tek e para me disa fjalë më shumë (me huazime), me shprehje nyjetimore të shqipes kur flasin

<sup>75</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Urgjenca gjuhësore*, Naimi, Tiranë, 2017, f. 199-200.

maqedonisht, sidomos në theksimin e fjalëve; me një morfologji e sintaksë të ndërmjetme (herë sipas natyrës së shqipes e herë sipas asaj të maqedonishtes).

Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip. Përkthimet lëngojnë sidomos në zëvendësimin e formave rasore të shqipes me forma analitike: parafjalë + emër, meqë maqedonishtja nuk ka lakim emrash.

Sidoqoftë dukuritë e tilla janë me interes e për gjuhët në kontakt dhe ndikimin ndër-gjuhësor e përgjithësisht për sociolinguistikën. Por, në këtë kumtim vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në problemet praktike që janë pasojë e përdorimit të maqedonishtes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, pra si “gjuhë e lartë” dhe të shqipes si “gjuhë e ulët”.

Për të parë kulturën e dobët gjuhësore, mjafton të shfletosh ndonjë gazetë ditore, të shohësh ndonjë web-faqe të rrallë në shqip të institucioneve shtetërore në Maqedoni, tekst shkollor të përkthyer nga maqedonishtja në shqip, ndonjë hartim nxënësi, provim, punim seminari a diplome të ndonjë studenti, një dokument zyrtar, ndonjë tekst shqip të ndonjë malli, ndonjë udhëzim për përdorimin e barërave; ose të lexosh tabelat rrugore, shkrimet shqip në ambulanca e spitale, në tabela e dokumente firmash, titrimet e filmave, titujt e këngëve, shkrimet në rrjetet sociale apo edhe shumëçka që ta zë syri të shkruar në shqip.

Mjetet e informimit, si shtypi ashtu edhe radioja e televizioni, kanë rëndësi të madhe jo vetëm si medime më masive të informimit publik, por edhe si mjete e burime për formimin gjuhësor të lexuesve, dëgjuesve dhe të teleshikuesve, meqë drejtpërdrejt ndikojnë për përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare të e gjithë popullata shqiptare në Maqedoni e më gjerë. Prandaj, gjuha e gazetave, e radios dhe e televizionit duhet t’u përgjigjet rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore të shqipes standarde.

Nga pakujdesia, puna e ngutshme, joserioziteti në punë, papërgjegjësia ose nga mosnjohja e mjaftueshme e normave të shqipes standarde, po bëhen gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme.

Në një shtjellim përmbledhës, siç është ky yni, nuk mund të përshkruhen të gjitha shkarjet gjuhësore, por me këtë rast po përmendim disa nga gabimet më të shpeshta që hetohen në media:

1. **Gabime teknike.** Shumë shpesh në mediet e shkruara te ne vërehen gabime teknike, si: arsimtar për *lnëdet* mjekësore (Lajm, 07.12.2012, f. 29), *kushtret* (duhet: kushtet, f. 29), pas zgjedhjes së *nabruar* (Lajm, 07.12. 2012, f. 29). Herë-herë në këto gazeta në vend të <i>-së së vogël gjejmë shkronjën <I> të madhe, për shkak të shkrimit kompjuterik të



automatizuar të <I>-së së madhe në pozita ta caktuara në anglishten. P.sh.: Në vendet ku është *I* zhvilluar sporti *I* skitarisë garat zyrtare fillojnë ... (Lajm, 07.12.2012, f. 23). Përgatitjet e tyre *I* kanë filluar që nga gushti *dhe atë* nëpër vende ku ka kushte adekuate për sportin e skitarisë. (Lajm, 07.12.2012, f. 23).

**2. Ndarja e gabueshme e fjalëve në fund të rreshtit.** Gjëja e parë që na ra në sy në shkrimet e gazetave është ndarja e gabueshme e fjalëve në fund të rreshtit. Në ndarjen e tekstit në kolona të ngushta, shpeshherë ndahen edhe dyshkronjëshat,<sup>76</sup> si në fjalët: *mar-rveshje*, *fil-limit*, *lid-hur*, *urd-hërdhënësi* (f. 2), *dal-lim* (f. 3), *ndër-roi* (f. 5), *pjesëmar-rësve* (f. 5), *hol-lësi* (f. 6), *menax-him* (f. 14), *gjithn-jë* (24), *mrekul-li* (f. 24), *ndër-roni* (f. 24), *mrekul-lueshëm* (f. 26) në gazetën "Lajm" të datës 07. 12. 2012; *mar-rëveshje*, *shkol-lë* (Koha e datës 07. 12. 2012, f. 2, 9), por ka raste edhe kur një shkronjë e vetme mbetet në fund të rreshtit, si *u sh/-pall* (Koha, 07.12. 2012, f. 7) etj.

**3. Shkrimi i shkronjës <e> në vend të <ë>-së dhe i <c>-së në vend të <ç>-së.** Ka jo pak shkrime gazetareske ku nuk gjejmë të shkruar as <ë>-në e as <ç>-në, por në vend të tyre <e>, përkatësisht <c>-në, si p.sh.: "*Lidershipi politik shqiptar ne Maqedoni, me rastin e fitores se sontme dhe kualifikimit te Kombetares per Kampionatin European ne France, ka shpalour urimet e perzemerta. Ne vazhdim ju sjellim vec e vec urimet e tyre. Gjuha shqipe sipas analizes se mesiperme del qe eshte e vetmja qe mund te perfaqesoje denjesisht kulturen dhe traditat e verteta te pjeses me te madhe te popullit qe banon ne Maqedoni* (Gazeta Lajm, Maqedoni, e diel, 11 tetor 2015)."

**4. Në shkrimin e fjalëve bashkë, ndaras dhe me vizë në mes, po kështu hetohen gabime.** P.sh.: *kundër akuza* (duhet: kundërukuza, Koha, 07.12. 2012, f. 8), ky projekt është *shumë vjeçar* (duhet: shumëvjeçar, Koha, 07. 12. 2012, f. 3), pauzë e shkurtë *dy javore* (Lajm, 07.12.2012, f. 23, duhet: dyjavore); *Parasëgjithash* për shkak të defokusimit të plotë të fqinjit tonë (duhet para së gjithash). Nuk ka më mirë në këtë botë *se sa* të jesh shqiptar (se sa, duhet sesa). Ministri i Ekonomisë Bekim Neziri dje ishte i ftuar në shënimin e jubileut të *10 vjetorit* të hyrjes së kompanisë së naftës Lukoil në Maqedoni (duhet 10-vjetorit, Koha, 12 tetor 2015) etj.

**5. Përdorimi i gabueshëm i shkronjave të mëdha.** Është bërë modë gjuhësore, si duket nën ndikimin e anglishtes, që emrat e muajve të

<sup>76</sup> Alfabeti i gjuhës shqipe ka 27 shkronja njëshe dhe 9 shkronja dyshe: <th, dh, sh, zh, xh, rr, ll, gj, nj>. Sipas rregullave, shkronjat dyshe nuk ndahen meqë mund të lexohen si shkronja më vete, përkatësisht si fonema të veçanta. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Sak-stil, Shkup, 2005; 2011, f. 33, 278.

shkruhen me shkronjën e parë të madhe (ndonjëherë edhe pa parafjalën më), si: Mbledhja e nënshkrimeve bëhet *07 Dhjetor 2012*. Gazeta Lajm, Maqedoni, E diell, *11. Tetor 2015*. Gazeta Koha, E diell, *11. Tetor 2015* (do të duhej: Lajm, e diel, 11 tetor 2015; Koha, e diel, 11 tetor 2015).

Gabohet shpesh kur shkruajmë emrat e institucioneve, sidomos ata që përbëhen prej grupeve emërore, sepse vetëm emri i parë po shkruhet me shkronjë të parë të madhe, nërsa të gjithë emrat a përcaktorët e tjerë me shkronja të vogla, nën ndikimin e rregullave të drejtshkrimit të maqedonishtes, sipas tipit: *Ministria e arsimit dhe shkencës, Byroja e zhvillimit të arsimit, Fakulteti filologjik*.

Siç dihet, sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes të gjitha pjesët përbërëse kuptimplota të emërtimit të institucioneve shkruhen me shkronjë të parë të madhe, përveç fjalëve shërbyese (parafjalët, nyjat, lidhëzat, pjesëzat). Sipas Drejtshkrimit të shqipes titujt e institucioneve të mësipërme, si edhe emrat e institucioneve të tjera, duhet të shkruhen me shkronjë të madhe, si: *Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Fakulteti i Filologjisë* (nga shembulli i fundit mund të nxirret konstatimi se nuk është e drejtë të thuhet *Fakulteti filologjik* – me emër + mbiemër (përcaktor), por kjo duhet të përdoret me grup emëror, nga të cilët emri i parë në rasën emërore të njëjësit të shquar, ndërsa emri i dytë në rasën gjinore, d.m.th. formë e drejtë është *Fakulteti i Filologjisë*.

**6. Përdorimi i gabueshëm i <ë>-së.** Përdorimi pa vend i ëë]-së në pozitë fundore është i shpeshtë. Shpeshherë shkruhet ku nuk duhet ose nuk shkruhet ku duhet, si: *parasyshë, zgjatë*, (Lajm 07.12.2012, f. 13, 12 duhet parasysh, zgjat). Oferta e tyre është e ndërlydhur *drejtpërdejtë* me popullatën (Koha, 07.12.2012, f. 6, duhet: drejtpërdrejt). Të gjithë lojtarët duhet ta kuptojnë se unë i *marrë* vendimet. Duhet: i marr). Të *shprehë* ngushëlim të thellë dhe T'ju inkurajoj në qëndrueshmërinë dhe vendosmërinë në luftën *me dhunës* (?) dhe të gjitha aktet kriminele (Koha, e diel, 11 tetor 2015). Struga e gatshme *ta përballoj* dëborën (duhet: ta përballojë, Koha, 07. 12. 2012, f. 8) Maqedonisë një porosi e *drejtpërdrejt* i erdhi edhe nga vet eurokomisari i zgjerimit (Koha, 07. 12. 2012, f. 2). Mijallkov kuadër i ekspunuar dhe *anëtarë* i organit më të lartë të partisë në pushtet (duhet: anëtar). Teksti i Ligjit mund *çdo kush ta interpretoj* si të *doje*, por e *sjellë* ligjvënësi" (Koha, 12. Tetor 2015, Duhet: Tekstin e ligjit mund ta interpretojë çdokush si të dojë, por e sjell ligjvënësi. Ai tha se deri më 20 tetor ky ligj mund të *pësoj* ndryshime (Koha, 12 tetor 2015).

Përdorimi i formës së shumësit të disa emrave pa <ë> fundore është dukuri shumë e shpeshtë, si *shqiptar* (në vend të formës së drejtë *shqiptarë*), *arsimtar* (në vend *arsimtarë*) etj.; ata *qytetar* (f. 15, Lajm, 07. 12. 2012), synon të vetëdijësojë afaristët *shqiptar* (pa <ë> në Lajm, 07. 12. 2012, f. 6) tubon afaristët *shqiptar* (Koha, 07. 12. 2012, f. 6.), Dializa realizohet nën mbykqyrje të mjekëve *specialist* (Koha, 07.12.2012, f. 8) etj.

Ndonjëherë hetohet edhe mospërdorimi i <ë>-së në trup të fjalës: Komisioni *shtetror* (Lajm, 07.12.2012, f. 15, duhet: shtetëror).

**7. Humbja e opozicionit fonologjik ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëses /r/:** Ngjashmëria nyjetimore dhe ngarkesa e vogël funksionale ka mundësuar rrafshimin e kundërvënieve fonologjike të bashkëtingëlloreve /r/ dhe /rr/ në disa të folme tona. Mirëpo, këto bashkëtingëllore në shqipen standarde janë dy fonema të veçanta, gjë që provohet me çifte minimale fjalësh të tilla , si *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë, deri ~ derri, rimë ~ rrimë* etj.

Bashkëtingëllorja /r/ ka denduri përdorimi e përndarje më të madhe sesa çifti i saj /rr. Marrë në tërësi, si në gazeta, ashtu edhe në radio e televizion përdoren fjalë vetëm me /r/ edhe pse sipas rregullave duhej të kishin /rr/. Pra, shkruhen e shqiptohen gabimisht me /r/ në vend të përdoren me /rr/ shumë fjalë, si: *rafsh, ri, rit, rjedh, (i, e) rallë, reth e rotull; karige, përall(ë), qere, haroj, ndëroj, ngatëroj*; disa huazime kryesisht nga gjuhët romane: *barikad(ë), karier(ë), korekt, koridor, teritor; andër, kokër, mor, obor, vjehër, zjar* etj.

**8. Përdorimi i gabueshëm i apostrofit.** Për shkak të ekonomizimit të ligjërimit dhe lehtësimit të shqiptimit në gjuhën shqipe shpeshherë bie zanorja [ë] në rrokje të patheksuar, sidomos kur gjendet në pozitë absolute fundore të fjalës, veçmas te fjalët shërbyese (jokuptimplota): te pjesëza *të*, te nyjat e përparme *të, së*; si dhe te trajtat e shkurtra të përemrave vetore *më, të*. Ky mosshqiptim i [ë]-së, apo siç e njohim edhe me termin elizion, është e lidhur ngushtë me prirjen e bashkimit a të shkrirjes së fjalëve të patheksuara me fjalët e theksuara, përkatësisht për ndërlidhje shqiptimore fjalësh në tërësi më të mëdha sintaksore (sand'hi), në sintagma e grupe fjalësh, si dukuri e përhershme e ligjërimit të folur.

Kjo dukuri e mosshqiptimit të [ë]-së është përlligjur edhe në Drejtshkrim përmes shënimit të apostrofit, sipas modelit: *t'i dha* (< të i dha), *m'i dha* (< më i dha), përkatësisht te format *m'i, t'i, m'u, t'u, t'et, s'ëmës* (< më i, të i, më u, të u, të et, së ëmës) etj.<sup>77</sup>

Në shkrimin e apostrofit në gazetatat ditore, përkthimet e gjetiu vërehen më shumë parregullsi sesa përdorim të rregullt të tij. Thjesht, rrallë në ndonjë tekst apostrofi përdoret drejt, d.m.th. rëndom shkruhet aty ku nuk duhet, ndërsa shkruhet aty ku s'duhet të shënohet. P.sh.: Duhet *t'i* shpalosen krejt kuptimet (Lajm, 07. 12. 2012, f. 11). Sikur *tu* kishim hedhur gaz lotsjellës (duhet: t'u). Për *tu* pasuruar me paratë publike të qytetarëve (duhet: t'u, Lajm, 11 tetor 2015).

Apostrofi nuk duhet të shënohet te trajta e shkurtër e bashkuar e kallëzores (e patheksuar): *ma* (më + e) dhe *ta* (< të + e), si *m'a, t'a*. Dihet se

<sup>77</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Sak-stil, Shkup, 2011, f. 255-256.

këto forma shkruhen pa apostrof, sepse këtu kemi shkrirjen e zanoreve *ë + e* që kanë dhënë *a*, por jo rënien [ë]-së patheksuar.

**9. Edhe shenjat e pikësimit shpeshherë nuk përdoren me vend:**

*Nuk ka dëshirë nuk ka vullnet nuk ka gatishmëri* (askund nuk ka presje e do të duhej: Nuk ka dëshirë, nuk ka vullnet, nuk ka gatishmëri. Koha, 07. 12. 2012, f. 4).

**10. Përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën të ndeshet shpesh,** si: (ai) *do lexojë, do punojë* (në vend: *do të lexojë, do të punojë*). Mjaft shpesh gabohet në përdorimin e formës standarde të lidhore, sepse ose në vend të <ë>-së përdoret <e>-ja ose pjesëza të + forma e mënyrës dëftore e kohës të tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh. (ai duhet) *të shkoje* ose *të shkon, të punoje* ose *të punon, të mësoje* ose *të mëson* (< duhet të shkojë, të punojë, të mësojë) etj.

**11. Përdorimi i gabueshëm i foljeve të zgjedhimit të tretë.** Në analogji me foljet e zgjedhimit të parë, edhe foljet e zgjedhimit të tretë disa herë si në të folurit, ashtu edhe në të shkruarit përdoren jo sipas rregullave gramatikore (pa mbaresa vetore në numrin njëjës në kohën e tashme të mënyrës dëftore), por me mbaresa në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit, si (ti, ai, ajo) *din, pin, han, flen* (< duhet: di, pi, ha, fle) etj.

**12. Gabime në përdorimin e foljeve apofonike.** Në prirjen për rrafshimin e formave të foljeve, edhe foljet apofonike (me këmbimet e fonemave /a/ ose /je/ në /o/) <sup>78</sup> në kohën e kryer të thjeshtë dhe në pjesore shpeshherë po përdoren gabimisht. Mbushullojnë format jonormative si në të folur, ashtu edhe në të shkruar: *vjel - vjela - vjelur* (< duhet: vjel - vola - vjelë), *merr - morra - marrur* (< duhet: marr - mora - marrë), *mbjell - mbjella - mbjellur* (< duhet: mbjell - mbolla - mbjellë), *sjell - sjella - sjellur* (< duhet: sjell - solla - sjellë) etj.

**13. Mospërdorimi i mbaresës së rrjedhore -sh për shumësin e pashquar.** Dihet se një ndër dallimet morfologjike ndërmjet dy dialekteve të shqipës është edhe prania në Veri, përkundër mungesës së formave të rrjedhore së shumësit të pashquar në Jug. Me fjalë të tjera, në të folmet e toskërishtes forma e rrjedhore shumës me **-sh** përdoret shumë rrallë (por është njësuar me formën e shquar, me mbaresën *-ve*), por në të folmet e gegërishtes kjo ka përdorim të dendur, si: ka pi: u:j *bretkocash*, kena pas lujt *arash*, koçak *pulash*, o:d *burrash* etj. Në media e në stilin administrativ

<sup>78</sup>Foljet, te të cilat /a/-ja apo /e/-ja e theksuar e rrënjës në kohën e tashme shndërrohet në /o/ quhen folje apofonike. Foljet apofonike që në të tashmen mbarojnë me *-l, -ll, -rr* nuk marrin ndajshitesën *-ur* në format e pashtjelluara. Prandaj duhet të themi: *për të dalë* (jo: për të dalur), *për të vjelë* (jo: për të vjelur), *për të sjellë* (jo: për të sjellur). Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe ...*, f. 227.

forma normative dhe e drejtë me -sh (varësisht nga konteksi dhe funksioni) pothuajse është shuar fare.

**14. Pështjellime në përdorimin i emrave të huaj vetjakë.** Emrat e huaj vetjakë që shkruhen me alfabetin latin në shqipen e kohës sonë po shkruhen në dy forma: a) të transkriptuara (sipas shqiptimit në shqipen) ose b) në formën e tyre origjinale (burimore). Ky përdorim i dylojshëm shfaqet me dy formash e paraqet problem që duhet zgjidhur. Mendojmë se forma e dytë (b) e shkrimit të emrave të huaj vetjakë është më e drejtë.

Nga pikëpamja morfologjike, parashtrohet pyetja vallë këta emra të huaj varësisht nga funksioni në fjali duhet të përshtaten sipas rregullave të lakimit të emrave në trajtën e pashquar e në të shquarën, si gjithë emrat e tjerë, pa përjashtim; përfshirë edhe emrat personalë, qofshin ata vendas ose të huaj. Vlerësojmë se edhe emrat e huaj vetjakë në shqipen duhet të lakohen nëpër rase, duke shënuar me vizë nyjat shquese e mbaresat rasore, sipas tipit: *Bayron-i, -it, -in; Victor Hugo, Victor Hugo-i, -it, -in; Friedrich Schiller-i, -it, -in; Heinrich Heine-ja, -it, -en* etj. Në normat kategorike të gjuhës (fonetike e morfologjike), nuk duhet të ketë dy apo më shumë forma, por kur ka luhatje e shumësi formash, standardi zgjedh vetëm një formë si të drejtë, ndërsa format e tjera nuk zhbëhen, por edhe më tej do të përdoren në ligjërime e në stile të tjera të gjuhës (përveç në ligjërimin libror).

Për këtë larmi si dhe për probleme të tilla të ngjashme drejtshkrimore, drejtshqiptimore e morfologjike apo edhe të natyrave të tjera që kemi e do t'i sjellë në të ardhmen zhvillimi i gjuhës në rrjedhë të kohës, duhet gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme. Është e njohur se gjuha gjithnjë është në lëvizje, në zhvillim dhe pëson ndryshime nga faktorët gjuhësor e jashtëgjuhësor, të brendshëm e të jashtëm. Drejtshkrimi, drejtshqiptimi, gramatikat, fjalorët e veprat e tjera, me të cilat përshkruhet gjuha bashkëkohore dhe përcaktohen normat e standardit, gjithsesi duhet të jenë përputhje me etapën e zhvillimit të gjuhës.

Shumë shpesh dëgjojmë e lexojmë emra e mbiemra të huaj personalë të papërshtatur me sistemin e lakimit që ka shqipja, edhe pse sipas funksionit të tyre në fjali do të duhej të përdoreshin në formë rasore të caktuar. Bie fjala, kujtojmë se është e parregullt të thuhet në shqip: *U takua me Bush*, në vend të formës normative: *U takua me Bush-in*. Jo: Paraprakisht Veljanovski ka dërguar shkresë *deri te Ivanova ...*; por: Paraprakisht Veljanovski i dërgoi shkresë *Ivanov-ës ...* Koha, 07. 12. 2012, f. 3. Keq: Interi u përforcua me *Martinez*. Mirë: Interi u përforcua me *Martinez-in*.

**15. Mosdallimi i gjinisë së përemrave vetorë të vetës së tretë të numrit shumës *ata* dhe *ato*:** *ata burra* dhe *ata gra* ose *ato burra* dhe *ato gra* (për të dy gjinitë) është dukuri mjaft e përhapur jo vetëm në të folmet

shqipe të Maqedonisë, por edhe më gjerë. Rrjedhimisht kjo veçori shfaqet shpesh edhe në ligjërimin letrar të folësve të këtij areali, qoftë në formën e folur, qoftë në formën e shkruar. Vlen të përmendet me këtë rast se edhe maqedonishtja ka një formë të vetme të përemrit vetor të vetës së tretë të shumësit për të dy gjinitë (тие (tie), për gjininë mashkullore e gjininë femërore). Po kështu, jorrallë në vend të përemrave vetorë *ne, ju* përdoren gabimisht trajtat e tyre të rasave të zhdrejta: *neve, juve* (*neve* kemi punuar, *juve* jeni të zellshëm).

#### 16. Përdorimi i panevojshëm i përemrave vetorë para foljeve.

Nën ndikimin e gjuhëve të huaja (të anglishtes, gjermanishtes ose frëngjishtes), por edhe për të vënë në pah a mbitheksuar vetveten ose partinë, organizatën, shoqatën e tij, veçmas politikanët përdorin përemrat vetorë shumë shpesh, saqë çdo fjali e frazë e fillojnë me *unë* ose *ne*, sipas tipit: *Unë* ju premtoj se do ta asfaltoj rrugën ... *Ne* si parti kemi punuar ... *Unë* ju garantoj se ... Përgjithësisht, dihet se në gjuhën shqipe nuk është e nevojshme që përemrat vetorë të përdoren para foljeve, sepse mbaresat foljore janë tregues të vetëmjaftueshëm të vetës, meqë dëftojnë edhe kryesin e veprimit.

Dihet se në shqipen (si edhe në maqedonishten) nuk ka nevojë të përdoren përemrat vetorë para foljeve, për shkak se mbaresa foljore është tregues i vetëmjaftueshëm i vetës, përkatësisht me kallëzuesin (foljen, veprimin) shprehet edhe kryefjala (kryesi i veprimit, personi që e kryen veprimin). Në këtë drejtim, shqipja si edhe maqedonishtja ka zgjedhim të pasur foljesh aq sa pothuajse për çdo vetë ka mbaresa foljore të posaçme (me ndonjë përjashtim), andaj te këto gjuhë nuk është e udhës para çdo foljeje të përdorim edhe përemrin vetor. Përkundër kësaj, te disa gjuhë, si në frëngjishten shumë folje kanë formë të njëjtë për disa veta, si fjala vjen, në kohën e tashme njëjës, veta I: je *travaille* (unë punoj), veta II: tu *travaille* (ti punon), veta III: il (elle) *travaille* (ai (ajo) punon). Pra, për tri vetat e njëjësit përdoret e njëjta formë e foljes: *travaille* dhe prandaj përdorimi i përemrit vetor para foljes është i detyrueshëm.

17. Përdorimi i pavend i formave rasore të emrave. Gabimet në mospërdorimin e rasës gjinore në shkrimet gazetareske në Maqedoni janë shumë të shpeshta. Në shpalljet a konkurset për punësim, në gazetatat shqipe në Maqedoni rëndom lexojmë: *Një arsimtar për gjuhë maqedonase, për histori, për fizikë, për kimi, për gjuhë angleze, për sociologji* (Lajm, 07.12.2012, f. 28, 29, 30; në vend: një arsimtar të maqedonishtes, të historisë, të fizikës, të kimisë, të anglishtes, të sociologjisë).

Dukuri shumë e shpeshtë është zëvendësimi i formës së drejtë të gjinores së emrit me parafjalë + emër (sipas modelit të anglishtes, maqedonishtes ose të ndonjë gjuhe tjetër që nuk ka lakim). Rëndom, te ne shkruhet gabimisht: *Ministri për punë të jashtme të Maqedonisë, Ministria*

*për arsim dhe shkencë* (në vend: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës); *Fakulteti filologjik, Fakulteti ekonomik* (në vend Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Ekonomisë etj.).

**18. Adresimi i letrave me “*deri te*”.** Në adresimin e letrave, kërkesave, lutjeve dhe përgjithësisht të ndonjë shkresaje zyrtare rëndom shkruajmë gabimisht: *deri te... Ministria për arsim dhe shkencë, Byroja për zhvillimin e arsimit, Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit filologjik... Dokumentet dorëzohen deri te Arkivi I Drejtorisë ...* (Lajm, 07. 10. 2012, f. 12). *Ivanov* dërgoi letër ngushëllimi *deri te* presidenti i Turqisë. Për këtë çështje Qeveria në gjysmën e parë të vitit ka dhënë drejtime konkrete *deri te* ministritë kompetente me çka, sipas Atanasoskit, punët kanë shkuar në drejtim më të mirë, ndërsa Drejtoria doganore ka marrë një seri aktivitete për lehtësimin dhe shpejtimin e transportimi të dërgesave ndërkombëtare. (Koha, 12 октомври 2015) etj.

Mbështetur në normat e shqipes standard emir i institucionit që i drejtohem i duhet të shkruhet në rasën gjinore, përkatësisht si: *Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, Këshillit Mësimor-shkencor të Fakultetit të Filologjisë.*

Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e sjellë, epidemi e përhapur te ne është jo vetëm përdorimi i emrave në emërore me parafjalë në vend të formës së drejtë të tyre në rasën gjinore, por edhe shkrimi i emrave të institucioneve vetëm me shkronjën e parë të madhe e me të gjitha shkronjat e tjera të vogla, nën ndikimin e rregullave të drejtshkrimit të maqedonishtes.

**19. Fjala shqipe a termi i shqipëruar në vend të fjalës së huaj apo termit joshqip.** Zakonisht ashtu siç të kujdesemi gjithnjë për pastërtinë e trupit tonë, mjedisit dhe përgjithësisht për natyrën, ashtu duhet të kujdesemi edhe për pastërtinë e ligjërimit. Shqipja, si edhe shumë gjuhë të tjera të popujve të vegjël kanë qenë dhe ende janë nën ndikimin e fuqishëm të gjuhëve të huaja, veçmas me depërtimin e vullshëm e shpeshherë të panevojshëm të fjalëve të huaja. Parimisht, sa më pak fjalë të huaja aq më mirë për të ruajtur qenien e një gjuhe si dhe për jetëgjatësinë e saj. Të pavetëdijshëm për këtë rrezik, mediat tona po përdorin pa nevojë një mal fjalësh të huaja, e më së shumti anglicizma. Shumë shpesh po dëgjojmë e po lexojmë: peshore *precize* – peshore e saktë; *definicion* – përkufizim; *kuantitet* – sasi; mënyrë *direkte* – mënyrë e drejtpërdrejtë; *presion* – trysni; *esencial* – themelor; *medicinë* – mjekësi; *inorganike* – duhet: joorganike); *nomenklaturë* – emërtim, emërtesë etj.

**20. Përkthimi i fjalëpërfjalshëm.** Një dukuri shumë e përhapur në tekstet e mjeteve të informimit shqip në Maqedoni është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i disa fjalive, togfjalëshave e shprehjeve, me fjalë e shprehje sipas gjedhës së huaj. Në pjesën më të madhe të rasteve përdoret

gabimisht ndonjë fjalë në vend të fjalës përkatëse që përdoret në mbarë shqipen, si “*edhe atë*” në ndikimin e maqedonishtes “i toa”: “Këtë vit, më së shumti reklamime janë paraqitur për *dërgesat të* humbura postare nga ana e operatorit kombëtar *edhe atë* gjithsej 2046. (Koha, 12 tetor 2015). *Numri i aksidenteve edhe atë për 400 më pak se vitin e kaluar. ... është votuar vendim* (maq. e izglasana odluka), *për vitin shkollor 2012/2013 viti* (në maqedonishten pas shifrës së vitit rregullisht shkruhet fjala vit - godina): *deri më datë 31. korrik 2012 viti* (Lajm, 07.12.2012, f. 18), *profesor i çrregullt* (nga maq. vonreden profesor - në vend të prof. inordinar ose prof. asistent), *përgatitje dimërore* (Koha, 07.12.2012, f. 9, në vend të fjalës pajisje).

Po kështu, e gabueshme është edhe shprehja “*ndaj mendimin me ...*” në vend “pajtohem me mendimin e...” Një dukuri e shpeshtë në mjetet e informimit në gjuhën shqipe në Maqedoni është shprehja “*vjen deri te*” që është kalk nga maqedonishtja “doagja do” si në fjalinë: *Nëse vjen deri te takimi...*, (për: Nëse takohen)... *Dokumentet dorëzohen deri te Arkivi I Drejtorisë...* (Lajm, 07. 10. 2012, f. 12) etj.

Një ndikim tipik është edhe përdorimi i ndajfoljes “*gjatë kohë*” kalk nga “dollgo vreme” në vend të shprehjes “për një kohë të gjatë”. Formë e papranueshme është edhe kalku “*në pyetje është*” nga “maq. vo prashanje e” në vend që të thuhet “fjala është për” ose *kjo është pyetje e rëndësishme* nga “maq. ova e značajno prashanje” në vend që të thuhet “kjo është çështje e rëndësishme”.

Gjatë shfletimit të gazetave ditore që botohen në Maqedoni gjejmë edhe fjali me mospërshtatje të përcaktorëve në gjini, përdorime të gabueshme të fjalëve nga pikëpamja kuptimore etj., si p.sh.: *Paralajmërohet drejtuesit e automjeteve që të mos marrin rrugë pa ndonjë nevojë dhe pa përgatitje dimërore* (duhet: Paralajmërohen ...pa pajisje..., Koha, 07. 12. 2012, f. 9). Më 19 dhjetor do të zhvillohet *spektri i bukurës* (Lajm, 07.12.2012, f. 16, duhet: konkursi, spektakli i bukurisë) etj.

**21. Renditja e fjalëve në fjali sipas gjedhes së huaj.** Në stilin administrativ, shoqëror-politik si dhe në stile të tjera të ligjërimit në Maqedoni është e shpeshtë renditja e fjalëve në fjali sipas gjedhes së huaj, veçmas sipas topikës së fjalëve në maqedonisht e në anglisht.

Mjafton të rikujtojmë me këtë rast propozim-emrin e mëparshëm të Maqedonisë: *Republika Ilindenase e Maqedonisë*, edhe më keq *Republika Ilinditase e Maqedonisë* (në vend të formë së drejtë: Republika e Maqedonisë së Ilindenit). Ja disa të tilla: *Në origjinal ose kopje e vulosur të diplomës ose certifikatë për arsimin e mbaruar* (Lajm, 7.12.2012, f. 29). *Origjinal ose kopje e vulosur nga diploma ose vërtetim për arsimin e kryer* (Lajm, 07.12.2012, f. 30). *Të zotërojnë gjuhën maqedonase dhe literaturë* (në vend: Të zotërojnë gjuhën dhe letërsinë maqedonase; në një shpallje, Lajm, 07.12.2012, f. 28). *Deri më 31.08. 2013 viti* (maq.: do 31. 08 2013 godina);



Lajm, 07.12.2012, f. 28, 29, 30); *deri më datë 31.08.2012 viti* (Lajm, 07.12.2012, f. 18). *Që pritet të jep mundësi për pranimin në kohë të sa më të shpejt të kësaj dispozite* (Lajm, 07.12.2012, f. 7). *Takimi shpejtë është dashur të ndërpritet sepse në aspektin e kohës kaloi në ditën e enjte* (duhet: shpejt, presje para lidhëzës sepse, mendimi nuk shprehet qartë; Lajm, 07. 12.2012, f. 2). *Shpallje publike për punësim në kohë të caktuar deri më datë 31 gusht 2012 viti në dimenzionet vijuese: një arsimtar për informatikë, dy arsimtarë për mësim klasor...* (Lajm, 07.12.2012, f. 30).

**22. Tekst i pakuptueshëm.** Ndonjëherë na bie të lexojmë fjali e periudha të paqarta a vështirë të kuptueshme deri në tekste të pakuptueshme: *Evropa, sipas vlerësimit të ekspertëve, paraqitet mirë për në përballje me krizën* (Koha, 11 tetor 2015). *Në terma afatmesëm, duhej të arrihej edhe integrimi i tyre në tregun e punës.* (Koha, 11 tetor 2015).

**Si përfundim**, mund të thuhet se për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) e kulturës së dobët gjuhësore shpeshherë ndodhin përzierje kodesh. Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor – pak fjalë nga shqipja e pak fjalë nga gjuha e huaj.

Dukuria e përzierjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip.

### **Masat që duhet ndërmarrë për mirësimin e kësaj gjendjeje dhe për mbrojtjen e shqipes**

Për të përmirësuar këtë gjendje të pamirë, me pasoja të rënda për gjuhën shqipe, ndihmesë të madhe duhet të japim të gjithë: familja, shkolla, intelektualët, institucionet shtetërore dhe gjithë shoqëria jonë. Çfarë masash duhet ndërmarrë për të përmirësuar këtë gjendje jo të mirë:

- prindërit duhet të kujdesen më shumë për arsimin e fëmijëve, për kulturën gjuhësore si dhe për kulturën e tyre të përgjithshme;
- mësimdhënësit duhet të punojnë më me përkushtim, me zell dhe me metoda të reja ndërvepruese (interaktive) dhe të zbatojnë normat letrare;
- të motivohen nxënësit e studentët për të lexuar sa më shumë vepra letrare me vlera;
- të sigurohen tekste mësimore cilësore;
- mjetet e informimit të jenë më të kujdesshëm në zbatimin e normës gjuhësore, të emetojnë më shumë programe arsimore e edukative;
- nga organet kompetente, të investohet më shumë në arsim;

- të themelohet një Këshill për gjuhën shqipe që do të mbikëqyr, japë këshilla e sugjerime për problemet e zbatimit praktik të shqipes standarde;
- të punësohen njerëz kompetentë, lektorë të aftë e të zellshëm në organet e administratës shtetërore e publike, redaksitë e mjeteve të informimit etj.;
- kultura e gjuhës të jetë lëndë e domosdoshme në programet mësimore të të gjitha fakulteteve;
- të organizohen seminare, takime pune, punëtori e kurse me arsimtarët, gazetarët, administratorët për të vetëdijësuar, përmirësuar e ngritur kulturën e tyre gjuhësore;
- të ngrihet statusi zyrtar i shqipes nga gjuhë me përdorim të kufizuar në komunat me mbi 20% në gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë;
- të rregullohet me ligj ndëshkimi i shkeljes së normës gjuhësore; dhe krejtësisht në fund:
- të ngrihet vetëdija jonë se ruajtja e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës, zbatimi i saj në praktikë është jo vetëm detyrë individuale e çdo shqiptari, por edhe detyrë kombëtare, sepse pastërtia e gjuhës është treguesi më i mirë i ruajtjes së pastërtisë së kombit. Parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël. Nëse e ruajmë gjuhën, do ta ruajmë edhe identitetin kombëtar. Po ta ndotim gjuhën, do ta ndotim edhe kombin. Po ta humbim gjuhën, do ta humbim edhe kombin.

### **Literatura e konsultuar:**

Gazetat *Lajm, Koha, Zhurnal, Shkup.*

Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Sak-stil, Shkup, 2011.

Hamiti, Asllan, *Shqipja standarde dhe kultura gjuhësore*, Gjuha shqipe, viti XXVIII, 2/2010, Prishtinë, 2010.

Hamiti, Asllan, *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni*, Shqyrtime albanologjike 8, Shkup, 2005.

Hamiti, Asllan, *Sistemi rasor i shqipes dhe përdorimi i emrave të përveçëm të huaj*, kumtesë e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, mbajtur më 13-24. 08. 2007 në Prishtinë.

Hamiti, Asllan, *Shqipja standarde dhe kultura gjuhësore te ne*, Konferenca e dytë Albanologjike, Ohër, 23-27 shtator 2008.

Hamiti, Asllan, *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni*, Scupi 2, Shkup, 2012.

Hamiti, Asllan, *Diglosia në Maqedoni dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe*, Kumtesat nga Konferenca "Java e Shkencës 2012", Prishtinë, 2012.

Hamiti, Asllan, *Shqipja në dokumentet zyrtare në Maqedoni*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 16–17 tetor 2015.

Lafe, Emil, *Gjuha e medias sot – probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1–2/2000, Tiranë.

IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.

Shkurtaç, Gjovalin, *Urgjenca gjuhësore*, Tiranë, 2017.

Shkurtaç, Gjovalin, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë nr. 1–2, 2000, Tiranë, 31-40.

Omari, Anila, *Problemi më i madh sot, kultura e dobët gjuhësore*, në <http://www.forumishqiptar.com>; shkarkuar më 23. 07. 2020.

#### 4. GJUHA E TEKSTEVE SHKOLLORE TË KIMISË TË ARSIMIT FILLOR NË MAQEDONI<sup>79</sup>

Kultura gjuhësore është pjesë përbërëse e kulturës së përgjithshme shoqërore dhe individuale. Shqipja standarde ka marrë një rrugë të mbarë të përsosjes së përhershme, pasurimit, herrjes dhe zhvillimit të hovshëm. Gjuha, siç dihet, është pasqyrë e kulturës dhe e të arriturave të gjithmbarshme të një populli, por edhe e çdo pjesëtari të tij. Ajo pëson ndryshime, zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Por, ky zhvillim i gjuhës varet prej njerëzve që e flasin atë. Gjuha standarde shqipe në Maqedoni po përdoret në institucionet arsimore, në mjetet e informimit, në veprat letrare e shkencore, në tekstet shkollore etj.

Mjetet e informimit, si shtypi ashtu edhe radioja e televizioni, kanë rëndësi të madhe jo vetëm si medime më masive të informimit publik, por edhe si mjete e burime për formimin gjuhësor të lexuesve, dëgjuesve dhe të teleshikuesve, meqë drejtpërdrejt ndikojnë për përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare të gjithë popullata shqiptare në Maqedoni e më gjerë. Prandaj, gjuha e gazetave, e radios dhe e televizionit duhet t'u përgjigjet rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore të shqipes standarde.

Marrë në tërësi, norma e shqipes standarde dukshëm po zbatohet në shkollat shqipe, në mjetet e informimit publik etj. Megjithkëtë, jemi dëshmitarë se në praktikën gjuhësore shpeshherë po thyhen normat në të gjitha rrafshet, si në rrafshin leksikor, sintaksor (si pjesë më të lëvizshme të

<sup>79</sup> Kumtesë imja botuar në përmbledhjen e punimeve të Seminarit V Ndërkombëtar të Albanologjisë, 3-4. 10. 2011, Tetovë – Shkup, f. 47-51. Ky artikull është postuar edhe në: <https://tradita.org/2020/01/26/gjuha-e-teksteve-shkollore-te-kimise-te-arsimit-fillor-ne-maqedoni/>, shkarkuar më 29. 06. 2020.

gjuhës e më të eksponuara ndaj ndikimeve të huaja), në rrafshin morfologjik, fonetik e fonologjik etj. Disa gazetarë, redaktorë gjuhësorë, përkthyes, lektorë, korrektorë etj., nga pakujdesia, puna e ngutshme, joserioziteti në punë, papërgjegjësia ose nga mosnjohja e mjaftueshme e normave të shqipes standarde, bëjnë gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme.

Jo rrallë vërehen ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku pëstjellohet mendimi deri në moskuptim.

Shkelje të normave të shqipes standarde paraqet edhe përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja. Siç dihet, varësisht nga shtrirja gjeografike, përkatësia administrative nëpër disa shtete ballkanike, kontakti shumëshekullor përfshirë lidhjet historike, ekonomike, kulturore me gjuhë të tjera etj., ka laramani sasiore të huazimeve leksikore nëpër të folmet shqipe. Thënë ndryshe, si në shqipen me vazhdimësi tokësore e gjuhësore, ashtu edhe në shqipen e diasporës diku ka më pak e diku më shumë fjalë të huaja: greke, turke, sllave, neolatine etj.<sup>80</sup> Disa nga këto fjalë të huaja janë mishëruar thellë në të folmet dialektore, kanë përhapje të përgjithshme në tërë shqipen dialektore. Një numër i konsiderueshëm fjalësh të tilla janë bërë edhe pjesë e leksikut të gjuhës standarde shqipe. Këto më vështirë zëvendësohen me fjalë të shqipes, edhe pse ekziston një mundësi e tillë. Por, ka edhe të tilla që kanë përhapje të ngushtë territoriale (në një krahinë, në një grup të folmesh, në disa të folme, në një të folme). Fjalët e këtilla nuk janë të pranueshme për normën leksikore letrare. Përveç ndikimit të vijueshëm të italishtes (sidomos në Shqipëri), kohët e fundit në shqipen letrare vërehet një ndikim gjithnjë e më i madh i anglishtes. Rritja e numrit të fjalëve angleze dhe në përgjithësi e fjalëve të huaja është thyerje e

---

<sup>80</sup> Të folmet në Shqipëri kanë qenë më tepër nën ndikimin e italishtes e të greqishtes, ndërsa të folmet e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut nën ndikimin e gjuhëve sllave. Gjuhët neolatine në Shqipëri kanë ndikuar me rrugë të drejtpërdrejtë, ndërsa në shqipen e ish-Jugosllavisë me ndërmjetësimin e serbishtes e të maqedonishtes. Terminologjia teknike në Shqipëri ka shumë huazime nga italishtja e frëngjishtja, kurse në Kosovë e Maqedoninë e Veriut nga gjermanishtja: khs. *ashensor* dhe *lift*, *autostradë* e *autoban*, *celular* e *mobil*, *bagazh* e *gepek* etj. Dallimet e tilla janë të pranishme edhe në gjuhë të shteteve të njësishtme. Në shqipen këto janë rezultat i veçimit të gjatë të shqiptarëve, por dallimet e tilla leksikore gjithnjë e më shumë po zvogëlohen, sidomos me mëvetësimin e Kosovës nga Serbia dhe në Maqedoninë e Veriut me sigurimin e mundësisë së shkollimit më të gjerë të shqiptarëve në gjuhën amtare edhe në shkollimin sipëror, me përmirësimin e statusit të shqipes si gjuhë e dytë zyrtare në komunat me mbi 20% shqiptarë.

normës leksikore e stilistikore të shqipes.<sup>81</sup> Parimisht, sa më pak fjalë të huaja të përdorim në ligjërimin tonë, do të ishte aq më mirë.

Procesi i globalizimit (që nga forcat e mëdha çmohet si shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të lirë dhe për shoqërinë e hapur, për zbatimin e parimeve të demokracisë dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përpjesëtime botërore), po bëhet rrezik për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë edhe mëtej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Ajo edhe tani si gjuhë zyrtare ose gjysmëzyrtare përdoret në më shumë se 60 shtete, kurse vend të posaçëm zë edhe në 20 vende të tjera. E gjithë bota e kulturuar kujdeset të mësojë anglishten; nga sasia e përgjithshme e informatave në kujtesën e sistemeve elektronike, 80% janë në anglisht. Nën ndikimin e anglishtes shkombëzohen gjuhë amtare. Mund të parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël.<sup>82</sup>

Shqiptarët e Maqedonisë janë dygjuhësorë: përveç gjuhës amtare dinë edhe maqedonisht e ndokush edhe turqisht ose ndonjë gjuhë tjetër. Maqedonishtja ka qenë dhe sot e kësaj dite është gjuhë zyrtare, gjuhë e shkollimit sipëror të një numri të konsiderueshëm shqiptarësh, gjuhë që krahas gjuhës amtare zhvillohet në shkollat fillore e të mesme që nga klasa e tretë. Ajo ka përhapje shumë më të madhe se gjuha shqipe në mjetet e informimit, në jetën publike, shoqërore, sportive, administrative e shoqërore. Në këtë gjendje diglosie janë huazuar shumë sllavizma, konstrukte fjalësh, janë krijuar kalke e sintaksa e ligjërimin shqip në Maqedoni është vërshuar nga renditja e natyrës sllave. Edhe pse parimisht shumica e gazetarëve shqiptarë përpiqen ta ruajnë natyrën e shqipes, duke respektuar parimin sa më pak fjalë e ndërtime të huaja në ligjërimin tonë, është aq më mirë; megjithkëtë ndikime nga maqedonishtja hetohen mjaft shpesh.

Marrë në përgjithësi mund të themi se tekstet shkollore të arsimit parauniversitar në gjuhën shqipe në Maqedoni janë të një niveli jo të kënaqshëm. Për një gjendje të këtillë të palakmueshme fajin e kanë së pari institucionet përgjegjëse shtetërore. Për shkak të kompensimit material të vogël për libra shkollorë në konkurset që shpall Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Maqedonisë arrijnë pak dorëshkrime. Autorët e kanë për detyrë të dorëzojnë dorëshkrimin të përgatitur edhe teknikisht, duke përfshirë të gjitha skicat, vizatimet e kopertinën. Ashtu siç dorëzohet nga hartuesit, në

<sup>81</sup> Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 92-100.

<sup>82</sup> Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 31-36.

formatin PDF shtypshkronja e nxjerr në letër. Për të përpiluar një tekst të mirë, hartuesi apo hartuesit duhet të kenë përgatitje profesionale bashkëkohore, të njohin materien që shtjellojnë, të kenë njohuri të shkëlqyera metodike e didaktike, të njohin mirë shqipen standarde, të jenë piktorë dhe kenë aftësi në përdorimin e kompjuterit, në veçanti ato të përgatitjes teknike të tekstit. Njerëzit e këtillë me të gjitha këto aftësi e shkathtësi janë të rrallë ndër ne. Hartimi i librave shkollorë kërkon punë ekipore profesionale, e këtë nuk mund ta sigurojë konkurruesi meqë nuk është e sigurt se pikërisht dorëshkrimi i tij do të përzgjidhet nga komisioni recensues dhe se ato pak mjete që i jep porositësi nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet materiale e as për të siguruar një honorar të vogël për pjesëmarrësit e grupit.

Në këto kushte dhe rrethana tejet të rënda, mosinteresimit të organeve gjegjëse për shkolla shqipe cilësore, përfshirë edhe tekstet shkollorë në gjuhën shqipe në Maqedoni. Në këtë kumtesë do të shtjellojmë gjuhën e teksteve shkollorë të kimisë të arsimit fillor në Maqedoni.

Siç dihet, teksti shkollor është burim i diturisë dhe mjeti mësimor i formësuar në pikëpamje didaktike për arritjen e qëllimeve edukative-arsimore në mësim dhe nxënie. Ai duhet t'i mundësojë nxënësit që të arrijë standarde të caktuara njohurish dhe ta nxisë zhvillimin e aftësive:

a) në *pushën kognitive* për të kuptuar, për të zbatuar njohuritë, për të analizuar e sintetizuar;

b) në *pushën afektive* për të zhvilluar aftësitë e pranimit dhe të përvetësimit të vlerave dhe si pikësypnim kryesor - formimin e personalitetit; dhe

c) në *pushën psikomotorike* për të përvetësuar shkathtësi, nxitur të menduarit dhe për të jetësuar në praktikë njohuritë e fituara.<sup>83</sup>

Marrë në përgjithësi mund të themi se tekstet shkollorë të arsimit parauniversitar në gjuhën shqipe në Maqedoni janë të një niveli jo të kënaqshëm.

Për të përpiluar një tekst të mirë, hartuesi apo hartuesit duhet të kenë përgatitje profesionale bashkëkohore, të njohin materien që shtjellojnë, të kenë njohuri të shkëlqyera metodike e didaktike, të njohin shqipen standarde e të shkruajnë atë në një stil të përshtatshëm për moshën e nxënësve etj.

Niveli gjuhësor i librave shkollorë të përkthyer nga maqedonishtja në shqip është edhe më e palakmueshme. Përkthehen pothuajse të gjitha librat e arsimit fillor dhe të mesëm, përveç librave të gjuhës shqipe. Në pjesën dërmuese të këtyre librave gjejmë gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme, si:

---

<sup>83</sup> Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Koncepcioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*, Shkup, maj, 2006, f. 7.

- përkthim të fjalëpërfjalshëm me sintaksë të maqedonishtes;
- përdorimin e larmishëm e të panjësuar të termave;
- mospërdorimin me vend të emrave në rasa;
- përdorimin e shumë fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe;
- gabime kuptimore, aq sa në tekste shkollore mund të gjejmë edhe fjali me kuptime të errëta ose periudha të gjata e të pakuptueshme;
- po kështu, gjejmë edhe gabime të shumta drejtshkrimore, të natyrës fonetike e morfologjike, veçmas në përdorimin e ë-së, rr-së, y-së, q-së, gj-së etj.

Mësimi i kimisë si lëndë më vete te ne fillon në klasën VII e vazhdon në klasat pasuese, ndërsa në klasat paraprake nxënësit marrin bazat e shkencave natyrore (kimisë, fizikës e biologjisë) në lëndën mësimore dituri natyre.

Në vrojtimin tonë në librat e kimisë për arsimin fillor në Maqedoni arritëm të hetojmë disa mangësi gjuhësore, por jo edhe aq sa mund të gjesh përgjithësisht nëpër tekste të tjera mësimore të përkthyer:

1. Në vend të disa fjalëve të huaja, do të ishte më mirë të përdorehin fjalët shqipe tani më mjaft të përhapura, si: peshore *precize* (f. 17) – peshore *e saktë*; *definicion* (f. 20) - përkufizim; *kuantitet* (f. 24) – sasi; mënyrë *direkte* (35) – mënyrë e drejtpërdrejtë; *presion* (f. 78) – trysni; *esencial* (52) – themelor; *medicinë* (f. 52) – mjekësi; *inorganike* (f. 58, duhet: joorganike); *nomenklaturë* (f. 74, 80, 85, 101, 110) – emërtim, emërtesë etj.

2. Përdorimi i gabueshëm i fjalëve për nga kuptimi, si: ... *dhënia e elektroneve* (f. 6, duhet: lirimi i elektroneve); *Pranë vetive të përbashkëta ...* (f. 36, duhet: përveç vetive të përbashkëta...); *Bërllogu prej metali që duhet të riciklohet* (f. 39, duhet: Mbetjet metalike që duhet ricikluar ...; *Gjatë të fotografuarit të freskave, ngjyrat kanë qenë të futura në mallter ose gjips* (f. 42, duhet: Gjatë pikturimit të freskave, ngjyrat paraprakisht janë përzier me llaç ose gjips...; *nga provat e zhvilluara* (f. 98, 125, duhet: nga provat e bëra);

3. Aty-këtu gjejmë edhe gabime në renditjen e fjalëve në fjali, sipas topikës së fjalëve në maqedonishte: *Përqindja më e lartë në organizmin e derrave, i takon yndyrave* (f. 122, duhet: Yndyrat janë përbërësit kryesorë të organizmit të derrave) etj.

4. Gabime drejtshkrimore të natyrës fonetike e morfologjike, si: *shqytrojmë* (f. 6) – në vend të formës normative *shqyrtojmë*; më lehtë liron elektrone *se sa metali ...* (f. 13, duhet: sesa); *është sjellur* (f. 29, duhet: është sjellë); *do t'a gjejmë* (f. 13, duhet: do ta gjejmë); *munden ta ndajnë* (f. 46, duhet: mund ta ndajnë); *përshkak* (f. 65, 90, duhet: për shkak); *për tu lidhur* (f.72, duhet: për t'u lidhur); me *ç'rast* lirohet (f. 75, 77, duhet: me çrast);

janë *nxjerrur* (f. 69, duhet: janë nxjerrë);<sup>84</sup> *egzistojnë* (f. 78, 80, 81; duhet: ekzistojnë, ka); *shum* (f. 124, duhet: shumë); në *munges* (f. 134, duhet: në mungesë); tani më e *din* (f. 132, duhet: tani më e di); *gjithëmonë* (f. 26, duhet: gjithmonë); *qirinjtë* (f. 75, duhet: qirinjtë); *ato shkrihen* (f. 75, duhet: ata shkrihen).

5. Përdorimi pa nyjë i përemrit të pacaktuar: ... në shumë *procese tjera* ... (f. 6); mungon nyja *i, e ose të*, pra duhet: në shumë procese të tjera. ... mund të nxirren të gjitha *madhësitë tjera* (f. 17, duhet: madhësitë e tjera). Kështu është edhe te *rastet tjera* (f. 10, duhet: rastet e tjera). *Metale tjera* (f. 33, duhet: metale të tjera). *Metalet tjera* (f. 37, duhet: metalet e tjera). Kështu është edhe *tek numri i madh i kompozimeve tjera* organike (f. 64, duhet: Kështu është edhe te shumica e kompozimeve të tjera organike). Disa *komponime tjera* (f. 122, duhet: disa komponime të tjera).

Teksti i kimisë, si edhe i librave të tjerë të arsimit fillor të përkthyer, lëngon në disa vende edhe nga përdorimi pa vend i shenjave të pikësimit, veçmas në përdorimin e presjes, si duket nën ndikimin e tekstit në maqedonisht.

Për të pasur rini të arsimuar e të edukuar duhet të kemi edhe tekste shkollore cilësore e pedagogë të mirë. Njohuritë që nxënësit i marrin në shkollimin fillor, janë të dobishme për gjithë jetën.

Prandaj, në të ardhmen të gjithë ata që përfshihen në përgatitjen dhe botimin e teksteve shkollore: Ministria e Arsimit, hartuesit, përkthyesit, redaktorët, recensentët, lektorët, korrektorët, ilustruesit, përpunuesit teknikë, botuesit etj., këtë veprimtari të rëndësishme për gjithë shoqërinë dhe ardhmërinë tonë duhet ta kryejnë më me përkushtim, përgjegjësi e profesionalizëm.

Teksteve shkollore duhet kushtuar shumë më tepër kujdes sesa deri më tani si në pikëpamje përmbajtjesore, ashtu edhe në pikëpamje metodike-didaktike e gjuhësore, sepse “**çdo të mbjellim, do të korrим.**”

### Bibliografia

Libra shkollorë të kimisë për asimin fillor tetëvjeçar, botuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Konceptioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*, Shkup, maj, 2006.

Qosja, Rexhep (2002). *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, Tiranë.

Shehu, Hajri (2002). *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*. Studime filologjike nr. 3-4, Tiranë.

<sup>84</sup> Dihet mirëfilli se foljet apofonike që mbarojnë me -ll, -ll rr në pjesore nuk marrin ndajshitesën -ur. Pra, duhet kam sjellë, kam mbjellë, kam marrë, kam korrë e jo kam sjellur, kam mbjellur, kam marrur, kam korrur etj.



## 5. NIVELI METODOLOGJIK I GRAMATIKAVE TË GJUHËS SHQIPE TË ARSIMIT FILLOR NË MAQEDONI<sup>85</sup>

Marrë në përgjithësi mund të themi se tekstet shkollore të arsimit parauniversitar në gjuhën shqipe në Maqedoni janë të një niveli jo të kënaqshëm. Për një gjendje të këtillë të palakmueshme fajin e kanë së pari institucionet përgjegjëse shtetërore. Për shkak të kompensimit material të vogël për libra shkollorë në konkurset që shpall Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Maqedonisë arrijnë pak dorëshkrime. Autorët e kanë për detyrë të dorëzojnë dorëshkrimin të përgatitur edhe teknikisht, duke përfshirë të gjitha skicat, vizatimet e kopertinën. Ashtu siç dorëzohet nga hartuesit, në formatin PDF shtypshkronja e nxjerr në letër. Për të përpiluar një tekst të mirë, hartuesi apo hartuesit duhet të kenë përgatitje profesionale bashkëkohore, të njohin materien që shtjellojnë, të kenë njohuri të shkëlqyera metodike e didaktike, të njohin mirë shqipen standarde, të jenë piktorë dhe të kenë aftësi në përdorimin e kompjuterit, në veçanti përgatitjen teknike të tekstit. Njerëzit e këtillë me të gjitha këto aftësi e shkathtësi janë të rrallë ndër ne. Hartimi i librave shkollorë kërkon punë ekipore profesionale, e këtë nuk mund ta sigurojë konkurruesi meqë nuk është e sigurt se pikërisht dorëshkrimi i tij do të përzgjidhet nga komisioni recensues dhe se ato pak mjete që i jep porositësi nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet materiale e as për të siguruar një honorar të vogël për pjesëmarrësit e grupit.

Çështja e librave shkollorë të përkthyer nga maqedonishtja në shqip është edhe më e palakmueshme. Përkthehen pothuajse të gjitha librat e arsimit fillor dhe të mesëm, përveç librave të gjuhës shqipe. Në pikëpamje metodike-didaktike, grafike e teknike këto tekste të përkthyer janë të pranueshme, por në aspektin gjuhësor në pjesën dërmuese të këryre librave kemi një gjysmëshqipe. Për shkak të papunësisë së madhe, për një honorar shumë të vogël, në të shumtën e rasteve përkthimin e bëjnë njerëz joprofesionistë, shkel e shko, duke pandehur se çdokush që di shqip e maqedonisht mund të përkthejë nga njëra gjuhë në tjetrën. Edhe përsikaj një redakturë gjuhësore që kinse bëhet, prapëseprapë në librat shkollorë të përkthyer gjejmë gabime të natyrave të ndryshme, si:

- përkthim të fjalëpërfjalshëm me sintaksë të maqedonishtes;
- përdorimin e larmishëm e të panjësuar të termeve;
- mospërdorimin me vend të emrave në rasa;
- përdorimin e shumë fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe;
- gabime kuptimore, aq sa në tekste shkollore mund të gjejmë edhe fjali me kuptime të errëta ose periudha të gjata e të pakuptueshme;

<sup>85</sup> Kumtesë imja e lexuar dhe e botuar me të njëjtin titull në përbledhjen e punimeve të Seminarit XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2011, f. 301-308.

- po kështu, gjejmë edhe gabime të shumta drejtshkrimore, të natyrës fonetike e morfologjike, veçmas në përdorimin e ë-së, rr-së, y-së, q-së, gj-së etj.

Në këto kushte dhe rrethana të mosinteresimit të organeve gjegjëse për shkolla shqipe cilësore, përfshirë edhe tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe të papërgjegjësive së disa individëve përfshihen edhe librat mësimorë të integruar të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Tekstet e gjuhës shqipe e të letërsisë të arsimit fillor në Maqedoni të hartuara nga autorë e bashkautorë të ndryshëm kanë aparaturë pedagogjike e didaktike të larmishme.

Libri i Gjuhës shqipe për kl. IV<sup>86</sup> si dhe ai për kl. VI<sup>87</sup> të arsimit fillor nëntëvjeçar dallohen nga tekstet e klasave të tjera (Gjuhë shqipe për kl. III, V, VI, VII, VIII) për nivelin didaktik-metodik që kanë, meqë mbështeten në baza shkencore-profesionale dhe didaktike-metodike bashkëkohore dhe kryejnë me sukses funksionin e zhvillimit edukativ-arsimor të nxënësit. Në to ka aparaturë didaktike të pasur, si: detyrë, plotëso, shkruaj, fjalor, analizo, ritrego, lidhni me vijë, mëso më shumë, mbani mend, mendohu, ushtrohu, të shprehurit krijues, të mësuarit kreativ, punë kreative, mësim në laborator, të kuptojmë përmbajtjen, shpjegim, këshilla praktike, bisedim, të diskutojmë, të përshkruajmë, vizitë mësimore e vizitë kërkimore etj. Në to është arritur qëllimi kryesor që libri të shërbejë si tekst themelor shkollor:

- për t'i thelluar e zgjeruar njohuritë e nxënësve;
- për të përmirësuar aftësitë që të flasin e të shkruajnë drejt dhe
- për t'u aftësuar të lexojnë, të kuptojnë e të mësojnë edhe vetë, pa ndihmën e mësimitdhënësit.

Me këto tekste, të nxënësit zhvillohet aftësia për të lexuar rrjedhshëm dhe shkruar drejt gjuhën tonë, për të parashtruar pyetje dhe për t'u përgjigjur siç duhet, për të bërë renditjen e drejtë të fjalëve e të fjalive. Po kështu, jepen udhëzime që gjatë komunikimit nxënësit të zgjedhin fjalët me të përshtatshme dhe t'i përdorin drejt ato. Ndërtimi i rregullt i fjalive është kusht i domosdoshëm për t'i thënë drejt e qartë mendimet, për të na kuptuar të tjerët.

Në librin e Gjuhës shqipe për kl. VI ka edhe shume tregime të shkurtra, përralla, përrallëza, vjersha, pjesë dramash etj., jo si pjesë të ndara, por të ndërlidhura me mësimin e gjuhës. Që në parathënien e këtij libri thuhet se "gjuha është mjeti me të cilin krijohen edhe veprat letrare. Letërsia na jep modelet më të bukura të shqipes. Veprat e shkrimtarëve janë një shkollë e gjuhës. Këto njohuri do të jenë një bazë e mirë për t'u

<sup>86</sup> Rita Petro – Natasha Pepivani, *Gjuha shqipe për kl. IV të shkollës nëntëvjeçare*, Botime shkollore, Albas, Tetovë, 2009.

<sup>87</sup> Asllan Hamiti – Ismail Hamiti, *Gjuhë shqipe për kl. VI të arsimit fillor nëntëvjeçar*, Shkup, 2011.

aftësuar dhe nxitur që nxënësit të lexojnë në mënyrë të pavarur libra e revista për fëmijë. Po kështu, do të aftësohen të kuptojnë dhe të tregojnë informata të shkurtra nga mediet: emisionet televizive, filmi, teatri, libri dhe shtypi për fëmijë.

Pasurinë e fjalëve të gjuhës shqipe nxënësit e përvetësojnë pak nga pak nga jeta e përditshme, nga shkolla e puna, por edhe nga librat, shtypi e radiotelevizioni.”

Gjuha shqipe për kl. IV të shkollës nëntëvjeçare mund të vlerësohet si një ndër tekstet më të mira në Maqedoni.

Kriteret e hartimit të tekstit. - Teksti është ndërtuar me katër rubrika kryesore, në të cilat materiali mësimor është grupuar sipas tematikës së pjesëve: 1. Unë mësoj nga të rriturit, 2. Unë mësoj nga miqtë e mi, 3. Unë mësoj nga natyra, 4. E shkuara në përralla e tregime të mpleksur me Rubrikën e poezive.<sup>88</sup>

1. *Në rubrikën unë mësoj nga të rriturit* përfshihen pjesë me tema nga jeta e përditshme e fëmijëve dhe marrëdhëniet e tyre me të rriturit. Varësisht prej kësaj teme janë zgjedhur lloje tekstesh të tilla, si: tregime realiste, përshkrime të mjediseve të përditshme (në fshat e në qytet) ditarë, letra etj., si dhe janë shpjeguar elemente të strukturës së tekstit tregimtar, si: hyrja, zhvillimi, mbyllja, tema dhe ideja (mesazhi) etj.

2. *Në rubrikën unë mësoj nga miqtë e mi* përfshihen pjesë me tematikë nga marrëdhëniet shoqërore që japin mesazhe të miqësisë së pastër, të mirëkuptimit, të mbështetjes për fëmijët në nevojë, të paqes e barazisë dhe të të drejtave të njeriut, veçanërisht të fëmijëve. Varësisht prej kësaj tematike janë zgjedhur lloje tekstesh të tilla, si: shkrimi i revistës, mesazheve, letrave, ditarit, postës elektronike etj. Gjithashtu, në këtë rubrikë përfshihen pjesë me tema që lidhen me lojërat e fëmijëve, aventurat dhe udhëtimet e tyre në vende reale dhe imagjinare.

3. *Rubrika unë mësoj nga natyra* ngërthen pjesë që sjellin imazhet e katër stinëve të vitit me bukurinë e peizazheve të tyre si dhe veprimtaritë e ndryshme të njerëzve. Këtu mbizotëron shkrimi përshkrues, i cili synon të gërshetojë tingujt, aromat dhe ngjyrat. Qëllimi i kësaj pjese të librit është kultivimi i dashurisë për natyrën dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e saj.

4. *Rubrika e shkuara në përralla e tregime* sjell përralla gojore dhe të shkruara nga shkrimtarë, si përralla me princër, me kafshë e me figura fantastike, fabula etj. Nëpërmjet tyre studiohen elemente të strukturës së përrallave, analizohen personazhet, duke zbërthyer moralin apo mesazhin që ato sjellin, si dhe tërhiqet vëmendja e nxënësve te figuracioni i tyre, i cili i lihet nxënësit që ta kuptojë dhe ta zbërthejë në mënyrë intuitive.

<sup>88</sup> Rita Petro – Natasha Pepivani, *Gjuha shqipe për kl. IV të shkollës nëntëvjeçare*, Botime shkollore, Albas, Tetovë, 2009, f. 3.

Gjithashtu, në këtë rubrikë ka legjenda, shkrime të llojit historik, që sjellin personazhe e ngjarje të vërteta historike. Po kështu, sillen informacione për figura të shquara të Rilindjes Kombëtare, trajtohet shkrimi biografik e autobiografik, tekste në dialekt, fjalë të urta etj.

Ndërmjet këtyre mplekset edhe Rubrika e poezive, e cila sjell poezi të llojeve të ndryshme sipas tematikave përkatëse.

Njohuritë gjuhësore në tekst janë integruar me pjesët letrare dhe joletrare si dhe me ushtrime për të folurin, të shkruarin dhe të dëgjuarin. Në mungesë të mjeteve elektronike, ushtrimet e të dëgjuarit parashikohen të lexohen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kërkohet të plotësojë testin e të dëgjuarit.

Një nga synimet kryesore të hartimit të tekstit në fjalë është rimarrja e njohurive pothuaj në të gjithë librin. Nëse deri në klasë të tretë nxënësi më tepër është ushtruar në të lexuar e në të kuptuarit e tekstit, tani i kërkohet që të dallojë elemente të veçanta të tekstit, si: titullin, autorin, temën, idenë, zhvillimin e ngjarjeve, strukturën e poezisë, rimën e strofën, kuptimin e figurshëm të fjalëve, si: krahasimin apo dhe shpirtëzimin e sendeve e të mjedisve.

Rubrikat didaktike synojnë një integrim të gjithanshëm të teksteve me njohuri nga muzika, piktura, media, filmi, gazeta e revista.

Në aparaturën metodike ka larmi kërkesash, si: lexojmë, shkruajmë, dëgjojmë, fjalorth, pyetje rreth tekstit, kthehu te teksti, po ti? apo si mendon ti?, detyrë, plotëso, bisedojmë së bashku, mbaj mend, ushtrohu, lidh me shigjetë, kujto, mëso më shumë e punë në grup.

Por, me keqardhje mund të themi se pjesa më e madhe e teksteve shkollore të gjuhës shqipe të arsimit fillor në Maqedoni kanë një metodologji të vjetruar e jobashkëkohore. Bie fjala, Gjuha shqipe për kl. IV të arsimit fillor nëntëvjeçar<sup>89</sup> dhe Gjuha shqipe dhe leximi për kl. VIII<sup>90</sup> kanë një aparaturë pedagogjike-didaktike të varfër me 4-5 kërkesa që përsëriten rregullisht pas çdo teksti të dhënë: fjalë dhe shprehje, bisedë rreth tekstit a vjershës, mbani mend, detyrë e rrallëherë jepet ndonjë ushtrim. Në fjalë dhe shprehje rëndom shpjegohet kuptimi i ndonjë fjale të panjohur në copën e dhënë. Biseda rreth tekstit ka pyetje stereotipe: kush?, pse?, çfarë?, çka?, si?, me kë?

Jo pak tekste shkollore të lëndës së Gjuhës shqipe të arsimit fillor në Maqedoni përgjithësisht kanë disa mangësi. Hartuesit e teksteve vëmendjen duhet ta përqendrojnë në disa çështje:

- sa përmbajtjet e gramatikave u përgjigjen moshës dhe aftësive psikike të nxënësve;

<sup>89</sup> Fejzi Bojku – Zihni Osmani, *Gjuha shqipe për arsimin fillor 9-vjeçar*, Shkup, 2009.

<sup>90</sup> Islam Karanfili – Zihni Osmani, *Gjuha shqipe dhe leximi për kl. VIII*, Shkup, 2010.

- sa ato plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe të qartësisë së gjuhës;
- sa libri i Gjuhës shqipe ka mungesa apo mbingarkesa teorike;
- ç'vend zënë detyrat, ushtrimet dhe format ndërvepruese të punës;
- sa nxitet puna e pavarur dhe veprimtaria krijuese e nxënësit;
- sa përmbajtjet u japin mundësi nxënësve të realizojnë funksionet zhvillimore: të kërkojnë, të gjejnë, të zbulojnë, të zgjidhin, të analizojnë, të provojnë, madje edhe të sintetizojnë gjërat;
- çfarë baze sigurojnë këto tekste të Gjuhës shqipe për zhvillimin e shkathëtisë të komunikimit në situata të ndryshme etj.

Teksti shkollor është burim i diturisë dhe mjeti mësimor i formësuar në pikëpamje didaktike për arritjen e qëllimeve edukative-arsimore në mësim dhe nxënie. Ai duhet t'i mundësojë nxënësit që të arrijë standarde të caktuara njohurish dhe ta nxisë zhvillimin e aftësive: a) në *fushën kognitive* për të kuptuar, për të zbatuar njohuritë, për të analizuar e sintetizuar; b) në *fushën afektive* për të zhvilluar aftësitë e pranimit dhe të përvetësimit të vlerave dhe si pikësypnim kryesor - formimin e personalitetit; dhe c) në *fushën psikomotorike* për të përvetësuar shkathëti, nxitur të menduarit dhe për të jetësuar në praktikë njohuritë e fituara.<sup>91</sup> Për të hartuar një tekst shkollor cilësor, duhet pasur para sysh që:

**a. Zgjedhja dhe sistematizimi i përmbajtjeve t'i përgjigjet moshës dhe karakteristikave zhvillimore të nxënësve:**

- të nxiten proceset njohëse dhe motivimi i nxënësve;
- të ketë përzgjedhje të mirë të ilustrimeve, vizatimeve, skemave sipas tematikës së përmbajtjeve, aktiviteteve njohëse si dhe llojit dhe peshës së detyrës;
- me përzgjedhjen e përmbajtjeve, vëllimin e tyre dhe mënyrën e sistematizimit të mos tejçmohen mundësitë zhvillimore të nxënësve, por të mos ketë edhe kërkesa që parashtrohen në nivelin e mundësive reale të nxënësve.

**b. Përmbajtjet duhet përzgjidhur me shumë kujdes:**

- teksti duhet të ofrojë përmbajtje bashkëkohore dhe informata që u përgjigjen të arriturave më të reja në shkencë;
- të mbajturit mend i fakteve, rregullave dhe riprodhimi i tyre ose mbamendja – memorimi të zëvendësohet me aktivitete hulumtuese për zgjidhjen e detyrave, problemeve, të folurit e të shkruarit etj.;

---

<sup>91</sup> Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Koncepcioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*, Shkup, maj 2006, f. 7.

- përmbajtjet e zgjedhura nga gjuha e letërsia të kenë jo vetëm sistem shkencor të nocioneve dhe të ligjshmërive, por me metodat e përpunimit të tyre të mundësohet zhvillimi i njohurive të nxënësit, formimi i botëkuptimit dhe pikëpamjeve të veta për botën dhe shoqërinë;
- gjatë zberthimit të temave mësimore në pjesë ose në njësi më të vogla të ketë sistematizim dhe ndërlidhje logjike;
- përmbajtjet të përpunojnë çështje për zbatimin e njohurive tekniko-teknologjike e informatike. Bie fjala, të trajnohen për përdorimin e programit kompjuterik për drejtshkrimin e shqipes, për përdorimin e fjalorit shpjegues elektronik, të dinë të kërkojnë e të nxiten të lexojnë materiale shtesë për gjuhën dhe letërsinë shqiptare nga literatura plotësuese, nga interneti, nga revistat, nga gazetatat, nga emisionet arsimore e shkencore etj.

**c. Libri mësimor duhet të nxisë të menduarit e të zhvillojë aftësinë për analizë dhe sintezë:**

- mënyra e përpunimit të përmbajtjeve t'ua mundësojë nxënësve që t'i njohin, përcjellin dhe t'i shënojnë rezultatet e mësimin të tyre: të parashtrojnë pyetje vetvetes, t'u parashtrojnë pyetje nxënësve, arsimtarëve, prindërve; të kërkojnë përgjigje, të zhvillojnë bisedime e debate për tema aktuale;
- me përpunimin e përmbajtjeve të krijohen situata kur nxënësi hulumton, krahason, mendon, analizon e sintetizon gjërat;
- nxënësi të udhëzohet që të mësojë më pak fakte e t'i mbetet më shumë kohë për të menduarit dhe të gjykuarit e pavarur, për të kërkuar përgjigje ose për të zgjidhur detyra;<sup>92</sup>
- të nxitet të menduarit logjik dhe kreativ, përmbajtjet dhe njohuritë të jenë bindëse që të mund të zhvillohet te nxënësi besimi në vetvete dhe në mundësitë e veta individuale;
- të bëhet lidhja e përmbajtjeve nga dy ose më shumë lëmi që i kanë mësuar nxënësit, si p.sh. të ndërlidhen gjuha me letërsinë, kulturën e të shprehurit, mediet e shkruara dhe elektronike, me artin figurativ, muzikën, historinë etj.

**ç. Teksti i gjuhës shqipe duhet të nxisë aktivitetin intelektual të nxënësit:**

- aktiviteti intelektual shtohet me përmbajtje tërheqëse, kur temat janë parashtruar në mënyrë interesante, me pyetje të qëlluara, detyra, ushtrime, ilustrime, skema etj.,

---

<sup>92</sup> Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Koncepcioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*, Shkup, maj, 2006, f. 29.

- libri duhet të jetë tërheqës dhe të sigurojë mësim bashkëveprues (interaktiv). Të ketë detyra problemore, pyetje që kërkojnë përvajtje dhe dituri më të gjerë që të nxitet interesi te nxënësi. Me këtë nxënësi do të nxitet të kërkojë burime plotësuese dhe do ta shtojë interesimin për mësim të pavarur.

**d. Në tekstin mësimor duhet të ketë përmbajtje dhe aktivitete për zbatimin e njohurive:**

- krijimin e situatave të atilla në tekst që njohuritë që i fiton nxënësi të mund t'i zbatojë në situata të ngjashme ose në detyra dhe në probleme të reja;
- të ketë detyra, ushtrime, aktivitete për zbatimin e njohurive si dhe vlerësimin e të arriturave;
- në tekst të ketë përmbajtje për përvetësimin e njohurive të reja që të përpunohen me aktivitete të pavarura hulumtuese, të mësuarit me anë të zbulimit të njohurive dhe të “zgjidhjes së problemeve”.

Në praktikën bashkëkohore, pos tekstit rekomandohet edhe botimi i doracaktit metodik për arsimtarin. Të tillët përgjithësisht mungojnë në Maqedoni.

Për të pasur rini të arsimuar e të edukuar duhet të kemi edhe tekste shkollore cilësore e pedagogë të mirë. Njohja e mirë e gjuhës amtare nxënësve do t'u ndihmojë edhe për të mësuar më mirë lëndët e tjera. Bashkë me lëndët mësimore, ata përvetësojnë edhe mënyrën për t'u shprehur me përpikëri, me qartësi dhe me rrjedhshmëri logjike. Ai që flet e shkruan mirë, ka më shumë sukses në jetën dhe në punën e tij. Shprehitë që nxënësit i marrin për gjuhën në shkollë, janë të dobishme për gjithë jetën.

Prandaj, në të ardhmen të gjithë ata që përfshihen në përgatitjen dhe botimin e teksteve shkollore: Ministria e Arsimit, hartuesit, redaktorët, recensentët, lektorët, korrektorët, ilustruesit, përpunuesit teknikë, botuesit etj., këtë veprimtari të rëndësishme për gjithë shoqërinë dhe ardhmërinë tonë duhet ta kryejnë me përkushtim, përgjegjësi e profesionalizëm. Teksteve shkollore duhet kushtuar shumë më tepër kujdes sesa deri më tani si në pikëpamje përmbajtjesore, ashtu edhe në pikëpamje metodike-didaktike e gjuhësore, sepse “**çdo të mbjellim, do të korrim**”.

**Literatura:**

- Bojku, Fejzi – Osmani, Zihni, *Gjuha shqipe për arsimin fillor 9-vjeçar*, Shkup, 2009. Botime shkollore, Albas, Tetovë, 2009.
- Hamiti, Asllan – Hamiti, Ismail, *Gjuhë shqipe për kl. VI të arsimit fillor nëntëvjeçar*,
- Karanfili, Islam – Osmani, Zihni, *Gjuha shqipe dhe leximi për kl. VIII*, Shkup, 2010.
- Koncepcioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*, Shkup, maj,

2006.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë, Byroja e Zhvillimit të Arsimit,

Petro, Rita – Pepivani, Natasha, *Gjuha shqipe për kl. IV të shkollës nëntëvjeçare*, Shkup, 2011.

## **6. PROGRAMI MËSIMOR I GJUHËS SHQIPE NË ARSIMIN FILLOR PËR NXËNËSIT E BASHKËSIVË TË TJERA ETNIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT<sup>93</sup>**

### **Shkurtime**

Gjuha shqipe në arsimin fillor nëntëvjeçar për nxënës të shqipen nuk e kanë gjuhë amtare (lëndë me zgjedhje) në Maqedoninë e Veriut tani mësohet nga kl. VI-IX me nga 2 orë në javë ose me gjithsej 72 orë në një vit shkollor. Lënda e gjuhës shqipe (si gjuhë e huaj) në shkollat tetëvjeçare në Maqedoni ka filluar të mësohet vetëm nga viti 2006 nga kl. V-VIII. Ne (në bashkautorësi) kemi hartuar tri tekste mësimore (Gjuhë shqipe për kl. V, VI, VII) për nevojat e nxënësve që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare. Por, interesimi i nxënësve për këtë lëndë deri më tani ka qenë mjaft i vogël. Me ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë e dytë zyrtare në komunat ku jetojnë mbi 20% shqiptarë pritet që të shtohet edhe interesimi i nxënësve joshqiptarë për ta mësuar shqipen. Kjo kërkon seriozitet më të madh në hartimin e kurrikulave, të teksteve mësimore si dhe në përgatitjen e kuadrit për këtë lëndë.

Para disa muajsh dy bashkautorët e kësaj kumtese (bashkë me dy kolege të praktikës dhe një këshilltar) hartuam Programin e ri mësimor të lëndës Gjuhë shqipe të arsimit fillor nëntëvjeçar për nxënës të bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilën më vitin 2019 e miratoi Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, përkatësisht sektori i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

---

<sup>93</sup> Kumtesë (në bashkautorësi me Ajten Qamilin) e Konferencës Shkencore “Zhvillimet në shkencat e ligjërimit dhe lënda e Gjuhës dhe e letërsisë shqiptare në arsimin parauniversitar”, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 12 korrik 2019.



Gjatë hartimit të këtij programi mësimor jemi përpjekur të marrim parasysh nivelet e përcaktuara, kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve, disa programe për gjuhën huaj të dytë në Maqedoni, Shqipëri e Kosovë. Që në kornizën konceptuale janë përcaktuar qëllimet e përgjithshme të lëndës, detyrat, tematikat që trajtohen, qëllimet zhvillimore, ushëzime didaktike, metodologjia e vlerësimit, kushtet hapësinore dhe materiale-teknike etj.

Përmbajtjet e programit janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës dhe nivelit zhvillimor të nxënësve. Ecuria e mbarështimit të lëndës dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi zgjon interesimin e tyre për të përvetësuar gjuhën shqipe. Nxënësit aftësohen për të përdorur format bazë të komunikimit: të kuptojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë, të pyesin dhe të përgjigjen.

Gjuha shqipe për nxënësit joshqiptarë duhet të mësohet nëpërmjet formave, metodave dhe aktiviteteve të larmishme, me qëllim që zotërimi i formës standarde të saj të bëhet me interesim, kënaqësi dhe vullnet, me çka do të arrihet aftësimi më i mirë i tyre për të shkruar e për të lexuar nëpërmjet ushtrimeve të të folurit dhe të të dëgjuarit.

## 1. HYRJE

Programi i lëndës **Gjuhë shqipe** nga kl. VI-IX të arsimit fillor nëntëvjeçar për nxënësit e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka për qëllim që nxënësit ta mësojnë, ta zotërojnë e të shërbejnë me gjuhën shqipe gjatë komunikimit të përditshëm. Mësimi i shqipes në këto katër vitet e shkollimit fillor ofron njohuritë e nevojshme për komunikim elementar në gjuhën shqipe. Kjo siguron mundësi për bashkëpunim, për realizimin e synimeve dhe veprimtarive të tjera shumë të dobishme, për mësimin dhe përdorimin e gjithanshëm të gjuhës shqipe si dhe për përafrim kulturor ndërmjet popujve.

Programi lëndor Gjuhë shqipe nga kl. VI-IX të arsimit fillor nëntëvjeçar (lëndë me zgjedhje) ka në fokus realizimin e kompetencave të përgjithshme të arsimit fillor dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave të përgjithshme dhe të kompetencave të lëndës, nëpërmjet mësimin të shqipes do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e kësaj lëndeje me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën. Gjatë punës kemi konsultuar jo pak kurrikula të ngjashme.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës shqipe me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë i shkëputur, por tërësor dhe t'i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm. Realizimi i programit në lëndën e Gjuhës shqipe mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të

përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithpërfshirës; duke përdorur sa më gjerë dhe në mënyrë efektive teknologjinë informatike.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe në konsolidimin e kompetencave. Gjithashtu, programi i jep mundësi mësuesit të jetë krijues dhe inovativ në punën e tij, duke përdorur metodat, strategjitë dhe qasjet më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, e mësimnxënies dhe të vlerësimit.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësve për ta bërë një komunikues të mirë, lexues aktiv e të mëvetësishëm dhe hartues të saktë shkrimesh nga praktika jetësore, të aftë për komunikimin shkrimor me administratën si dhe për shkrim kreativ. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë janë një nga detyrat parësore të arsimit, të cilat synojnë të përmbushin pesë kompetencat: **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit dhe përdorimit e drejtë të gjuhës**. Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë amtare, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë.

Diagrama e mëposhtme paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e kornizës kurrikulare, e cila synon mësimdhënien me në qendër nxënësin si dhe zhvillimin e përgatitjen e tij për t'u bërë anëtar i shoqërisë intelektuale.




Diagrama 1. Korniza konceptuale e programit lëndor “Gjuhë e huaj e dytë”

**Të nxënit është i orientuar drejt përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme.** Përgjithësisht, në lëndën e Gjuhës shqipe nga kl. VI-IX (me zgjedhje) nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar me gojë dhe me shkrim; që të lexojnë dhe kuptojnë tekste llojesh e zhanresh të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre

duke lexuar tekste letrare dhe joletrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme; mësojnë ta përdorin drejt shqipen standarde etj.

Lënda e Gjuhës shqipe nga kl. VI-IX (me zgjedhje) ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe ta edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë.

Përmbajtjet e programit janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës dhe nivelit të nxënësve. Ecuria e mbarështimit të lëndës dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi zgjon interesimin e tyre për të përvetësuar gjuhën shqipe. Nxënësit aftësohen për të përdorur **format bazë të komunikimit**: të kuptojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë, të pyesin dhe të përgjigjen.

Gjuha shqipe për nxënësit joshqiptarë duhet të mësohet nëpërmjet formave, metodave dhe aktiviteteve të larmishme, me qëllim që zotërimi i formës standarde të saj të bëhet me interesim, kënaqësi dhe vullnet, me çka do të arrihet aftësimi më i mirë i tyre për të shkruar e për të lexuar nëpërmjet ushtrimeve të të folurit dhe të të dëgjuarit.

Lënda e Gjuhës shqipe (për nxënësit që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare) ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të të shprehurit në shqip. Diagrama e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënës të kompetencave kyçe (universale) që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj:




Diagrama 2. Lidhja e kompetencave të përgjithshme (kyçe) me kompetencat e lëndës

## 2. ORGANIZIMI I PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE

Mësimi i gjuhës shqipe si lëndë me zgjedhje për nxënësit që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare në shkollën fillore nëntëvjeçare duhet të bëhet hap pas hapi dhe të jetë në pajtim të plotë me moshën dhe zhvillimin psikofizik të nxënësit. Ky proces lidhet me zhvillimin dhe kultivimin e shprehive të komunikimit (të kuptuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Gjuha shqipe në arsimin fillor nëntëvjeçar për nxënësit që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare (lëndë me zgjedhje) mësohet nga kl.VI-IX me nga 2 orë në javë ose me gjithsej 72 orë në një vit shkollor.

## 3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËS GJUHË SHQIPE NGA KL. VI-IX (lëndë me zgjedhje)

### **Nxënësi/nxënësja:**

- të formojë qëndrim pozitiv për gjuhën shqipe si njëra nga gjuhët e mjedisit ku jetojnë;
- të zhvillojë interesimin, dashurinë dhe dëshirën për ta njohur, për ta zotëruar e për ta zbatuar gjuhën shqipe në praktikë;
- të përparojë e të përsosë të dëgjuarit, leximin dhe komunikimin korrekt, të qartë e të rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim;
- të aftësohet për të shprehur mendimet, idetë, ndjenjat, dëshirat, qëndrimet dhe përvojën e vet;
- të aftësohet për përdorimin e gjuhës shqipe në rrethana të ndryshme jetësore;
- edukimi në frymën e paqes dhe të tolerancës – marrëdhënie të mira mes popujsh, etnish e qytetërimesh.

**Kjo lëndë mësimore duhet pranuar si lëndë kulturash dhe aftësish.** Nxënësi hedh hapat e parë drejt zbulimit dhe njohjes së një gjuhe të huaj. Tabela e mëposhtme pasqyron përputhjen e niveleve gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave dhe shtrirjen e tyre sipas klasave në sistemin arsimor parauniversitar të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

nivelet klasat	A 1	A 1+	A 2	A 2+
Klasa 12				
Klasa 11				
Klasa 10				
<b>Klasa 9</b>				
Klasa 8				
Klasa 7				
Klasa 6				

*Tabela e niveleve sipas klasave*

Referuar Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, niveli gjuhësor për gjuhën shqipe (lëndë me zgjedhje), për nxënësit që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare, që fillon nga klasa VI dhe e përmbyll këtë cikël në klasën IX i përket nivelit A1. Përkatësisht, **nxënësi në klasën e nëntë përmbyll nivelin A1 dhe merr elemente të A1+.**

Më poshtë po japim përshkrimin e nivelit A1 sipas shkallës globale:

Shkalla globale A1	Nxënësi mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete. Ai mund të prezantojë veten dhe të tjerët si dhe të pyesë, por edhe të përgjigjet për çështje që lidhen me të, si: ku jeton, banon, njerëzit që njih, sendet që ka etj. Nxënësi mund të komunikojë në mënyrë të thjeshtë, nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm të ndihmojë.
--------------------	--

Zotërimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon në zgjerimin e dijeve në fusha të tjera. Përvetësimi i gjuhës së huaj kontribuon jo vetëm në ngritjen dhe në formimin e individualitetit të nxënësit, por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike e humane; në frymën e bashkëpunimit, tolerancës, mirëkuptimit, respektimit të tjetrit, bashkëjetesës në shoqëri shumëgjuhësore e shumëtnike dhe në përgjithësi të vlerave individuale e kolektive, që i shërbejnë krijimit të një qytetari të ri të Evropës si dhe gjithë shoqërisë për një të ardhme më të mirë.

#### 4. PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE TË LËNDËS

Kompetencat e lëndës së Gjuhës shqipe për joshqiptarët në arsimin fillor në Maqedoninë e Veriut janë përshkruar për çdo klasë veçmas. Për të mos e ngarkuar këtë kumtesë, po mjaftohemi të paraqesim vetëm kompetencat e lëndës së Gjuhës shqipe për kl. IX, kur edhe përmbyllet niveli A1.

##### a) Të dëgjuarit dhe të folurit për të komunikuar

Nxënësit përdorin drejt gjuhën standarde gjatë të folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim, karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

##### b) Të lexuarit dhe interpretimi i teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe, maqedonase (të përkthyer në shqip), dhe botërore dhe bëjnë interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për moshën dhe shkallën e zotërimit të shqipes). Shfrytëzojnë për të mirë mediet e shkruara dhe ato elektronike: gazeta, revista, radion dhe televizionin; bibliotekën, internetin etj.

##### c) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësit shkruajnë për qëllime të ndryshme. Fitojnë kulturë gjuhe dhe aftësohen si të shkruajmë një: lutje a kërkesë, letër, urim, falënderim, ftesë, autobiografi, e-mail. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa, si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

##### ç) Njohuri për shqipen dhe përdorimi i drejtë i gjuhës

Në këtë klasë me të cilën përfundon niveli A1 i zotërimit të gjuhës shqipe, nxënësit duhet të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur. Ata tani më duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të shqipes. Kështu, nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit. Ata duhet të zotërojnë një numër të konsiderueshëm fjalësh shqipe. Njohuritë e tyre për shqipen do të zgjerohen edhe me tema të parapara për këtë klasë, si gjuha standarde dhe dialektet e shqipes, shqipja – gjuhë indoevropiane dhe ballkanike; fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra; fjalia e thjeshtë, kryefjala dhe

kallëzuesi, fjalitë pohore dhe mohore, fjalitë pyetëse dhe nxitëse, funksionet e fjalëve në fjali, fjalia e përbërë.

#### d) Të përkthyerit nga shqipja në gjuhën amtare dhe anasjelltas

Nxënësi aftësohet të përkthejë fjalë e fjali të shkurtra nga shqipja në gjuhën e vet amtare ose anasjelltas. Siç dihet, përkthimi është komunikimi i kuptimit të një teksti në gjuhën burimore me anë të një teksti të njëjtë të gjuhës së synuar. Nëpërmjet përkthimit nxënësit do të mësojnë fjalë, do të zhvillojnë aftësinë krijuese të të folurit e të të shkruarit në shqip si dhe do të mund të krahasojnë gjuhët.

### 5. FUSHAT PROGRAMORE (NJËSITË MODULARE)

Fushat programore apo njësitë modulare në programin mësimor të Gjuhës shqipe prej kl. VI-IX (lëndë me zgjedhje) dallojnë nga njëra klasë në tjetrën. Në formë tabelore për secilën klasë veç e veç në katër kolona të posaçme janë dhënë: a) objektivat a qëllimet, b) përmbajtjet dhe nocionet, c) aktivitetet dhe metodat, ç) standardet e vlerësimit. Mbështetur në programet simotra, kemi përcaktuar këto fusha programore:

Klasa VI:

- a) Shkrim-lexim fillestar;
- b) Drejtshkrim e drejtshqiptim;
- c) Të shprehurit (me gojë e me shkrim).

Klasa VII:

- a) Pasurimi i fjalorit (me tekste joletrare dhe letrare);
- b) Përdorimi i drejtë i gjuhës;
- c) Të shprehurit dhe krijimtaria.

Klasa VIII:

- a) Komunikim dhe lexim letrar;
- b) Gjuhë;
- c) Të shprehurit dhe krijimtaria.

Klasa IX:

1. Lexim letrar;
2. Gjuhë;
3. Kulturë gjuhe.

### 6. DETYRAT E LËNDËS GJUHË SHQIPE NGA KL. VI-IX (lëndë me zgjedhje)

- të nxënës të orientuar drejt përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme;
- njohja e shkallëshkallshme e gjuhës shqipe dhe përdorimi i drejtë i saj;

- njohja me nocionet, përmbajtjet dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore të gjuhës shqipe;
- aftësimi i nxënësve për të kuptuar, lexuar dhe shkruar;
- përvetësimi i fondit të nevojshëm fjalësh për të komunikuar lirshëm në situata të ndryshme;
- përvetësimi i formave themelore të të shprehurit me gojë dhe me shkrim (tregim, ritregim, përshkrim, lajmërim, ...);
- aftësimi i nxënësve për të lexuar, kuptuar, interpretuar e shijuar tekste joletrare e letrare;
- aftësimi i nxënësve që në mënyrë të pavarur të shfrytëzojnë literaturë dhe informata të ndryshme.

Tematikat që trajtohen në lëndën e gjuhës së huaj, përfshirë edhe gjuhën shqipe për joshqiptarët nga kl. VI-IX, janë të larmishme dhe përfshijnë të gjitha fushat e jetës, si:

- **Jeta e përditshme** (*përsëritjet, trupi, veshja, objektet që na rrethojnë, ngjyrat, ushqimet, ditët e javës, orari i mësimi, muajt e vitit, stinët, koha e lirë, aktivitetet e moshës, planifikimi i kohës, sporti, ushqimet, të dhëna personale, plane personale* etj.).

- **Jeta shkollore** (*klasa, shkolla, shokët, orari mësimor, lëndët mësimore, biblioteka, pikniku* etj.).

- **Jeta personale dhe shoqërore** (*familja, anëtarët e familjes; trupi i njeriut, shëndeti; festat, pushimet, profesionet, dëshirat, marrëdhëniet shoqërore* etj.).

- **Bota rreth nesh** (*qyteti, fshati, shteti, kontinentet, natyra, kafshët, ambienti, bimët, udhëtimet dhe turizmi, kultura, kujdesja për planetin* etj.).

- **Bota e komunikimit** (*kompjuteri, interneti, shkenca dhe teknologjia, posta, telefoni, radioja, televizioni, muzika, filmi, teatri, çështje aktuale; shkrime nga praktika jetësore (letra, shkresa, ftesa, letërrimi; e-maili); komunikimi shkrimor me administratën (lutja, kërkesa, biografia)* etj.

## 7. QËLLIMET ZHVILLIMORE TË LËNDËS GJUHË SHQIPE NGA KL. VI-IX (lëndë me zgjedhje)

- **zhvillimi i dashurisë dhe i interesimit për gjuhën standarde shqipe** - që nënkupton rolin dhe rëndësinë e gjuhës, njohjen dhe komunikimin e ndërsjellë, marrëveshjet dhe argëtimin;
- **përvetësimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme** - që nënkupton të shprehurit e qartë e në mënyrë përmbajtësore dhe sipas normës standarde të gjuhës shqipe; të dëgjojnë me vëmendje dhe ta kuptojnë atë që u thonë bashkëbiseduesit gjatë komunikimit verbal dhe joverbal;
- **zhvillimi i aftësive të shkrim-leximit** - që nënkupton shfaqjen e interesimit për përvetësimin dhe paraqitjen e formës grafike të sistemit



të gjuhës shqipe, përdorimin e mjeteve mësimore sipas udhëzimeve të dhëna, dëshirën për zgjidhjen e pavarur të një detyre praktike; aftësinë për të shqiptuar e shkruar drejt shkronjat dhe fjalët e shqipes;

- **nxitja e interesimit, dashurisë dhe gatishmërisë për shfrytëzimin e librit si burim informacionesh dhe si mjet mësimor** – që nënkupton aftësimin e nxënësve për të lexuar e kuptuar tekstet e përshtatshme për moshën e tyre;
- **zhvillimi i kulturës së të folurit (të shprehurit me gojë dhe me shkrim) dhe të kulturës së medias** – që nënkupton zhvillimin e aftësive për përdorimin qëllimor dhe të orientuar të gjuhës dhe medieeve në funksion të kultivimit dhe shfrytëzimit të traditës kulturore dhe gjuhësore, si bazë për marrëdhënie humane me kulturat e tjera të mjedisit tonë;
- **zhvillimi i proceseve të të menduarit** - Një nga synimet madhore të shkollës është nxitja e të menduarit te nxënësit. Të menduarit dhe njohuritë shkojnë së bashku. Ne duhet të kemi njohuritë që të mendojmë rreth diçkaje! Sa më shumë dimë rreth tyre, aq më mirë jemi në gjendje të debatojmë, analizojmë apo vlerësojmë. Mendimi kritik nevojitet për të marrë vendimet e përditshme, që individi të bashkëveprojë në mënyrë funksionale me botën që e rrethon. Detyra qendrore për nxënësit sot është të mësojnë si të nxënë në mënyrë frytdhënëse dhe të mendojnë në mënyrë kritike.

Në përpjekje për të reformuar shkollën tonë, mësimdhënësit duhet të përditësojnë njohuritë e tyre, nxënësit duhet të provojnë dhe të analizojnë dijet që u jepen, në mënyrë që shkolla të bëhet vendi ku të gjithë mësojnë dhe mësohen nga njëri-tjetri, ku të gjithë të mund të mendojnë pa i marrë gjërat të gatshme, por duke i testuar në realitetin shoqëror dhe ku çdo dije do të vihet në pikëpyetje, para se të “gëlltitet” e papërpunuar.



**Çelësa të procesit të të menduarit:**

- a) *Njohja* (të mbajturit mend). Thoni se ç'dini, ç'mbani mend, përshkruani, përsëritni, identifikoni, thoni se cili, kur, kë, ku, çfarë?
- b) *Të kuptuarit* (interpretimi dhe kuptimi). Përshkruani me fjalët tuaja, thoni se çfarë mendoni për ..., thoni se çdo të thotë, shpjegoni, krahasoni, lidhni...
- c) *Zbatimi* (të përdorurit e...). Si mund ta përdorni, ku të çon, demonstro...?
- ç) *Analiza* (zbërthimi, ndarja në pjesë). Cilat janë pjesët, rendi, arsyeja pse, shkaqet, problemet, zgjidhjet, pasojat...
- d) *Sinteza* (bashkimi i pjesëve). Si mund të ishte ndryshe, çfarë tjetër, po sikur, të supozojmë, zhvillo, përmirëso, krijo në mënyrën tënde...  
dh) *Vlerësimi* (gjykimi dhe vlerësimi). Si do ta gjykonit, a ka sukses, a do të ecë, çfarë do të parapëlqenit, pse e mendon kështu?....

## 8. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME DIDAKTIKE

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë metodikën e gjuhës dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Procesi mësimor në përgjithësi, përfshirë edhe lëndën Gjuhë shqipe nga kl. VI-IX (lëndë me zgjedhje) duhet të karakterizohet nga këto parime: *mësimdhënie me në qendër nxënësin, të mësuarit bashkëveprues, integrimi dhe procesi i rimarrjes së njohurive.*

### a) Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit duhet të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, nënie e pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, kjo lëndë dhe të tjerat të ngjashme kërkojnë që nxënësit të nxënë konceptet, të zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë si dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Këto diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënit dhe nevojat e nxënësve.

### b) Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit duhet të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues (interaktiv) si dhe të menduarit logjik, kritik e krijues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës shqipe shpesh do të motivohen të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre njëri me tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit

të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

### c) **Integrimi**

Veprimtaritë gjuhësore, si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës duhet të trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje të ngushta ndërmjet tyre. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku për ta bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të përdorë njohuritë e marra në situata të njohura dhe të panjohura për të.

### ç) **Procesi i rimarrjes së njohurive**

Aftësitë dhe shkathtësitë, njohuritë për sistemin gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njohura tek e panjohura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njohuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në faza të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli paraprak në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

Realizimi i qëllimeve të përgjithshme të lëndës *Gjuhë shqipe* si lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë (nga kl. VI-IX), do të arrihet nëse plotësohen në tërësi kërkesat programore që janë shpërndarë në mënyrë të vazhdueshme nëpër klasa.

Fusha programore e shkrim-leximit fillestar duhet të realizohet përmes formash dhe metodash bashkëkohore të punës, gjë që do të varet nga paranjohuritë dhe aftësitë konkrete të nxënësve. Gjatë procesit të përvetësimit të kësaj fushe programore, krahas tekstit bazë mësimor do të ishte mirë të shfrytëzohen edhe situata të ndryshme të jetës, si: leximi i mbishkrimeve të firmave, emrave të rrugëve, titujve të librave, prospekteve etj.

Tekstet për lexim duhet të jenë të shkurtër (edhe si përmbajtje edhe si strukturë fjalish), dinamikë dhe interesantë. Kujdes të posaçëm duhet t'u kushtohet fjalëve të panjohura. Gjatë mësimdhënies e mësimnxënies do të duhet të bëjmë përsëritje, dialogje të shkurtra, plotësime mbi figura, pyetje të tipit “e saktë apo e gabuar”, letra me zëvendësime fjalësh, teste që përfshijnë ngjyrat, ndërtim fjalish të thjeshta; krahasime ndërmjet gjuhës së nxënësit e shqipes, përkthim fjalësh e fjalish, praktika të shkrimit të lutjes, kërkesës, urimit, ftesës, jetëshkrimit etj.

Nxënia e përmbajtjeve të fushës programore të Gramatikës duhet të bëhet sipas metodës së rathëve koncentrikë. Kjo do të thotë se njohuritë

nga kjo fushë do të përvetësohen shkallëshkallshëm, nga viti në vit. Çështjet gramatikore duhet të mësohen në kontekste ligjërimore, jo si metagjuhë.

Është e udhës të përdoren një varg metodash didaktike për të bërë orët e mësimi më të larmishme e më tërheqëse. Përzgjedhjen e metodës, mjeteve mësimore dhe materialeve të tjera ndihmëse si dhe formën e punës duhet ta bëjë arsimtari. Mësimdhënësi mund të përdorë të gjitha burimet, mjetet dhe materialet që ndihmojnë arritjen e rezultateve dhe kompetencave të lëndës së gjuhës shqipe nga kl. VI-IX. Mjetet mësimore, siç janë: libri, fletorja e punës, fotografitë, udhëzuesit profesionalë, fjalorët, gazetat dhe revistat për fëmijë, materialet pedagogjike janë të domosdoshëm. Përdorimi i kompjuterit, i kasetave, i disqeve, i ilustrimeve, i video projektorit, i materialit auditiv, i video materialit, i internetit dhe i mjeteve të tjera të konkretizimit ndihmon nxënësit për përvetësimin e të gjitha formave të gjuhës shqipe. Mësimdhënësi, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimi, zgjedh mjete mësimore plotësuese, me të cilat konkretizon mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve, të menduarit dhe siguron cilësi më të lartë të realizimit të mësimi praktik.

Parapëlqehet që mësimdhënësit (po edhe nxënësit) të përzgjedhin dhe në orët e mësimi (po edhe jashtë orëve të mësimi) të ndjekin së bashku (ose edhe ndaras) materiale audiovizuale nga Interneti e YouTube-ja që lidhen me tema të caktuara mësimore, si p.sh.: alfabeti shqip, të mësojmë së bashku, fjalë të ndryshme shqip, numrat shqip, ngjyrat, kafshët shtëpiake, kopshti zoologjik, filma vizatimorë për fëmijë (në gjuhën shqipe), këngë shqipe për fëmijë; fjalë të urta, gjëgjëza, frazeologjizma, poezi të recituara nga aktorë të njohur, përralla e tregime për fëmijë; drama, emisione televizive për fëmijë, revista për fëmijë, materiale mësimore për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në përgjithësi etj. Arsimtari i lëndës mund të ftojë në orën e mësimi ndonjë profesionist që lidhet me temën që trajtojnë (shkrimtar, mjek etj.) ose të organizojë edhe vizita mësimore me nxënësit në kopshtin zoologjik, në ndonjë bibliotekë, në postë, në ndonjë televizion etj., me qëllim që nxënësit të njoftohen jo vetëm me punën që bëjnë kompetentët, por gjatë shpjegimit që jep ai (në shqip) të dëgjojnë e të mësojnë edhe fjalët e termet kryesore që lidhen me veprimtarinë e tyre profesionale.

## 9. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE E VETËVLERËSIMIT TË NXËNËSVE

Vlerësimi i njohurive dhe aftësive konkrete arritjeve të nxënësve kërkon zbatimin e metodave bashkëkohore pedagogjike. Gjatë këtij procesi, arsimtari përkujdeset dhe gjithnjë duhet të krahasojë arritjet aktuale të

nxënësve me qëllimet e përcaktuara paraprakisht. Ai shfrytëzon instrumente të ndryshme për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e arritjeve të nxënësve në fushë të leximit, shkrimit, dëgjimit, shpjegimit dhe të të kuptuarit të gjuhës. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet me nota numerike (nga 1-5).

Në rastet kur nxënësit nuk i përvetësojnë me sukses përmbajtjet e caktuara; arsimtari, me ndihmën e drejtorit, pedagogut dhe psikologut të shkollës, ndërmerr masa të nevojshme dhe shfrytëzon metoda përkatëse për motivimin e tyre, derisa të arrijë efektet e dëshiruara.

Mësuesi, njëherazi, i përdor këto vlerësime për të përmirësuar forma të ndryshme të punës së tij, vlerëson në mënyrë kritike metodat e tij të mësimdhënies dhe mban qëndrim po në mënyrë kritike për të përmirësuar frytshmërinë e tyre.

Në procesin e mësimit të gjuhëve të huaja vetëvlerësimi mund të përqendrohet në tri aspekte kryesore:

1. Në procesin e mësimit, që do të thotë vlerësimin i përparimit të tyre, nivelin e arritur në secilën shkallë dhe suksesin ose mosp suksesin në realizimin detyrave dhe qëllimeve të caktuara.

2. Në aftësitë e tyre komunikuese.

3. Në zotërimin e gjuhës, pra në numrin e fjalëve që di, në mënyrën si i shqipton ose i shkruan ato dhe në mënyrën e lidhjes së tyre në fjali (përdorimin e strukturave gjuhësore).

## 10. KUSHTET HAPËSINORE DHE MATERIALE-TEKNIKE

Realizimi i mësimit të lëndës Gjuhë shqipe si lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë mund të arrihet në kushtet hapësinore të parapara me Normativin për hapësirën e nevojshme për mësimdhënie. Për të arritur efektet e dëshiruara, kjo lëndë mësimore duhet të realizohet në mësonjëto të specializuara ose nëpër kabinete të veçanta, ku do të ketë pajisje kompjuterike, qasje në internet, LCD projektor etj.

## 11. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Konstatim i përgjithshëm është se në Maqedoninë e Veriut kemi arsim jocijëlor. Për këtë gjendje të pamirë fajtor jemi të gjithë. Këtu mund të përfshihen planet e programet mësimore jo të përshtatshme për nxënësit e studentët e kohës sonë, tekste të dobëta shkollore (shumica e tyre të përkthyer nga maqedonishtja në një gjysmëshqipe), kushtet jo të mira hapësinore dhe mospasja e mjeteve mësimore, pagat e ulëta të mësimdhënësve, punësimet jo sipas kriterit të cilësisë, mungesa e shprehisë për të lexuar tekste e vepra me vlerë që sjell kufizime në

kulturën e përgjithshme të rinisë sonë si dhe në kulturën e dobët gjuhësore, duke mbjellë analfabetizmin funksional dhe jorrallë duke prodhuar analfabetë me diplomë. Thjesht, të rinjtë e të rejat tona nuk kanë motivim as të brendshëm e as të jashtëm për të nxënë dituri që më pas të merren me punë intelektuale, por shpresojnë të dalin jashtë vendit për një jetë materiale më të mirë. Si përfundim, sistemi i keq arsimor prodhon kuadro të dobëta.

Interesimi për të mësuar shqipen nga popullata joshqiptare në Maqedoninë e Veriut deri më tani ka qenë fare e vogël. Të paktë janë joshqiptarët që përcaktohen të mësojnë shqipen (në shkollë, në kurse apo edhe në fakultet). Mësimi i gjuhës shqipe si gjuhë e dytë e huaj në Maqedoninë e Veriut me patëdrejtë ndërpritet me përfundimin e shkollimit fillor (me nivelin A1), meqë nuk e kemi të pranishme në programet mësimore të shkollave të mesme. Ajo nuk mësohet më nga joshqiptarët as në fakultet, përveç në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Fakultetin e Filologjisë “Bilazhe Koneski” në Shkup, në programin studimor Përkthim e interpretim nga shqipja në maqedonisht e anasjelltas.

Njohësit e mirë të shqipes me gjuhë amtare maqedonishten mund të jenë mjaft të suksesshëm në përkthimet nga shqipja në maqedonisht. Përkthyesi duhet të ketë njohuri të përgjithshme, të njohë shumë mirë gjuhën burimore dhe gjuhën e synuar së bashku me kulturat që lidhen me to si dhe njohuri të thelluara në fushën që përkthen (ekonomi, drejtësi, letërsi, art, sport etj.).

Përkthimi nga maqedonishtja në shqip e anasjelltas është zgjeruar mjaft dhe do të zgjerohet edhe më tej me Ligjin për Zbatimin e Gjuhëve, me vajtje-ardhjet Shqipëri, Kosovë - Maqedoni, komunikimin dhe bashkëpunimin institucional të Maqedonisë së Veriut me Shqipërinë e Kosovën. Andaj, edhe pse tani përballen me shumë vështirësi, përkthyesit dhe interpretuesit e mirë do të jenë mjaft të kërkuar në tregun e punës.

Maqedonia e Veriut është shtet shumënacional e shumëgjuhësor, por etnitetet janë shumë të mbyllur në vete, kanë paragjykime negative për tjetrin që shprehet gjithkund, si në jetën e përditshme, në mjetet e informimit, në sport, art, muzikë, politikë, pseudoshkencë; madje edhe në disa tekeste mësimore e në Fjalorin enciklopedik të Maqedonisë.

Mbyllja e kujtdo vetëm në guackën e vet sjell izolim, mosnjohje të mjaftueshme të kulturës së tjetrit që ka për pasojë edhe probleme të shumta natyrash të ndryshme. Në këtë kuptim, shqiptarët janë mjaft të hapur ndaj botës, ndaj trashëgimisë materiale e shpirtërore të të tjerëve, rrjedhimisht edhe ndaj gjuhës e kulturës maqedonase. Nxënësit shqiptarë maqedonishten e kanë lëndë të domosdoshme dhe fillojnë ta mësojnë që nga klasa e tretë e deri në studime (në vitin e parë), ndërsa shqipja për joshqiptarët në Maqedoninë e Veriut ka statusin e gjuhës fakultative vetëm në katër vitet e arsimit fillor (nga klasa VI-IX).

Gjuha shqipe dhe ajo boshnjake statusin e lëndës me zgjedhje e kanë edhe në Turqi që nga viti 2018. “Mësimdhënia e gjuhës shqipe si lëndë me zgjedhje në shkollat 8-vjeçare në Turqi, përkrah kurseve intensive të pavarura të shqipes u konsiderua si një arritje e rëndësishme nga Ambasadori i Shqipërisë në Turqi, Genti Gazheli. Numri i individëve apo i biznesmenëve, që duan të vijnë në Turqi apo të shkojnë në Shqipëri, sipas ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, Genti Gazheli, është gjithnjë në rritje” (Gazeta Dita, 25. 12. 2008).

Do të ishte mirë që të ndiqen edhe te ne modelet më të mira të vendeve shumëgjuhësore, përkatësisht **Gjuha shqipe të ketë statusin e lëndës së detyrueshme në arsimin parauniversitar (fillor e të mesëm) në Maqedoninë e Veriut edhe për nxënësit e etniteteve të tjera.**

### **Programet mësimore të konsultuara:**

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Programi mësimor, Gjuhë shqipe nga kl. VI-IX të arsimit fillor nëntëvjeçar (lëndë me zgjedhje)*, Shkup, 2019.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Programi mësimor, Gjuhë shqipe për kl. VI të arsimit fillor nëntëvjeçar (lëndë me zgjedhje)*, Shkup, 2019.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Programi mësimor, Gjuhë shqipe për kl. VII të arsimit fillor nëntëvjeçar (lëndë me zgjedhje)*, Shkup, 2019.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Programi mësimor, Gjuhë shqipe për kl. VIII të arsimit fillor nëntëvjeçar (lëndë me zgjedhje)*, Shkup, 2019.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Programi mësimor, Gjuhë shqipe për kl. IX të arsimit fillor nëntëvjeçar (lëndë me zgjedhje)*, Shkup, 2019.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Gjuhë shqipe (si lëndë zgjedhore në shkollat fillore, kl. V-VIII)*, Shkup, 2005.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Koncepti për përpilimin e librit dhe metodologjia për vlerësimin e librit*, Shkup, dhjetor 2010.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Programet mësimore për kl. VI në arsimin fillor nëntëvjeçar*, Shkup, 2008.

Министерство за образование и наука на Република Македонија, Биро за развој на образованието, *Наставна програма по македонски јазик за децата на граѓаните на Р. Македонија кои престојувале во странство и се вратиле во Р. Македонија каде што ги започнуваат или продолжуваат основното образование*, Скопје, ноември, 2013.

Министерство за образование и наука на Република Македонија, Биро за развој на образованието, *Јазик и култура на власите, VI одделение, Деветгодишно основно образование*, Скопје, 2008.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, *Kurrikula e bazuar në kompetenca*, Lënda: Gjuhë e huaj e dytë, klasa VII, Tiranë, 2016.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, *Udhëzues kurrikular lëndor për gjuhën e huaj, Material ndihmës për mësuesit e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9*, Tiranë, 2018.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, *Gjuhë amtare maqedonase, Shkalla: III&IV, Klasa: VI-IX*, Tiranë, 2017.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Kurrikula lëndore / Programi mësimor, *Gjuhë shqipe – për nxënësit e komuniteteve joshqiptare*, klasa III (Draft), Prishtinë, 2018.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Kurrikula lëndore / Programi mësimor, *Gjuhë shqipe – për nxënësit e komuniteteve joshqiptare*, klasa VI (Draft), Prishtinë, 2018.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Kurrikula lëndore / Programi mësimor, *Gjuhë shqipe – për nxënësit e komuniteteve joshqiptare*, klasa X (Draft), Prishtinë, 2018.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Kurrikulat lëndore / Programet mësimore*, klasa VI, Prishtinë, 2018.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Kurrikulat lëndore / Programet mësimore*, klasa VII, Prishtinë, 2018.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Kurrikulat lëndore / Programet mësimore*, klasa VIII (Draft për shkollë pilot), Prishtinë, 2018.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Kurrikula bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës, Klasa VI, VII, VIII dhe IX* (e rishikuar), Prishtinë, gusht, 2016.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës* (e rishikuar), Prishtinë, gusht 2016.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Plani dhe programi mësimor për kl. VI të shkollës së mesme të ulët*, Prishtinë, gusht, 2003.

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Plani dhe programi mësimor për kl. IX të shkollës së mesme të ulët*, Prishtinë, dhjetor, 2005.



**Burime nga Interneti:**

file:///D:/Programe%20mesimore%202019/Planprogramet%20mesimore%20shkurt%202019/KS/Kurrikula/udherrefyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf

file:///D:/Programe%20mesimore%202019/Planprogramet%20mesimore%20shkurt%202019/kl.%209,%20albanski\_jazik.pdf

file:///D:/Programe%20mesimore%202019/Planprogramet%20mesimore%20shkurt%202019/Konceptet.pdf

file:///D:/Programe%20mesimore%202019/Planprogramet%20mesimore%20shkurt%202019/nastaven%20plan%20devetgodishno%202018%20-2019.pdf

file:///D:/Programe%20mesimore%202019/Planprogramet%20mesimore%20shkurt%202019/V\_oddelenie\_programi.pdf

file:///D:/Programe%20mesimore%202019/Planprogramet%20mesimore%20shkurt%202019/MK/kl%205/V\_oddelenie\_programi\_na\_albanski\_jazik.pdf

<http://www.gazetadita.al/gjuha-shqipe-lende-me-zgjedhje-ne-turqi/>

[http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Albanski\\_izboren\\_6.pdf](http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Albanski_izboren_6.pdf)

## 7. NDRYSHIME RRËNJËSORE NË GJITHË SISTEMIN ARSIMOR

*Konstatim i përgjithshëm është se arsimi shqip gjatë 20-30 viteve të fundit ka pasur një rënie të përhershme dhe fatkeqësisht deri më tani nuk ka shenja përmirësimi. Për të shëruar këtë epidemi të kohës, këtë gjendje alarmante, të pamirë, me pasoja të rënda për ardhmërinë tonë, duhet kushtrimuar të gjithë: institucionet shtetërore, politika, shkolla, familja dhe gjithë shoqëria jonë.*

### **Intervistë, Delvina KËRLUKU<sup>94</sup>**

Asllan Hamiti lindi më 20. 05. 1960 në fshatin Goden të Gjilanit, Republika e Kosovës. Shkollimin fillor dhe të mesëm e mbaroi në Shkup me sukses të shkëlqyeshëm. Fakultetin e Filologjisë, Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në Shkup e kreu më vitin 1985 me notë mesatare mbi nëntë. Magjistroi dy herë në fushën e gjuhësisë: në Degën e gjuhës shqipe në Prishtinë (1992) e në Shkup (1994); doktoroi në Shkup (1999).

Që nga viti 1986 është në marrëdhënie të përhershme pune në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në Fakultetin e Filologjisë “Blazhe Koneski” në Shkup. Krahas kësaj, vite me radhë ka mbajtur edhe kursin e Gjuhës shqipe për të huaj, për disa vjet i angazhuar si ligjërues në Universitetin për Menaxhment dhe Teknologji Informativë, në Akademinë Pedagogjike në Shkup, në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit, në Kolegjin Evropian “Juridika” të Prishtinës dhe në ciklin e dytë në Universitetin e Tetovës. Ka marrë pjesën disa projekte vendore linguistike ndërkombëtare si dhe në shumë konferenca shkencore.

Deri më tani ka ligjëruar jo pak lëndë në fushën e gjuhësisë shqiptare: Fonetikë e fonologji e gjuhës shqipe, Gramatikë e gjuhës shqipe, Dialektologji shqiptare, Histori e gjuhës shqipe, Drejtshkrim, Drejtshqiptim, Praktikum i gjuhës shqipe, Gjuhësi indoevropiane, Shkrim akademik, Metodologji e hulumtimit shkencor, Kulturë gjuhe, Histori e shqipes standarde, Filologji shqiptare etj. Është mentor i akredituar për ciklin e dytë e të tretë të studimeve, udhëheqës shkencor i dhjetëra magjistrantëve e doktorantëve nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria. Deri më tani ka botuar mbi 150 artikuj profesionalë e shkencorë, disa monografi, shtatë tekste për arsimin fillor e të mesëm si dhe katër tekste universitare. Dy mandate qe

---

<sup>94</sup> Inrevistë e gazetares Delvina Kërliku me Asllan Hamitin (me pak ndryshime). Fotografitë i kemi hequr. Intervistën e plotë e gjeni edhe në: <http://www.koha.mk/hamiti-ndryshime-rrenjesore-ne-gjithe-sistemit-arsimor/>, shkarkuar më 26. 06. 2020.

përgjegjës i Katedrës dhe për katër vjet udhëhoqi studimet e doktoratit në Degën e gjuhësisë në Fakultetin e Filologjisë në Shkup.

Prof. dr. Asllan Hamiti është laureat i çmimit shtetëror “Goce Dellçev” për vitin 2014. Po kështu, më vitin 2016 fitoi Çmimin “13 Nëntori”, Dita e çlirimit të Shkupit, për ndihmesë të veçantë shumëvjeçare në fushën e shkencës e të arsimit, me vlerë të posaçme për afirmimin e qytetit të Shkupit e më gjerë.

**KOHA: Profesor Hamiti, keni lindur në fshatin Goden të Komunës së Gjilanit. Shkollimin e keni kryer në Shkup. Cili është rrëfimi i fëmijërisë suaj?**

HAMITI: Kam lindur në një fshat të vogël malor të Gjilanit, në një familje fisnike me katër vëllezër e dy motra. Stërgjyshin tim, Hamitin e kishin plagosur hordhitë bullgare e pas shërimit e kishin vrarë e masakruar hordhitë serbe, duke punuar në mullirin e vet, që gjendej jo larg shtëpisë së lindjes. Për ekonomi familjare më të mirë, në vitin 1965 im atë me dy vëllezërit e vet (tanimë të ndjerë) erdhën e u vendosën në fshatin Hasanbeg të Shkupit ku edhe tani jetojmë. Fëmijërinë e hershme e kam kaluar në bashkësi familjare shumanëtarëshe që arriti deri më 25 veta, duke jetuar së bashku me anëtarët e familjes së dy xhaxhallarëve të mi. Aty çdokush punonte, përfshirë edhe ne fëmijët që u ndihmonim të rriturve. Aso kohe nuk kishim ndonjë pasuri të madhe, por ishim të lumtur. Mbizotëronte mirëkuptimi e respekti ndërmjet anëtarëve të kësaj bashkësie familjare. Aty rrëfeshin anekdota, mençuri popullore, këndoheshin këngë popullore e folklorike dhe përgjithësisht zhvilloheshin biseda edukative e moralizuese. Pra, u rrita dhe u edukova në frymën e traditave e të trashëgimisë sonë kombëtare. Arsimin fillor e mbarova në shkollën “25 Maji” në Hasanbeg si njëri ndër nxënësit më të mirë të gjeneratës. Më kujtohet mirë se që në këtë moshë dëshira ime jetësore ishte që të bëhesha mësues. Ky më dukej profesioni më i mirë (që është mision), më i dashur, më më fisnik, më human dhe më i dobishmi për shoqërinë. Arsimin e mesëm e kreu në gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup me sukses të shkëlqyeshëm. Si nxënës e më pas si student merrja pjesë si instrumentist në shoqërinë kulturore-artistike “Drita” të riemërtuar me detyrim në “Alija Avdoviq”. Nga kjo kohë më kanë mbetur kujtime shumë të mira: ushtrime të shpeshta, udhëtime, koncerte, incizime e dasma që kanë ndikuar dukshëm në shoqërizimin tim.

**KOHA: Profesor Hamiti, ju keni përfunduar studimet në Shkup, në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare. Çfarë mund të na flisni për këtë Katedër, si student dhe si profesor?**

HAMITI: Është kënaqësi të studiosh në një institucion të lartë arsimor e me traditë shumëvjeçare e më pas të punosh si mësues në të. Kam pasur

fatin të pajisem me dituri nga pedagogë e studiues të njohur, si nga: prof. Remzi Nesimi, prof. Xhevat Gega, prof. Zihni Osmani, prof. Haki Ymeri, prof. Avzi Mustafa, prof. Zeqirija Neziri, prof. Nehas Sopaj, prof. Agim Poloska, lektor Qani Memeti, si dhe nga profesorët e angazhuar nga Universiteti i Prishtinës: dr. Latif Mulaku, dr. Shefqet Pllana dhe dr. Imri Badallaj.

Më vitin 1951 në Fakultetin Filozofik të Shkupit u hap lektorati i gjuhës shqipe, më vitin shkollor 1959/60 u ngrit në Seminar të Gjuhës Shqipe, ndërsa që nga viti 1971/72 në Katedër të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare. Themelues i Katedrës është profesori dhe veprimtari i shquar, dr. Petro Janura, i cili për 20 vjet rresht ishte i vetmi mësimdhënës nga themelimi (1951) e deri në transformimin në Departament, përkatësisht në Katedër (1971). Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare e Universitetit "Shën Kirili e Metodi" në Shkup është njëra ndër institucionet më të moçme të arsimit të lartë të shqiptarëve, jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rrafshin kombëtar.

Tani kemi tri programe studimore: a) Gjuhë dhe Letërsi Shqiptare (drejtimi arsimor); b) Përkthim dhe Interpretim nga Maqedonishtja në Shqip (për studentë që shqipen e kanë gjuhë amtare) dhe c) Përkthim dhe Interpretim nga Shqipja në Maqedonisht (për studentë që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare). Gjatë punës së saj 70-vjeçare të frytshme arsimore dhe shkencore Katedra ka dhënë dhe po jep ndihmesë të madhe për arsimimin e lartë dhe për shkencën albanologjike. Deri më tani në këtë Katedër kanë diplomuar mijëra studentë, kanë marrë gradën e magjistratit e të doktorit të shkencave disa dhjetëra kandidatë nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria; të cilët me punën e tyre arsimore, shkencore, shoqërore e përgjithësisht intelektuale janë dëshmuar mjaft të suksesshëm. Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare e Shkupit në veprimtarinë e saj ka arritur rezultate të lakmueshme arsimore, shkencore e kulturore, por ajo përballet edhe me shumë vështirësi për shkak të mospërtëritjes së kuadrit, mungesës së hapësirave të nevojshme, përdorimit të kufizuar të gjuhës shqipe dhe përgjithësisht nga lënia pas dore nga organet kompetente shtetërore. Të shpresojmë se në të ardhmen punët do të ecin nga e mbara.

**KOHA: Profesor Hamiti, jeni autor i shumë teksteve shkollore, universitare. Çfarë mund të tregoni për këtë kontribut të devotshëm?**

**HAMITI:** Përgjithësisht, veprimtaria jonë mund të degëzohet në tri fusha: a) në punë arsimore (mësimdhënie), b) në punë kërkimore-hulumtuese (shkencore) dhe c) në punë profesionale-pedagogjike (hartimi i teksteve mësimore). Me fjalë të tjera, mbaj mësim në tri ciklet akademike: në studimet themelore, në ciklin e dytë e të tretë, duke udhëhequr kandidatë për punimet e magistraturës e të disertacioneve të doktoratit në Gjuhësinë shqiptare. Një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë sonë ia kemi kushtuar

edhe hartimit të teksteve parauniversitare e universitare me karakter mësues dhe didaktik. Si autor ose bashkautor deri më tani kemi hartuar gjashtë tekste shkollorë për arsimin fillor (Gramatikë e gjuhës shqipe për kl. III; Gjuhë shqipe për kl. VI, VII, VIII, IX (lëndë me zgjedhje), Gjuhë shqipe për kl. VI (gjuhë amtare), në bashkautorësi me dr. Ismail Hamitin; një tekst shkollor për arsimin e mesëm (Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV, njërin version në bashkautorësi me dr. Nehas Sopaj, tjetrin me dr. Zeqirija Neziri e dr. Agim Leka); katër tekste universitare, përkatësisht: “Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe” (Shkup, 2005; botimi i dytë 2011; botimi i tretë 2020), “Fonetika dhe fonologjia e shqipes” – të shkruar në maqedonisht 2008, 2011). “Dialektologjia e gjuhës shqipe” (në bashkautorësi me dr. Ajten Qamilin, Shkup, 2014) dhe “Kultura e gjuhës për të gjithë”, Shkup, 2018.

**KOHA: Çështja e revidimit të teksteve shkollorë është proces i vështirë, andaj për eliminimin e mangësive duhet të angazhohen ekspertët më eminentë të arsimit. Por, për të arritur efektin e dëshiruar nevojitet punë dhe kohë?**

**HAMITI:** Jo vetëm që duhen riparë e rihartuar të gjitha tekstet shkollorë, por është e domosdoshme të bëhen ndryshime rrënjësore në gjithë sistemin arsimor të Maqedonisë, që nga edukimi parashkollor, arsimi fillor, i mesëm dhe ai sipëror. Planet e programet mësimore, përmbajtjet e tyre, aparatura didaktike-metodike, gjuha në to nuk janë në përputhshmëri me moshën dhe aftësitë psikike të nxënësit. Shumë libra shkollorë janë të stërngarkuar me informata të panevojshme e kërkesa të rënda, që krijojnë efekte negative te nxënësit, duke shkaktuar mosinteresim dhe averzion.

Thjesht, nxënësi duhet të ngarkohet me barrë aq sa mund të bart, të qëndrojë në këmbë e të mos rrëzohet, sepse mund të mos ngrihet më asnjëherë për të qëndruar në këmbë të shëndosha dhe për të ecur përpara. Marrë në përgjithësi, mund të themi se tekstet shkollorë të arsimit parauniversitar në Maqedoni janë të një niveli të ulët. Ato u sjellin nxënësve njohuri të vjetruara, jobashkëkohore, të ngarkuara me paragjykime e stereotipe, me pasaktësi shkencore (sidomos librat e historisë), me përmbajtje e gjuhë që nxisin urrejte, mostolerancë, me porosi joqytetëruese etj.

Ndër shkaqet për cilësi të dobët të arsimit parauniversitar në Maqedoninë e Veriut është edhe shqipja e mangët e teksteve shkollorë të përkthyer. Siç dihet, tekstet shkollorë shqipe për arsimin fillor dhe të mesëm në Maqedoni përkthehen nga maqedonishtja ose nga anglishtja (përveç librave të gjuhës shqipe e të letërsisë), andaj shumë sosh lëngojnë jo vetëm nga sëmundjet e sapothëna, por edhe nga përkthimet e dobëta, aq sa në shumicën e këtyre librave kemi një gjysmëshqipe. Në pjesën

dërmuese të këtyre librave gjejmë gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme ose siç shprehet prof. Gjovalin Shkurtaç në to është bërë “masakrimi i gjuhës shqipe”: përkthim të fjalëpërfjalshëm me sintaksë të maqedonishtes; mospërdorimin me vend të emrave në rase; përdorimin e fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe; përdorimin e larmishëm e të panjësuar të termave; mbushullojnë gabimet drejtshkrimore, të natyrës fonetike, morfologjike; gabime kuptimore, aq sa në to mund të gjejmë edhe fjali e periudha të pakuptueshme. Nga kjo “shqipe e çoroditur” e kanë të vështirë të shpjegojnë arsimtarët e të mësojnë nxënësit. Librat shkollorë duhet të hartohen në shqip e të mos përkthehen. Shqiptari mendon e shkruan shqip dhe këtë gjuhë do ta kuptojë shumë mirë lehtë nxënësi shqiptar.

Për një gjendje të këtille të mjerueshme fajin e kanë së pari institucionet përgjegjëse shtetërore. Sigurimi i librave shkollorë të cilësisë së nevojshme kërkon qasje serioze të Ministrisë së Arsimit: plane e programe të mira e bashkëkohore, mbështetje materiale e teknike, përzgjedhjen e paanshme të dorëshkrimeve nga komisioni recensues, punë ekipore profesionale etj. Të gjithë ata që përfshihen në përgatitjen dhe botimin e teksteve shkollorë: Ministria e Arsimit, hartuesit, përkthyesit, redaktorët, recensentët, lektorët, korrektorët, ilustruesit, përpunuesit teknikë, botuesit etj., këtë veprimtari të rëndësishme për gjithë shoqërinë dhe ardhmërinë tonë duhet ta kryejnë me përkushtim, përgjegjësi e profesionalizëm. Pra, teksteve mësimore duhet kushtuar shumë më tepër kujdes sesa deri më tani, si në pikëpamje përmbajtjesore, ashtu edhe në pikëpamje metodike-didaktike e gjuhësore, sepse ardhmëria e një kombi varet nga shkalla e arsimit të tij. Për të pasur rini të arsimuar e të edukuar, duhet të kemi edhe tekste shkollorë cilësore e pedagogë të mirë. Njohuritë që nxënësit i marrin në shkollimin parauniversitar, janë të dobishme për gjithë jetën.

**KOHA: Qëllimi kryesor i reformave të sistemit arsimor ka qenë dhe do të jetë garantimi i një sistemi arsimor modern, i cili nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rrit konkurrencën në rajon e më gjerë dhe konsolidon ndërgjegjen qytetare. Si i shihni Ju këto reforma të arsimit në dhjetëvjeçarin e fundit në Maqedoni?**

**HAMITI:** Në dhjetëvjeçarin e fundit në emër të reformave të sistemit arsimor janë ndryshuar e sjellë shumë akte ligjore (nene, rregullore, ligje). Por, për fat të keq, çdo ndryshim i Ligjit të Arsimit Fillor, të Mesëm e Universitar ishte i keq, i paarsyeshëm dhe e përkeqësonte edhe më tej gjendjen e arsimit në Maqedoni. Thjesht, arsimit u shkatërrua pikërisht me këto ndryshime të njëpasnjëshme Ligjesh dhe çdo Ligj pasues që më i keq se i mëparshmi.

T'ju rikujtojmë se në vitin 2011 u soll një Ligj i Arsimit të Lartë ku shumica e ndryshimeve ishin shumë të ashpra, të paarritshme, fyese, të palogjikshme, të dëmshme, centralizuese, jopraktike, të pazbatueshme, me të cilat partia dhe shteti hoqi çdo autonomi dhe fitoi të drejtën absolute për sundim. Ndryshime për të keq janë, p.sh.: heqja e autonomisë së universiteteve, heqja e kategorisë së asistentëve, vlerësimi i studentëve edhe nga një komision i jashtëm, botimi i domosdoshëm për profesorët i punimeve me faktorin impakt, dënime prej 500 e 1000 euro për mësimdhënësin për ndonjë lëshim fare të vogël etj. Praktika e dëshmoi se edhe shumë projekte të tjera u bënë mbrapsht: kompjuter për çdo nxënës në klasë, futja e provimit ekstern, përkthimi i 1000 librave nga gjuhët e huaja si literaturë e domosdoshme në dëm të literaturës vendore etj., etj.

Motoja e ndryshimeve të Ligjit (të Arsimit Fillor, të Arsimit të Mesëm e të Arsimit të Lartë) ishte që punëtorët e arsimit të bëheshin robër të pushtetit dhe të “padëgjueshmit” e “të papërshtatshmit” t'i dënojnë e t'i përjashtojnë nga puna. Këto vërejtje i kam bërë me shkrim edhe në kohën e shqyrtimit publik të Propozim-ligjit të Arsimit të Lartë.

**KOHA: Jeni një ndër punonjësit e çmuar në fushën e arsimit shqip. Ku ka qenë arsimi shqip dje dhe ku është sot, në Maqedoni?**

**HAMITI:** Me keqardhje mund të pohojmë se arsimi shqip në Maqedoni, si edhe në vendet e tjera të Ballkanit, dikur ishte më cilësor, ndërsa në dy dhjetëvjetëshit e fundit gjithnjë e më tepër është përkeqësuar. Fatkeqësisht nga analfabetizmi klasik po kalojmë në analfabetizmin funksional, apo në “analfabetizëm modern”. Tani me shkollimin “në masë” të gjithë fëmijët tanë ndjekin shkollë fillore e të mesme, shumica prej tyre edhe universitete dhe rrjedhimisht marrin edhe diplomë. Por, disa prej tyre nuk marrin dot as njohuritë themelore profesionale.

Përgjithësisht për gjendjen e mjerueshme të shkollimit shqip në Maqedoni e në rajon mund të flasë çdokush e mund të thotë shumëçka. Ky nivel i ulët i cilësisë së arsimit tonë duhet të na shqetësojë të gjithëve: prindërit, arsimtarët, nxënësit, sociologët, hartuesit e teksteve, gazetarët, politikanët... Me një punë të përbashkët të koordinuar mirë, mund të përmirësohet cilësia e shkollimit të të rinjve tanë. E gjithë kjo që u tha deri më tani, mund të përmbledhet me konstatimin se në shumicën e vendeve në tranzicion, përfshirë vendet ballkanike, edhe Maqedoninë, Kosovën e Shqipërinë, kemi anarki në arsim, te ne veçmas në arsimin shqip. Mjaft e qëlluar është thënia e mençur: “Si e kemi arsimin sot, do ta kemi kombin nesër.”

**KOHA: Ka shumë kritika për nivelin e dobët të arsimit si në Maqedoni ashtu edhe në Kosovë. Çfarë masash duhet të ndërmerren për të përmirësuar këtë gjendje?**

**HAMITI:** Konstatim i përgjithshëm është se arsimi shqip gjatë 20-30 viteve të fundit ka pasur një rënie të përhershme dhe fatkeqësisht deri më tani nuk ka shenja përmirësimi. Për të shëruar këtë epidemi të kohës, këtë gjendje alarmante, të pamirë, me pasoja të rënda për ardhmërinë tonë, duhet kushtrimuar të gjithë: institucionet shtetërore, politika, shkolla, familja dhe gjithë shoqëria jonë. Çfarë masash duhet ndërmarrë?

1) ***Të hartohet, të miratohet e të zbatohet një strategji afatgjate arsimore.*** Na mungon një strategji afatgjate për ngritjen e cilësisë në arsim. Lipset ristrukturuar rrënjësisht sistemin arsimor. Rinia është ardhmëria jonë. Një urti popullore thotë: “Çfarë të mbjellësh, do të korrësh”.

2) ***Nga organet kompetente, të investohet më shumë në arsim.*** Kushtet hapësinore të këqija, veçmas të shkollave shqipe, pagat e ulëta të mësimitdhënësve, mungesa e mjeteve didaktike janë një ndër faktorët që ndikojnë në nivelin e dobët të shkollimit te ne, përfshirë edhe analfabetizmin funksional.

3) ***Të përmirësohet gjendja ekonomike e popullatës.*** Në shoqëritë ku popullata ballafaqohet me mungesën e të mirave materiale që janë elementare për mbijetesën e tyre, nuk mund të kërkojmë nga ta që të arsimohen. Po të shëtisësh vetëm për pak minuta nëpër Çarshinë e Vjetër të Shkupit, po edhe në çdo qytet tjetër me shqiptarë në Maqedoni, do të të dhemb shpirti kur sheh skena si në kohën e Migjenit: fëmijë që mezi ecin, fëmijë të njomë, pleq e plaka me “fytira të zbehta e sy të jeshilta, që të shikojnë si hije e shtrijnë duart e mpita...” për të kërkuar lëmshë ose për të shitur ndonjë cikërrimë për të fituar “sa të mos vdesë urie.”

Të shumtë janë edhe nxënësit e studentët që për të siguruar kafshatën e gojës dhe shpenzimet e shkollimit detyrohen të punojnë punë të ndryshme jointelektuale, punë krahu. Në rastet e tilla, kur punohet 8-10 orë në ditë nuk mbetet kohë për të mësuar.

4) ***Të përmirësohen e të rihartohen planet e programet, tekstet mësimore.*** Planet e programet mësimore, përmbajtjet e tyre, aparaturo didaktike-metodike, gjuha në to duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me moshën dhe aftësitë psikike të nxënësit. Shumë libra shkollorë janë të stërngarkuar me informata të panevojshme e kërkesa të rënda, që sjellin efekte negative te nxënësit, duke shkaktuar mosinteresim dhe averzion. Thjesht, nxënësi të ngarkohet me barrë aq sa mund të bart, të qëndrojë në këmbë e të mos rrëzohet, sepse mund të mos ngrihet më asnjëherë për të qëndruar në këmbë të shëndosha dhe për të ecur përpara.

5) ***Të motivohen nxënësit e studentët.*** Për të arritur sukses në ngritjen profesionale, njeriu duhet të jetë i motivuar. Jo vetëm nxënësit e shkollave fillore e të mesme, por as edhe studentët vërej se nuk janë të motivuar. Shumica e të rinjve tanë pjesën më të madhe të kohës po e



humbin me telefon, televizor e rrjetet sociale. Të merr malli të shohësh dikë duke lexuar ndonjë libër. Pa lexim librash, nuk ka arsimim. Shumë nga të rinjtë nuk kanë vizion të qartë për të ardhmen, asgjë nuk mund të parashikohet në këtë shoqëri anarkie, ku asnjë gur më nuk gjendet në vendin e vet. Puna mund të sigurohet vetëm nëpërmjet partisë në pushtet ose nëse ikin jashtë shtetit. Të rrallë janë ata që gjejnë punë për shkollimin përkatës që kanë kryer. Kam dëgjuar shumë herë nga studentët: “nuk është me rëndësi se çfarë fakulteti mbaron, pajisu me një diplomë dhe bëju ushtar i partisë në pushtet.”

6) ***Mjetet e informimit të emetojnë më shumë programe arsimore e edukative.*** Po të shëtisim nëpër programet televizive, aty më së shpeshti shohim antivlera: seriale me përmbajtje të shfrenuara filmike, luftë, dhunë, programe politike me gjuhë të urrejtjes, këngëtare e valltare gjysmëlakuriqe, përmbajtje të turpshme këngësh e “pislleqe” nga më të ndryshmet.

7) ***Prindërit duhet të kujdesen më shumë për fëmijët e tyre.*** Rëndom, ne i gëzohemi vetëm rastit kur fëmija jonë regjistrohet në shkollë, në klasën e parë dhe nuk mungon edhe interesimi ynë për punën e tij deri sa të mësojë të shkruajë e të lexojë, ndërsa në klasat e mëvonshme interesimi ynë zvogëlohet ose shuhet krejtësisht. Prindërit merren vetëm me punët e përditshme të mbijetesës, ndërsa për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve nuk qajnë kokën. Po të kemi ndonjë ankesë nga nxënësi për masat pedagogjike e ndëshkuese të arsimitarit, jo rrallë prindi bëhet arrogant, agresiv e ndonjëherë edhe kërcënues, madje i dhunshëm ndaj arsimitarit. Gjatë vitit shkollor rrallë sheh prind në shkollë, në fund të vitit shkolla mbushullon me prindër që intervenojnë për nota “të shkëlqyeshme” për fëmijët e tyre. Fëmija duhet të jetë gjithnjë nën përkujdesjen e prindit: A shkon në shkollë?, Kur shkon e kur kthehet?, Çfarë sjelljesh e çfarë edukate ka? A lexon, çka e sa lexon? A i bën detyrat? Si e kalon kohën e lirë? Kur zgjohet e kur fle? Sa kohë qëndron në internet? Çka shfrytëzon nga rrjeti i internetit? etj.

8) ***Mësimdhënësit duhet të punojnë më me përkushtim, më me zell dhe me metoda ndërvepruese*** (interaktive). Për të qenë të suksesshëm, mësimdhënësi duhet të përpiqet që ta bëjë punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Metoda klasike e mësimdhënies, veçmas metoda frontale (e ligjërimit të arsimitarit) me gjeneratat e tanishme të të rinjve nuk po jep rezultate, as edhe në fakultet. Andaj, duhet zbatuar metodat bashkëkohore në mësimdhënie.

Në orët e gjuhës amtare të shmanget mësimi skolastik, të mos kërkohet nga nxënësit vetëm që të riprodhojnë atë që e dëgjojnë ose e lexojnë, por të kërkohet nga ta të flasin e të shkruajnë me një origjinalitet,

stil dhe kreativitet. Mësimi i gramatikës të vihet në funksionin e zbatimit praktik në jetën e përditshme. Nxënësit të nxiten që të lexojnë sa më shumë vepra artistike me vlerë të mirëfilltë letrare e gjuhësore. Ata të motivohen të thonë atë që mendojnë (qoftë edhe gabimisht), duke mbështetur e argumentuar mendimin, të kuptojnë atë që kanë lexuar a dëgjuar si dhe të kenë qëndrim vlerësues e kritik ndaj tyre. Mësimdhënësi në vlerësimet që jep për nxënësit duhet të jetë i matur, i drejtë, jofyes. Ndonjëherë, për fat të keq ne “luleve të njoma” (nxënësve) u hedhim ujë të valuar (valë).

9) ***Të mos mashtrojmë njëri-tjetrin me fryrje notash.*** Një ndër parimet themelore të çdo njeriu duhet të jetë objektiviteti, që nënkupton se gjërat duhet parë e vlerësuar realisht, ashtu siç janë, pa i shtrembëruar ato. E vërteta duhet mbrojtur, thënë e kultivuar, qoftë edhe nëse ajo është e hidhur. Ne për disa vjet jemi duke e gënjyer e mashtruar njëri-tjetrin: nxënësi mashtron prindin – prindi mashtron mësuesin – mësuesi mashtron shkollën – shkolla mashtron Ministrinë, Ministria mashtron Qeverinë – Qeveria mashtron botën.

Thjesht, çdokush mashtron çdokënd. Praktikisht, nxënësi mashtron e gënjen prindin se po mëson; prindit i parapëlqen të besojë se fëmija i tij është në rrugë të drejtë, i bën trysni arsimtarit që t’i japë nota të larta, arsimtari mashtron nxënësin duke mundësuar për të “kopjuar, ndihmuar e treguar” në testimin intern dhe ekstern si dhe në provimin e maturës; Ministria e Arsimit e mirëpret dhe vetëkënaqet me mashtrimin e shkollave, pastaj këtë gënjeshtër e përhap nëpër botë.

**KOHA: Profesor i nderuar, ju jeni edhe anëtar Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. Na thoni diçka për këtë?**

**HAMITI:** Dy akademitë shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës qysh më vitin 2004 themeluan Këshillin Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. Të dy Akademitë, duke pasur parasysh se gjuha shqipe është tipari kryesor i kombit, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore midis hapësirave e vendeve që flasin shqip përtej ndarjeve administrative-politike, me krijimin e këtij Këshilli synojnë institucionalizimin mbarëkombëtar të kujdesit për shqipen standarde. Ai merret me të gjitha çështjet që dalin në fushën e gjuhës standarde dhe të përdorimit të saj. Shumica e intelektualëve shqiptarë përkrahin mendimin se duhet bërë përmirësimin e mëtejshëm të rregullave të Drejtshkrimit, duke synuar sidomos mënjanimin e përjashtimeve jo të pakta, që shoqërojnë shpesh rregullat e përgjithshme. E dëshirueshme është që rregullat e Drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, sa më përgjithësuese e sa më të lehta në përdorim, që nuk kërkojnë shumë mund e energji në përvetësim.

Që nga themelimi e deri më tani Këshilli ka mbajtur disa takime pune, në Tiranë e në Prishtinë dhe deri më tani ka sjellë jo pak propozime për përmirësimin dhe ndryshimin e disa rregullave të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, si: për drejtshkrimin e disa zanoreve e bashkëtingëlloreve, shumësin e disa emrave, përdorimin e shkronjave të mëdha, për drejtshkrimin e antroponimeve të huaja etj. Këto propozime për ndryshimin e rregullave ekzistuese janë bërë publike.

**KOHA: Profesor Hamiti, koha me familjen është kohë e shenjtë dhe duhet mbrojtur e respektuar. Sa i përkushtoheni familjes?**

**HAMITI:** Konstatimi juaj është i drejtë. Por, të them të vërtetën, njeriu kur pjesën më të madhe të kohës ia kushton punës profesionale, atëherë nuk i mbetet shumë kohë për t'iu përkushtuar familjes, shokëve, miqve, dashamirëve etj.

Megjithëkëtë, kam një familje që kanë mirëkuptim për angazhimin tim dhe për çdo çështje gjejmë gjuhë të përbashkët. Me bashkëshorten time Nerxhivanen, çunin Fidanin dhe çupën Arjetën (studentë) jetojmë në harmoni të plotë. Kuptohet, kur mund të gjejmë ndonjë kohë të lirë edhe vizitojmë të afërmit e farefisën, dalim në piknik dhe pushimet e verës i kalojmë gjithnjë së bashku.

### III. DIALEKTOLOGJI E ONOMASTIKË


#### 1. ATLASI DIALEKTOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE – VEPËR KOLEKTIVE ME RËNDËSI KOMBËTARE<sup>95</sup>

Në rrugën e zhvillimit ka faza në të cilat një fushë studimesh shkencore shënon arritje shumë të rëndësishme. Për dialektologjinë shqiptare, një arritje e këtillë me rëndësi të veçantë është Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe. Dalja në dritë Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe bashkë me disa vepra themelore të gjuhësisë shqiptare shënon një periudhë të artë të arritjeve të shkencës shqiptare. Atlasi është ndër veprat më të mira të kohës, si vepër kolektive me rëndësi kombëtare.

Pas gati një shekull përpjekjesh, kultura shqiptare u pasurua edhe

me Atlas dialektologjik në dy vëllime: vëllimi I 2007, vëllimi II 2008, Napoli, Itali. E nisur dekada më parë si një projekt i disa albanologëve italianë, të prof. Mateo Bartolit (1929), më pas të prof. Karlo Taliavit (1940) dhe i pasuar nga profesor Eqrem Çabej, kjo vepër madhore u kurorëzua me punën shumëvjeçare të emrave të njohur të gjuhësisë shqiptare: të Jorgji Gjinarit (drejtues), Bahri Becit, Gjovalin Shkurtajt, të ndjerit Xheladin Gosturani si dhe të ndihmesës së pakrysyer që dhanë shumë bashkëpunëtorë të tjerë, sidomos Anastas Dodi e Minella Totoni.

Ideja për hartimin e një atlasit të tillë është hedhur për herë të parë në vitet '30-'40 të shekullit të kaluar



<sup>95</sup> Kumtesë imja me të njëjtin titull botuar në përmbledhjen e punimeve të Seminarit VI Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë-Shkup, 20-22 shtator 2012, f. 211-218. Për Atlasin dialektologjik të shqipes kemi bërë fjalë edhe në tekstin universitar *Dialektologjia e gjuhës shqipe* (në bashkautorësi me Ajten Qamilin), UIShM, Shkup, 2014, f. 55-60.

nga prof. Çabej. Ai e mendoj i pari domosdoshmërinë e një atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, madje hartoi që atëherë edhe një pyetësor të gjerë për këtë punë. Më tej, ideja ka vijuar me punën e prof. Mahir Domit dhe të shumë e shumë pasardhësve dhe kolegëve të tjerë gjuhëtarë, që kanë kontribuar për plotësimin e Atlasit me materialet, studimet dhe hulumtimet e kryera ndër vite.

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe është një vepër madhore përgjithësuese e dialektologjisë sonë, sintezë e të arriturave të deritashme në fushën e dialektologjisë shqiptare dhe kurorëzim i punës shumëvjeçare ekipore të koordinuar të punonjësve shkencorë. Në të me metodën e hartografimit jepet shtrirja e dukurive gjuhësore në gjithë hapësirën e shqipes.

Atlasi dialektologjik të gjuhës shqipe është rrjedhojë e punës paraprake që kanë bërë shumë gjuhëtarë të huaj e shqiptarë, hartues të monografive e të skicave dialektore. Ky projekt i rëndësishëm për gjuhën, kulturën dhe gjithë kombin shqiptar u kurorëzua me punën njëzetepesëvjeçare të gjuhëtarëve tanë të shquar si me ekspeditat shkencore në terren brenda 6 vitesh, ashtu edhe me punën kabinetike të përpunimit të materialit dhe të hartografimit të tij.

Në ADGjSh jepet një pasqyrë e përgjithshme e gjuhës shqipe në variacionin e saj gjeografik sipas koncepteve e metodave të gjeografisë gjuhësore. Ai ka vlera të shumta jo vetëm shkencore, por edhe praktike.

Kjo vepër është me rëndësi të veçantë për dialektologjinë dhe historinë e shqipes. Në radhë të parë është një vepër që i adresohet publikut të specializuar. Atlasi do të vlejë dhe do të shërbejë vazhdimisht në të ardhmen si një pikë referimi për të gjitha studimet gjuhësore. Albanologjia shqiptare, ajo e huaj dhe gjuhësia e përgjithshme, do ta kenë të dobishëm këtë Atlas.

Atlasi u jep përgjigje shumë pyetjeve që padyshim ngrihen dhe u interesojnë gjuhëtarëve në punën e tyre studimore-shkencore. Është një vepër me interes në përgjigjet që jep për dialektologjinë shqiptare të zonave të caktuara, por edhe në përgjithësi. Vepra jep një pasqyrë tërësore, përgjithësuese, të dialekteve dhe të folmeve të gjuhës sonë, të tipareve të përbashkëta dhe veçorive të tyre. Padyshim, jepen kufijtë e shtrirjes së këtyre veçorive, pra, një vështrim i përgjithshëm i gjuhës shqipe në variacionin e saj gjeografik.

Kjo është e para vepër e hartuar sipas koncepteve dhe metodave të gjeografisë gjuhësore, një vepër, realizimi i së cilës u bë i mundur nga një veprimtari paraprijëse 25-vjeçare me studime e hulumtime të gjuhës shqipe. Vepra sjell të dhëna jo vetëm për dialektologjinë, por edhe për disiplina të tjera të veçanta gjuhësore si leksikologjinë dhe historinë e gjuhës e, po kështu, edhe për ndonjë disiplinë jogjuhësore, si historinë e popullit tonë. Kjo është një vepër madhore e gjuhësisë shqipe, që ka interes

për gjuhësinë historike, problemet e kontakteve të gjuhëve, studimet ballkanistike dhe probleme të tjera lidhur me to. Një ndihmesë të veçantë i sjell historisë së gjuhëve kufitare nga të cilat të folmet shqipe, kryesisht të folmet anësore, ruajnë shumë gjurmë frazash të moçme të kontakteve të zhdukura ndonjëherë në vetë trevat e atyre gjuhëve

ADGjSh është i vlefshëm për të gjithë: për studentët, për mësuesit dhe pedagogët, për specialistët e fushave të ndryshme, si edhe për cilindo që kërkon të dije më shumë dhe të rritë më tej nivelin e tij gjuhësor, kulturor e shkencor.

Ai është i vlefshëm jo vetëm për gjuhësinë shqiptare, por edhe për gjuhësinë ballkanike, historinë, etnologjinë etj. Ky kurorëzim bëhet duke përdorur edhe metodën e gjeografisë gjuhësore në shkallën më të përparuar të saj.


Pas një pune të madhe për skedimin e materialeve të mbledhura në pikat e banuara të krahinave të ndryshme më përfaqësuese të të folmeve të shqipes, mbi bazën e materialeve të grumbulluara e të shkencorizuara në një qendër të përbashkët, u themeluan edhe Kartoteka kombëtare e dialekteve të shqipes, pastaj edhe Fonoteka e dialekteve e të folmeve të shqipes, të cilat do të pasuroheshin më tej në mënyrë të pandërprerë edhe nga anketimet e bëra nga bashkëpunëtorë të jashtëm, kryesisht mësues të dalluar të gjuhës shqipe të rretheve, të dhënë pas studimeve

dialektologjike.

Të gjitha anketat për ADGjSh-në janë regjistruar edhe në magnetofon. Bobinat e regjistruara si dhe blloqet e shënimeve të anketave për Atlasin ruhen në kartotekën e fonotekën e sektorit të gramatikës e të dialektologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

Në fillim, ADGJSH-ja ka disa harta jogjuhësore: harta fizike, harta administrative, harta historike, harta etnografike, harta me emrat e katundeve ose qyteteve ku janë bërë anketimet dhe rreth 700 harta gjuhësore.

Hartat e Atlasit janë dy llojesh: harta sqaruese dhe harta josqaruese d.m.th. harta ku shënohet fjala pranë numrit të pikës së anketuar dhe harta ku



nuk vihen fjalët a format, por simbole të llojeve të ndryshme. Pas hartave analitike ka edhe harta përgjithësuese.


Në shumë harta leksikore dhe në disa harta morfologjike dallimet gramatikore dhe dallimet fonetike që nuk janë objekt i tyre, pasqyrohen në një tregues në shpinën e hartës paraprijëse. Në tregues, sipas një renditjeje të shkallëzuar, pasqyrohen variantet e ndryshme gramatikore, fjalëformuese e fonetike për hartën leksikore dhe variantet fonetike për hartën morfologjike. Sigurisht, këta tregues bëhen vetëm kur shihet e domosdoshme. Po kështu, kur është e nevojshme, edhe komentari jepet brenda hartës përkatëse.

Mbi këtë bazë, sigurisht, do të zgjerohen e do të thellohen më tej njohuritë për dialektet e shqipes dhe do të bëhet e mundur të nxirren përfundime më të përditësuara për gjendjen e sotme të dialekteve tona e për historinë e tyre. Vlen për t'u theksuar fakti që Atlasi sjell të dhëna jo vetëm për dialektologjinë, sociolinguistikën, historinë e gjuhës, por edhe për disiplina të tjera të veçanta gjuhësore të shqipes standarde, si për leksikologjinë, fonetikën e fonologjinë, morfologjinë e sintaksën, madje për disiplina jogjuhësore, si për historinë e popullit, etnologjinë etj.

Përhapja gjeografike e fjalëve, e dukurive fonetike, fonologjike, morfologjike e sintaksore sigurojnë material të vlefshëm jo vetëm për dialektologjinë shqiptare, por edhe për historinë e shqipes e të shqiptarëve, për raportet e brendshme të të folmeve, nëndialekteve e dialekteve të shqipes, për marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde, për gjuhët në takim e për gjuhësinë ballkanike. Një ndihmesë të veçantë i sjell historisë së gjuhëve kufitare nga të cilat të folmet shqipe, kryesisht të folmet anësore, ruajnë shumë gjurmë fjalësh e formash të moçme të gjuhës përkatëse në takim, të zhdukura ndonjëherë në vetë trevat e atyre gjuhëve.

Duke pasur në dorë atlasin, njerëzit mund të binden vetiu se nga pjesa më veriore e deri në atë më jugore gjen të njëjtat fjalë me forma të ndryshme. Gjen elemente të strukturës që e përafrojnë gjuhën shqipe dhe tregojnë se shqipja e moçme me shqipen e sotme kanë disa ndryshime, por ato nuk janë ndryshime tepër të mëdha dhe kjo tregon rëndësinë që ka atlasin për të mbështetur zgjidhjet e sotme që janë bërë për gjuhën standarde.

Përgjithësisht është konstatuar se vazhdimësia tokësore e shtrirjes së shqiptarëve në Ballkan bashkëpërputhet me vazhdimësinë gjuhësore. Nga kjo pikëpamje, të folmet shqipe në mënyrë të shkallëshkallshme gërshetohen njëra me tjetrën.



Ky shkallëzim gjuhësor me zona kalimtare nga një tip të folmesh në tipin tjetër, që më së miri e pasqyron ADGjSh me izoglosa e jo me kufij të prerë dialektor është një dëshmi e fuqishme gjuhësore se shqiptarët në Ballkan janë autoktonë dhe se me shekuj kanë jetuar e jetojnë aty. Kontinuiteti tokësor, etnik, historik e gjuhësor i shqiptarëve në Ballkan mohojnë bindshëm hipotezën e disa dashakqinjve të popullit tonë se kinse para dy-tre shekujsh paskësh pasur dyndje të mëdha popullsie nga Shqipëria në Maqedoni.

Dy vëllimet e Atlasit janë literaturë e patjetërsueshme jo vetëm për studentët e filologjisë shqiptare, por edhe për çdo intelektual tjetër shqiptar. Me këtë vepër kapitale është bërë një hap i madh përpara në studimet shqiptare. Me vlerat që ka, ai do të ndihmojë zhvillimin e një faze më të ngritur të gjuhësisë sonë.

ADGjSh përfshin një rrjet dialektor prej 175 pikash, nga të cilat 85 vendbanime në Republikën e Shqipërisë, 66 në trevat shqiptare jashtë saj: në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, në anët e Peshterit, të Jabllanicës dhe të Preshevës e Bujanovcit, në diasporën arbëreshe të Italisë, të Greqisë dhe të arbneshëve të Zarës (Dalmaci).

Hartuesit e Atlasit u përballën me probleme të shumta jo vetëm gjuhësore, por edhe me probleme politike e financiare. Në një deklaratë prof. Gjovalin Shkurtaç thotë: "Në atë periudhë kur është shkruar kjo vepër nuk shkonim dot në disa vende, për arsye të konjunkturave politike, i kemi plotësuar duke marrë vepra apo botime të albanologëve ose të studiuesve shqiptarë në ato treva. Pra, është bërë një punë e vështirë dhe e madhe, por si për çdo vështirësi, pasi kalohet, njeriu ndjen vetëm gëzim. Unë mund të them pa mburrje që libri që sapo kemi marrë në dorë, dy vëllimet e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe shkon jo vetëm krahas me Fjalorin dhe me Gramatikën, por shkon edhe më tej se ato, për faktin se ndërsa ato janë vepra që kanë gjithmonë vulën e një autori, kjo është një vepër që ka vulën e autorëve dhe të një populli të tërë, sepse ne kemi bërë ekspedita, kërkime në të gjitha trevat shqiptare. Krahas me emrat tanë në faqet e para të Atlasit, janë edhe emrat e shumë informatorëve me të cilët ne kemi



qëndruar me ditë të tëra, i kemi pyetur dhe ata na janë përgjigjur me shumë durim”.

### **Rëndësia e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe**

ADGjSh ka rëndësi të shumëfishtë. Përmbledhtas mund të thuhet se:

- Nga ADGjSh përftohet një tablo shumë e gjerë e dukurive gjuhësore që lidhen me fonetikën e fonologjinë, morfologjinë, sintaksën (vëllimi I) dhe leksikun (vëllimi II). Përfundimet janë të pasqyruara në harta gjeografike shumëngjyrëshe për të lehtësuar leximin e simboleve që përfaqësojnë varietetet gjuhësore. Ai ka vlera të shumta jo vetëm shkencore, por edhe praktike.

- Përhapja gjeografike e fjalëve, e dukurive fonetike, fonologjike, morfologjike e sintaksore sigurojnë material të vlefshëm jo vetëm për dialektologjinë shqiptare, por edhe për historinë e shqipes e të shqiptarëve, për raportet e brendshme të të folmeve, nëndialekteve e dialekteve të shqipes, për marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde, për gjuhët në takim e për gjuhësinë ballkanike. Me një emërtesë të përbashkët mund të thuhet se Atlasi është një enciklopedi e gjuhës dhe e kulturës popullore.

- Në Atlas janë përmbledhur (sintetizuar) me sukses qindra e mijëra faqe tekst të monografive dhe të skicave dialektore.

- Ai sjell një metodologji të re në studimin e dialektologjisë shqiptare, metodën e gjeografisë gjuhësore në shkallën më të përparuar të saj. Kjo metodë e hartografimit të dukurive gjuhësore në të ardhmen mund të zbatohet edhe për mikrosistemet dialektore.

- Mbi këtë bazë, sigurisht, do të zgjerohen e do të thellohen më tej njohuritë për dialektet e shqipes dhe do të bëhet e mundur të nxirren përfundime më të përditësuara për gjendjen e sotme të dialekteve tona e për historinë e tyre.

- Populli ka ruajtur materialin burimor të këtij atlas. Ai ka merita shumë të mëdha që ka arritur të ruajë vazhdimësinë gjuhësore nga ilirishtja – shqipja e vjetër – arbërishtja – shqipja e re. Atlasi ka vulën e popullit, sepse në të pasqyrohet gjuha e tij dhe nëpërmjet saj sigurohet një material burimor për botën materiale e shpirtërore të tij. Atlasi dokumenton shqipen territoriale të shekullit XX.

- Dijetari i shquar frëng Charl Nodie me të drejtë ka thënë se “ai që nuk ka hulumtuar me kujdes dialektet dhe të folmet e gjuhës së vet, nuk njih as gjysmën e saj“. Me ADGjSh zgjerohen, thellohen dhe saktësohen njohuritë tona për larminë territoriale të shqipes dhe bashkë me gramatikat normative, fjalorët dhe veprat e tjera shtohen studimet themelore për gjuhën dhe kulturën kombëtare.

Dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijojnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të gjuhës standarde me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyime fjalësh, mjete shprehëse si dhe

për zhvillimin e normës leksikore. Pasuria leksikore e frazeologjike e shqipes, vlerësohet si pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.

- Dy vëllimet e Atlasit janë literaturë e domosdoshme jo vetëm për studentët e filologjisë shqiptare, por edhe për çdo intelektual tjetër shqiptar. Me këtë vepër kapitale është bërë një hap i madh përpara në studimet shqiptare. Me vlerat që ka, ai do të ndihmojë zhvillimin e një faze më të ngritur të gjuhësisë sonë.

## **Përmbledhje**

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (në dy vëllime: Napoli, 2007, 2008) është një vepër madhore përgjithësuese e dialektologjisë sonë, sintezë e të arriturave të deritashme në fushën e dialektologjisë shqiptare dhe kurorëzim i punës shumëvjeçare ekipore të koordinuar të punonjësve shkencorë. Në të me metodën e hartografimit jepet shtrirja e dukurive gjuhësore në gjithë hapësirën e shqipes.

Dalja në dritë e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe, bashkë me disa vepra themelore të gjuhësisë shqiptare, shënon një periudhë të artë të arritjeve të shkencës shqiptare. Atlasi është ndër veprat më të mira të kohës, si vepër kolektive me rëndësi kombëtare.

Mbi këtë bazë, sigurisht, do të zgjerohen e do të thellohen më tej njohuritë për dialektet e shqipes dhe do të bëhet e mundur të nxirren përfundime më të përditësuara për gjendjen e sotme të dialekteve tona e për historinë e tyre. Vlen për t'u theksuar fakti që Atlasi sjell të dhëna jo vetëm për dialektologjinë, sociolinguistikën, historinë e gjuhës, por edhe për disiplina të tjera të veçanta gjuhësore të shqipes standarde, si për leksikologjinë, fonetikën e fonologjinë, morfologjinë e sintaksën, madje për disiplina jogjuhësore, si për historinë e popullit, etnologjinë etj. Një ndihmesë të veçantë i sjell historisë së gjuhëve kufitare nga të cilat të folmet shqipe, kryesisht të folmet anësore, ruajnë shumë gjurmë frazash të moçme të kontakteve të zhdukura ndonjëherë në vetë trevat e atyre gjuhëve. Atlasi u jep përgjigje shumë pyetjeve që padyshim ngrihen dhe u interesojnë gjuhëtarëve në punën e tyre studimore-shkencore. Është një vepër me interes në përgjigjet që jep për dialektologjinë shqiptare të zonave të caktuara, por edhe në përgjithësi.

## **Literatura:**

AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.

Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997.

*Fjalor enciklopedik shqiptar 1*, Tiranë, 2008.

Asllan Hamiti, *Atlasët krahinorë çojnë përpara gjeografinë gjuhësore të shqipes*, Aktet – revistë shkencore e Institutit Alb-shkenca, vëllimi III, nr. 4, Tiranë – Prishtinë – Shkup, 2010.

Asllan Hamiti, *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010.

Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, www.albanologjia.com, kumtesa.

<http://www.zeriyt.com/gjuha-shqipe/gjuha-shqipe-me-atlas-dialektologjik-t42034.0.html>

<http://depca.albanianforum.net/t221-atlasi-dialektologjik-i-gjuhes-shqipe>

<https://vargmal.org/lg/dan3929>

[http://lajme.parajsa.com/Kulture/id\\_23293/](http://lajme.parajsa.com/Kulture/id_23293/)

<http://www.forumishqiptar.com/threads/81918-Botohet-Atlasi-Dialektologjik-amaneti-i-prof-Eqrem-Çabejt>

<http://drita.org/arkivi/drita4.pdf>

## 2. ATLASËT KRAHINORË ÇOJNË PËRPARA GJEOGRAFINË GJUHËSORE TË SHQIPES<sup>96</sup>

### ***Përmbledhje***

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (në dy vëllime: Napoli, 2007, 2008) është një vepër madhore përgjithësuese e dialektologjisë sonë, sintezë e të arriturave të deritashme në fushën e dialektologjisë shqiptare dhe kurorëzim i punës shumëvjeçare ekipore të koordinuar të punonjësve shkencorë. Në të me metodën e hartografimit jepet shtrirja e dukurive gjuhësore në gjithë hapësirën e shqipes.

Megjithëkëtë, puna nuk duhet ndërprerë. Njohja më e thelluar e varieteteve territoriale duhet vazhduar me monografi përshkruese, studime për dukuri të veçanta e përgjithësuese, duhen vëzhguar edhe më

<sup>96</sup> Kumtesë imja e lexuar dhe më pas e botuar në AKTET e Revistës Shkencore të Institutit Alb-Shkenca, vëll. III, nr. 4, 2010, Tiranë – Prishtinë – Shkup, 2010, f. 519-521 (ISSN 2073-2244).

tej marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën standarde, ndërveprimet e tyre, ndërndikimet e të folmeve shqipe me gjuhët e huaja në takim etj., por duhet punuar sidomos në hartimin e atlasëve krahinorë.

Siç thuhet edhe në Hyrje të ADGjSh, të dhënat për të folmet e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi e të Çamërisë (me përjashtim të jashtë pikave: të tri pikave në Kosovë dhe të tri pikave në Maqedoni) janë marrë nga informues që kanë shkuar nga këto vende në Shqipëri para më se 50-60 e më shumë vitesh dhe që jetojnë atje. Kuptohet se gjuha e tyre duhet të ketë ndryshuar dhe nuk është autentike.

Të dhënat për të folmet shqipe, jashtë territorit shtetëror të Shqipërisë, sidomos ato të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi e të arbëreshëve të Greqisë do të vërtetohen, do të plotësohen, do të zgjerohen dhe do të saktësohen nga hartimi i atlaseve krahinorë. Hartimi i atlasëve krahinorë është nevojë e kohës, dobiprurës, që do të çojë përpara gjeografinë gjuhësore të shqipes.

**Fjalët kyçe:** *vepër madhore, atlas dialektor, atlas krahinor, gjeografi gjuhësore*

Pas gati një shekull përpjekjesh, kultura shqiptare u pasurua edhe me Atlas dialektologjik. E nisur dekada më parë si një projekt i disa albanologëve italianë, të prof. Mateo Bartolit (1929), më pas të prof. Karlo Taliavit (1940) dhe i pasuar nga profesor Eqerem Çabej, kjo vepër madhore u kurorëzua me punën shumëvjeçare të emrave të njohur të gjuhësisë shqiptare: të Jorgji Gjinarit (drejtues), Bahri Becit, Gjovalin Shkurtajt, të ndjerit Xheladin Gosturani si dhe të ndihmesës së pakysyer që dhanë shumë bashkëpunëtorë të tjerë, sidomos Anastas Dodi e Minella Totoni.

Atlasi dialektologjik të gjuhës shqipe është rrjedhojë e punës paraprake që kanë bërë shumë gjuhëtarë të huaj e shqiptarë, hartues të monografive e të skicave dialektore. Ky projekt i rëndësishëm për gjuhën, kulturën dhe gjithë kombin shqiptar u kurorëzua me punën njëzetepesëvjeçare të gjuhëtarëve tanë të shquar si me ekspeditat shkencore në terren brenda 6 vitesh, ashtu edhe me punën kabinetike të përpunimit të materialit dhe të hartografimit të tij.

Në ADGjSh jepet një pasqyrë e përgjithshme e gjuhës shqipe në variacionin e saj gjeografik sipas koncepteve e metodave të gjeografisë gjuhësore. Ai ka vlera të shumta jo vetëm shkencore, por edhe praktike.

Përhapja gjeografike e fjalëve, e dukurive fonetike, fonologjike, morfologjike e sintaksore sigurojnë material të vlefshëm jo vetëm për dialektologjinë shqiptare, por edhe për historinë e shqipes e të shqiptarëve, për raportet e brendshme të të folmeve, nëndialekteve e dialekteve të

shqipes, për marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde, për gjuhët në takim e për gjuhësinë ballkanike.

Dy vëllimet e Atlasit janë literaturë e patjetërsueshme jo vetëm për studentët e filologjisë shqiptare, por edhe për çdo intelektual tjetër shqiptar. Me këtë vepër kapitale është bërë një hap i madh përpara në studimet shqiptare. Me vlerat që ka, ai do të ndihmojë zhvillimin e një faze më të ngritur të gjuhësisë sonë.

Siç thuhet edhe në Hyrje të ADGjSh “njohja më e thelluar e dialekteve në fazën e tanishme dhe në të ardhmen do të bëhet jo vetëm me “Atlasin” dhe me monografi përshkruese më të gjera për disa të folme të veçanta, por edhe me studime e kërkime të tjera, siç janë ato për leksikun dialektor, punime të ndryshme për historinë e dialekteve e të dukurive të veçanta të tyre, studime për të folmet e diasporës, që pak janë trajtuar deri tani, me punime përgjithësuese për grupet e të folmeve dhe për mbarë dialektet e shqipes, studimet për marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare etj.”<sup>i</sup>

ADGjSh përfshin një rrjet dialektor prej 175 pikash, nga të cilat 85 vendbanime në Republikën e Shqipërisë, 66 në trevat shqiptare jashtë saj: në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, në anët e Peshterit, të Jablanicës dhe të Preshevës e Bujanovcit, në diasporën arbëreshe të Italisë, të Greqisë dhe të arbneshëve të Zarës (Dalmaci).

Rrjeti i pikave të përfaqësuar dialektore në Shqipëri është i dendur, ndërsa i atyre jashtë Shqipërisë është më i rrallë. P.sh. të folmet shqipe të Maqedonisë janë paraqitur vetëm në 18 pika dialektore, ndërsa të dhënat për to janë siguruar kryesisht nga punimet e pakta dialektore ose nga informatorë që kanë vajtur në Shqipëri para shumë vitesh.

Sipas marrëveshjes së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ishin caktuar të punonin me zonat e të folmeve shqipe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi edhe katër gjuhëtarë vendorë, përkatësisht Latif Mulaku, Mehmet Halimi dhe Remzi Nesimi nën drejtimin e prof. Idriz Ajetit. Deri në fund të vitit 1980, arritën të bëheshin gjashtë anketa të përbashkëta: tri në Kosovë dhe tri në Mal të Zi. Pas vitit 1981, me rezistencën e shqiptarëve ndaj dhunës së përhershme gjithnjë e më të egër që ushtronte pushteti serb dhe politikës së egër antishqiptare të përgjithshme në ish-Jugosllavi u bë e pamundur që të bëheshin ekspedita të tilla. Për të mos e ndërprerë plotësisht punën dhe për të mos dështuar ky projekt madhor, grupi i punës u detyrua të kërkonte informatorë të ardhur në Shqipëri nga viset e parapara në rrjetin e pikave.

Hartuesit e Atlasit u përballën me probleme të shumta jo vetëm gjuhësore, por edhe me probleme politike e financiare. Në një deklaratë prof. Gjovalin Shkurtaç thotë: “Në atë periudhë kur është shkruar kjo vepër nuk shkonim dot në disa vende, për arsye të konjunkturave politike, i kemi plotësuar duke marrë vepra apo botime të albanologëve ose të studiuesve

shqiptarë në ato treva. Pra, është bërë një punë e vështirë dhe e madhe, por si për çdo vështirësi, pasi kalohet, njeriu ndjen vetëm gëzim. Unë mund të them pa mburrje që libri që sapo kemi marrë në dorë, dy vëllimet e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe shkon jo vetëm krahas me Fjalorin dhe me Gramatikën, por shkon edhe më tej se ato, për faktin se ndërsa ato janë vepra që kanë gjithmonë vulën e një autori, kjo është një vepër që ka vulën e autorëve dhe të një populli të tërë, sepse ne kemi bërë ekspedita, kërkime në të gjitha trevat shqiptare. Krahas me emrat tanë në faqet e para të Atlasit, janë edhe emrat e shumë informatorëve me të cilët ne kemi qëndruar me ditë të tëra, i kemi pyetur dhe ata na janë përgjigjur me shumë durim.

Megjithë vlerat e jashtëzakonshme që ai ka, vështirësitë e atëhershme financiare që kalonte Shqipëria e bënë të pamundur për disa vite botimin e tij. Më pas u arrit që në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, përkatësisht të Akademisë së Shkencave dhe të Departamentit të Studimeve të Evropës Lindore të Universitetit Oriental të Napolit në Itali të botohet Atlasi në dy vëllime me fondet financiare që ndau për të, falë edhe angazhimit të madh të prof. Italo Costante Fortino.

### **Nevoja e hartimit të atlasëve krahinorë**

Me këtë paraqitje tonë të shkurtër, nuk duam të vëmë në diskutim vlerat e Atlasit, sepse ato janë të padiskutueshme dhe ai paraqet një nga të arriturat albanologjike më të mëdha të kohës, por duam të vëmë në pah nevojën e vazhdimit të punës së filluar, përkatësisht të zbatimit të gjeografisë gjuhësore edhe për mikrosistemet e shqipes dialektore. Dobiprurës do të jenë atlasët krahinorë. Fjala vjen, do të ishte mirë të hartoheshin nga një atlas krahinor për:

- a) të folmet shqipe në Maqedoni;
- b) të folmet e Kosovës, duke përfshirë edhe ato të Preshevës e Bujanovcit;
- c) të folmet shqipe të Malit të Zi;
- ç) arbërishten e Italisë;
- d) arbërishten e Greqisë etj.

Më mirë do të ishte edhe të mos zbatohet një ndarje krahinore si kjo më sipër, por atlasët krahinorë të përpiloheshin mbi bazën e ndarjes dialektore, përkatësisht të hartoheshin një atlas dialektor për:

- a) dialektin e gegërishtes;
- b) dialektin e toskërishtes;
- c) grupin e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore;
- ç) grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore;
- d) grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore;

- dh) grupin e të folmeve të Shqipërisë së Mesme;
- ë) grupin e të folmeve të toskërishtes veriore;
- f) grupin e të folmeve të labërishtes;
- g) grupin e të folmeve të çamërishtes etj.

Nga ADGjSh përftohet një tablo shumë e gjerë e fenomeneve gjuhësore që lidhen me fonetikën, morfologjinë, sintaksën (vëllimi I) dhe leksikun (vëllimi II). Përfundimet janë të pasqyruara në harta gjeografike shumëngjyrëshe për të lehtësuar leximin e simboleve që përfaqësojnë varietetet e fenomeneve gjuhësore.

Thuhet edhe në Hyrje se ky “Atlas do të paraprijë atlasët krahinorë, që do të hartohen në etapa të ardhshme për njohjen më me hollësi dhe më në thellësi të tipareve dhe çështjeve të veçanta që kanë njësitë e ndryshme dialektore të shqipes”.<sup>ii</sup>

Duhet theksuar se ky është Atlas i tërë shqipes dialektore dhe jep një pasqyrim të plotë të dialekteve e të folmeve të shqipes, të tipareve e veçorive të tyre. E njëjta dukuri gjuhësore është pasqyruar në një hartë të caktuar, në të gjithë hapësirën shqipfolëse, duke na dhënë mundësinë të dallojmë tiparet dialektore në një rrafsh krahasues. Atlasi përmban 10 harta jogjuhësore dhe 405 harta gjuhësore që trajtojnë e pasqyrojnë në dy vëllime dallimet dialektore fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës shqipe.

Siç shprehet prof. Gjovalin Shkurtaç, ndonëse i botuar më 2007 dhe 2008, “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe” paraqet një realitet dhe dukuri gjuhësore të viteve ‘80. Gjuhëtarët nuk e kanë pasuruar materialin me të dhëna të marra pas ‘90-ës, kohë në të cilën lëvizja e madhe demografike e popullsisë dhe intensifikimi i mjeteve komunikuese ka kushtëzuar edhe zhvillime apo ndryshime gjuhësore.

Për hartimin e atlasëve krahinorë do të duhet një organizim tjetër gjuhëtarësh e shkencëtarësh në nivel kombëtar. Tani më nuk ka nevojë të fillohet nga e para, meqë mund të shfrytëzohet përvoja e punës së dialektologëve tanë që kanë bërë për ADGjSh. Rrjedhimisht në këtë punë ekipore duhet të marrin pjesë bashkë me gjuhëtarët e asaj zone edhe autorët e Atlasit dialektologjik të shqipes. Siç thotë me një rast prof. Gjovalin Shkurtaç, “nëse Atlasi përfshin 175 pika anketimi dhe paraqitje hartografike për të gjithë shtrirjen gjuhësore shqiptare, vetëm në një krahinë mund të ketë më shumë se 200 pika”. Me atlasët rajonalë do të plotësohet, do të vërtetohet e do të përimitohet shtrirja gjeografike e dukurive gjuhësore të shqipes.

Që dukuritë gjuhësore të paraqitura në Atlasin e përbashkët të shqipes dhe në Atlasët krahinorë të jenë të krahasueshme do të ishte më mirë të shfrytëzohej i njëjti Pyetësor hartuar nga Jorgji Gjinari, Gjovalin Shkurtaç e i ndjeri Xheladin Gosturani. Kuptohet se për të folme të ndryshme që kanë tipare të veçanta ky pyetësor mund të plotësohet edhe

me pyetje të tjera. Bie fjala, për të folmet e gegërishtes qendrore pyetësorit duhet shtuar edhe pyetje për diftongimin e zanoreve të theksuara /i, y, u/, për zh buzorëzimin e [y]-së në [i], qiellzorizimin e bashkëtingëllores [g] në [gj], për evoluimin e grupeve të vjetra konsonantike [kl, gl], për zhvillimin e grupeve [pl, bl, fl], por edhe ndonjë pyetje të karakterit të përgjithshëm, si për të hetuar vlerën fonologjike të gjatësisë së zanoreve, vlerën fonologjike të hundorësisë së zanoreve, duke kërkuar që këto dukuri të rëndësishme të vërtetohen me çifte minimale fjalësh.

Po kështu duhet të ruhen incizimet origjinale që gjuhëtarët do të bëjnë në terren bashkë me shënimet e tyre. Nga materiali i vjelë të themelohet kartotekë dhe fonotekë e atyre të folmeve. Arkivat audio duhet të digjitalizohen dhe të hidhen në internet, që të kenë një përdorim më të gjerë, e të mos mbeten vetëm në kuadrin e studiuesve të gjuhës. Një punë të ngjashme kanë bërë kolegët maqedonas për dialektet e maqedonishtes.

Do të ishte e udhës të themelojmë një fonotekë, kartotekë dhe një laborator të fonetikës eksperimentale. Këto punë madhore kërkojnë përkrahjen e organeve shtetërore, bashkërendimin e gjuhëtarëve dhe bashkëpunimin e specialistëve dhe institucioneve arsimore e shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Mendojmë se në të ardhmen gjuhësia shqiptare në fushën e dialektologjisë duhet të shtrojë detyra të tjera: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik, leksikor e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm si dhe me metoda bashkëkohore. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt. Hartimi i atlasëve krahinorë do të ngërthente të arriturat në këtë fushë.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.



### 3. RRJETI I PIKAVE TË TË FOLMEVE SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT PËR ATLASIN E SINTAKSËS DIALEKTORE TË SHQIPES<sup>97</sup>

Të dashur, të nderuar e të respektuar miq!

Kam nderin e kënaqësinë që sot në këtë tryezë të rrumbullakët në emrin e grupit punues Asllan Hamiti, Ajten Qamili, Ismet Osmani nga Universiteti i Shkupit dhe Berton Sulejmani e Izmit Durmishi nga Universiteti i Tetovës të shfaqim mendime për pikat dialektore të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Përgëzojmë Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë për punën që po bën e do të bëjë në planifikimin, organizimin, vjeljen e materialit, grumbullimin, përpunimin, përgatitjen dhe hartimin e Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipes.

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (në dy vëllime: Napoli, 2007, 2008) është një vepër madhore përgjithësuese e dialektologjisë sonë, sintezë e të arriturave të deritashme në fushën e dialektologjisë shqiptare dhe kurorëzim i punës shumëvjeçare ekipore të koordinuar të punonjësve shkencorë. Kjo vepër madhore u kurorëzua me punën shumëvjeçare të emrave të njohur të gjuhësisë shqiptare si dhe të ndihmesës së pakysyer që dhanë shumë bashkëpunëtorë të tjerë, sidomos Anastas Dodi e Minella Totoni.

Siç dihet, me metodën e hartografimit u pasqyruan tiparet fonetike, fonologjike, morfologjike e leksikore të shqipes dialektore, ndërsa mbeti pa u përfshirë shtrirja e dukurive sintaksore në hapësirën e shqipes, përkatësisht u pasqyruan vetëm 9 veçori sintaksore në po aq harta dialektore. Atlasin e Sintaksës Dialektore do të jetë edhe një hap i rëndësishëm në gjeografinë gjuhësore të shqipes.

Është fat që i kemi ende shëndosh e mirë tre nga katër hartuesit e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, gjuhëtarët tanë të mëdhenj: Jorgji Gjinarin, Bahri Becin e Gjovalin Shkurtajn, të cilët përvojën e tyre të shkëlqyer në hartimin e dy vëllimeve të mëparshme të Atlasit do ta bartin edhe në vëllimin e tretë. Sigurisht se në këtë punë kolektive me përmasa kombëtare ndihmesë të vyer mund të japin edhe gjuhëtarë të tjerë të shquar e bashkëpunëtorë të të gjitha trojeve, sidomos në vjeljen e materialit të nevojshëm dialektor.

Edhe me dy vëllimet botuara të Atlasit, njerëzit mund të binden vetiu se nga pjesa më veriore e deri në atë më jugore gjen të njëjtat fjalë me

---

<sup>97</sup> Kumtesë (në bashkautorësi) e lexuar në Tryezën e rrumbullakët, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 13. 10. 2017.

forma të ndryshme. Gjen elemente të strukturës që e përafrojnë atë dhe dëshmojnë se shqipja dialektore ka shumë ngjashmëri e fare pak dallime, fare të natyrshme edhe për të gjitha gjuhët e tjera të gjalla. Përgjithësisht është konstatuar se vazhdimësia tokësore e shtrirjes së shqiptarëve në Ballkan bashkëpërputhet me vazhdimësinë gjuhësore. Nga kjo pikëpamje, të folmet shqipe në mënyrë të shkallëshkallshme gërshetohen njëra me tjetrën.

Ky shkallëzim gjuhësor me zona kalimtare nga një tip të folmesh në tipin tjetër, që më së miri e pasqyron ADGjSh me izoglosa e jo me kufij të prerë dialektor, është një dëshmi e fuqishme gjuhësore se shqiptarët në Ballkan janë autoktonë dhe se me shekuj kanë jetuar e jetojnë aty. Kontinuiteti tokësor, etnik, historik e gjuhësor i shqiptarëve në Ballkan mohojnë bindshëm hipotezën e disa dashakqinjve të popullit tonë se kinse para dy-tre shekujsh paskësh pasur dyndje të mëdha popullsie nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut.

Me Atlasin e Sintaksës Dialektore të Shqipes do të përdëftohet edhe më bindshëm uniteti i shqipes, kontinuiteti gjuhësor e territorial si dhe autoktonia e shqiptarëve jo vetëm brenda kufijve të sotëm shtetërorë të Shqipërisë e Kosovës, por edhe në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në Greqi dhe në Serbi. Nga ana tjetër, me Atlasin e Sintaksës Dialektore të Shqipes do të fuqizohet edhe më bindshëm zgjidhja e bërë për variantin standard të shqipes.

Grupi ynë nga Maqedonia e Veriut me përfaqësues nga Universiteti i Shkupit dhe i Tetovës përfshirjen tonë në këtë projekt kombëtar e kemi mirëpritur dhe do të përpiqemi që detyrën tonë ta kryejmë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për të përcaktuar pikat dialektore të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut, përveç udhëzimeve e materialeve të marra nga organizatorët e projektit, kemi konsultuar edhe monografi e skica dialektore, studime e tekste përgjithësuese, si dhe Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe (në dy vëllime).

Ja propozimet tona konkrete:

**1. Grumbullimi i materialit dialektor për Atlasin e Sintaksës Dialektore të Shqipes të bëhet sipas standardeve tanimë të njohura,** me ekspedita të drejtpërdrejta në terren nga specialistë të fushës. Vjelja e materialit të bëhet në dy mënyra:

- a) me pyetësor të përgatitur paraprakisht, dhe
- b) nëpërmjet bisedës së lirë tematike.

**2. Krahasuar me ADGjSh, të zgjerohet rrjeti i pikave dialektore jashtë Shqipërisë**

Siç dihet, ADGjSh përfshin një rrjet dialektor prej 175 pikash, nga të cilat 85 vendbanime në Republikën e Shqipërisë, 66 në trevat shqiptare jashtë saj: në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoninë Veriut, në anët e Peshterit, të Jabllanicës dhe të Preshevës e Bujanovcit, në diasporën arbëreshe të Italisë, të Greqisë dhe të arbnesëve të Zarës (Dalmaci).

Në hartat e ADGjSh shihet se në territorin e Shqipërisë pikat dialektore janë të dendura (85), në Kosovë pikat dialektore janë të rralla (34), ndërsa në Maqedoninë e Veriut janë shumë të rralla, përkatësisht të gjitha të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut përfaqësohen vetëm me 18 pika dialektore. Kjo mund të jetë e pranueshme, siç thuhet në parathënien e Atlasit, meqë "hartuesit e Atlasit u përballën me probleme të shumta jo vetëm gjuhësore, por edhe me probleme politike e financiare."

Tani me demokratizimin e shteteve ballkanike, lëvizjen e lirë të njerëzve, botimin e shumë monografive dialektore, ngritjen arsimore e shkencore si dhe përgjithësisht me krijimin e rrethanave më të favorshme edhe për gjeografinë gjuhësore të shqipes, mendojmë se duhet të zgjerohet rrjeti i pikave dialektore jashtë Shqipërisë, sidomos në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut.

**3. Pjesa më e madhe e pikave dialektore të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut mendojmë se duhet të mbeten po ato të ADGjSh-së, por propozojmë edhe disa ndërrime pikash, saktësim emrash si dhe shtimin e disa pikave të reja.**

Në vazhdim po sjellim propozimin tonë:

#### PROPOZIM

**për rrjetin e pikave të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut për Atlasin e sintaksës dialektore të shqipes**

1. KUMANOVË				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
61	Orizore	Kumanovë	-	Duhet: Orizare
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Orizare	Kumanovë	-	gegërishte qendrore
	Sllupçan	Kumanovë	-	gegërishte verilindore

**Shënim:**

## 1. KUMANOVA

Të folmet shqipe të Kumanovës (25 fshatra) i përkasin dy nëndialekteve: a) gegërishtes veriore dhe b) gegërishtes jugore.

a) **Gegërishtes qendrore** – 7 fshatra (fshatra të komunës së Likovës): Nikushtak, Vishticë, Ropalcë, Mateç, Hotël, Likovë, Orizare.

b) **Gegërishtes verilindore** – 18 fshatra (fshatra të komunës së Likovës): Ērkoc, Gllaznjë, Bellanoc, Izvor, Allashec, Strazhë, Runicë, Sllupçan, Opajë, Vaksincë, Llojan; (fshatra të komunës së Kumanovës): Llopat, Ērzhanoç, Çerkez, Kojnare, Vojnoviç, Sopot, Rramanli.

**Propozim:** Propozojmë të kemi dy pika dialektore: një përfaqësuese të gegërishtes qendrore dhe një të gegërishtes verilindore.

2. SHKUP				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
60	Tanishevc	Shkup	Karadaku i Shkupit	Duhet: Tanushë.Tanusha është shpopulluar.
63	Shkup	Shkup	-	Në Shkup kemi larmi të folmesh.
104/A	Cërnivor	Shkup	-	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Bllacë	Shkup	Karadaku i Shkupit	
	Brezë	Shkup	Karadaku i Shkupit	Breza është fshat i izoluar malor që e ka ruajtur mirë shqipen
104/A	Cërnivor	Shkup	Karshiakë	

**Shënim:**

## 2. SHKUPI

### 2.1. KARADAKU I SHKUPIT

Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.

E folmja shqipe e Malit të Zi të Shkupit (e njohur në popull si Karadak) përfaqëson një izoglosë “ndërkaluëse nga gegërishtja qendrore në gegërishten verilindore apo anasjelltas.” Në strukturën dialektore të shqipes, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit i përket *gegërishtes*

*qendrore*, por në të gjejmë të gërshetuara mjaft tipare gjuhësore të gegërishtes verilindore.

Sipas veçorive gjuhësore që përkojnë me shtrirjen gjeografike, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit mund të cilësohet si e folme më skajore verilindore e gegërishtes qendrore. Me fjalë të tjera, të folmet e fshatrave të Malit të Zi të Shkupit, si për nga shtrirja hapësinore, ashtu edhe për nga tiparet gjuhësore, përfaqësojnë kufirin më verior të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore. Pjesa veriore e kësaj krahine në një farë mënyre është përvijuar me kufirin shtetëror të Maqedonisë së Veriut me Kosovën: fshatrat Tanushë e Bllacë kufizohen me të folmet e gegërishtes verilindore (afër kufirit të Maqedonisë së Veriut me Kosovën), ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen diçka më në jug të kësaj zone.

## 2.2. KARSHIAKA

Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.

Rajoni i Karshiakës (maq. Markova Rekës) shtrihet përgjatë lumit Vardar, në jug të Shkupit deri në komunën e Velesit. Në veri ka qytetin e Shkupit e më në veri Karadakun e Shkupit, ndërsa në perëndëm kufizohet me të folmet e Dervenit. Ky rajon shtrihet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së Shkupit. Rajoni fillon me kreshtën malore të Vodnos, hyn nja 50 km thellë në territorin qendror të R. së Maqedonisë së Veriut dhe mbaron diku në afërsi të qytetit të Velesit.

**Vendbanime të populluara me shqiptarë:** Gërçeci, Krushopeku, Nerezi, Mallçishta, Draçevica, Koliçani i Epërm, Çifliku, Gumaleva, Patishka Reka, Gaberi, Smesnica, Dikavec, Dobrina, Tisovica, Vërtakica, Mallçishta, Alldinca, Vërzhallë, Paligradi, Setapetka, Strogodica, Studeniçani, Cërnavoda, Cërnivori, Jabollçishta e Poshtme dhe e Epërme, Buzllakova.

**Vendbanime me popullsi të përzier:** Jabollca, Morana dhe Batinca.

Tre fshatra: Jabollçishtë e Poshtme, Jabollçishtë e Epërme dhe Buzllakovë i takojnë komunës së Velesit.

**Propozim:** E folmja e qytetit të Shkupit mendojmë se nuk duhet të merret për pikë dialektore. Qyteti përbëhet prej banorësh të ardhur zonash të ndryshme të Maqedonisë së Veriut e jashtë saj e që përgjithësisht ruajnë të folmet e prejardhjes.

E folmja e Shkupit propozojmë të përfaqësohet me tri pika rurale dialektore: (a) f. Bllacë që ka jopak elemente të gegësishtes verilindore, (b) f. Brezë si e folme tipike e të folmeve verilindore më skajore të gegërishtes qendrore si dhe (c) f. Cërnivor që gjendet në jug të Shkupit, më në brendi të Maqedonisë së Veriut, që i takon zonës së Karshiakës.

<b>3. DERVEN</b>				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
62	Grupçisht	Tetovë	Derven	Duhet: Grupçin
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Zhelinë	Tetovë	Derven	
	Bukoviç	Shkup	Derven	

**Shënim:****3. DERVENI**

Prof. dr. Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008.

Derveni (turqizëm ballkanik, me kuptimin ngushticë, vendkalim) shtrihet midis Shkupit e Tetovës. Derveni i Poshtëm që i takon komunës së Shkupit ka 16 fshatra; Derveni i Epërm në pikëpamje administrative i takon komunës së Tetovës ka 11 fshatra. Nga 27 katunde që ka Derveni 25 vendbanime janë me popullsi të pastër shqiptare, ndërsa vetëm dy me popullsi të përzier (Shishova dhe Matka).

Në rrethin e Shkupit – komuna e Karposhit shtrihen këto fshatra: Arnaqia, Bojana, Bukoviqi, Çajlana, Gllumova, Kondova, Kopanica, Llaskarca, Matka, Paniçari, Radusha, Raoviqi, Rashçja, Semenishiti, Sullarja e Epërme, Sullarja e Poshtme e Shishova. Në rrethin e Tetovës: Cerova, Çifliku, Debërca, Grupçini, Kapaçindolli, Llërca, Merova, Novosella, Rogla, Strimnica e Zhelina. Popullsia e këtij rajoni ka prejardhje nga vende të ndryshme, kryesisht nga viset veriperëndimore: nga Reka e Epërme, nga Dibra, nga Luma, Mati etj. (që nga shek. XVII). Pleqtë në pikëpamje gjenealogjike përmendin gjer më 7-8 breza.

<b>4. TETOVË</b>				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
43	Odër	Tetovë	-	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Odër	Tetovë	-	Odri gjendet afër qytetit të Tetovës.
	Shipkovicë	Tetovë	Malësia e Sharrit të Tetovës	Shipkovicë është fshati më i madh.

**Shënim:**

#### 4. TETOVA

##### MALËSIA E SHARRIT

Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.

Malësia e Sharrit të Tetovës është vend malor. Kjo krahinë malore kufizohet në juglindje me fushën e Tetovës (Pellgun e Poshtëm), në verilindje me Lubotenin dhe me malet e Bukovikut, në veriperëndim me bjeshkët e Sharrit, përkatësisht Torbeshinë (Gorën) dhe Opojën (Prizren, Kosovë) dhe në jugperëndim me malësinë e Gostivarit, përkatësisht me Pellgun e Epërm. Malësia e Sharrit të Tetovës ka 19 katunde të banuara prej popullsisë shqiptare me një numër prej 25.000 banorësh dhe 2.500 shtëpish. Për nga numri i banorëve, katundet më të mëdha janë Shipkovicica, Sellca, Novosella e Veshalla.

**Propozim:** Përveç Odrin, pikë dialektore propozojmë të jetë edhe fshati më i madh i Malësisë së Sharrit të Tetovës, Shipkovicica.

5. GOSTIVAR				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
90	Ravenë	Gostivar	Pollog	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Reçan	Gostivar		
	Vërbjan	Gostivar	Reka e Epërme	

#### Shënim:

##### 5. GOSTIVARI

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna\\_e\\_Gostivarit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Gostivarit)

Komuna e Gostivarit shtrihet në pjesën perëndimore të Maqedonisë, duke u kufizuar me komunën e Vrapçishtit, Kërçovës, Tetovës dhe Mavrovës. Gostivari përbëhet nga: shqiptarë 54.038 apo 66.7%, maqedonas 15.877 apo 19.6%, turq 7.991 apo 9.8%, romë 2.237 apo 3.8%, vllah 15 apo 0.01%, serbë 160 apo 0.19%, bohnsnjakë 39 apo 0.04%, të tjerë 685 apo 0.84%.

##### 5.1. REKA E EPËRME E GOSTIVARIT

Sejfedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.

Asllan Hamiti, *Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme*, Konferenca Shkencore "Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës" (përmbledhje kumtesash), Gostivar – Shkup, 2014, f. 55-64.

Regjioni i Rekës së Epërme shtrihet në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë së Veriut, midis Gostivarit, Dibrës e më thellë dhe përfshin rrjedhën e sipërme të lumit Radikë, në veri kufizohet me Kosovën e në perëndim me Shqipërinë. Përgjatë luginës së Radikës dhe në shpatet e tij shtrihen 16 fshatra të banuara me popullsi shqipfolëse. Fshatrat e Rekës së Epërme janë: Belçiça (15 shtëpi, 90 banorë), Bibaj (20 shtëpi, 110 banorë), Bogdi (35 shtëpi, 260 banorë), Grekaj (20 shtëpi, 99 banorë), Kiçinica (10 shtëpi, 54 banorë), Krakornica (40 shtëpi, 240 banorë), Niçpuri (15 shtëpi, 75 banorë), Nistrova (45 shtëpi, 315 banorë), Nivishta (15 shtëpi, 75 banorë), Rimnica (45 shtëpi, 280 banorë), Senca (50 shtëpi, 300 banorë), Tanushaj (50 shtëpi, 310 banorë), Vau (80 shtëpi, 380 banorë), Vallkavia (30 shtëpi, 200 banorë), Vërbani (90 shtëpi, 480 banorë) dhe Zhuzhnja (23 shtëpi, 102 banorë). Numri i shtëpive dhe i banorëve të këtyre fshatrave është sipas regjistrimit të vitit 1971. Sipas regjistrimit të vitit 1981 ky numër është më i vogël. Në 16 fshatrat e përmendura jetonin afër 3.400 banorë, por tani ky numër është zvogëluar dukshëm. Popullsia flet shqip dhe është e besimit islam e ortodoks, por rekasit nuk kanë pasur as grindje e as mosmarrëveshje të karakterit fetar. Kohëve të fundit ka filluar të ngjallet përkatësia etnike e tyre.

Banorët e Rekës së Epërme edhe në të kaluarën edhe tani shtegtojnë me familje e grupe-grupe në vende të ndryshme të Maqedonisë së Veriut, si në qytetet Gostivar, Dibër, Tetovë, Shkup, Veles e gjetiu, në fshatrat: Koritë, Sedllarevë, Gurgurnicë (komuna e Tetovës), Patishka Rekë, Nerez (rrethi i Shkupit), Jabollçishtë e Epërme dhe Jabollçishtë e Poshtme e Velesit etj.

E folmja e Rekës është mjaft konservatore (ruajtëse). Ajo përfshin një kurorë katundesh, duke filluar nga Korita, Gurgurnica, Sallareva; disa fshatra të Karshiakës së Shkupit (Gerçecin, Nerezin, Sveta Petkën, Çiflikun, Patishka Rekën), e deri në Jabollçishtë të Velesit. Katundet e rrethit të Shkupit e të Velesit të populluar me banorë të Rekës, edhe pse të muslimanizuar, sot janë dëshmi e gjallë që në vete ruajnë po ato karakteristika etnike e gjuhësore, si të banorëve të paktë që ende kanë mbetur në Rekën e Epërme.

**Propozim:** Pikë dialektore të jetë f. Vërbjan. Vendbanimi më i madh shqiptar sot në Rekën e Epërme është Vërbjan me 625 banorë.



6. KËRÇOVË				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
94	Zajas	Kërçovë	-	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Zajas	Kërçovë	-	
	Tuhin	Kërçovë	-	

**Shënim:****6. KËRÇOVA**

Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.

Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011.

<https://sq.wikipedia.org/wiki/K%C3%ABr%C3%A7ova>

Kërçova ndodhet në pjesën qendrore të Maqedonisë Perëndimore dhe ka qenë e banuar që në periudhën më të lashtë parahistorike, të neolitit, nga popullsi bartëse të kulturës mediterane dhe ilire. Kërçova shtrihet në një fushë tejet pjellore e rrethuar me malet Ujmiri ose Dobra Voda dhe malet e Bistrës.

Në rrethinën e Kërçovës gjenden 81 fshatra. Me ndarjen e re territoriale të vitit 1996, regionin e Kërçovës është i ndarë në 5 komuna: Komuna e Kërçovës me 30.138 banorë, Komuna e Zajazit me 11.605 banorë, Komuna e Oslomesë me 10.420 banorë, Komuna e Drugovës me 3.249 banorë dhe Komuna e Vraneshticës me 1.322 banorë. Gjithsej 56.734 banorë sipas regjistrimit të vitit 2002. Në pikëpamje demografike, shqiptarët përbëjnë popullsinë më të vjetër autoktone dhe për nga numri asnjëherë nuk ka qenë pakicë. Më 1994 Kërçova ka pasur 53044 banorë prej të cilëve 26310 shqiptarë, 20829 maqedonas, 3840 turq, 1394 romë etj.

**Propozim:** Të folmet e krahinës së Kërçovës degëzohen në dy grupe: a) të folmet e Zajazit dhe b) të folmet e Tuhinit. Mendojmë se do të ishte mirë që të kemi nga një pikë dialektore për dy tipet e të folmeve.

7. DIBËR				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
89	Tanushaj	Dibër	Reka e Dibrës	Tanushaj bën pjesë në bashkinë e Gostivarit

93	Dibër	Dibër	Dibër	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Shullani	Dibër	Dibër	
	Dibër	Dibër	Dibër	

**Shënim:****7. DIBRA**

Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Dibra>

Dibra ose Dibra e Madhe ndodhet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë pranë kufirit me Shqipërinë, jashtë rrugës nga Struga për në Gostivar.

Sipas të dhënave statistikore në vitin 1994 në Komunën e Dibrës jetojnë 17.588 banorë nga të cilët 77% jetojnë në qytetin Dibër, ndërsa 23% jetojnë nëpër fshatrat përreth qytetit. Sipas regjistrimit të vitit 2002 Komuna e Dibrës kishte 19.452 banorë, shtesa e popullsisë vjen nga shtimi natyral i saj dhe nga bashkëngjitja e dy fshatrave që i ishin hequr Komunës së Dibrës në vitin 1994. Fshatrat që u shtuan janë Mogorca dhe Gari.<sup>9</sup> Popullsia e qytetit të Dibrës së Madhe në vitin 2002 arriti në 14.561 banorë, me këtë përbërje etnike: shqiptarë 10.768 (73,95%), turq 1.415 (9,71%), maqedonas 1.054 (7,24%), romë 1.079 (7,41%), serbë 22.

Gjuhët zyrtare janë shqipja dhe maqedonishtja, kurse si zonë gjuhësore i takon grupit të së folmeve të gegërishtes qëndrore dhe si e tillë gjithmonë në kohë të vona, ka mbajtur lidhje të vazhdueshme komunikative me të folmet si motra.

<b>8. PRILEP, VELES E KRUSHEVË</b>				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
104	Jabollçishtë	T. Veles	-	Jo: Titov Veles, por Veles
105	Zhitoshë	Prilep	-	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Jabollçishtë	Veles	Pellagoni	
	Cërnilishtë/ Zhitoshë	Prilep	Pellagoni	
	Nerovë	Krushevë	Pellagoni	

**Shënim:****8. PRILEP, VELES E KRUSHEVË**

Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.

**Komuna e Prilepit:** Në 19 katunde jetojnë kryesisht popullsi maqedonase, ndërsa 14 vendbanime kanë popullsi të përzier. Shqiptarët janë të përqendruar në Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan dhe Debresht.

**Propozim:** Nga këto të folme propozojmë që pikë dialektore për sintaksën e ADGjSh të jetë f. Cërnilishtë, i cili sipas regjistrimit të vitit 2002 ka gjithsej 1773 banorë, nga të cilët 1720 shqiptarë, 10 maqedonas dhe 43 turq. Në dallim nga fshatrat e tjera ku ka më shumë maqedonsa e të tjerë, mendojmë se në këtë fshat për shkak të numrit të madh të shqiptarëve e numrit të vogël të të tjerëve shqipja është ruajtur më mirë sesa në fshatrat e tjera. Edhe Zhitosha është e arsyeshme të merret si pikë dialektore, meqë nga gjithsej 1926 banorë, 1200 janë shqiptarë, 20 turq, 700 boshnjakë dhe 6 serbë).

**Komuna e Krushevës:** f. Alldançe, sipas regjistrimit të 2002 ka 450 banorë: 425 shqiptarë, 25 maqedonas). F. Borinë: 476 banorë (352 shqiptarë, 19 turq dhe 105 boshnjakë). Fshati Bellushinë: 70 banorë (70 shqiptarë). F. Jakrenovë: 201 banorë (101 shqiptarë, 50 turq dhe 50 boshnjakë). F. Nerovë ka 600 banorë (600 shqiptarë). F. Presill ka 410 banorë (400 shqiptarë, 10 maqedonas).

**Komuna e Velesit** ka vetëm një fshat ku jetojnë shqiptarë, përkatësisht f. Sogle që ka 127 banorë (83 maqedonas, 19 shqiptarë, 16 turq, 5 serbë dhe 4 të tjerë). Tre fshatra që gjuhësisht i takojnë Karshiakës: Jabollçishtë e Poshtme, Jabollçishtë e Epërme dhe Buzllakovë i takojnë komunës së Velesit.

**Propozim:** Nga të folmet e Krushevës, pikë dialektore të jetë fshati Nerovë, si fshati më i madh e me popullsi të pastër shqiptare (nga 600 banorë të gjithë janë shqiptarë). Prilepi, Velesi e Krusheva i përkasin krahinës së Pelagonisë.

9. STRUGË				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
98	Korashtishtë	Strugë	-	Duhet: Koroshishtë
102	Radolishtë	Strugë	-	Duhet: Ladorishtë
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				

	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Dollogozhdë / Veleshtë	Strugë	-	
	Ladorishtë	Strugë	-	
	Strugë	Strugë	-	

### Shënim:

#### 9. STRUGA

Ajten Hajdari - Qamili, *Të folmet shqipe të qarkut të Strugës (në kontekst ballkanik)*, disertacioni doktorati, Shkup, 2011.

Ajten Hajdari - Qamili, *E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot*. Konferenca "Java e Shkencës 2013", 14-18 maj 2013. Prishtinë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, 2013, 15-21.

Ajten Hajdari - Qamili, *Tosk And Geg In The Spoken Albanian Of Struga*. *Folia Linguistica et Litteraria: Časopis za nauku o jeziku i književnosti / Folia Linguistica et Litteraria: Journal of Language and Literary Studies*, Nikšić: Institute for Language and Literature, Faculty of Philosophy, 2011, 109-119.

Ajten Hajdari - Qamili, *Përcaktimi i të folmes së Strugës*. *ANAS Studia humanitatis*, 3-4, Shkup: Instituti Alb-Shkenca, 2014, 138-146.

**Struga** ndodhet në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë dhe shtrihet përreth brigjeve të liqenit të Ohrit dhe të lumit Drini i Zi. Nga të gjitha anët është e rrethuar me male: në perëndim me Jabllanicën, në veri me Karaormanin dhe në lindje me Galiçicën dhe Debërcën. Në anën juglindore lidhet me qytetin e Ohrit, në veri me Dibrën, kurse në perëndim kufizohet me R. e Shqipërisë. Fushëgropa e Strugës ka sipërfaqe prej 226 km<sup>2</sup> dhe gjendet në lartësi mbidetare prej 695-800 m. Sipas regjistrimit të fundit të vitit 2002 në qarkun e Strugës ka pasur 63 376 banorë, prej të cilëve 56.50% janë shqiptarë, 32% janë maqedonas, turq 6%, vllah 1%, romë, 0.18%, serbë 0.16%, boshnjakë 0.16% dhe të tjerë 4%. Kurse vetëm qyteti ka 33 000 banorë. Kjo shifër është pak a shumë e njëjtë edhe sot (në vitin 2016) pra, mbi 63 000 banorë, sipas informatave që siguroam në zyrat e Komunës së Strugës.

Rrethin e Strugës e popullojnë folës të gegërishtes qendrore dhe të toskërishtes veriore, gjegjësisht fshatrat shqiptare të rrethit të Strugës në anën veriore dhe verilindore apo në anën e djathtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi janë geqe (Dollogozhdë, Livadhi, Koroshishtë, Misllodezhdë, Zhepin, Poum, Tatesh i Epërm, Tatesh i Poshtëm, Bixhovë, Novo Sellë,

Bogovicë, Dobovjan, Belicë e Poshtme, Labunishtë, Veleshtë),<sup>98</sup> kurse në anën jugperëndimore, gjegjësisht fshatrat në anën e majtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi janë toske (Ladorisht, Frëngovë, Kalisht, Zagraçan, Shum, Teferiç). Sipas një studimi më shumë se 10 vjet në terren për të folmet shqipe të rrethit të Strugës, të folmen e qytetit të Strugës e kemi përcaktuar si kalimtare dhe jo si toskërishte veriore, sepse parakusht për këtë është vendndodhja e qytetit në mes dy dialekteve (toskërishtes veriore dhe gegërishtes qendrore), ndërsa dominimi i elementeve të toskërishtes është për arsye se fshatrat toske janë më afër qytetit, kurse për të arritur në fshatrat geqe duhet kaluar nëpër disa fshatra maqedonase.

Në anën tjetër, shpërngulja e vazhdueshme e popullsisë nga rrethina në qytet, të cilët më shumë janë gegë, por edhe toskë, bën që e folmja e qytetit të bëhet e larmishme me synim të një shkrirjeje mes veti. Mund të themi se e folmja e qytetit të Strugës në paradigmat e monografive dialektore dhe në veçoritë dalluese (fonetike, morfologjike dhe leksikore) të shqyrtuara në studimet e lartpërmendura, duket sikur hidhet si top ping-pongu herë në toskërishte veriore, herë në gegërishte qendrore e herë mbetet si e mesme, por natyrisht më shpesh anon nga toskërishtja, për shkak të afrisë gjeografike të fshatrave toske me qytetin e Strugës, si dhe të të folmeve të tjera toske përreth në territorin e Shqipërisë dhe të kontakteve të përhershme më ato. Megjithatë, kjo e folme nuk mund të përcaktohet vetëm si të folme toske, sepse ka edhe një mori dallimesh prej tyre, prandaj duke u mbështetur në këto studime përmbyllim se e folmja e qytetit të Strugës sot i takon të folmeve kalimtare. Këto përfundime bazohen në fakte të analizuara dhe të pasqyruara në studimet e lartpërmendura, saktësisht bëhet fjalë për dallime të: 19 tipareve fonetike, 14 tipareve morfologjike dhe 142 dallime leksikore mes tri të folmeve të Strugës.

<b>10. PRESPË</b>				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
106	Resnjë	Resnjë	Prespë	
143	Kranjë	Resnjë	Prespë	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Resnjë	Resnjë	Prespë	

<sup>98</sup> Belica e Poshtme, Labunishti dhe Veleshta ndodhen në anën e majtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi, por janë në anën veriore të Strugës dhe janë shumë afër fshatrave të tjera geqe, kurse nga fshatrat toske janë tepër larg dhe nuk kanë rrugë lidhëse me këto të fundit.

	Kranjë	Resnjë	Prespë	
--	--------	--------	--------	--

**Shënim:****10. PRESPA**

Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1996.

Prespa shtrihet në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë së Veriut, vazhdon në Shqipëri e Greqi. Prespa njihet edhe me këta emra:

**Prespa e Sipërme**, që gjendet në veri të liqenit të Prespës, përfshin në tërësi fushën e Resnjës, në të cilën bëjnë pjesë: qyteti Resnjë (Resen), Sopocka, Zllatari, Kriveni, Loreka, Krushja, Bukova, Izbishta, Jankoveci, Bouna (Bolno), Petrina, Evlla (Ehla), Dupeni i Sipërm (Gorno Dupeni), Stipona, Llaca (Lavci), Prelubja, Pokërveniku, Vollkoderi, Shurlenci, Oteshova, Carina, Leskoveci, Carexvori (Carev Dvor), Dërmeni, Perova, Ezereni, Bollocërka e Sipërme (Gorna Bela Crkva), Bollocërka e Poshtme, Kozjaku, Podmoçani, Gërçari dhe Stenja.

**Prespa e Madhe** përfshin pjesën lindore dhe një pjesë të asaj jugore të liqenit të Prespës, duke përfshirë edhe një pjesë të Greqisë, përbëhet nga këto vendbanime: Raica (Rajca), Asamati – Osamati, Pretori, Kurbinova, Slimica (Slivnica), Kranji (Krani), Arvati, Shtërbova, Bratuçina (Brajçino), Lubonja, Nakoleci, Dupeni i Poshtëm (Dolno Dupeni), që ndodhen në Maqedoni; mandej vijojnë vendbanimet që ndoshen në territorin e Greqisë: Gjermani, Rëmbi, Opaja, Stirkova, Rudari, Pëpla, Orovniku, Bukoviku, Brezevina, Linki, Drenova, Drabitishta, Irnova, Vinani, Aili (Ahili), Grazhdani, Ceri, Orao dhe Nivica.

**Prespa e Vogël**, në të cilën bëjnë pjesë këto vendbanime: Pusteci, Zërnovska, Leska, Shullini, Gollomboqi, Gorica e Poshtme, Gorica e Sipërme, që ndodhen në Shqipëri dhe Koncka (Konjsko) që ndodhet në Maqedoninë e Veriut.

<b>11. MANASTIR</b>				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
107	Manastir	Manastir	-	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Manastir	Manastir	-	E folme toske
	Ostrec / Obednik	Manastir	-	E folme gege
	Këshavë	Manastir	-	E folme toske

**Shënim:**

## 11. MANASTIRI

Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Logos-A, Shkup, 1997.

Territori i Manastirit dhe i qarkut të tij shtrihet në pjesën jigperëndimore të Maqedonisë. Pjesa më e madhe e tij gjendet në fushëgropën e Pellagonisë. Territori në fjalë në anën jugore kufizohet me Greqinë. Në pjesën veriore të tij ndoshet komuna e Prilepit dhe e Ohrit, ndërsa në atë perëndimore ajo e Resnjës.

Shqiptarët jetojnë në: Manastir (qytet), Bratindoll, Černovec (Crnoec), Dolencë (Dolenci), Drevenik, Grashnicë, Kazhan, Këshavë, Lerë, Llazhec, Mexhitli, Obednik, Ostrec, Suvodoll, Tërovë (Trnovo), Xhinxhopolë (Nizho Pole), Zhabjan (Zhabjane), Zllokuqan (Zllokuqane). Më parë shqiptarë ka pasur edhe në Porodin, Kaninë (Kanino) e Vellushinë, mirëpo banorët e tyre janë shpërngulur në Ostrec dhe në Manastir. Në vendbanimet e përmendura vetëm shqiptarë jetojnë në: Këshavë, Ostrec, Zllokuqan e Drevenik.

Në të folmen e Manastirit dhe të qarkut të tij janë të pranishme dy areale fonemash zynore me dy sisteme:

a) të folme toske me serinë e zanoreve të shkurtra gojore;

b) të folme geqe (fshati Ostrec, Zllokuqan dhe një pjesë e vogël e qytetit të Manastirit): 17 fonema zanore në tri seri me diftongim zanorësh. Gjuhësisht ka afëri më të mëdha me të folmet e Dibrës, Luznisë së Dibrës dhe të Matit.

<b>12. OHËR</b>				
RRJETI I PIKAVE TË ADGjSh				
Nr. i pikës	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Shënim
103	Ohër	Ohër	-	
RRJETI I PIKAVE TË PROPOZARA				
	Fshati/ Qyteti	Rrethi	Krahina	Arsyetim
	Ohër	Ohër	-	E folme e ndërmjetme me elemente mbizotëruese të toskërishtes veriore
	Gorencë	Ohër	-	E folme e gegërishtes qendrore

**Shënim:**

## 12. OHRI

Qamili, Ajten (2013). *E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot*. Konferenca "Java e Shkencës 2013", 14-18 maj 2013. Prishtinë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2013, f. 15-21.

Gjatë këtyre njëqind viteve të fundit, për shkaqe politike, por edhe për shkaqe ekonomike, Ohri ka pësuar shumë ndryshime infrastrukturore e strukturore, e sidomos struktura e popullsisë, e cila ka ndikuar në ndryshimin e të folmes shqipe. Vallë, a ka mbetur e folmja e Ohrit toskërishte veriore apo jo? Deri më sot në dialektologjinë shqiptare për këtë të folme thuhej se i takon toskërishtes veriore, duke u bazuar në të dhëna më të hershme gjuhësore dhe nga afërsia gjeografike, meqë Ohri gjendet më afër Pogradecit.

Këto njëqind vitet e fundit për shkaqe politike, por edhe ekonomike shqiptarët e Ohrit janë shpërngulur në Turqi, në Strugë, në Shkup e në vende të tjera; disa nga myslimanët janë turqizuar, ortodoksët janë sllavizuar, fshatra të tëra shqiptare janë shfarosur, djegur e asimiluar (Kështu e pësuan fshatrat Pesoçani, Volina, Podmulli, Rashçe, Orovnik, Tërpejca, Lubanishta, Peshtani, Shën Naumi (Sari Salltëk) etj). I vetmi fshat ku ende jetojnë shqiptarë është Gorenca dhe një familje në Trebenishtë, të cilët i takojnë gegërishtes qendrore. Ndërkaq shqiptarët e sotëm të Ohrit, janë të shpërngulur (ardhur) nga rrethi i Strugës, më shumë gegë, por edhe toskë, prandaj e folmja e tyre është e larmishme me synim të një shkrirjeje mes veti.

Mund të themi se e folmja e qytetit të Ohrit në monografitë përcaktohet herë si toskërishte veriore, herë si gegërishte qendrore e herë mbetet si e mesme, por natyrisht më shpesh anon nga toskërishtja, për shkak të afrisë gjeografike të fshatrave toske me qytetin e Strugës, si dhe të të folmeve të tjera toske përreth në territorin e Shqipërisë dhe të kontakteve të përhershme me to. Megjithatë, e folmja e Ohrit për shkak të tipareve dalluese që ka duhet të përcaktohet si e folme kalimtare me më shumë elemente toske.

### **Literatura e konsultuar:**

*Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, AShSh; vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.

Aliu, Luzim, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011.

Basha, Naim, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.

Beci, Bahri, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.

Beci, Bahri, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994, f. 45-55.

Gjinari, Jorgji - Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Tiranë, 2000.



- Hajdari - Qamili, Ajten, *Të folmet shqipe të qarkut të Strugës (në kontekst ballkanik)*, disertacion doktrate, Shkup, 2011.
- Hajdari - Qamili, Ajten, *E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot*. Konferenca "Java e Shkencës 2013", 14-18 maj 2013. Prishtinë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, 2013, 15-21.
- Hajdari - Qamili, Ajten, *Tosk And Geg In The Spoken Albanian Of Struga*. *Folia Linguistica et Litteraria: Journal of Language and Literary Studies*, Nikšić: Institute for Language and Literature, Faculty of Philosophy, 2011.
- Hajdari - Qamili, Ajten, *Përcaktimi i të folmes së Strugës*. *ANAS Studia humanitatis*, 3-4, Shkup: Instituti Alb-Shkenca, 2014, 138-146.
- Hajdari - Qamili, Ajten, *E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot*. Konferenca "Java e Shkencës 2013", 14 - 18 maj 2013. Prishtinë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2013, f. 15-21.
- Hamiti, Asllan, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Hamiti, Asllan, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe - vepër kolektive me rëndësi kombëtare*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë - Shkup, 20-22 shtator 2012, f. 211-218.
- Hamiti, Asllan, *Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme*, Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës (përmbledhje kumtesash), Gostivar - Shkup, 2014, f. 55-64.
- Hamiti, Asllan, *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79-84.
- Haruni, Sejfedin, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.
- Ibrahimi, Mustafa, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.
- Murati, Qemal, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.
- Nesimi, Remzi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008.
- Osmani, Zihni, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Logos-A, Shkup, 1997.
- Osmani, Zihni, *E folmja shqipe e Prespës*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1996.
- Reçani, Fehim, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Skok, Petar, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Sulejmani, Fadil, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Shkurtaj, Gjovalin, *Dialektet e shqipes*, Botimet Morava, Tiranë, 2012.
- Ymeri, Haki, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- [https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna\\_e\\_Gostivarit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Gostivarit)  
<https://sq.wikipedia.org/wiki/K%C3%ABr%C3%A7ova>  
<https://sq.wikipedia.org/wiki/Dibra>


#### 4. TIPARET SINTAKSORE TË SË FOLMES SË KARADAKUT TË SHKUPIT<sup>99</sup>

##### a. Pozita gjeografike

Karadaku i Shkupit (që e quajmë edhe Mali i Zi i Shkupit, *maq.* Скопска Црна Гора (Skopska Crna Gora), *anglisht* Black Mountain of Skopje); shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut dhe në skajin jugor të Kosovës. Në lindje kufizohet me fshatrat e Kumanovës dhe të Likovës, ndërsa në perëndim si kufi natyror mund të merret lumi Lepenec, si edhe rruga magjistrale Shkup – Prishtinë.<sup>100</sup>

Karadaku i Shkupit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Fushëgropës së Shkupit, përkatësisht në koordinatat 42°17'N21°43'E. Nga veriu, perëndimi si dhe nga lindja është mbyllur me kurorë malesh si gjysmërreth ose me pjesë malore më të ulëta. Vetëm në pjesën jugore kufiri i Karadakit të Shkupit nuk është plotësisht i përcaktuar, meqë është rrafshinë me sipërfaqe të valëzuar edhe me ndonjë kodrinë.<sup>101</sup>

Pjesa veriore e Karadakit të Shkupit (në bazë të veçorive gjuhësore) është përcaktuar me kufirin ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Në lindje kufizohet me fshatrat e Kumanovës: Goshincë, Strimë dhe Nakushtak; ndërsa në perëndim si kufi natyror mund të merret lumi Lepenec, por edhe rruga magjistrale Shkup - Prishtinë.



*Shtrirja hapësinore e Karadakit*

<sup>99</sup> Kumtesë e lexuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Variacioni sintaksor në dialektet dhe të folmet e shqipës”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 15. 12. 2016.

<sup>100</sup> Проф. д-р Митко Панов, *Селата во Република Македонија*, Скопје, 1993, f. 246.

<sup>101</sup> Бојко Стојановски, *Љубанци и Скопско Црногорие*, Скопје, 1994, f. 167.

Të dhëna të përgjithshme për Karadaku i Shkupit gjejmë edhe në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*, në sythin përgatitur nga Gjovalin Gruda dhe Asllan Selmani.<sup>102</sup>

Për të përcaktuar më mirë këtë zonë, varësisht nga ajo se cili qytet gjendet më afër dhe administrohet nga ai, quhet: Karadaku i Shkupit, Karadaku i Gjilanit, Karadaku i Kumanovës etj.

Duke filluar nga pjesa jugperëndimore e duke shkuar nga pjesa verilindore e më pas duke vazhduar nga jugu, në Karadaku e Shkupit sot gjenden këto fshatra: Brazdë (maqedonisht Бразда), Glluvo (maq. Глуво), Çuçer (maq. Чучер), Gornjane (maq. Горњане), Vanjane (Бањане), Vllacë (maq. Блаце), Tanushë (maq. Танушевци), Brezë (maq. Брест), Brodec (maq. Бродец), Robozhje (maq. Побожје), Kuçevishtë (maq. Кучевиште), Mirkovc (maq. Мирковци), Lubancë (maq. Љубанци), Luboten (maq. Љуботен), Rashtak (maq. Раштак), Bullaçan (maq. Булачани), Creshevë (maq. Црешево), Straçincë (maq. Страчинци), Grushinë (maq. Грушино), Orllancë (maq. Орланци), Moјancë (maq. Мојанци) dhe Bërnјancë (maq. Брњарци).

## b. Popullsia

Në Karadaku e Shkupit jetojnë popullsi me përkatësi të ndryshme kombëtare: shqiptarë, maqedonas, serbë, myslimanë, turq, romë dhe të tjerë.<sup>103</sup> Meqë mungojnë të dhëna të sakta statistikore, sipas gjithë gjasash në katundet e Karadaku të Shkupit afërsisht jetojnë 9.300 banorë shqiptarë, pa llogaritur katundet Haraçinë (që me regjistrimin e vitit 2002 kishte 7.351 banorë e që llogaritet fshati më i madh në Maqedoninë e Veriut) e Hasanbeg që ka afër 2.700 shtëpi dhe 9.000 banorë, ku kanë zbritur e tani jetojnë një numër i madh i karadakinjve. Nga këto të dhëna del se numri i përgjithshëm i popullatës rezidente në katundet e Karadaku si dhe në fshatrat e kësaj zone (Haraçinë e Hasanbeg), pa përfshirë të shpërngulurit në Turqi si dhe në vende të tjera të Maqedonisë së Veriut, Kosovës, Evropës e të botës është mbi 25. 600 veta. Pra, mbi 25.000 veta që nuk kanë migruar jashtë krahinës së tyre, flasin në të folmen e Karadaku të Shkupit.

Karadaku është krahinë kodrinore e malore që shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut dhe në pjesën jugore të Kosovës. Malet ngrihen përpjetë nga fushëgropa e Shkupit (në jug), lugina e Kumanovës

<sup>102</sup> AShSh, *Fjalor enciklopedik shqiptar 2*, Tiranë, 2008, f. 1609.

<sup>103</sup> Митко Панов - Младен Митев, *Општините во Република Македонија според новата поделба во 1996 година – основни просторни, демографски и аграрно-структурални обележја*, Shkup, 1997, f. 240-257. Митко Панов, *Селата во Република Македонија 1*, Shkup, 1993, f. 253-254.

(në lindje), lugina e Gjilanit (në veri) si dhe rrjedha e lumit Lepenc. Në ultësisrat e Karadaku gjenden katër qytete: Shkupi (në jug), Kumanova (në lindje), Kaçaniku (në perëndim) dhe Gjilani (në veri).<sup>104</sup>

Fshatra shqiptare tipike malore janë Breza, Malina e Tanusha; kodrinore-malore janë Mojanca e Orllanca; ndërsa kodrinore janë Luboteni, Straçinca e Bllaca. Katundet e Karadaku të Shkupit të banuara me shqiptarë mund të grupohen në dy tipa kryesorë: fshatra me shtëpi të tipit të grumbulluar (të ngjeshur) dhe fshatra me shtëpi të tipit të shpërndarë. Tipit të parë i përkasin shumica e fshatrave, përveç fshatrave Brezë e Tanushë.

### c. Karadaku në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe

Në hartën krahinore të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe<sup>105</sup> është paraqitur edhe Karadaku i Shkupit. Do përmendur se për nevojat e hartimit të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe (ADGjSh) nga krahina e Karadaku të Shkupit material dialektor është vjelë në të folmen e fshatit Tanushë.<sup>106</sup>

Në bazë të të dhënave që na siguron Atlasi për punën e secilit anëtar të grupit hartues të ADGjSh për anketat në terren, në Tanushë anketimi është kryer në vitin 1986 nga dy dialektologë e gjuhëtarë të shquar shqiptarë, Jorgji Gjinarit e Gjovalin Shkurtajt; ndërsa skedimin e materialit të anketave si dhe hedhjen e të dhënave të anketave në hartat e punës për Atlasin e ka bërë prof. Gjovalin Shkurtajt.<sup>107</sup>

Për këtë areal gjuhësor kemi botuar një monografi,<sup>108</sup> në të cilën janë përshkruar tiparet fonetike e fonologjike, morfologjike, fjalëformuese e leksikore. Në këtë artikull do të trajtojmë përmbledhtas veçoritë kryesore sintaksore të këtij areali gjuhësor, përkatësisht të 11 fshatrave me mbi 15 mijë banorë, pra të katundeve Tanushë, Brezë, Malinë, Bllacë, Luboten, Straçincë, Orllancë, Mojanca, Grushinë. Për shkak se pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave Haraçinë dhe Hasanbeg, që gjenden në jug të zonës, janë të ardhur nga katundet përreth, në aspektin dialektor edhe këto dy fshatra i takojnë këtij areali.

Për ekonomi shkrimi, në këtë punim do të përdorim shkurtime të mëposhtme për emrat e fshatrave të kësaj krahine: Bll. – Bllacë; Br. – Brezë; Mal. – Malinë; Gr. – Grushinë; Orll. – Orllancë; Moj. – Mojanca; Str. – Straçincë; Lub. – Luboten; Tan. – Tanushë.


<sup>104</sup> [http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopska\\_Crna\\_Gora](http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopska_Crna_Gora).

<sup>105</sup> ASHSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007, f. 56.

<sup>106</sup> Prof. dr. Bahri Beci, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994, f. 45-55.

<sup>107</sup> ASHSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007, f. 60-64.

<sup>108</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadaku të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.



*Pikat dialektore të eksploruar në Malin e Zi të Shkupit*

Materialin për sintaksën dialektore e mbledhëm gjatë vitit 2016, nëpër fshatrat e kësaj krahine të banuar me shqiptarë me ekspedita të drejtpërdrejta, në bazë të pyetësorit të përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore” botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në vitin 1987.<sup>109</sup> Të anketuarit tanë janë nga brezi i vjetër, pak ose aspak të arsimuar, që rrallë kanë lëvizur nga fshati apo krahina e tyre dhe, natyrisht, duke mos pasur kontakte intensive me të folmet e tjera dhe gjuhët e huaja, në mënyrë më autentike kanë ruajtur të folmen e tyre deri në gjendjen e sotme.

Pasi merrnim gjithë përgjigjet e planifikuara nga pyetësi, atëherë materialin gjuhësor e vënim edhe përmes bisedës së lirë, nëpërmjet rrëfimeve për përjetime të ndryshme, përrallave, ngjarjeve historike, legendave, bisedave për punën e tyre të përditshme etj.

Për qëllime praktike, si dhe për të qenë më lehtë të krahasueshme tiparet sintaksore a morfosintaksore të këtij areali gjuhësor me veçoritë sintaksore (më saktë morfosintaksore) të arealeve të tjera dialektore të shqipes, në vënien në pah të veçorive sintaksore të kësaj të folmeje jemi udhëhequr nga pyetjet e Pyetësorit për variacionin sintaksor në të folmet e shqipe, duke u dhënë përgjigje atyre sipas radhës. Në fund të punimit, kemi dhënë edhe disa tekste nga e folmja e kësaj krahine, ku do të shfaqen në rrjedhën e ligjërimit të lirë disa nga tiparet sintaksore të kësaj të folmeje.

<sup>109</sup> *Pyetësor për variacionin sintaksor në të folmet e shqipes* (përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore”, IGJL, Tiranë, 1987.

## 1. Si përshtatet folja-kallëzues: në njëjës apo në shumës, kur kryefjala është emër përmbledhës

“Midis emrave të përgjithshëm dallohen si një grup i veçantë, për veçoritë e tyre leksikore e gramatikore, *emrat përmbledhës*. Emrat përmbledhës emërtojnë një tërësi vetash, kafshësh ose sendesh të një fare, në formën e numrit njëjës. Ndryshe nga emri i numrit shumës, emri përmbledhës emërton një shumicë sendesh të njëjlojta si një tërësi të pandarë dhe, nga pikëpamja sasiore, të panumërueshme. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me shumësi, por, ndërsa te forma e numrit shumës shumësia paraqitet e diferencuar, e ndashme në njësi, tek emrat përmbledhës ajo merret si një e tërë e pazbërthyeshme. Kjo del e qartë kur krahasojmë format e numrit shumës të disa emrave me emrat përmbledhës që janë formuar prej tyre: *djemtë, dy djem, tre djem – djalëria; gratë, dy gra, tri gra – gratë; proletarët, dy proletarë, tre proletarë – proletariati.*”<sup>110</sup>

Siç dihet, kallëzuesi përshtatet në numër me kryefjalën: vihet në njëjës, në qoftë se kryefjala është në njëjës, vihet në shumës, në qoftë se kryefjala është në shumës... Kallëzuesi vihet zakonisht në shumës, kur kryefjala është një emër përmbledhës; po si në gjuhën e folur, edhe në të shkruarën, mund të vihet edhe në njëjës...”<sup>111</sup>

Kur kryefjala është një emër përmbledhës, folja mund të përdoret edhe në vetën e tretë shumës, në rast se synohet të vihet në dukje shumësia e atyre që e kryejnë veprimin e shprehur prej saj: **U çudit gjithë bota. Bota thonë ashtu, se kanë inat. – E ç’inat do të kenë bota? – pyeti Hakiu. – Di në ç’inat kanë?**<sup>112</sup>

Nga materiali i vjelë me metodën e vëzhgimit të drejtpërdrejtë në të folmen e Karadakut të Shkupit, mund të konstatohet se në këtë areal gjuhësor kur kryefjala është një emër përmbledhës, kallëzuesi vihet në shumës, si në fjalitë:

- a) *Xhinja u çun. Xhinja ishin çu. Xhint ishin çu.* (Br.)
- b) *Gjemt u nisën.* (në të gjitha katundet e Karadakut).
- c) *U mlodhën kah jan e kah s’jan djemnia.* (Lub.)

## 2. Vihet në trajtën e shquar a të pashquar emri i rasës kallëzore me parafjalë “në”, “mbi”, që ndiqet nga një emër tjetër në rasën gjinore ose nga një mbiemër?

E përdorur me parafjalë, rasa kallëzore merr kuptime të ndryshme. Me parafjalën *në, mbi, përmbi, nëpër* tregon kryesisht vend: *në shtëpi, mbi*

<sup>110</sup> Grup autorësh, *Morfologjia*, ASHRSh, IGjL, Tiranë, 1995, f. 85.

<sup>111</sup> Grup autorësh, *Sintaksa*, ASHSh, IGjL, Tiranë, 2002. f. 199.

<sup>112</sup> Po aty (1995), f. 269.

*tavolinë, nëpër male ...; me parafjalën me, pa mund të përdoret për të konkretizuar një send: mur me gur, njeri me vullnet, gjellë me kripë ...*<sup>113</sup>

Në arealin gjuhësor të Malit të Zi të Shkupit emri i rasës kallëzore me parafjalën “në”, “mbi”, që ndiqet nga një emër tjetër në rasën gjinore ose nga një mbiemër, vihet në trajtën e pashquar, si në fjalitë:

a) Ra **n'breg** t'detit. Ra **n'grop** t'kampirav. (Br.)

b) Hipi **n'kala** t'Shkupit. (Orll.) Hipi **n'kodër** t'Cenës. (Br.)

### 3. Cila është forma që përdoret në folmen tuaj?

Rrjedhorja njëjës e pashquar e tipit *dru lisi*, që për nga forma është identike me dhanoren dhe për nga funksioni e afërt me gjinoren e shquar, kur kjo ka kuptim të përgjithësuar: *dru (= druri) i lisit* (në përgjithësi) ka kuptim të përgjithësuar dhe afron me mbiemrin, kurse përcaktori në gjinore përdoret më shpesh në kuptim të individualizuar. Të krahasohet: *drejtor shkolle* (në përgjithësi) me *drejtori i shkollës* (i kësaj ose i asaj shkolle të njohur).<sup>114</sup>

Rrjedhorja pranemërore përdoret kryesisht pa parafjalë, në funksione përcaktuese të ngjashme me ato të gjinores. Ajo njeh vetëm trajtën e pashquar dhe mund t'i shërbejë si përcaktor vetëm një emri të pashquar. Pra, si emri i përcaktuar, ashtu edhe përcaktuesi, të cilët përbëjnë gjymtyrët e një togfjalëshi, duhet të jenë patjetër në trajtën e pashquar, përndryshe në vend të rrjedhores del gjinorja. Sikurse shihet, për rrjedhoren pranemërore, ka kufizime strukturore: *dru lisi, këngë dasme, shushurimë gjethesh* (me rrjedhore) edhe në anën tjetër: *druri i lisit, këngët e dasmës, shushurima e gjetheve* (me gjinore).

Rrjedhorja pa parafjalë, si përcaktor i emrit, duke pasur gjithmonë trajtën e pashquar, e karakterizon sendin sikur të ishte një mbiemër. Në ndonjë rast, në funksione të tilla ajo mund të marrë edhe parafjalën *prej*, sidomos kur jep një karakteristikë lëndore: *raki thane – raki prej thane, tuba gize – tuba prej gize* etj.<sup>115</sup>

Në të folmen tonë përdoret rrjedhorja pa parafjalë si përcaktor i emrit, përkatësisht togfjalëshat emër + emër në rasën rrjedhore ku shprehin lëndë: P.sh.:

a) **ni thes gru:n** (në të gjitha katundet);

b) **lu:g druni** (Lub.); **lu:gj druni** (Orll., Br.).

### 4. Rrethanori i kufizimit a ndërtohet me parafjalën “nga” apo me rrjedhore pa parafjalë?

<sup>113</sup> Po aty, f. 110.

<sup>114</sup> Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I (Morfologjia)*, ASHRSh, IGjL, Tiranë, 1995, f. 107.

<sup>115</sup> Po aty, f. 111.

Rrethanori i kufizimit në të folmen e Karadakut të Shkupit ndërtohet me rrjedhore herë me parafjalë, herë pa parafjalë, si në fjalitë: *Ka lujt pi menve. Ka lujt mensh* (në gjithë arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit).

### 5. Në ndërtimet: *Gjyshi me të birin u nis/ u nisën, në ç'numër vihet folja-kallëzues?*

Kategoria gramatikore e numrit të folja ka karakter thjesht sintaksor, sepse kushtëzohet nga numri i kryefjalës së shprehur ose të nënkuptueshme. Kategoria gramatikore e numrit të folja, ashtu si të mbiemri, nuk sjell ndonjë ndryshim në kuptimin leksikor të saj. Një folje e përdorur në numrin shumës nuk emërton shumë veprime, por një veprim që e kryejnë shumë njerëz.

Siç dihet, "në fjalinë me kryefjalë të shprehur me togfjalësh të tipit *unë me vëllanë* ose me emër përmbledhës, gjymtyra emërore e shprehur me mbiemër vihet në formën e njëjësit ose të shumësit po ashtu si këpuja."<sup>116</sup>

Në të folmen e Malit të Zi të Shkupit kur kryefjala shprehet me një togfjalësh: emër në emërore të shquar + parafjalën *me* + emër në rasën kallëzore, folja-kallëzues vihet në numrin shumës, sipas tipit:

*Gjyshi me t'birin u nisën.* (Lub.)

*Baba plak me gjalin jan nâis.* (Orll.) Ose në variantin:

*Baba qak me gjalin u nisën.* (Br.)

### 6. Përshtatje kryefjalë-kallëzues, sipas rendit të fjalëve:

Kur kryefjala shprehet me dy mbiemra të emëruar (në trajtën e shquar), të paraprirra me lidhëzën bashkërenditëse këpujore *si... si* (të tipit: *si i miri si i keqi*), si gjymtyrë homogjene, atëherë kallëzuesi në arealin tonë dialektor përdoret në numrin shumës. P.sh.:

a) *Si i mâiri si i keqi fundin e ka:n nisoj.* (Lub.) *Si i mâiri si i keqi barabar e kan pas hakin.* (Orll.) *Si fukaraja si i pasmi isto*<sup>117</sup> *e kan pagju hoxhën.* (Br.)

b) *Mbas mu: kan ardh ene i mâiri ene i keqi. Mbas mu: kan ardh edhe i mâiri edhe i keqi.* (Lub.) *Mas meje kan ardh i mâiri ene i keqi.* (Orll.) *Mas meje kan ardh i mâiri e i keçi.* (Br.)

### 7. A përdoret rrethanori i vendit që shënon drejtimin e një lëvizjeje pa parafjalë?

Rrethanori i vendit që shënon drejtimin e një lëvizjeje përdoret me parafjalë:

a) *Rash n'Shkup* (në të gjitha katundet).

<sup>116</sup> Po aty, f. 200.

<sup>117</sup> *isto* – sllavizëm, që ka kuptimin *njësoj, njëlloj*.



b) *Shkova n'Shkup. Shkova n'pazar* (në të gjitha katundet).

### 8. A përdoret rrethanori i shkakut pa parafjalë?

Rrethanori i shkakut, përveç me ndajfolje, shprehet edhe me emër në rasën emërore me parafjalën *nga*; në rasën kallëzore zakonisht të pashquar, me parafjalën *për* ose *me*, sidomos pas foljesh që tregojnë procese psikike e në radhë të parë ndjesi; në rasën rrjedhore me parafjalën *prej* ose pa parafjalë; me emër të prirë nga lokucionet parafjalore *nga shkaku (i), për shkak (të), për arsye (të), nga puna (e), për punë (të), për hir (të)* etj.<sup>118</sup>

Rrethanori i shkakut në të folmen në spikamë përdoret gjithnjë me parafjalë: më dendur me parafjalën *për* + një emër në rasën kallëzore ose me parafjalën *prej* (< pi) dhe një emër në rasën rrjedhore:

a) *Vdiqa për buk.* (Lub.) *Vdiq pi s'uni.* (Orll.) *Vdiç pi s'uni.* (Br.)

b) *Qasa pi s'nxetit. Qasa pi nxetit.* (Lub.) *U doxha pi zaparis.* (Orll.) *Qasa pi zaparis.* (Br.)

### 9. Cilën rasë kërkon parafjala “tej”, “përtej”: rrjedhoren apo kallëzoren?

Në këtë të folme parafjala “tej”, “përtej” nuk përdoret. Në vend të tyre përdoren lokucionet parafjalore “tej përtej”, “tej m'tej”, “qosh m'qosh” (< qosh ëm qosh) etj. Këto gjithnjë përdoren me rrjedhoren, si p.sh.:

a) *Tej përtej udhës.* (Lub.) *Qosh ëm<sup>119</sup> qosh udhës.* (Orll.) *Tej m'tej udhës.* (Br.)

b) *Tej përtej malit.* (Lub.) *Qosh ëm qosh malit.* (Orll.) *Tej m'tej malit.* (Br.) etj.

### 10. Përdoren me rasën kallëzore dhe me rasën vendore parafjalët: “për”, “me”, “në/ndë”, “nën”, “mbi/mbë”:

Në të folmen e Karadakut të Shkupit parafjalët: “për”, “me”, “në/ndë”, “nën”, “mbi/mbë” (me variante të caktuara fonetike: *për, me, n', nër*) përdoren rregullisht me rasën kallëzore. Sipas vëzhgimeve tona, në gjendjen e sotme kjo e folme nuk ka rasë vendore dhe funksionin e saj e ka marrë rrasa kallëzore me parafjalë, si në shembujt:

a) *Shkoj n'mal.*

b) *Hipi n'da:rdh.*

c) *N'u:dh* (në të gjitha fshatrat).

<sup>118</sup> Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi II (Sintaksa)*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002. f. 275.

<sup>119</sup> Trajta e shkurtër e vetës së parë njëjës *ëm* është formë metatetike e formës *më*.

### 11. A ka raste kur nuk e përsërit trajta e shkurtër kundrinën?

Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, të pabashkuara apo të bashkuara, kanë përdorim të dendur në të folmen e Karadakut të Shkupit si dhe përgjithësisht në të gjitha të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut. Ato, detyrimisht përdoren në funksionin e kundrinës së zhdrejtë para foljes-kallëzues, si:

*I thash ni shoqit. I thash shoqit. Aj e kshirke librën.* (Lub., Orll.) ose *defterin* (Br.). *I gjiva di bilu:r, i gjiva di barda:k.* (Lub.) *I kam gji di bardaka.* (Orll.) *I blev di shishe gaz.* (Br.) *Um*<sup>120</sup> *murr mu:, Mue um murr.* (Lub.) *M'ka ma:rr mu: .* (Orll.) *Um mur mu: e shku:m.* (Br.) *T'ka la:n ti.* (Lub.) *T'ka la:n tâi.* (Orll.) *T'ka lan tâi, m'ka marr mu:.* (Br.).

Rimarrje (përsëritje) të kundrinës kemi edhe në rastet kur emri në funksion të kundrinës së drejtë është në trajtën e shquar. P.sh.: *Engarkova kalin. E pa:sh dajën* etj. Pra, në të folmen e Malit të Zi të Shkupit, si dhe përgjithësisht në të gjitha të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut rimarrja e kundrinës me anë të trajtave të shkurtra është e domosdoshme, d.m.th. ajo gjithnjë përsëritet. Përsëritja e kundrinës është e domosdoshme edhe në maqedonishte.

### 12. Trajta e shkurtër “më” e vetës së parë numër njëjës me folje të mënyrës urdhërore, e ka përdorimin proklitik apo edhe enklitik?

Trajtat e shkurtra *m'* (< më), *i*, *e* si edhe format e bashkuara *ma*, *m'i*, *ja*, *naj*, *jav* dhe *va* në Karadakun e Shkupit përgjithësisht përdoren si fjalë enklitike pas foljeve të mënyrës urdhërore, duke krijuar në këtë mënyrë një formë të përngjitur, fonetikiisht kemi vetëm një fjalë të vetme, duke u shqiptuar vetëm me theks kryesor (një theks të vetëm, një tërësi e vetme theksore). Në format mohore trajtat e shkurtra kanë përdorim proklitik. P.sh.: *Kallxóm!* (*Mo m'kallxó!*); *Béri!* (*Mos i ber!*); *Dáje!* (*Mos e dáj!*); *Fálma!*, (*Mos ma fál!*); *Ma ép!* (*Mos ma ép!*); *Shkrâumi!* (*Mos m'i shkrâuj!*); *Çoja!* (*Mos ja ço!*); *Bernaj!* (*Mos naj ber!*); *Mshójav!* (*Mos jav mshó!*); *Lípva!* (*Mos va líp!*) etj.

Trajta e shkurtër “më” e vetës së parë numër njëjës me folje të mënyrës urdhërore në të folmen e Kradakut të Shkupit ka përdorim enklitik: *Fugma!* (Lub.) *Fugjma!* (Orll.), *Çitma!* (Br.); *Çoma!* (në të gjitha fshatrat), *Kapma* dorën, *nimom* t'dal! (në të gjitha fshatrat); *Përgjom!* (Lub.), *Prâitëm!* (Orll., Br.); *Bema!* (Lub.), *Berma!* (në katundet e tjera).

<sup>120</sup> Trajta e shkurtër e përemrit vetor e vetës së parë njëjës *um* fonetikiisht duhet të jetë përfutur nga buzorëzimi i [ë]- së në [u] dhe nga metateza. Pra, nga *më* > *mu* > *um*..

### 13. Përemri pronor në fjalinë e varur “i/e vet” i referohet kryefjalës apo kundrinës së fjalisë drejtuese?

Siç dihet, për të shprehur marrëdhëniet e përkatësisë për vetën e tretë, kemi pronorët vetorë *i (e) tij, i (e) saj, i (e) tyre* dhe pronorin vetvetor *i (e) vet, e vet / e veta*. Midis këtyre pronorëve ka një dallim kuptimor të qartë: a) pronori vetor mund t’i referohet çdo gjymtyre të fjalisë ku bën pjesë (në vend të tij); b) ndonjë gjymtyre të ndonjë fjalie tjetër. Pronori vetvetor i referohet, siç u tha, kryefjalës së fjalisë ku bën pjesë (Zana ... zëri i vet).

Përdorimi edhe i pronorëve vetorë, edhe i pronorit vetvetor është një domosdoshmëri, sepse mënjanon keqkuptimin, kur në të njëjtën fjali a frazë kemi të bëjmë me dy veta të treta dhe duam të dallojmë se cilës prej të dyjave i përket prona e dhënë...<sup>121</sup>

Në të folmen në shqyrtim pronori vetvetor “i/e vet” në fjalinë e varur mund t’i referohet herë kundrinës e herë kryefjalës së fjalisë drejtuese. Kështu, në periudhat e tipit:

a) *Sadrija i tha Xhemës t’shkoje n’katunin (n’katanin) e vet. Alia i tha Sadis t’shkoje n’katan t’vet*; pronori vetvetor (e vet, t’vet) i referohet kundrinës, ndërsa në frazat e tipit:

b) *Anila ja kallxoj Vjollcës librin e vet*. (në të gjitha katundet) pronori vetvetor (e vet) i referohet kryefjalës.

### 14. Përemri pronor në fjalinë e varur “i tij/e saj” i referohet kryefjalës apo kundrinës së fjalisë drejtuese?

Përemri pronor në fjalinë e varur “i tij/e saj” në këtë të folme i referohet kryefjalës, si p.sh.:

a) *Gena i tha Blertës t’i kshire slika e asaj*.

b) *Beni i kallxoj Gonit arat e atâi*. (Lub.)

**Shënim:** Pronori vetvetor “i/e vet” përdoret dendur, ndërsa përemri pronor “i tij/e saj” përdoret rrallë. E folmja e Karadakut të Shkupit, si dhe shumica e të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut,<sup>122</sup> nuk i njeh format *e tij, e saj, e tyre*, por vetëm *i, e atâi; i, e asaj, i, e atâine*.

### 15. Përemrat dëftorë shoqërohen me emra të shquar apo të pashquar?

Shumica e të folmeve gege (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej variantit standard, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më gjerë) për faktin se

<sup>121</sup> Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 235.

<sup>122</sup> Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 310.

përemrat dëftorë në to shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *qeky/çeky, qekjo/çekjo, qekta/çekta, qaj/çaj, qajo/çajo, qata/çata, qeto/çeto* etj. sesa në formën me shtrirje në të dy dialektet *ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato*. Me forma të këtilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) ‘ja’ dhe një përemër dëftor *ky: çe+ky, çe+kjo* ‘ja+ky, ja kjo’... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem. – Çeky është gjali jem. ‘Ky është djali im. – Ja, ky është djali im’. Ajo a:r është ma e maira. – Çajo a:r është ma e maira. ‘Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.’*<sup>123</sup>

Edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kur duam të veçojmë një qenie të gjallë, një send etj. nga grupi që i përket, d.m.th. kur duam ta individualizojmë një emër të përgjithshëm, para tij përdorim një përemër dëftor dhe një emër në trajtën e shquar (ki gjali). Siç dihet, nyja shquese në gjuhët indoevropiane buron nga përemri dëftor.<sup>124</sup>

Në fakt, krahas rasteve të zakonshme të përdorimit të përemrave dëftorë të shoqëruar me emra të shquar apo të pashquar në shqipen standarde,<sup>125</sup> në këtë të folme, si dhe në shumë të folme të tjera shqipe në Maqedoninë e Veriut,<sup>126</sup> regjistruam një dukuri shumë të shpeshtë dhe të rregullt të individualizimit të dyfishtë, përkatësisht shquarsinë e dyfishtë të emrit: me përdorimin e përemrit dëftor dhe me nyjën shquese, si në rastet: *ki gjali, aj burri, ki shoki, ajo gruja, çaj shoqi, çajo lopa, çiki ca:lli, çekjo caca, çiki kali*, etj. Përgjigjet e marra nga pyetësi i përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore” na dalin në formën:

*Ai gjali po ven. Ki gjali tha.* (në të gjitha katundet e Karadakut)

*Ajo çika u nis.* (Lub.) *Ajo çika u nâis. Ajo caca u nis* me ardh. (Br.)

Shquarsia e dyfishtë dëgjohet sidomos kur gjatë të folurit përsëriten emra të njëjtë njerëzish a kafshësh. Për shembull, në tregimet popullore edhe të kësaj krahine: *Ish ka:n ni bu:rr e ni grue // Ajo gruja ni dit i tha ktâi burrit: O burri jem / shko laroje arën... // Ki burri e ngjoj at gruen ene shkoj //*<sup>127</sup>

## 16. Po kur emrat janë të shoqëruar me emra, në ç’formë del mbiemri?

Mbiemrat në të folmen tonë, si dhe në mbarë gjuhën shqipe, kanë dy gjini: mashkullore dhe femërore. Gjinia femërore e mbiemrave krijohet

<sup>123</sup> Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Dialektologjia ...*, f. 172.

<sup>124</sup> Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 82.

<sup>125</sup> Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 121-131.

<sup>126</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997, f. 154-155.

<sup>127</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut ...*, f. 255-256.

nga gjinia mashkullore. Në vijim do të sjellim rregullat kryesore të formimit të mbiemrave të gjinisë femërore në shqipen e Karadakut:

a) Mbiemrat që në shqipen standarde mbarojnë me *-ë, -ël, -ër* dhe *-ët*; gjininë femërore e bëjnë duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme **i** në **e**, sipas tipit: *i mâir - e mâir, i amël - e amël, i ba:rdh - e ba:rdh, i shpejt - e shpejt, i gja:t - e gja:t, i u:rt - e u:rt, i vogël - e vogël, i smu:t - e smu:t, i poshtër - e poshtër, i ra:n - e ra:n, i ka:ft - e ka:ft, i trash - e trash, i nxe:t - e nxe:t, i ftoft - e ftoft, i vetër - e vetër* etj.

b) Të gjithë mbiemrat që mbarojnë me *-ëm* dhe *-shëm*, si dhe mbiemrat prejfoljorë, gjininë femërore e bëjnë duke ndryshuar nyjën e përparme si dhe duke marrë mbaresën **-e** ( $i > e + e$ ): *i pasëm - e pasme, i knâushëm - e knâushme, i hershëm - e hershme, i la:m - e lame* etj. Me këtë rrugë gjininë femërore e bëjnë edhe mbiemrat: *i madh - e madhe, i kuç - e kuçe, i keç - e keçe, i shkrâum - e shkrâume* etj.

c) Disa mbiemra gjininë femërore e bëjnë me ndërrimin e nyjës së përparme dhe me shndërrimin në gjatësi të zanores fundore, nga zanore e shkurtër në zanore të gjatë. Te mbiemri i gjinisë femërore zanorja është më e gjatë sesa te mbiemri përkatës mashkullore. P.sh.: *i lig - e li:g, i par - e pa:r, i dit - e di:t* 'i dytë - e dytë', *i tret - e tre:t* 'i tretë - e tretë', *i shkret - e shkre:t* etj.

**Shënim:** Disa mbiemra dallohen nga ndajfoljet. Mbiemrat përdoren gjithmonë me nyje të përparme, ndërsa ndajfoljet nuk kanë nyje të përparme. Krahaso mbiemrat nga ndajfoljet përkatëse: *i mâir, e mâir - mâir; i na:lt, e na:lt - nalt, i shpe:jt, e shpe:jt - shpejt; i ba:rdh, e ba:rdh - bardh; i ho:ll, e ho:ll - holl; i ke:ç, e keçe - keç; i nga:t, e nga:t - ngat* etj. Në përgjithësi te mbiemrat zanorja fundore është e gjatë, ndërsa te ndajfoljet e shkurtër.

Kur në të njëjtën fjali kemi dy e më tepër emra, atëherë mbiemri përshtatet në gjini e në numër me emrin e fundit. Mbështetur në pyetësin për variacionin sintaksor në të folmet e shqipes nga informatorët e Malit të Zi të Shkupit kemi marrë këto përgjigje:

a) *Tre burra e tre gra t'thâirta.* (Lub., Orll.) *Tre burra e tre gra t'grâishta.* (Br.)

b) *Tre çika ene tre gjem t'regjistrâum.* (Lub., Orll.) *Tre caca e tre gjem t'shkra:m* (Br.)

c) *Tre gjem e tre çika t'regjistrâume.* (Lub., Orll.) *Tre gjem e tre caca t'shkrame.* (Br.)<sup>128</sup>

<sup>128</sup> Numërori *tre/tri* (për gjininë mashkullore/për gjininë femërore) në shumë fshatra të arealit gjuhësor të Malit të Zi të Shkupit e ka humbur kundërvënien e gjinisë, përkatësisht përdoret forma **tre** për të dy gjinitë. Edhe përemrat e vetës së tretë shumës në disa fshatra të kësaj zone gjuhësore kanë një formë të vetme për të dy gjinitë. Në këtë kuptim, në të folmet e fshatrave Brezë, Malinë dhe Tanushë

**17. A përdoret me vlerë të një fjalie kohore të njëkohësisë, forma e pashtjelluar e tipit “me të ardhur” apo vetëm fjalia kohore me lidhëzat “sa, sapo, posa”?**

Forma e pashtjelluar e tipit “me të ardhur” nuk përdoret në këtë të folme, por vetëm fjalia kohore me lidhëzën “sa”:

a) *Sa mrrâini agje/aj e mur* (në të gjitha katundet).

b) *Sa hini katund/thâiri met'madhe*. (Lub.) *Sa hini n'katan, bërtâiti sha:m*. (në të gjitha katundet)

**18. A përdoret ndërtimi me formë të pashtjelluar i tipit “një të thënë” apo vetëm një fjali kohore lidhëzore?**

Në të folmen e Malit të Zi të Shkupit nuk përdoret asnjëherë ndërtimi me formë të pashtjelluar të tipit “një të thënë”, por vetëm fjalia kohore lidhëzore e tipit:

*Sa e tha/ u nis. Sa shkoj, erdh//Sa e pa/e thâirri//Sa e pa, i tha: bujrëm//* (në të gjitha katundet).

**19. A përdoret ndërtimi me emra 182rejfoljorë asnjëherë në trajtë të shquar pa parafjalë apo vetëm një fjali kohore lidhëzore?**

Emrat prejfoljorë, më saktë emrat prejpjesorë (foljet e substantivuara) të tipit: *të ecurit, të kënduarit, të mësuarit*, të cilat në gjuhën standarde janë të gjinisë asnjëherë, në të folmen tonë përdoren në gjininë femërore në formën: *e hecmja, e këndâumja, e mcâumja* etj.

Rrjedhimisht, në këtë të folme nuk kemi ndërtime me emra prejfoljorë asnjëherë në trajtë të shquar pa parafjalë (të zbritunit poshtë u vra), por vetëm me fjali kohore lidhëzore:

*Sa zdripi posht/ u vra://* (në të gjitha fshatrat).

*Sa hini mrenda/ u shim drita//* (Lub.)

*Sa hini mrena/ u nal drita//* (Orll.)

*Çim hini mrena, u nal drita//* (Br.)

*Sa dul dilli/ lehi çeni//* (në të gjitha pikat e kësaj izoglose).

---

dallohen përemrat: **ata** (veta e tretë shumësi për gjininë mashkullore) dhe **ato** (për gjininë femërore); ndërsa në f. Bllacë dhe Luboten dëgjohet vetëm forma **ata** (për të dy gjinitë), ndërsa në f. Orllancë, Mojançë dhe Grushinë **ato** (për të dy gjinitë). Forma dyshe kemi edhe për vetën e tretë njëjës të gjinisë femërore: **ajo**, në f. Tanushë, Mojançë, Orllancë, Brezë, Malinë dhe Grushinë, por **aja** në f. Bllacë, Straçincë dhe Luboten. Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadikut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014, f. 279.

## 20. Në togjet foljore në të cilat përbërësi i parë shpreh fillimin e veprimit (zë, nis, filloj, hyj), përdoret forma parataktike apo hipotaktike?

Në të folmen e Kartadakut të Shkupit si dhe në pjesën më të madhe të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut<sup>129</sup> pas foljeve modale si dhe foljeve që tregojnë fillimin e veprimit përdoret edhe mënyra lidhore, edhe forma e pashtjelluar e paskajores, sipas tipit: duhet *t'shkoj* dhe duhet *me shku*. P.sh.:

- a) *Zu t'bërtase*. – *Zuni me bërtâit*. *Ja nisi t'bërtâise*. – *Ja nisi me bërtâit*. *Nâisi t'bërtase*. – *Nâisi me bërtâit*.
- b) *Hini t'haje buk*. – *Hini me hangër buk*.
- c) *Nisi / nâisi me fol*. *Ja nisi me kajt*. *Nis e kan*. *Ja nisi me thâirr*. *Nis e thâirr* (në të gjitha katundet e kësaj izoglose).

## 21. Në ndërtimet e mëposhtme kallëzuesi foljor shprehet me formë të shtjelluar apo të pashtjelluar?

Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit lidhorja dhe paskajorja përdoren paralelisht.<sup>130</sup> Për shembull: *Duhet t'shkoj ta shoh arën* dhe *Duhet me shku: me pa arën*. *Njeri duhet t'punoje sa t'jete xha:ll* – *Njeri duhet me punu: sa t'jete xhall*. *Mâikin lipet ta dush e t'i bash sajgi* – *Mikin duhet me da:sht e mej ba: sajgi* etj. Edhe në të folmen e Karshiakës format e mënyrës lidhore përdoren më dendur sesa format e pasklajores gege.<sup>131</sup>

Lidhorja zakonisht përdoret pas foljeve gjysmëndihmëse,<sup>132</sup> të cilat së bashku (si një tërësi) formojnë një kallëzues të vetëm të përbërë: *duhet t'shkoje, nâisa t'mcoj, zuni t' këndoje* etj. P.sh.:

- a) *Zu me kundâu*. (Lub.). *Zu me kërku*. (Orll.)

<sup>129</sup> Kallëzuesi foljor i përbërë me një folje gjysmëndihmëse modale apo që tregon fillimin e veprimit dhe me një folje themelore përdoret paralelisht edhe në mënyrën lidhore edhe në formën e paskajores, jo vetëm në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, por edhe në të folmen e Dervenit: *Zu t'bërtase*. *Nâiset t'vaje*. *Zun t'larojn*, por edhe: *Duhet me punâu*. *Nâisi me hongër* etj. Shih: Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 379.

<sup>130</sup> Në të folmet toske, siç është e njohur, në vend të paskajores gege (me punue), çdoherë kemi lidhoren (të punojë ose paskajoren toske (për të punuar). shih: Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 44; Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 88; Dr. Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 40 etj.

<sup>131</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997, f. 168-169.

<sup>132</sup> Folje gjysmëndihmëse në të folmen tonë janë: a) foljet modale *duhet* ose *lipet*, *mund* (*mun*) etj. Si dhe në fjalinë: *Duhet t'vâish*. *Mun t'rrâish sa t'dush*. b) foljet që tregojnë fillimin e veprimit: *nâisa, zâ*., si *Nâisi t'punoje*. *Zuni t'kallzoje se sa u gjazmâu për darsmën e gjalit* etj.

- b) *Sa u rrâit, nisi t'kërkoje nase.* (Br.)  
 c) *Nisi me kajt.* (Lub.). *Nis t'kaje.* (Br.)  
 ç) *Ja nisi me pâi, kundâu.* (Lub.) *Nâisi me kajt* (Orll.)  
 d) *Sa i bani di muj, nisi me pâi tamel lope.* (Br.)  
 dh) *Ja nisi me kundâu, pâi, kna:.* (Lub., Orll., Br.)  
 e) *Kur i bani ni vet, nisi t'fole.* (Br.)

**Përdorimi paralel i të ardhmes së domosdoshme (futurum necessitatis) dhe i të ardhmes së dëshiruar (futur volitiv, futurum voluntatis)**

Duke u mbështetur në materialin e vjelë në terren, erdhëm në përfundim se në të folmen e Karadakut të Shkupit koha e ardhme shprehet me dy forma të përbëra. Në fakt, njëra është karakteristike dhe mbizotëruese në të folmet e gegërishtes, ndërsa tjetra në të folmet e toskërishtes. Megjithatë, siç dihet, në folmet e gegërishtes qendrore kemi përdorimin e dyfishtë të të dyja formave, me shtrirje më të gjerë të formës së dytë të lartshënuar (futur volitiv). Në arealin gjuhësor për të cilin po shkruajmë, janë të pranishme edhe njëra edhe forma tjetër, por sipas vlerësimit tonë, forma **do + lidhore** (do t'fshâi) gjen përdorim të më shpeshtë.

Njëra formë (kushtimisht e thënë toske) ndërtohet me pjesëzën **do** (e desemantizuar nga folja due, du, dua) + **folja** themelore në mënyrën lidhore, sipas tipit: *do t'shkoj, do t'punoj, do t'laroj ....* Forma tjetër geqe formohet nga folja ndihmëse **kam + paskajorja**, apo kam + me + pjesore: *kam me shku:, kam me punu: (punâu, puna ©, kam me laru: (larâu, lara:)...*

Në studimet albanologjike përgjithësisht është pranuar se këto dy forma të veçanta foljore të së ardhmes dallojnë jo vetëm në pikëpamje strukturore, por edhe në pikëpamje kuptimore, ose së paku tregojnë nuanca me vlerë kuptimore (semantike).

Në fakt, forma geqe e kohës së ardhme (kam me a:rdh), e quajtur në shqip **e ardhme e domosdoshme** a **e detyrimit** (futurum necessitatis), është konstatuar se tregon veprime që duhen patjetër të kryhen, që janë të domosdoshme, të detyrueshme për t'u bërë, apo parashikimet e premtimet për t'u realizuar diçka thuhet me një siguri shumë të lartë, premtimet janë bindëse, folësi zotohet për atë që e thotë se do ta bëjë.

Ndërkaq, me formën tjetër toske (standard 'do të 'i'), e emërtuar në shqip **e ardhme e dëshiruar** (futur volitiv), shprehet një siguri më e ulët për atë që pritet të realizohet, një mëdyshje për atë që do të kryhet, diçka që është mirë të bëhet, por nuk është e domosdoshme.<sup>133</sup> Me fjalë të tjera, me futurum necessitatis tregohet një veprim që me të vërtetë do të kryhet, ndërsa me futurum volitiv shprehet një veprim që duam të kryhet.

<sup>133</sup> Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe ...*, f. 285-286.



Kjo kundërvënie (dyshe) binare: e vërtetë, e sigurt ~ e mundshme, e pritshme apo e domosdoshme, e patjetërsueshme ~ e dëshirueshme, e parapëlqyeshme shihet edhe në përbërjen (strukturën) e tyre: forma foljore gege (kam me a:rdh) ndërtohet me mënyrën dëftore (indikativin), ndërsa forma toske (do të vi) me mënyrën lidhore (konjunktivin). Të rikujtojmë se me mënyrën dëftore shënjohej një e vërtetë, diçka reale; ndërsa me mënyrën lidhore – e dëshirueshmja, e pritshmja.

Mua si banor i krahinës së Karadakut të Shkupit, kur më thotë dikush: *Kam me a:rdh*, jam i bindur se ai vërtetë 'ka me ardhë' dhe bëj përgatitjet për ta pritur; ndërsa kur dikush më thotë: *Do t'vâi*, atëherë nuk ndërmarr asgjë për ta pritur, meqë nuk jam i bindur se ai 'ka me ardhë'.<sup>134</sup>

## 22. Në fjalitë e pavarura pyetëse, me se shprehet kallëzuesi, me formë të shtjelluar apo të pashtjelluar?

Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kemi dy forma të paskajores: një paskajore gege dhe një paskajore toske, që formohen me:

a) pjesëzën **me + pjesoren: me shku:** (që quhet edhe pjesore gege, e që nuk e gjejmë në të folmet toske) dhe

b) **për t' + particip: për t'shku:** (< për të shkue) (karakteristik për të folmet toske dhe që nuk e gjejmë në të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore). Në këtë të folme, pjesorja gjithnjë është e cinguar.

Në të folmen tonë, në ndërtime e funksione të ndryshme sintaksore përdoren paralelisht:

a) **paskajorjae mbarë gegërishtes** (me punu☺);

b) **paskajorja toske** (për t'punâu), dhe

c) **lidhorja** (t'punoje).<sup>135</sup>

Paskajorja përdoret kryesisht në fjalitë e nënrenditura qëllimore, kushtore, krahasore, etj. P.sh.:

*Kimi a:rdh me punâu // Kimi ardh për't'punâu //*

*Ka shku: me livru: // Ka shku: për't'larâu //*

*Hajde me nejt sante // Hajde't'rrâim sante //*

*hkova'n'Shkup me ble ni kusai // Shkova'n'Shkup për't'gje ni kusâi //*

*Kesh'n'mullâi me blu // Kesh'n'mullâi për't'gju: //*

*Ra me fje:t // Ra për't'fe:t //*

Infinitivi, gjithashtu, përdoret për të formuar kohën e ardhme (me foljen ndihmëse kam + paskajorja), sipas tipit: *Nesër kam me shku: te daj- - Nesër kam për't'shku: te daja // 'N've:sht kam me mell gru:n - 'N'vesht kam për't'mell gru:n // Kimi me ba: shum ishim për xha: - Kimi për't'ba: shûam ishim për xha: //*

<sup>134</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut...*, f. 310-312.

<sup>135</sup> Po aty, f. 333-334.

Mbështetur në “Udhëzuesin për kërkime në fushën e sintaksës popullore” kemi vjelë këto ndërtime:

- a) *Shtëi a dimen, ku t'shkoj une* (në të gjitha katundet).
- b) *Xhit t'boj* (Lub.). *Mrrâina, xhit t'punoj* (Br.). *Shka t'baj* (Orll.)
- c) *Pse me ardh?* (Lub., Tan., Bll.). *Pse t'vâi?* (Orll.)
- ç) *Pse t'vêish têt, kur shkoj une?* (Br.) etj.

### 23. Fjalitë bashkërenditëse kundërshtore a shprehen edhe në mënyrën jolidhëzore?

Fjalitë bashkërenditëse kundërshtore në të folmen në fjalë shprehen edhe në mënyrën jolidhëzore:

- a) *T'mdhojat i prev, t'voglat i râiti (irâujti).*
- b) *Mos ja kshir setren, po kshirja pu:nt.*
- c) *Aj tha e mar une, ki tha e mar une* (në të gjitha katundet).

### Përfundime

Sipas veçorive gjuhësore që përkojnë me shtrirjen gjeografike, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit mund të cilësohet si **e folme më skajore verilindore e gegërishtes qendrore**. Me fjalë të tjera, të folmet e fshatrave të Malit të Zi të Shkupit, si për nga shtrirja hapësinore, ashtu edhe për nga tiparet gjuhësore, përfaqësojnë kufirin më verior të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore. Pjesa veriore e kësaj krahine në një farë mënyre është përvijuar me kufirin shtetëror të Maqedonisë së Veriut me Kosovën: fshatrat Tanushë, Bllacë, Brezë dhe Malinë kufizohen me të folmet e gegërishtes verilindore (afër kufirit të Maqedonisë së Veriut me Kosovën), ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen diçka më në jug të kësaj zone kufitare. Prandaj, kjo e folme përfaqëson një izoglosë “*ndërkaluese nga gegërishtja qendrore në gegërishten verilindore*”.

Si përfundim, në strukturën dialektore të shqipes, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit i përket *gegërishtes qendrore*, por në të gjejmë të gërshetuara mjaft tipare gjuhësore (fonetike - fonologjike, morfologjike e leksikore) të gegërishtes verilindore.

### Literatura:

Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E. (1995). *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I (Morfologjia)*. ASHRSh, IGjL. Tiranë.

*Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (2007, 2008). ASHSh, IGjL. Napoli.

*Fjalor enciklopedik shqiptar 1, 2, 3* (2008, 2009). ASHSh, Tiranë.

Beci, B. (1994). Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes. *Jehona 1-2*. Shkup.

Beci, B. (1994). Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike. *Shqiptarët e Maqedonisë*. Shkup.

- Çeliku, M., Domi, M., Floqi, Mansaku, S., Përnaska, R., Prifti, S., Totoni, M. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi II (Sintaksa)*. AShSh, IGjL. Tiranë.
- Demiraj, Sh. (1980). *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II). Prishtinë.
- Gjinari, J. (1989). *Dialektet e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Gjinari, J. (1988). *Dialektologjia shqiptare*. Tiranë.
- Hamiti, A. (2014). *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*. Logos-A, Shkup.
- Hamiti, A. Qamili, A. (2014). *Dialektologjia e gjuhës shqipe*. UIShM, Shkup.
- Nesimi, R. (2008). *E folmja e Dervenit*. Tetovë.
- Панов, М. (1993). *Селата во Република Македонија 1*, Shkup.
- Панов, М., Митев, М. (1997). *Општините во Република Македонија според новата поделба во 1996 година – основни просторни, демографски и аграрно-структурални обележја*, Shkup.
- Ryetësor për variacionin sintaksor në të folmet e shqipes*. (1987) (përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore”, IGjL, Tiranë).
- Стојановски, Б. (1994). *Љубанци и Скопско Црногорие*, Скопје.
- Shkurtaj, Gj. (2012). *Dialaktet e shqipes*, Botimet Morava, Tiranë.
- Томовски, К. (1996). *Населби и народна архитектура*, Етнологија на Македонците, МАНУ, Скопје.
- Ymeri, H. (1997). *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup.
- [http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopska\\_Crna\\_Gora](http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopska_Crna_Gora)

## 5. SI TË PËRCAKTOJMË INVENTARIN E FONEMAVE ZANORE TË NJË TË FOLMEJE TË CAKTUAR<sup>136</sup>

Tërësia e fonemave zanore e bashkëtingëllore të një të folmeje përbën inventarin vokalik dhe konsonantik të saj. Inventari i fonemave dhe kundërvëniet (opozicionet) që kanë ndërmjet tyre formojnë sistemin fonologjik të gjuhës përkatëse. Sistemet fonologjike të gjuhëve, dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve dallojnë midis tyre jo vetëm nga numri i fonemave që përfshihen në to dhe nga raportet që vendosen mes fonemave të një sistemi, por edhe nga substanca fonetike e tyre. Inventari i fonemave zanore përcaktohet në bazë të zanoreve në rrokje të theksuar.

<sup>136</sup> Këtë çështje e kemi trajtuar edhe në tekstin *Dialektologjia e gjuhës shqipe* në bashkautorësi Asllan Hamiti - Ajten Qamili, me temën *Përcaktimi i inventarit të fonemave zanore të të folmeve*, Shkup, Unioni i Intelektualëve Shqiptarë në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2014, f. 126-131.

Se një tingull është variant fonetik i një fonemeje të vetme apo fonemë më vete më së miri dallohet në çifte minimale fjalësh (fjalë që në përbërjen e tyre dallohen vetëm me një njësi vijore). Për të provuar funksionin dallues të fonemave, përdoret metoda e zëvendësimit (komutacioni) të një fonemeje me një tjetër. Në qoftë se në çifte minimale fjalësh këmbimet e fonemave dallojnë njërin nga tjetra për nga kuptimi ose nga ndonjë tipar morfologjik, atëherë ato janë fonema më vete. Por, nëse dy tinguj që i zëvendësojmë njërin me tjetrin në çifte fjalësh nuk kanë vlerë kuptimdaluese e as gramatikore, atëherë ato janë variante fonetike të një fonemeje të vetme. P.sh. /i/-ja dhe /y/-ja janë fonema më vete, sepse dallon kuptimi i fjalëve: *di ~ dy, si ~ sy, pikë ~ pykë, mik ~ myk*; ashtu siç janë fonema më vete bashkëtingëlloret /a/ dhe /e/ meqë në kundërvëniet (opozicionin) e tyre dallohet njëjësi nga shumësi (*dash ~ desh*), veta e parë nga veta e dytë (*dal ~ del, marr ~ merr*) etj. Në çiftet e fjalëve *tash ~ dash, tru ~ dru, ti ~ di, tu ~ du, tel ~ del; /t/-ja dhe /d/-ja* janë fonema më vete, por në variantin dialektor të Veriut e të Jugut në fjalët *vend - vënt, zog - zok, breg - brek* etj. [k]-ja dhe [g]-ja janë alofone dialektore që lidhen me pozicionin fundor të fonemës /g/, por jo fonema të veçanta.

**Një nga detyrat parësore, të domosdoshme e të nevojshme të dialektologut është përcaktimi i sasisë së fonemave i të folmes që përshkruan.** Në disa monografi dhe në përshkrime të tjera të tipit të mesëm e në skica dialektore të deritashme, nuk është dhënë inventari i fonemave të të folmes në vëzhgim. Praktikisht, shpeshherë tingujt janë vëzhguar vetëm nga pikëpamja fonetike, por jo edhe nga pikëpamja fonologjike, pra nga funksioni i tyre në gjuhë. Për të inventarizuar me sukses fonemat zanore e bashkëtingëllore, lipset një përgatitje e mirë teorike e praktike fonologjike e dialektologut. Pa një parapërgatitje solide teorike fonetike e fonologjike nuk mund të përcaktohet me saktësi inventari i fonemave, veçmas i fonemave zanore, e as të nxirren në shesh me sukses tiparet fonetike e fonologjike të të folmes. Ngjashëm me këtë, nuk mund të bëhet përshkrimi morfologjik i të folmes, pa njohuri të thelluara të morfologjisë; nuk mund të studiohet leksiku i një të folmeje, pa njohuri solide leksikologjike, pa njohjen e sintaksës, nuk mund të studiojmë strukturën sintaksore të një të folmeje.

Fatmirësisht, deri më tani në studimet për shqipen është punuar jo pak dhe të interesuarit kanë çka të lexojnë e të mësojnë. Prandaj, për studentët si dhe për studiuesit e rinj që duan të merren me studime dialektore, e vlefshme është këshilla që: së pari duhet pajisur me njohuri teorike e praktike në atë fushë studimi, në shqip e në gjuhë të tjera (fonetikë e fonologji, morfologji, leksikologji, sintaksë), të lexojnë monografi dialektore, të shfletojnë e analizojnë me kujdes Atlasin dialektologjik të shqipes, të konsultohen me njerëz me përvojë etj., e më

pas t'i rreken vjeljes së materialit dhe përshkrimit të një të folmeje të caktuar.

Në përshkrimin e të folmes nuk duhet të jemi robër të përgjithësimeve që vlejné për gjithë makrosistemin a mikrosistemet. Fjala vjen, përveç të folmeve gege, ka edhe të folme toske që kanë inventar të fonemave zanore të gjata; jo të gjitha të folmet gege doemos duhet të kenë fonema zanore hundore; jo të gjitha të folmet e gegërishtes qendrore doemos të diftongojnë [i]-në dhe [u]-në e theksuar etj. Konceptet e këtilla janë të vjetruara, të tejkaluara e të pasakta.

Çdo areal ka një inventar të caktuar fonemash, që e dallon atë nga arealet e tjera dialektore. Asnjë areal nuk e ka gjithë numrin e inventarit të fonemave zanore të të gjitha të folmeve të marra së bashku. Në çdo areal sasia e fonemave zanore është gjithmonë më i vogël se inventari i përbashkët i të folmeve të të dy dialekteve. Areali me inventarin më të vogël ka gjashtë fonema zanore, kurse areali me inventarin më të madh ka nëntëmbëdhjetë fonema zanore. Arealet e tjera kanë një inventar që lëviz nga 7 deri në 17 fonema zanore. Areali me inventarin më të vogël shtrihet në pjesën jugore të Shqipërisë, në një hapësirë të kufizuar që përfshin qytetin e Gjirokastrës me rrethinat, zonën e Kardhiqit, Libohovën, Nepravishtën dhe zonën e Delvinës. Ato kanë vetëm inventarin e fonemave zanore gojore të shkurtra (siç e ka edhe shqipja standarde), por pa fonemën /y/, ashtu si mungon ajo edhe në disa të folme të labërishtes dhe në të folmet e çamërishtes (Gjinari - Shkurtaç, 1997: 113-114). Numri i fonemave zanore në të folmet e gegërishtes është më i madh sesa në të folmet e toskërishtes.

Në dialektin jugor të shqipes veçohen të folmet e labërishtes, sidomos ato të Kurveleshit dhe të Bregdetit, si dhe të folmet e çamërishtes, të cilat ruajnë ende zanore të gjata. Rrjedhimisht, ato kanë 12 fonema zanore, përkatësisht 6 të shkurtra: /ǎ, ɛ̃, ɛ̄, ǔ, ǐ, ǔ/ dhe 6 të gjata: /a:, e:, ɛ:, o:, i:, u:/. Përgjithësisht dihet se të folmet e gegërishtes nuk kanë fonemë /ɛ̄/ në rrokje të theksuar, prandaj del se kanë serinë e fonemave zanore të shkurtrta, me 6 zanore: /ǎ, ɛ̃, ɛ̄, ǔ, ǐ, ǔ/; serinë e zanoreve të gjata me 6 zanore: /a:, e:, o:, i:, y: u:/ dhe ndonjë prej tyre edhe serinë e zanoreve hundore me 4 fonema: /ǎ, ɛ̃, ǐ, ǔ, ǔ/. Zanorja /o/ në asnjë të folme të shqipes nuk është hundore, por e hundorëzuar, që është përfutur nga buzorëzimi i /ǎ/-së hundore. Në shumicën e të folmeve të gegërishtes qendrore mungon fonema /y/, meqë ajo është zhbuzorëzuar në /i/, rrallëherë në /u/ e më pas ka pësuar diftongim (Shih hartat 18, 19, 20 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Të folmet shqipe dallohen dukshëm në alofoninë e fonemave zanore, si në shkallën e hapjes së zanoreve: diku shqiptohen më të hapura e diku më të mbyllura. Në të folmet e gegërishtes veriore zanoret gojore të shkurtra shqiptohen më të hapura se në të folmet e tjera të shqipes,


sidomos se në të folmet e toskërishtes (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, Dialektologjia, ShBLU, Tiranë, 1997, f. 119). Disa zanore nëpër të folmet shqipe realizohen jo vetëm si variante më të hapura apo më të mbyllura sesa varianti kryesor i tyre (nëse shqiptimin e varianteve dialektore e krahasojmë me shqiptimin letrar), por edhe si diftongje, diftongoide, madje edhe si triftongje (disa gjuhëtarë në monografitë përshkruese për ndonjë të folme pohojnë se ajo e folme ka edhe për triftongje). Disa alofoni të tjera fonemash zanore vijnë për shkak të diferencave që kanë të folmet në tiparin e buzorësisë së ndonjë fonemeje, veçmas i [ã]-së: diku një fonemë shqiptohet e buzorëzuar e diku jo, diku timbri buzor është më i madh e diku më i vogël.

Në përvojën tonë pedagogjike kemi vërejtur se jo gjithnjë studentët e kanë të qartë dhe e kuptojnë drejt alofoninë territoriale të fonemave, sidomos të zanoreve.

Në rrjedhën e të folurit (në fjalë e fjali) fonemat zanore realizohen si nuanca fonemash përkatëse: ato modifikojnë radhën, shkallën e buzorëzimit, mund të hundorëzohen etj. Variantet e tingujve të nyjëtuar në pozitë të izoluar (të nyjëtuar veças, pa tinguj të tjerë) quhen variante themelore. Kurdo që përshkruhet nyjëtimi i fonemave zanore, zakonisht merret parasysh nyjëtimi i varianteve themelore të tyre.

Variantet krahinore lidhen drejtpërdrejt me përkatësinë territoriale të folësit. Në bazë të këtyre modulimeve pa ndonjë vështirësi mund të identifikojmë njeriun cilës të folme, krahine apo dialekti i përket. Për të përcaktuar se në çfarë varianti krahinor nyjëtohet një zanore në ndonjë të folme shqipe, si variant: më i hapur apo më i mbyllur, më i përparmë apo më i prapmë, variant i buzorëzuar etj., mbështetemi në variantet themelore që kanë zanoret në shqiptimin letrar, në shqipen standarde. Pra, përshkrimi nyjëtimor i zanoreve të cilësdo të folme shqipe bëhet duke krahasuar ato me sistemin vokalik të shqipes standarde. Kjo rrugë është e drejtë, meqë mënyra e nyjëtimt, vendi i nyjëtimt, shkalla e hapjes dhe buzorësia e zanoreve në shqipen standarde përgjithësisht janë të njohura (përshkrimi nyjëtimor i zanoreve të shqipes standarde bëhet në tekstet e Fonetikës dhe mësohen në lëndën e Fonetikës, rëndom në vitin e parë). Në këtë kuptim (si në matematikë  $x + 5 = 12$ ,  $x = 12 - 5 = 7$ : krahasohet një e panjohur (e folmja) me një të njohur (standardja), dhe kështu e panjohura bëhet e njohur për të gjithë.


Të përkujtojmë se vendi i ngritjes së gjuhës drejt qiellzës (në pjesën e përparme, të mesme apo të prapme të gojës), shkalla e hapjes së gojës (e hapur, gjysmë e hapur, e mbyllur) si dhe pjesëmarrja apo mospjesëmarrja e buzëve (të buzorëzuara, të pabuzorëzuara) në nyjëtim përcaktojnë tiparet e përgjithshme nyjëtimore të zanoreve. Përkujtohu, shih e analizo diagramin e dhënë:



Siç dihet, **fonemat** ekzistojnë në formën e varianteve **kombinatorë, pozicionale, krahinore, individuale e stilistike**. E shprehur me terma artikulative dhe akustike kjo do të thotë që çdo fonemë zanore ose bashkëtingëllore ka një zonë artikulative dhe akustike karakteristike brenda së cilës realizohen variantet e saj. Kjo quhet **pushë e përhapjes** (fr. champ de dispersion) së fonemave.

Variantet kombinatorë dhe pozicionale janë të detyrueshme, meqë kushtëzohen nga konteksti tingullor që përcaktohet nga tingujt fqinjë ose nga pozicioni i tyre në fjalë (në fillim, në mes a në fund të fjalës, në rrokje të hapur a të mbyllur, të theksuar a të patheksuar). Variantet krahinore, individuale e stilistike janë variante të lira, që kushtëzohen nga faktorët jashtëgjuhësorë, që mund të jenë shoqërorë ose individualë, si p.sh. realizimet e të njëjtës fonemë në variante krahinore të ndryshme.

Variant quhet cilido realizim konkret i fonemës në kontekste të ndryshme. Një fonemë ka aq variante sa ka edhe realizime kontekstuale. Pra, me variante të fonemave kuptohet realizimi i tingujve me veçori të ndryshme fizike, që në aktin e komunikimit kanë të njëjtin funksion, d.m.th. bashkohen dhe përbëjnë një fonemë. Variantet e fonemave quhen alofone. Grafiku më poshtë paraqet shumësi alofonesh të fonemave zanore:



*Larmi alofonesh të fonemave zanore*

Për të shtjelluar mëtej veçoritë dalluese në sistemin e zanoreve të të folmeve shqipe, me interes është të trajtohet çdo zanore veç e veç, duke u përqendruar sidomos në zanoret që shfaqen në variante të ndryshme.

**Literatura:**

AShSh, *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, I*; Napoli, 2007, 2008.

Beci, Bahri, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, IGjL, Tiranë, 1995.

Gjinari, Jorgji - Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997.

Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*; Interdiskont, Sak-stil, Shkup, 2005; 2011.

Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UIShM, Shkup, 2014.

Trubeckoi, N. S., *Parime të fonologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1985.



## 6. HUNDORËSIA E ZANOREVE TË GEGËRISHTES VËSHTRUAR NGA PIKËPAMJA FONOLOGJIKE<sup>137</sup>

### Shkurtime

Hundorësia e zanoreve në të folmet e gegërishtes ka filluar të lëkundet dhe gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh, te të cilat një zanore gojore i kundërvihet një zanoreje hundore.

Është e vërtetë se çdo e folme geqe ka zanore të hundorëzuara. Por, për çdo të folme fonemat duhet identifikuar veç e veç nëpërmjet kundërvënieve fonologjike (kuptimdalluese ose gramatikore).

Të folmet geqe në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi fonemë zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

**Fjalët celës:** hundorësi, fonemë, kundërvënie, defonologjizim, prirje

Në dialektologjinë shqiptare janë arritur rezultate të lakmueshme. Janë përshkruar pothuajse të gjitha të folmet shqipe, janë hartuar punime përgjithësuese si dhe janë botuar e ribotuar disa tekste universitare shumë të vlefshme (Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaç: *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997, 2000), është botuar edhe Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. Deri më tani janë shkruar shumë monografi dialektore. Çdonjëra nga to, duke marrë parasysh kohën kur është shkruar, ka vlerë të madhe. Megjithkëtë, vëzhgimet dialektore duhet vazhduar edhe më tej. Pothuajse për çdo të folme geqe thuhet se ka zanore hundore, pa u saktësuar se hundorësia është e tipit fonetik apo fonologjik. Andaj, nga përshkrimet e deritashme dialektore vështirë se mund të krijohet mozaiku i plotë i sistemit vokalik të gegërishtes, sepse për shumë të folme të dhënat për vlerën fonologjike të gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve janë të pakta ose mungojnë fare, rrjedhimisht edhe nuk është përcaktuar me saktësi inventari i fonemave për disa të folme.

<sup>137</sup> Kumtesë e lexuar dhe e botuar në AKTET e Takimit Vjetor të Institutit Alb-shkencë, mbajtur më 15-16. 08. 2007 në Prishtinë, vëll. I, nr. 1, f. 83-91. Këtë çështje e kemi trajtuar edhe në temën *Prirja e defonologjizimit të zanoreve hundore në të folmen e gegërishtes*, Kumtesat I nga “Konferenca vjetore e shkencës në Kosovë 2014”, Prishtinë, 2014, f. 55-60.

Të arriturat teorike dhe praktike të dialektologjisë shqiptare si dhe të gjuhësisë shqiptare e të gjuhësisë së përgjithshme duhet zbatuar edhe në përshkrimet dialektore.

Dukuria e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe ka ngjallur interesim të madh ndër gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj, rrjedhimisht për këtë dukuri janë shkruar disa artikuj e studime të ndryshme. Në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe I, vëllimi I, Napoli 2007, vëllimi II Napoli 2008<sup>138</sup>, në hartat 8, 9, 10, 11, 12 është paraqitur përndarja e fonemave hundore /ā/, /ē/, /ī/, /ỹ/, /ũ/ në të gjitha të folmet shqipe të trungut e të diasporës nëpërmjet fjalëve *bān* 'bën', *ēn* 'end', *u pī* 'u mpi', *sỹ* ose *sø* 'sy', *hũ* 'huri'. Më pastaj, në hartën përgjithësuese nr. 19 është paraqitur numri i serive të fonemave zanore të theksuara. Sipas kësaj harte përgjithësuese mund të përfundohet se kemi tri areale:

1. Areal me një seri fonemash zanore të theksuara;
2. Areal me dy seri fonemash zanore të theksuara;
3. Areal me tri seri fonemash zanore të theksuara.

Konstatimi i përgjithshëm se toskërishtja (dhe shqipja standarde) nuk ka fonema zanore hundore është plotësisht i saktë dhe ka karakter universal, ashtu siç është i saktë konstatimi i përgjithshëm se të folmet gege kanë një inventar vokalik prej dy seri zanoresh: a) zanore gojore të shkurtra, dhe b) zanore gojore të gjata.

Por, por se të folmet gege në gjendjen e sotme kanë fonema zanore hundore është i diskutueshëm. Duhet **rishqyrtuar vlera fonologjike e zanoreve hundore të gegërishtes**. Mendojmë se kundërvënia e gjatësisë së zanoreve dhe hundorësia e tipit fonetik është mbarëdialektore gege; por, hundorësia në pikëpamje fonologjike nuk ka vlerë absolute. Gjykojmë se hundorësia e zanoreve tani më është defonologjizuar jo vetëm në nëndialektin e gegërishtes jugore, por edhe në shumë të folme të nëndialektit të gegërishtes veriore. Për ta përdëftuar këtë, përshkrimi i sistemit vijor (segmentor, linear) veçmas të të folmeve gege në të ardhmen duhet bërë si nga aspekti fonetik, ashtu edhe nga ai fonologjik.

Fonetikanët kanë shpjeguar prej kohësh se hundorësia shtrihet si ndër zanoret që i prijnë ashtu edhe ndër ato që ndjekin një bashkëtingëllore hundore. Ky hundorëzim është fryt i përshtatjes nyjëtimore të zanoreve nën ndikimin e bashkëtingëlloreve në kontakt, i përzierjes së fazës së fundit të tingullit paraprak me fazën e fillimit të tingullit pasues, përkatësisht të ndryshimeve kombinatorë që shkaktohen për shkak të akomodimit të organeve të të folurit (Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup; 2005, 2011, f. 218-220). Zanorja /ë/ e theksuar nuk bën pjesë në inventarin vokalik të të folmeve

<sup>138</sup> AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.

gege, ndërsa /o/-ja nuk i nënshtrohet ligjit të hundorësisë. Prandaj, nëpër të folmet gege me hundorësi mund të dëgjojmë 6 zanore /î/, /ÿ/, /ô/, /ê/, /â/, /û/ e më pak.

Siç dihet, në të folmet e gegërishtes shqiptohen me timbër hundor ato zanore që gjenden ose dikur janë gjendur në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore [m, n, nj], sipas skemës *zanore + bashkëtingëllore hundore* > *zanore hundore* ([a] + [n] = [â] = /â/).

Është pranuar nga të gjithë se zanoret hundore, krahas atyreve gojore dikur kanë qenë të mbarë shqipes, me intensitet më të ulët në të folmet e gegërishtes dhe me intensitet më të lartë në ato të toskërishtes, por në një fazë të zhvillimit të saj, në të folmet e Jugut rotacizmi (shndërrimi i /n/-së ndërzanore në /r/, që ka vepruar para më se 1300-1500 vjetësh) shkaktoi edhe çhundorëzimin e zanoreve (Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996).

Ka zanore me hundorësi në këto pozicione: a) përpara bashkëtingëlloreve hundore; b) pas bashkëtingëlloreve hundore; c) në mes dy bashkëtingëlloresh hundore; ç) kur pas zanores ka qenë një bashkëtingëllore hundore që ka rënë; d) hundorësi për ngjashmëri (analogji).

Në përshkrimin dialektor të çdo të folmeje gege kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat gojore duhet parë në çifte minimale fjalësh, si p.sh.:

- /a:/ ~ /ã:/: *ha:n* (ata hanë) ~ *hã:n* “hënë”, *va:th-i* ~ *vã:th-t* “vëthët”;
- /ã:/ ~ /a:/: *kã:m* “këmbë” ~ *kam* (unë), *hã:n* “hënë” ~ *han* (ai ha), *atã* “atë” ~ *ata*, *ktã* “këtë” ~ *cta* “këta”;
- /ã/ ~ /ã/: *lãm* (ne) “lam” ~ *lã:m* “lëmë”, *kãn* “kanë” ~ *kã:n* “kënë”;
- /e:/ ~ /ê:/: *ve:* “vezë” ~ *v ê:* “(unë) vë”;
- /i/ ~ /ĩ:/: *mi* (djemt e) “mi” ~ *mĩ:* “miu” etj., por ato mund të jenë të ndryshme nga një e folme në një të folme tjetër.

Në qoftë se një e folme ka çifte të tilla ose të ngjashme fjalësh, atëherë mund të nxirret përfundimi se ajo e folme, përveç gojoreve, ka fonema të veçanta hundore, që krijojnë edhe seri fonemash më vete, të cilat mund t'i quajmë **zanore hundore**. Nga ana tjetër, nëse nuk kemi çifte fjalësh të tilla, rrjedhimisht realizimet e zanoreve me timbër hundor janë variante kombinatorë të fonemave përkatëse gojore, ato nuk krijojnë seri të posaçme fonemash dhe mund të quhen **zanore të hundorëzuara**.

Megjithëse shqiptimi i ndërhundshëm i zanoreve në të folmet Veriore të shqipes ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, prapë kanë mbetur pa u sqaruar përfundimisht disa çështje të rëndësishme:

1. Cilat të folme gege kanë fonema zanore hundore e cilat kanë zanore të hundorëzuara?
2. Çfarë inventari vokalik kanë të folmet veç e veç?

3. Çfarë kundërvëniesh krijojnë ato me zanoret e tjera hundore e gojore?
4. Çfarë shkalle të hundorësisë kanë ato?
5. Vallë në gjendjen e sotme hundorësia e zanoreve në të folme të veçanta gege është defonologjizuar apo jo?
6. A formojnë zanoret hundore në mbarë gegërishten seri zanoresh më vete apo diku janë variante kombinatorore të zanoreve përkatëse gojore?

Nuk mëtojmë se mund të japim përgjigje në këto çështje, por po i parashtrijmë si një nga detyrat që duhet zgjidhur në të ardhmen me një bashkërendim të punës, jo vetëm për këtë problematikë, por edhe për çështje të tjera të dialektologjisë e të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi.

Bie fjala, ka mundësi të hartohet një pyetësor dialektor i veçantë për vjeljen e materialit në fushën e fonetikës e të fonologjisë, në të cilin do të përfshihen pyetje për kundërvëniet fonologjike të zanoreve sipas mungesës ~ pranisë së hundorësisë dhe ai të bëhet publik në një faqe elektronike në Internet. Materialet e siguruara përmes kësaj forme të grumbullohen, sistematizohen dhe përpunohen, natyrisht duke u mbështetur edhe në të dhënat që mund të sigurohen edhe nga punimet e deritashme si dhe nga Atlasi dialektologjik i shqipës.

Në studimet e deritashme dialektore për të folme të veçanta gege vërehet një larmi e madhe. Kjo laryshi është e natyrshme po të kihet parasysh se:

a) Përshkrimi i të folmeve tona është bërë brenda një periudhe kohore 50-60 vjeçare, kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore e deri më tani.

b) Një numër jo i vogël gjuhëtarësh janë marrë me studime dialektore në fazën e hershme të pjekurisë profesionale.

c) Gjatë vjeljes së materialit dialektor dhe përpunimit të tij janë përdorur metoda kërkimore-shkencore të ndryshme.

ç) Veshi ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite aparati i vetëm i përshkrimit të të folmeve tona.

d) Sistemi tingullor në disa përshkrime të folmesh është paraqitur shkarazi, vetëm në aspektin fonetik, ndërsa mungon pikëpamja fonologjike.

Fjala vjen, mund të lexojmë përshkrime të folmesh gege ku thuhet se “akëcila e folme përveç zanoreve gojore ka edhe zanore hundore”, por nuk jepen çifte minimale fjalësh për të përdëftuar vlerën fonologjike të tyre, e as nuk saktësohet inventari i fonemave zanore. Është e vërtetë se çdo e folme gege ka zanore të hundorëzuara. Pra, mungon vështrimi fonetiko-eksperimental (deri më tani kemi vetëm një të këtij lloji për të folmen e Shkodrës) dhe ai fonologjik (me disa përjashtime). Kuptohet se vëzhgimet eksperimentale kërkojnë mjete teknike ndihmëse të posaçme, laborator të fonetikës eksperimentale, të cilin fatkeqësisht nuk e kemi as në Shqipëri, as

në Kosovë e as në Maqedoninë e Veriut. Për këndvështrimin fonologjik të sistemit tingullor të të folmeve lipset një përgatitje e nevojshme teorike dhe një përkushtim e punë serioze, veçmas tani kur literatura përkatëse teorike (Dodi, Anastas: *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, IGjL, Tiranë, 2004); dhe modelet e mira të monografive dialektore nuk mungojnë (Shkurtaç, Gjovalin: *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, Dialektologjia shqiptare IV, IGjL, Tiranë, 1982, f. 144-278).

Praktikisht, për çdo të folme fonemat duhet identifikuar nëpërmjet kundërvënieve fonologjike (kuptimdalluese ose gramatikore).

Prania e hundorësisë së zanoreve është vërtetuar në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës, Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit, të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit, të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Gollakut, të Ferizajit, të Gjilanit, të Kaçanikut etj. Edhe akademik Idriz Ajeti me të drejtë konstaton se “rëndom thuhet se e folmja e Shkodrës ka mjaft hundorësi sekondare. Më në fund, kjo është njëra ndër çështjet më të ndërlikuara të gramatikës historike të të folmeve gege, ku numri i shembujve të çhundorëzimit nuk është i vogël. Për të ndriçuar deri diku hundorësinë e tyre, është e nevojshme një analizë e veçantë e çdo zanoreje ose fjale...”<sup>139</sup>

Përgjithësisht, në të folmen e skajshme të etnisë: të Preshevës, të Bujanovcit, të Ulqinit, të Llapit e Gollakut si dhe në të folmet lindore të gegërishtes qendrore (veçmas ato të Maqedonisë së Veriut) hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, përkatësisht aty më nuk mund të gjejmë çifte minimale fjalësh me kundërvënie zanore gojore me zanoren hundore përkatëse.

Nga leximi i punimeve përshkruese të të folmeve gege, lidhur me hundorësinë e zanoreve nuk mund të përftohet pasqyrë e qartë: në disa përshkrime dialektore fitohet ideja se hundorësia e zanoreve ka vlerë fonologjike, ndërsa në disa punime të tjera nuk janë sjellë dëshmi të mjaftueshme për ta pohuar ose për ta mohuar atë. Gjatë punës sonë në të ardhmen nuk duhet të kënaqemi vetëm me konstatimin se “në një të folme gege dëgjohen apo nuk dëgjohen zanore hundore”, kur dihet se hundorësia fonetike e zanoreve është veçori e përgjithshme e dialektit Verior, por duhet analizuar vlera fonologjike e tyre, duhet përcaktuar inventari vokalik me: a) serinë e zanoreve gojore të shkurtra, b) serinë e zanoreve të gjata, dhe c) serinë e zanoreve hundore. Gjithsesi, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera duhet rishqyrtuar.

<sup>139</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 33.

Për gjendjen e sotme të studimeve dialektore në përgjithësi mund të thuhet se shkalla e hundorësisë së zanoreve bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike të tyre: sa më në veri që janë, hundorësia është aq më e madhe dhe anasjelltas. Kështu, në të folmet e nëndialektit verior të gegërishtes kemi një hundorësi me intensitet të lartë, ndërsa në nëndialektin e gegërishtes jugore kemi një shkallë më të ulët hundorësie. Zaten, po të duam të krahasojmë të folmet e Kosovës me të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, sipas një shkallëzimi hundorësie, duke filluar nga një shkallë më e lartë e përfunduar me një shkallë më të ulët, afërsisht do të kishim edhe një zbritje gjeografike veri – jug: të folmet e Kosovës, të Preshevës e Bujanovcit, të folmet e Kumanovës, të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Dibrës dhe të Strugës. Në këto dy të folmet e fundit pothuajse nuk dëgjojmë fare zanore me timbër hundor. Por, ashtu si për gjatësinë e zanoreve, edhe për shkallën e hundorësisë fjalën e fundit mund ta thotë vetëm analiza laboratorike, ndërsa vlera e tyre fonologjike duhet provuar me metodën e zëvendësimit (komutacionit).

Të folmet geqe në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Nga punimet dialektore që na kanë rënë në dorë, kemi fituar përshtypjen se të folmet e nëndialektit jugor të gegërishtes po shkojnë drejt çhundorëzimit dhe në këtë proces prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, ku hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, ndërsa gjatësia e tipit fonologjik ende ruhet (sidomos në saje të mosshqiptimit të [ë]-së fundore). Në nëndialektin verior të gegërishtes aty-këtu (por jo gjithkund) vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve ende ruhet.

### **Përfundim**

Si përfundim, nga monografitë, nga punimet dialektore për të folmet e gegërishtes që i kemi konsultuar gjykojmë se hundorësia e zanoreve në të folmet e gegërishtes është përzierje e sistemit të vjetër të trashëguar me zanore hundore që janë fonema më vete, me tipin e ri të hundorësisë jofonologjike. Edhe brendapërbrenda gegërishtes dallimi fonologjik i zanoreve gojore me zanoret hundore nuk është dukuri e përgjithshme, sepse nëpër të folme ka larmi. Ajo ka filluar të lëkundet dhe gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh, te të cilat një zanore gojore i kundërvihet një zanoreje hundore.

Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Kjo tregon se gegërishtja në çështjen e hundorësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: pjesa më e madhe e të folmeve të nëndialektit verior gegë e ruan tipin fonologjik të hundorësisë, ndërsa një numër i madh i të folmeve të nëndialektit të gegërishtes jugore, prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, kanë evoluar në tipin fonetik të hundorësisë. Edhe atje ku ruhet kundërvënja fonologjike e mungesës

kundruall pranisë së hundorësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

### Literatura:

Ahmetaj, Mehmet, *E folmja shqipe e Plavës dhe e Gucisë*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

Ajeti, Idriz, *Studime dialektore dhe etimologjike*, ASHSh, Tiranë, 2005.

ASHSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëll. I, Napoli, 2007; vëll II, Napoli, 2008.

Bardhi, Mehdi, *Disa veçori karakteristike në vokalizmin e së folmes së Hasit*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

Basha, Naim, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

Beci, Bahri, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, IGjL, Tiranë, 1995.

Berani, Shaqir, *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988.

Demiraj, Shaban, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.

Dodi, Anastas, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, IGjL, Tiranë, 2004.

Gjinari, Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin: *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997; 2000.

Halimi, Mehmet, *Disa tipare të së folmes së Moravës së Epërme*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Interdiskont, 2005; Sak-Stil, 2011, Shkup.

Hamiti, Asllan: *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.

Haruni, Sefedin, *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.

Haruni, Sejfedin, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.

Ibrahimi, Mustafa, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005.

Kelmendi, Hasan, *Disa veçori morfologjike të së folmes së lokalitetit të Turiçevcit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

Kelmendi, Tafil, *Sistemi foljor i së folmes së Balincës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

Mulaku, Latif – Bardhi, Mehdi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

Murati, Qemal, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

Nesimi, Remzi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.

- Raka, Fadil, *E folmja e qytezës së Kaçanikut, Studime gjuhësore I* (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Reçani, Fehim, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Skok, Petar, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Sulejmani, Fadil, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Shkurtaç, Gjovalin, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, Dialektologjia shqiptare IV, IGJL, Tiranë, 1982.
- Tagliavini, Carlo, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Trubeckoi, N. S., *Parime të fonologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1985.
- Ymeri, Haki, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Zyberi, Abdullah, *Vëzhgime mbi të folmen e fshatrave të Lugut të Drinit të Bardhë*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

## 7. DUKURI MORFONOLOGJIKE NË TË FOLMET E GEGËRISHTES<sup>140</sup>

Në këtë kumtesë, do të përpiqemi të shqyrtojmë disa aspekte morfonologjike në rrjetin dialektor të Veriut. Do të ndalemi në 3 çështje kryesore, përkatësisht në:

- a) ndërrimet morfonologjike,
- b) kundërvënien e zanoreve sipas gjatësisë dhe në
- c) hundorësinë e zanoreve.

Do të përpiqemi të japim edhe ndonjë vlerësim përgjithësues.

### a) Ndërrimet morfonologjike në të folmet e gegërishtes

Gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe janë zhvilluar disa procese fonologjike me vlerë morfologjike, të cilat zakonisht quhen dukuri morfonologjike. Ndonjë nga dukuritë morfonologjike është shumë e vjetër, e përftuar qysh në gjuhën “nënë” të shqipes. Por shumica e dukurive të

---

<sup>140</sup> Kumtesë e lexuar dhe e botuar me titullin “Disa dukuri morfonologjike në të folmet e gegërishtes”, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 31/1, Prishtinë, 2012, f. 731-737.



këttilla të shqipes së dokumentuar janë, në thelb, zhvillime të brendshme të vetë kësaj gjuhe, megjithëse procesi për ndonjë prej tyre mund të ketë nisur qysh në gjuhën “nënë” të saj.<sup>141</sup>

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera indoevropiane me morfonologji të zhvilluar,<sup>142</sup> hasen:

a) *ndërrime fonemore që shërbejnë si mjet i vetëm gramatikor dhe*

b) *ndërrime fonemore që veprojnë krahas me ndajshitesat eptimore.*

Ndryshimet fonemore kanë prekur mesin ose fundin e fjalës. Ndryshimet e fonemave nistore janë tepër të rralla në shqipen e sotme, sepse ato janë më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve. Kjo është shpjeguar me atë që për ndjenjën gjuhësore të shqipfolësit, ndryshimi i fonemës nistore të një morfeme shpie në prishjen e identitetit kuptimor të saj.

Dihet se kundërvëniet morfonologjike në mbarë shqipen janë më të shpeshta në paradigmën emërore (sipas numrit, trajtës, rasës) dhe në paradigmën foljore (sipas vetave, numrit, kohëve, mënyrave dhe diatezës), e më pak në sistemin mbiemëror.<sup>143</sup>

Në çështjen e ndërrimeve morfonologjike shqipja na del mjaft e njësuar (unike), meqë po të njëjtat këmbime kanë shtrirje të përgjithshme territoriale. Dukuri më të përhapura në të dy dialektet janë qiellzorëzimi, metafoia, apofonia si dhe disa ndërrime të tjera zanoresh e bashkëtingëlloresh.

Duhet përmendur se të folmet gege realizojnë edhe kundërvënien e gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve, që të folmet toske përgjithësisht e kanë bjerrë këtë.

Këtë shtrirje dialektore të kundërvënies së fonemave zanore të shkurtra me gjegjëset e gjata si dhe me inventarin e fonemave zanore hundore të arealeve të shqipes mjaft mirë i pasqyron Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (shih hartat: 1.a, 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 1.dh, 1.e; 2.a, 2.b, 2.c, 2.ç, 2.d; 1.a – 7., 1.a – 2.d., 1.a. – 4.).<sup>144</sup>

Qiellzorëzimi i fonemave, si dukuri morfonologjike e ndërrimit të një foneme joqiellzore në një fonemë qiellzore, ka shtrirje mbarëdialektore. Nga bashkëtingëlloret qiellzorëzohen /k/-ja në /q/, /g/-ja në /gj/; /ll/-ja, /l/-ja dhe /r/-ja në /j/. Ndërrimin e /k/ ~ /q/ e gjejmë tek emrat mashkullorë, kryesisht të burimit shqip, por edhe të huaj. Me qiellzorëzimin e /k/-së në /q/ nga forma e njëjësit shumësin e formojnë disa emra mashkullorë.

Për të parë ndërrimet e fonemave në të folmet e veriut mbështetje mund të gjejmë në skicat dhe monografitë dialektore, por kjo nuk do të

<sup>141</sup> Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 120.

<sup>142</sup> Gjuhë të tilla janë gjermanishtja, gjuhët sllave etj.

<sup>143</sup> Rahmi Memushaj, *Morfonologjia e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989, f. 86.

<sup>144</sup> AShSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007.

ishite e mjaftueshme, pa vjeljen e materialit me vëzhgim të drejtpërdrejtë. Një ndër marrje e këtillë kërkon punë disavjeçare ekipore të koordinuar.

Në përpjekjen tonë për ta përditësuar çështjen dhe për të nxitur studimet në këtë fushë, do të sjellim pak shembuj kryesisht nga të folmet e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut.

**ka ~ qe** (shqipja standarde): Me interes për morfonologjinë e gegërishtes është shtrirja terrotoriale e larmishme e formës së shumësit të emrit *ka*. Në bazë të të dhënave që kemi mundur të sigurojmë, të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore, veçmas ato të Kosovës e deri te të folmet veriore të Shkupit e ruajnë formën e vjetër të paqjellzorëzuar *kije*, me përjashtim të të folmes shqipe të Peshterit, ku krahas formës *kije* përdoret edhe forma **qe** ose **çe** (si variant territorial me afrikatizimin e [q]-së në [ç]) si dhe e folmja e Prilepit dhe e Krushevës **qie**. Në të folmet e tjera në shtrirje gjeografike në jug të Tetovës dëgjojmë formën e palatalizuar *qe*. P.sh.: *ka ~ kie* (Kosovë, Karadak i Shkupit), *qie* (Prilep e Krushevë), *çe* (Pollog), *qe* dhe *kie* (Peshter), *kije* (Moravë e Epërme dhe e Poshtme), *çie* dhe *kie* (Tetovë).

Tek emrat *mik*, *anmik*, *plak*, *ujk*, *krushk* në të gjitha të folmet gege, ashtu si edhe në ato toske kemi qiellzorëzim të plotë të /k/-së fundore në /q/. Në të folmet e gegërishtes veriore dëgjojmë variante fonetike me /q/ të afrikatizuar, ndërsa në gegërishten qendrore me /i/ dhe /u/ të diftonguar, përkatësisht në *miq*, *miç*, *maiq*; *pleq*, *pleç*, *pqeq*, *qeq*; *uq*, *uç*, *auq*, *ouq*; *anmiq*, *anmiç*; *krushq*, *krushç*. Këtë mund ta dëshmojmë me shembujt:

**mik ~ miq**: *miç* (në Kosovë, Pollogun e Tetovës, Karadakun e Shkupit), *mâik* – *mâiq* (në Prilep e Krushevë).

**armik ~ armiç**: *anmik* ~ *anmiç* (në Kosovë e Maqedoninë e Veriut).

**plak ~ pleq**: *plak* ~ *pleç* (në Kosovë, në Karadakun e Shkupit, në Malësinë e Sharrit të Tetovës), *pleq* në Peshter, *pqak* ~ *pqeq* por edhe *qak* ~ *qeq* (Pollog), *pleq* (Peshter), nga forma e njëjësit *plak* ose *qak* ~ *pleq* ose *qeq* (në Karadakun e Shkupit).

**ujk ~ ujç**: Edhe shumësi i fjalës *ujk* na del me /k/ fundore të qiellzorëzuar (e më pas në disa të folme edhe të afrikatizuar). P.sh.: *uk* ~ *uç* (Kosovë e Maqedoninë e Veriut), në Prilep e Krushevë me /u/ nistore të diftonguar në [âu]: *âuk* ~ *âuq*, në f. Straçincë të Karadakut të Shkupit me /u/ nistore të diftonguar në [ôu]: *ôuk* ~ *ôuq*; *uç* (Pollog), *ujq* (Peshter), *uç* (Tetovë).

**krushk ~ krushq**: *krâushk* – *krâushq* (Prilep e Krushevë); *krushç*, *krushçi* (Kosovë).

**peshk ~ peshq**: Shumësi i emrit *peshk* del i larmishëm në të folmet e Veriut. Kështu, në Kosovë dëgjojmë formën *peshçi*, më rrallë edhe *peshç*, në Karadakun e Shkupit *peshki*, në Karshiakë të Shkupit e Derven (zonë gjuhësore midis Shkupit e Tetovës) kemi formën me /i/ fundore të diftonguar *peshkai* dhe *peshka* si dhe formën *peshqe* në Prilep e Krushevë.

Një numër emrash të tjerë, përveç ndërrimit të /k/-së fundore në /q/ > [ç], marrin edhe prapashtesën -e ose nuk e qiellzorëzojnë /k/-në dhe marrin mbaresën -a, formë mjaft e përhapur në të folmet e Veriut, si p.sh:

**bark ~ barqe:** Te forma e shumësit *bark* po kështu ka vepruar qiellzorëzimi. Prandaj është përfutur forma *barqe*, *barçe* (në Kosovë, Preshevë, Bujanovc, Peshter e Maqedoninë e Veriut), ndërsa sipas të dhënave që kemi, vetëm në Derven është ruajtur /k/-ja fundore e paqiellzorëzuar, përkatësisht formës së njëjësit i shtohet mbaresa -a: *bark* ~ *barka*.

**bllok ~ blloqe:** *blloka* (në Kosovë e në Derven), *blloka* e *blloqe* (në Karadak, në Karshiakë në qarkun e Shkupit), *blluok* ~ *blluoqe* (në Prilep e Krushevë).

**prag ~ pregj:** *praga* (në Kosovë, në Karadak të Shkupit, në Derven), *pragje* (në Prilep e Krushevë).

**oxhak ~ oxhaqe:** Forma më e përhapur e shumësit të emrit *oxhak* është ajo me zanoren /a:/ të gjatë: *oxha:k* por edhe *oxhaqe* (Prilep e Krushevë), si dhe *oxhaçe* e *oxheç* (Moravë e Epërme në Kosovë), *oxhaka*, *praga* (në të folmen e Opojës e të Anadrinit).<sup>145</sup>

**brisk ~ brisque:** Edhe forma e shumësit *brisk* është e shumëllojshme: *brisç*, *brisçi* (në Kosovë), *briska* (në Derven), *brisqe* (në Prilep e Krushevë).

Siç dihet, në gjuhën shqipe disa emra shumësin e formojnë duke qiellzorëzuar tingullin e fundit të temës /g/ në /gj/:

**zog ~ zogj:** Me interes për morfonologjinë dialektore është edhe shtrirja teritoriale e larmishme e emrit *zog*. Nga të dhënat që kemi arritur të sigurojmë për të folmet e veriut, kemi hetuar se në to gjallojnë 4 forma shumësi: 1. *zogj* (ose në variantet fonetike *zoq*, *zoxh*), 2. *zøj*,<sup>146</sup> 3. *zoxhi* dhe 4. *zoga*. Forma më e përhapur në gjithë Kosovën e deri në veri të Shkupit është *zoxh*, por në Moravë të Epërme, në të folmen e Drinit të Bardhë (Kosovë) dhe në Pollog (zonë ndërmjet Tetovës e Gostivarit) mbizorëron forma *zøj*. Në Karshiakë të Shkupit thonë *ni zogj* – *shumë zogj*, por edhe *zoga*, *zuog* – *zuoq* (Prilep e Krushevë), *zøj* (Pollog, Moravë e Epërme, Drini i Bardhë), *zoq* e *zøj* (Peshter), *zoxhi* (Tetovë).

**pllug ~ pllugje:** *plluga*, *pllugje*, por edhe *ni pllugj* – *sha:m pllugja* (Tetovë dhe në f. Brest të Karadakut të Shkupit, për shkak të qiellzorëzimit të [g] > [gj] edhe në formën e njëjësit), *plluxh* (me afrikatizimin [gj] > [xh] në Kaçanik, Moravë e Poshtme, Opojë; përkatësisht në tërë Kosovën).

**brig ~ brigje:** *bregje*, *brega* (Karadak, *ni bregj* – *sha:m bregja*, Tetovë, f. Brest të Karadakut), *brexhe* (Pollog, Moravë e Epërme), *brega* dhe *brexhe*, rrallë *brixhe* (Derven).

<sup>145</sup> Dr. Naser Pajaziti, *E folmja e Opojës*, Prishtinë, 2005, f. 118.

<sup>146</sup> Dr. Naser Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 159.

**shteg ~ shtigje:** *shtega* dhe *shteqe* (Karadak), *shtexhe* (Pollog), *shtixhe* (Kosovë), *shteqe* dhe *shtiqe* (Peshter).

**varg ~ vargje:** *varga* dhe *vargje* (Karadak), *varxhe* (Pollog), *varxhi*, *verxhi* (Kosovë), *vargja* (Tetovë),

Derisa në shumë të folme shqipe qiellzorëzohet edhe /-ll/-ja fundore e formës së njëjësit në /-j/ te disa emra mashkullorë në shumës,<sup>147</sup> në të folmet e veriut ka edhe fjalë të tipit të tillë me /ll/ të paqiellzërëzuar edhe në shumës, si p.sh.:

**kungull ~ kunguj:** forma më e përhapur në Kosovë është kuqëll – *kuqi*, kungëll – *kungi* në Pollog, në Derven e në Karshiakë; ndërsa *kunglla* në Karadakun e Shkupit.

**yll ~ yje:** *yje* në Kosovë e në Pollog, *ill ~ illzi*, *illa* në Karadakun e Shkupit, *yllzi* në Kaçanik, *yzi* në të folmen e Anadrinit të Kosovës.

**mashkull ~ meshkuj:** Me interes për morfonologjinë e gegërishtes është edhe shtrirja terrotoriale e larmishme e formës së shumës të emrit mashkull: *mashkëll ~ mashklli* (Prilep e Krushevë), *mashki* (në Derven, në Karshiakë), *mashkoll ~ mashçi* (në të folmen e Opojës). Nuk është qiellzorëzuar /ll/ -ja as te shumësi i emrit *kalli*: *ka:ll – kalli*, *kallëi*, *kallâi* dhe *kallzi* (në Karadak e në Kaçanik), *kajzi* (në shumë të folme të Kosovës).

**hamall ~ hamaj:** Shumësi i emrit *hamall* bën me mbaresën -a: *hamalla* (në Kosovë, Karadak, Derven).

**kalë ~ kuaj:** Përgjithësisht në gegërishten veriore emri *kalë* përdoret vetëm në trajtë të shquar *kali*. Shumësin e bën në disa forma: *kali ~ kual* (përgjithësisht në Kosovë) me disa variante: *kval*, *gval*, *kfal* (në të folmen e Anadrinit e të Opojës, por edhe *kol* (në Karshiakë), *ka:l ~ kol* (në Derven, Tetovë), *kval* (Pollog, me konsonantizimin e [u] > [v]: *kual > kval*).

**lepur ~ lepuj:** Marrë në përgjithësi, nuk qiellzorëzohet as /r/-ja fundore te shumësi i emrit *lepur*, por ose ruhet /i/-ja e moçme fundore ose merr mbaresën -a të shumës. P.sh.; *lepër ~ lepri* por edhe *lepra* e *leprêi*, *leprâi* (në Karadak të Shkupit), *ljepër ~ ljepri* (Prilep e Krushevë), *lepri* (Pollog), *lepura* (Peshter).

## b) Kundërvënia e zanoreve sipas gjatësisë në të folmet e Veriut

Toskërishtja dhe shqipja standarde kanë gjatësi zanoresh të tipit fonetik. Zanoret e gjata janë nuanca kombinatorë dhe përgjithësisht mungon kundërvënia fonologjike të shkurtra ~ të gjata. Gjatësia e zanoreve

<sup>147</sup> Ndërrimi /ll/ ~ /j/ është ndër më prodhuesit nga ndërrimet e bashkëtingëlloreve. Atë e ndeshim në një shumicë emrash mashkullorë që dalin me fundoret -ull, -all, -ill, -ell, -yell, -uall, -iell, -yll, -ëll dhe -oll: *akull ~ akuj*, *mangall ~ mangaj*, *kërmill ~ kërmij*, *kërçell ~ kërcej*, *fëndyell ~ fëndyjej*, *buall ~ buaj*, *truall ~ troje* etj. Shih: Rahmi Memushaj, *Morfonologji...*, f. 119-122.

në toskërishte ka karakter pozicional dhe kombinator, ndërsa në gegërishte gjatësia e zanoreve shpeshherë ka vlerë fonologjike.

Nuk ka dyshim se gjatësia fonologjike e zanoreve është tipar i vokalizmit të gegërishtes. Megjithatë, në disa përshkrime të të folmeve të veçanta gege gjatësia e zanoreve nuk trajtohet në mënyrë të duhur, përkatësisht nuk vërtetohet vlera funksionale e tyre dhe nuk përcaktohet inventari i fonemave zanore të shkurtra përballë fonemave zanore të gjata. Nga ana tjetër, tani më kemi edhe monografi që mund të shërbejnë si model ku zanoret janë vështruar si nga aspekti fonetik ashtu edhe nga ai fonologjik. Prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës është 2:1.

Gjatësia e zanoreve nuk varet nga faktorë thjesht fonetikë, por është tipar i vazhdueshëm i fonemave, sepse vetëm në bazë të gjatësisë fonemat e shkurtra i vihen përballë fonemave të gjata, duke krijuar opozicion fonologjik. Kundërvënia e këtyllë e fonemave, në mungesë të treguesve të tjerë, përdoret për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore. Kjo bën që zanoret e shkurtra nga gjegjëset e tyre të gjata të luajnë rolin e fonemave të veçanta në gjuhë. Rrjedhimisht, kështu dalin dy seri fonemash zanore në rrokje të theksuar: fonema të shkurtra /a/, /e/, /i/, /o/, /u/, /y/ dhe fonema të gjata /a:/, /e:/, /i:/, /o:/, /u:/, /y:/.

Kundërvënia zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë shërben shpesh si mjet fonologjik për të dalluar kuptimin e disa çifteve minimale fjalësh, e sidomos për diferencimin e formave morfologjike të fjalëve. Gjatësia e tipit fonologjik ruhet në sajë të mosshqiptimit të ëë]-së fundore.

Po sjellim disa shembuj nga të folmet e gegërishtes ku gjatësia ka vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve ose i formave gramatikore dallohet vetëm nga ky tipar:

1. **Gjatësia e zanoreve ka funksion leksikor** (semantik), si në çiftet *maz* ~ *ma:z* (mëz - ajkë), *çaj* ~ *ça:j* (pije e nxehtë freskuese - çaj dru), *kos* ~ *ko:s* (kosi - kosa), *boll* ~ *bo:ll* (mjaft - lloj gjarpri), *kot* ~ *ko:t* (pa dobi - dremit), *shpat* ~ *shpa:t* (shpati - shpata), *mall* ~ *ma:ll* (malli - mallëngjim), *hall* ~ *ha:ll* (brenge - hallë-a), *shtat* ~ *shta:t* (trup - shtatë), *boj* ~ *bo:j* (trup - ngjyrë) etj.

2. **Gjatësia si mjet fonologjik ka përdorim të dendur, sidomos për dallimin e formave morfologjike.** Më të shumta janë fjalët, në përbërjen e të cilave kundërvënia e zanores së shkurtër ndaj zanores së gjatë bart me vete funksion gramatikor sesa karakter leksikor. Kështu, disa emra

dallohen sipas gjinisë apo numrit, si dhe disa folje dallohen në mënyrë, kohë dhe vetë. Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve të theksuara, emrat në numrin njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë.<sup>148</sup> Në të mirë të këtij konstatimi mund të sjellim disa shembuj:

a) *Dallim në gjini* (mashkullore ~ femërore): *plak* ~ *pla:k*, *kunat* ~ *kuna:t*, *krushk* ~ *kru:shk* etj. Emrat e gjinisë mashkullore shqiptohen me zanorre të shkurtër, ndërsa emrat e gjinisë femërore me zanore të gjatë. Kjo kundërvënie fonologjike e gjatësisë së zanoreve është rrjedhojë e rënies së /-ë/-së së patheksuar në fundin absolut të fjalës në të folmet e gegërishtes te emrat e gjinisë femërore në 4-5 shekujt e fundit të zhvillimit të shqipes. Mendohet se /ë/-ja e patheksuar fundore ka rënë jo më herët se 4-5 shekujt e fundit, meqë në tekstet e vjetra shqipe të shkruara në gegërishte, si te Meshari i Gjon Buzukut (1555) <ë>-në fundore e gjejmë të shkruar.

b) *Dallim në numër* (njëjës ~ shumës): *vesh* ~ *ve:sh*, *dyshek* ~ *dyshe:k*, *fyshek* ~ *fyshe:k*; *dham* ~ *dha:m*, *oxhak* ~ *oxha:k*, *baxhanak* ~ *baxhana:k*, *dollap* ~ *dolla:p* etj.<sup>149</sup> Në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes njëjësi i emrave të mësipërm shqiptohet me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi me zanore fundore të gjatë, pra me kundërvënie fonologjike zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë, gjegjësisht /e/ ~ /e:/, /a/ ~ /a:/. Në të folmet e toskërishtes e në shqipen standarde njëjësi i emrave të mësipërm shkruhet pa <ë>, ndërsa shumësi me <ë>. Shqiptimi i zanoreve të gjata te format e shumësit është rezultat i rënies së /-ë/-së fundore, që ka sjellë për pasojë zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse.

### c) Hundorësia e zanoreve

Dukuria e hundorësisë dhe e gjatësisë së zanoreve në gjuhën shqipe ka ngjallur interesim të madh ndër gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj, rrjedhimisht për këto dukuri janë shkruar disa artikuj e studime të ndryshme. Për morfonologjinë e gegërishtes me interes është të shqyrtohet

<sup>148</sup> Çifte leksikore me dallim kuptimor dhe dallime gramatikore të fjalëve në bazë të gjatësisë së zanoreve në gegërishten janë krijuar sidomos **me rënien e /-ë/-së fundore**. Në dialektin e Veriut rënia e /-ë/-së fundore ka shkaktuar **zgjatje kompensatore të gjatësisë** së zanores që gjendej para saj. Prandaj, emrat në numrin njëjës dhe të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa po të njëjtit emra në shumës dhe në gjininë femërore dalin me zanore të gjatë.

<sup>149</sup> Në çiftin minimal të fjalëve (një, dy, tre...) *bu:k* ~ (një copë ose do) *buk* bëhet dallimi i një tërësie (që shqiptohet me zanore të gjatë) nga ndonjë pjesë e asaj tërësie (me zanore të shkurtër). Në shembujt (një) *gu:r* ~ (shumë) *gur* bëhet përjashtim i rregullës së përgjithshme të funksionit gramatikor të gjatësisë fonologjike të zanoreve të theksuara, sepse në këtë rast njëjësi del me zanore të gjatë, ndërsa shumësi me zanore të shkurtër.

edhe hundorësia e zanoreve. Prania e hundorësisë së zanoreve është vërtetuar në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës, Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit, të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit, të Opojës, të Anadrinit, të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Gollakut, të Ferizajt, të Gjilanit, të Kaçanikut etj. Sipas tyre del se në nëndialektin verior të gegërishtes vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve ende ruhet.

Deri më tani janë shkruar shumë monografi dialektore. Çdonjëra nga to, duke marrë parasysh kohën kur është shkruar, ka vlerë të madhe. Pothuajse për çdo të folme geqe thuhet se ka zanore hundore, pa u saktësuar se hundorësia është e tipit fonetik apo fonologjik. Andaj, nga përshkrimet e deritashme dialektore vështirë se mund të krijohet mozaiku i plotë i sistemit vokalik të gegërishtes, sepse për shumë të folme të dhënat për vlerën fonologjike të gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve janë të pakta ose mungojnë fare, rrjedhimisht edhe nuk është përcaktuar me saktësi inventari i fonemave për disa të folme.

Dihet se brendapërbrenda gegërishtes dallimi fonologjik i zanoreve gojore me zanoret hundore nuk është dukuri e përgjithshme, sepse nëpër të folme ka larmi.

Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Kjo tregon se gegërishtja në çështjen e hundorësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: pjesa më e madhe e të folmeve të nëndialektit verior gegë e ruan tipin fonologjik të hundorësisë, ndërsa një numër i madh të folmesh të nëndialektit të gegërishtes jugore (veçmas të folmet e skajshme lindore, prijnë ato të Maqedonisë së Veriut) kanë evoluar në tipin fonetik të hundorësisë. Edhe atje ku ruhet dallimi fonologjik i mungesës përkundër pranisë së hundorësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Konstatimi i përgjithshëm se toskërishtja dhe shqipja standarde nuk kanë zanore hundore, ndërsa gegërishtja ka një inventar vokalik prej tri seri zanoresh: a) zanore gojore të shkurtra, b) zanore gojore të gjata, dhe c) zanore hundore është i drejtë.

Mendojmë se kundërvënia e gjatësisë së zanoreve dhe hundorësia e tipit fonetik është mbarëdialektore geqe, por, hundorësia në pikëpamje fonologjike nuk ka vlerë absolute, prandaj në të ardhmen përshkrimi i sistemit tingullor të një të folmeje duhet bërë si nga aspekti fonetik, ashtu edhe nga ai fonologjik.

Fonetikanët kanë shpjeguar prej kohësh se hundorësia shtrihet si ndër zanoret që i prijnë ashtu edhe ndër ato që ndjekin një

bashkëtingëllore hundore. Ky hundorëzim është fryt i përshtatjes nyjëtimore të zanoreve në ndikimin e bashkëtingëlloreve në kontakt, i përzierjes së fazës së fundit të tingullit paraprak me fazën e fillimit të tingullit pasues, përkatësisht të ndryshimeve kombinatorë që shkaktohen për shkak të akomodimit të organeve të të folurit. Zanorja /ë/ e theksuar nuk bën pjesë në inventarin vokalik të të folmeve gege, ndërsa /o/-ja nuk i nënshtrohet ligjit të hundorësisë. Prandaj, nëpër të folmet gege me hundorësi mund të dëgjojmë 6 zanore /î/, /ÿ/, /ô/, /ê/, /â/, /û/ e më pak.

Siç dihet, në të folmet e gegërishtes shqiptohen me timbër hundor ato zanore që gjenden ose dikur janë gjendur në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore [m, n, nj], sipas skemës *zanore + bashkëtingëllore hundore* > *zanore hundore* ([a] + [n] = [â] = /â/).

Është pranuar nga të gjithë se zanoret hundore, krahas atyreve gojore dikur kanë qenë të mbarë shqipes, me intensitet më të ulët në të folmet e gegërishtes dhe me intensitet më të lartë në ato të toskërishtes, por në një fazë të zhvillimit të saj, në të folmet e Jugut rotacizmi (shndërrimi i /n/-së ndërzanore në /r/, që ka vepruar para më se 1300-1500 vjetësh) shkaktoi edhe çhundorëzimin e zanoreve.

Ka zanore me hundorësi në këto pozicione:

- a) përpara bashkëtingëlloreve hundore;
- b) pas bashkëtingëlloreve hundore;
- c) në mes dy bashkëtingëlloresh hundore;
- ç) kur pas zanores ka qenë një bashkëtingëllore hundore që ka rënë;
- d) hundorësi për ngjashmëri (analogji).

Të arriturat teorike dhe praktike të dialektologjisë shqiptare si dhe të gjuhësisë shqiptare e të gjuhësisë së përgjithshme duhet zbatuar edhe në përshkrimet dialektore. Në përshkrimin dialektor të çdo të folmeje gege kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat gojore duhet parë në çifte minimale fjalësh, si p.sh.:

- /a:/ ~ /ã:/: *ha:n* (ata hanë) ~ *hã:n* "hënë", *va:th-i* ~ *vã:th-t* "vëthët";
- /ã:/ ~ /a:/: *kã:m* "këmbë" ~ *kam* (unë), *hã:n* "hënë" ~ *han* (ai ha), *atã* "atë" ~ *ata*, *ktã* "këtë" ~ *kta* "këta";
- /ã/ ~ /ã/: *lãm* (ne) "lam" ~ *lã:m* "lëmë", *kãn* "kanë" ~ *kã:n* "kënë";
- /e:/ ~ /ê:/: *ve*: "vezë" ~ *v ê*: "(unë) vë";
- /i/ ~ /î:/: *mi* (djemt e) "mi" ~ *mî*: "miu" etj., por ato mund të jenë të ndryshme nga një e folme në një të folme tjetër.

Në qoftë se një e folme ka çifte të tilla fjalësh ose të ngjashme, atëherë mund të nxirret përfundimi se ajo e folme, përveç gojoreve, ka fonema të veçanta hundore, që krijojnë edhe seri fonemash më vete, të cilat mund t'i quajmë zanore hundore. Nga ana tjetër, nëse nuk kemi çifte fjalësh të tilla, rrjedhimisht realizimet e zanoreve me timbër hundor janë variante



kombinatorë të fonemave përkatëse gojore, ato nuk krijojnë seri të posaçme fonemash dhe mund të quhen zanore të hundorëzuara.

Megjithëse shqiptimi i ndër-hundshëm i zanoreve në të folmet Veriore të shqipes ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, prapë kanë mbetur pa u sqaruar përfundimisht disa çështje të rëndësishme:

1. Cilat të folme gege kanë fonema zanore hundore e cilat kanë zanore të hundorëzuara?
2. Çfarë inventari vokalik kanë të folmet veç e veç?
3. Çfarë kundërvëniesh krijojnë ato me zanoret e tjera hundore e gojore?
4. Çfarë shkalle të hundorësisë kanë ato?
5. Vallë në gjendjen e sotme hundorësia e zanoreve në të folme të veçanta gege është defonologjizuar apo jo?
6. A formojnë zanoret hundore në mbarë gegërishten seri zanoresh më vete apo diku janë variante kombinatorë të zanoreve përkatëse gojore?

Me këtë kumtesë të shkurtër nuk mëtojmë se mund të japim përgjigje në këto çështje, por po i parashtroj si një nga detyrat tona të përbashkëta që duhet zgjidhur në të ardhmen me një bashkërendim të punës, jo vetëm për këtë problematikë, por edhe për çështje të tjera të dialektologjisë e të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi. Bie fjala, ka mundësi të hartohet një pyetësor dialektor i veçantë për vjeljen e materialit në fushën e fonetikës e të fonologjisë, në të cilin do të përfshihen pyetje për kundërvëniet fonologjike të zanoreve sipas mungesës ~ pranisë së hundorësisë dhe ai të bëhet publik në faqen elektronike të Alb-shkencës. Materialet e siguruarat përmes kësaj forme të grumbullohen, sistematizohen dhe përpunohen, natyrisht duke u mbështetur edhe në të dhënat që mund të sigurohen edhe nga punimet e deritashme.

Në studimet e deritashme dialektore për të folme të veçanta gege vërehet një larmi e madhe. Kjo laryshi është e natyrshme po të kihet parasysh se:

a) Përshkrimi i të folmeve tona është bërë brenda një periudhe kohore 50-60 vjeçare, kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore e deri më tani.

b) Një numër jo i vogël gjuhëtarësh janë marrë me studime dialektore në fazën e hershme të pjekurisë profesionale.

c) Gjatë vjeljes së materialit dialektor dhe përpunimit të tij janë përdorur metoda kërkimore-shkencore të ndryshme.

ç) Veshi është aparati i vetëm i përshkrimit të të folmeve tona.

d) Sistemi tingullor në disa përshkrime të folmesh është paraqitur shkarazi, vetëm në aspektin fonetik, ndërsa mungon pikëpamja fonologjike.

Fjala vjen, mund të lexojmë përshkrime të folmesh gege ku thuhet se “akëcila e folme përveç zanoreve gojore ka edhe zanore hundore”, por nuk jepen çifte minimale fjalësh për të përdëftuar vlerën fonologjike të tyre, e as nuk saktësohet inventari i fonemave zanore. Është e vërtetë se çdo e folme gege ka zanore të hundorëzuara, Pra, mungon vështrimi fonetiko-eksperimental (deri më tani kemi vetëm një të këtij lloji për të folmen e Shkodrës) dhe ai fonologjik (me disa përjashtime).

Kuptohet se vëzhgimet eksperimentale kërkojnë mjete teknike ndihmëse të posaçme, laborator të fonetikës eksperimentale, të cilin fatkeqësisht nuk e kemi as në Shqipëri, as në Kosovë e as në Maqedoninë e Veriut. Për këndvështrimin fonologjik të sistemit tingullor të të folmeve lipset një përgatitje e nevojshme teorike dhe një përkushtim e punë serioze, veçmas tani kur literatura përkatëse teorike dhe modelet e mira të monografive dialektore nuk mungojnë. Praktikisht, për çdo të folme fonemat duhet identifikuar nëpërmjet kundërvënieve fonologjike (kuptimdalluese ose gramatikore).

Nga leximi i punimeve përshkruese të të folmeve gege, lidhur me hundorësinë e zanoreve nuk mund të përftohet pasqyrë e qartë: në disa përshkrime dialektore fitohet ideja se hundorësia e zanoreve ka vlerë fonologjike, ndërsa në disa punime të tjera nuk janë sjellë dëshmi të mjaftueshme për ta pohuar ose për ta mohuar atë.

Gjatë punës sonë në të ardhmen nuk duhet të kënaqemi vetëm me konstatimin se “në një të folme gege dëgjohen apo nuk dëgjohen zanore hundore”, kur dihet se hundorësia e zanoreve është veçori e përgjithshme e dialektit Verior, por duhet analizuar vlera fonologjike e tyre, duhet përcaktuar inventari vokalik me:

- a) serinë e zanoreve gojore të shkurtra,
- b) serinë e zanoreve të gjata, dhe
- c) serinë e zanoreve hundore.

Gjithsesi, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera kërkojnë shqyrtime të mëtejme.

Për gjendjen e sotme të studimeve dialektore në përgjithësi mund të thuhet se shkalla e hundorësisë së zanoreve bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike të tyre: sa më në veri që janë, hundorësia është aq më e madhe dhe anasjelltas. Kështu, në të folmet e nëndialektit verior të gegërishtes kemi një hundorësi me intensitet të lartë, ndërsa në nëndialektin e gegërishtes jugore kemi një shkallë më të ulët hundorësie.

Zaten, po të duam të krahasojmë të folmet e Kosovës me të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, sipas një shkallëzimi hundorësie, duke filluar nga një shkallë më e lartë e përfunduar me një shkallë më të ulët, afërsisht do të kishim edhe një zbritje gjeografike veri – jug: të folmet e

Kosovës, të Preshevës e Bujanovcit, të folmet e Kumanovës, të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Dibrës dhe të Strugës. Në këto dy të folmet e fundit pothuajse nuk dëgjojmë fare zanore me timbër hundor. Por, ashtu si për gjatësinë e zanoreve, edhe për shkallën e hundorësisë fjalën e fundit mund ta thotë vetëm analiza laboratorike, ndërsa vlera e tyre fonologjike duhet provuar me metodën e zëvendësimit (komutacionit).

Sido që të jetë, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera kërkojnë studime të mëtejme.

### Si përfundim mund të thuhet se:

1. Të folmet e gegërishtes ruajnë disa forma të vjetra të ndërmjetme të paqellzorëzuara të shumësit të emrave. Bie fjala, mund të nxirret një përgjithësim se emrat *peshk, kungull, lepur, mashkull, ka* etj. në shumë të folme geqe ende e ruajnë mbaresën e vjetër **-i**: *peshki, kungi, lepri, mashki, kie*. Kjo vërteton bindshëm pohimin se bashkëtingëlloret /q/ e /gj/ janë përfutur nëpërmjet qiellzorëzimit të prapagjuhoreve /k-/ dhe /g-/ nën ndikimin e zanores së përparme të mbyllur /-i/.<sup>150</sup> P.sh. nga forma bazë *peshk* është kaluar te forma *peshq* nëpërmjet një faze të ndërmjetme *peshki*, pra: *peshk - peshki - peshq*.<sup>151</sup> Shtrirja gjeografike e formave morfologjike të fjalëve janë të dobishme jo vetëm për gjeografinë gjuhësore të shqipes, por edhe për historinë e gjuhës.

2. Forma e shumësit me mbaresën **-a**: *zoga, plluga, shtega, brega, varga, barka, praga, blloka, briska, peshka* ende gjallon në disa të folme të veriut, krahas shumësit me qiellzorizimin e bashkëtingëllores fundore (zogi, shtigje, brigje, vargje, barqe, pregj, blloqe, brisqe, peshq).

3. Në të njëjtën të folme gjallojnë 1, 2 ose më shumë forma shumësi: *breg ~ brega - bregje, brigje; bark ~ barka - barqe; bllok ~ blloka - blloqe; prag ~ praga, pragje*.

4. Në disa të folme geqe shumësi bëhet me metafoji, duke i shtuar edhe mbaresën **-ni**, si *dash - desh, vllah - vllah; kunat - kunet*, por edhe *kunet-ni, muzat - muzet dhe muzet-ni*.

5. Ruhët kundërvënja fonologjike e gjatësisë së zanoreve të tipit *plak ~ pla:k, kunat ~ kuna:t, kos ~ ko:s*. Marrë në përgjithësi, emrat në njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë.

6. Vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve në të folmet e Veriut po lëkundet. Në procesin e defonologjizimit të hundorësisë së zanoreve prijnë të folmet e skajshme të etnisë, veçmas ato të Maqedonisë së Veriut.

<sup>150</sup> Po aty, f. 196.

<sup>151</sup> Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 218.

**Literatura:**

- Ajeti, Idriz, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978.
- AShSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, II; Napoli, 2007, 2008.
- Badallaj, Imri, *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë*, Zëri i arbëreshëve nr. 10, Janinë, 1977.
- Badallaj, Imri, *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit të Prizrenit*, GJA V, 1975, Prishtinë, 1976.
- Badallaj, Imri, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2010.
- Basha, Naim, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.
- Beci, Bahri, *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gëgnisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965.
- Beci, Bahri, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994.
- Beci, Bahri, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, Studime Filologjike 1, Tiranë, 1985.
- Beci, Bahri, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Beci, Bahri, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.
- Çabej, Eqrem, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1987.
- Demiraj, Shaban, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.
- Gjinari, Jorgji, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
- Gjinari Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologji*, ShBLU, Tiranë, 1997.
- Halimi, Mehmet, *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985.
- Halimi, Mehmet, *Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985.
- Hamiti, Asllan, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Interdiskont, Shkup, 2005; Sak-stil, Shkup, 2011.
- Hamiti, Asllan, *Tiparet fonetike e fonologjike të të folmes së Karadakut të Shkupit*, kumtesë e Takimit V Ndërkombëtar të Alb-shkencës, Tiranë, 2-5.09.2010.
- Haruni, Sefedin, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme*, Shkup, 1998.
- Haruni, Sefedin, *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.

- Ibrahimi, Mustafa, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.
- Memushaj, Rahmi, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989.
- Mulaku, Latif – Bardhi, Mehdi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, GjA, SShF, II-1972, Prishtinë, 1974.
- Murati, Qemal, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.
- Nesimi, Remzi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Nesimi, Remzi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.
- Pajaziti, Naser, *E folmja e Opojës*, Prishtinë, 2005.
- Pajaziti, Naser, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008
- Reçani, Fehim, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.

## 8. NDIHMESA E STUDIUESVE TË MAQEDONISË SË VERIUT NË FUSHËN E DIALEKTOLOGJISË SHQIPTARE<sup>152</sup>

### ***Përmbledhje:***

Në dialektologjinë shqiptare janë arritur rezultate të lakmueshme. Janë përshkruar pothuajse të gjitha të folmet në Shqipëri e Kosovë, ndërsa nuk mungojnë edhe studimet për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Preshevë e Bujanovc si dhe për të folmet e diasporës shqipe. Çdonjëra nga to, duke marrë parasysh kohën kur është shkruar, ka vlerë të madhe. Megjithkëtë, një numër jo i vogël monografish e punimesh të tjera dialektologjike janë kopje e njëra-tjetrës.

Pa mohuar rezultatet e arritura deri më tani në studimin e të folmeve shqipe të Maqedonisë së Veriut, me këtë edhe ndihmesën e studiuesve të Maqedonisë së Veriut në fushën e dialektologjisë shqiptare,

<sup>152</sup> Kumtesë e botuar në Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79-84; AKTET e Takimit Ndërkombëtar Vjetor, IASH 2008, Tiranë 1-3 shtator 2008, vëll. II, nr. 1, f. 53-57 (ISSN 2073-2244). Artikulli është përditësuar.

mendojmë se në të ardhmen duhet të shtrohen detyra të tjera më të mëdha: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, por duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm më të madh si dhe me metoda bashkëkohore. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt, te ne sidomos me maqedonishten.

Do të ishte e udhës në Maqedoninë e Veriut të themelojmë një fonotekë, kartotekë dhe një laborator të fonetikës eksperimentale.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.

**Fjalët çelës:** studim sistematik, e folme, fonotekë, kartotekë, atlas dialektologjik

## 1. Hyrje

Studimet e të folmeve tona kanë vlerë të madhe për njohjen e larmisë gjuhësore të shqipes, historisë së gjuhës dhe folësve të asaj gjuhe, marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera në takim si dhe për shqipen standarde në përgjithësi. Dialektet janë burime më autentike për studimin e së kaluarës dhe të tashmes së një gjuhe, ndërsa dialektologjia paraqet mjetin më të sigurt të gjuhësisë bashkëkohore.

Në dialektologjinë shqiptare janë arritur rezultate të lakmueshme. Janë përshkruar pothuajse të gjitha të folmet në Shqipëri e Kosovë, ndërsa nuk mungojnë edhe studimet për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Preshevë e Bujanovc si dhe për të folmet e diasporës shqipe. Çdonjëra nga to, duke marrë parasysh kohën kur është shkruar, ka vlerë të madhe.

Të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut kanë tërhequr vëmendjen e disa studiuesve të huaj dhe vendës. I pari ndër të huajt që flet për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut është albanologu gjerman Jochan Georg Hahn, në veprën *Albanesische Studien* (Studime shqiptare, 1854). Norbert Jokli mblodhi material dialektor edhe nga të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, por ai nuk u botua. Më 1925 S. Mlladenovi botoi artikullin *Vërejtje mbi shqiptarët dhe shqipen në Maqedoninë Veriore dhe në Serbinë e Vjetër*. Më pas Ahmet Imami më vitin 1930 jep disa të dhëna për të folmen e Dibrës. Petar Skoku më vitin 1941 botoi punimin *Hulumtime gjuhësore për popullsinë josllave të fushëgropës së Shkupit*. Më 1942 Carlo Tagliavini shkroi skicën *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*.

Pas Luftës së Dytë Botërore për të folmet në fjalë janë shkruar mbi 40 skica e monografi dialektore. Ndihmesë të madhe për përshkrimin e këtyre të folmeve kanë dhënë: Abedin Zenku (për të folmen e Kërçovës), A.

Selimi (për të folmen e Zajazit të Kërçovës), I. Hyseni (për Dervenin e Tetovës), Petro Janura (për Pollogun e Gostivarit), Esat Hoxha (për të folmen toske të Strugës), Naim Basha (të folmen e Dibrës), Fadil Sylejmani (të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës), Remzi Nesimi (të folmen e Tetovës dhe të Dervenit), Qemal Murati (të folmen e Tuhinit të Kërçovës), Haki Ymeri (të folmen e Kumanovës dhe Karshiakës së Shkupit), Zihni Osmani (të folmen e Prespës dhe të Manastirit), Sefedin Haruni (për të folmen e Gostivarit), Fehim Reçani (të folmen e Pollogut), Agim Poloska (të folmen e Prespës), Asllan Hamiti (të folmen e Karadakut të Shkupit), Mustafa Ibrahimimi (të folmen e Prilepit dhe të Krushevës) etj.

Janë botuar edhe disa studime përgjithësuese, si Bahri Beci *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 261-269. Qemal Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998. Zeqir Kadriu, *Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë, 2002. Ismet Osmani, *Ndërrimet morfonologjike në të folmet e gegërishtes qendrore* (në dorëshkrim), Shkup, 2002.

Nuk mungojnë edhe studimet për marrëdhëniet e të folmeve shqipe të Maqedonisë së Veriut me gjuhët sllave, veçmas me maqedonishten. Ndër to shquhen studimet e akademik Olivera Jasharit – Nastevës, *Fjalë shqipe në gjuhët e fshehta maqedonase*, Gjuha maqedonase, viti III, nr. 3, 4, 5-6, Shkup, 1953. *Ndikimi i maqedonishtes në të folmet shqipe dhe turke në Maqedoni*, Gjuha maqedonase, viti VIII, libri. 2, Shkup, 1957. *Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmet shqipe*, GJA nr. 19, Prishtinë, 1989. *Shfaqja e diglosisë dhe bilinguizmit në RS të Maqedonisë*, Gjuha shqipe, nr. 3, Prishtinë, 1990. *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998.

Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 39-50.

Qemal Murati, *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985. *Huazimet shqipe në maqedonishten*, Gjurmime albanologjike (SShF) 14-1984, Prishtinë, 1985. *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, Prishtinë, 1990.

Agim Poloska, *Interferenca leksikore e të folmes shqipe dhe maqedonase të Prespës* (punim magjistrature), Shkup, 1988. *Interferenca leksikore e shqipes dhe maqedonishtes dialektore* (disertacion doktorati), Shkup, 1996.

Remzi Nesimi, *Disa elemente shqipe në të folmet e maqedonishtes perëndimore*, Gjuha shqipe, nr. 2, Prishtinë, 1986.

Rexhep Ismajli, *Disa fjalë shqipe në maqedonishte*, GJA nr. 1, Prishtinë, 1972.

Idriz Ajeti, *Studime leksikore shqiptare-sllave*, GJA, nr. 2, Prishtinë, 1968. *Marrëdhëniet gjuhësore sllavo-shqiptare, III*, Prishtinë, 1985.

Christian Gut, *Kontakte linguistike midis shqipes dhe maqedonishtes*, GJA, III, Prishtinë,

1975.

Safet Hoxha, *Elemente leksikore të shqipes në disa të folme të maqedonishtes*, BShUT, nr.

1, Shkodër, 1984.

Erik Hemp, *Marrëdhëniet gjuhësore maqedonase - shqipe*, Seminari VII i Gjuhës,

Letërsisë dhe Kulturës maqedonase, Ohër, 28-31. 08. 1974, Shkup, 1975.

Mojsi Lutfiu, *Ndikimi reciprok i gjuhëve sllave dhe i shqipes në të folunit e Dibrës*, Përparimi, nr. 1-2, Prishtinë, 1962.

Jollanda Mindak, *Paralele morfosintaksore ndërmjet maqedonishtes përëndimore dhe shqipes*, Literaturën zbor, nr. 5-6, Shkup, 1990.

Ajten Qamili, *Variantet shoqërore në të folmet e Strugës dhe ndikimi ndërgjuhësor te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh* (dorëshkrim), Shkup, 2008.

E quajmë të dobishme të përpiqemi të japim një bibliografi të monografive e të punimeve për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut. Kjo bibliografi nuk është e plotë, por megjithatë mund t'i shërbejë lexuesit të zellshëm si pikënisje ose udhëzues themelor për të kërkuar materialin e nevojshëm. Sigurisht se përveç veprave tani më të botuara, ka edhe punime të pabotuara, disa sosh janë shkruar e mbrojtur si tema magjistraturash e doktoratesh që përshkruajnë ndonjë të folme të caktuar në Maqedoninë e Veriut. Nga një kopje e këtyre punimeve gjenden në bibliotekat e fakulteteve përkatëse.

Abedin Zenku, *Disa karakteristika të krahinës së Kërçovës*, Jehona 3, Shkup, 1968.

Agim Poloska, *Pasuria leksiokore në të folmen e Prespës*, Jehona, nr. 8, Shkup, 1984.

Agim Poloska, *Vëzhgime mbi leksikon e kuzhinës në regjionin e Prespës*, Jehona, nr. 1, Shkup, 1987.

Agim Poloska, *Лексичка интерференција на македонскиот и албанскиот дијалектен јазик*, Менора, Скопје, 1998.

Agim Poloska, *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*, Asdreni, Shkup, 2003.

A. Selimi, *Të folmet e Zajazit me disa karakteristika*, Përparimi 6, Prishtinë, 1961.

Ajten Qamili, *Variantet shoqërore në të folmet e Strugës dhe ndikimi ndërgjuhësor te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski", Shkup, 2008.

Ajten Qamili, *E folmja shqipe e strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski", Shkup, 2012.

Ajten Qamili, *Perla gjuhësore*, Sak-stil, Shkup, 2018.



- Asllan Hamiti, *Maqedonizmat në të folmen e shqiptarëve të Shkupit*, Shqyrtime albanologjike 2, Shkup, 1996.
- Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, Konferenca Shkencore Mbarëshqiptare “Shqipja në etapën e sotme, politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Durrës, 15-17 dhjetor 2010.
- Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Shtrirja e orientalizmeve në të folmet shqipe në Maqedoni*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Leksikografi Tahir Dizdari dhe turkologët për shqipen”, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 31. 01. 2013.
- Asllan Hamiti, *Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme*, Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës (përmbledhje kumtesash), Gostivar - Shkup, 2014.
- Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UIShM, Shkup, 2014.
- Asllan Hamiti, *Tiparet sintaksore të së folmes së Karadakut të Shkupit*, ASA, IGjL, Tryezë e rrumbullakët “Variacioni sintaksor në të folmet e shqipes, tipare dhe treva”. Përgatitje për Atlasin e Sintaksës Dialektore të Shqipes, Tiranë, 13 dhjetor 2017.
- Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-stil, Shkup, 2018.
- Bahri Beci, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994, f. 45-55.
- Bahri Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSH, SShSh, 1962/2, 1963/3.
- Bahri Beci, *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gëgnisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 261-269.
- Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 39-50.
- Feim Reçani, *E folmja e rrethit të Gostivarit* (punim magjistrature në dorëshkrim), Prishtinë, 1977.
- Feim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Esat Hoxha, *E folmja toske e rrethit të Strugës*, Jehona nr. 6, Shkup, 1979.
- Fadil Sylejmani, *Dukuritë fonetike në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Dituria 1, Prishtinë, 1983.
- Fadil Sylejmani, *Vokalizmi në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Gjurmime albanologjike (SShF), 1985/14 dhe 1986/15, Prishtinë.
- Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Haki Ymeri, *Veçoritë morfologjike të së folmes së Kumanovës me rrethinë*, Jehona 1-2, Shkup, 1982.

- Haki Ymeri, *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore* (shikuar sipas së folmes shqipe të Markova-Rekës), Jehona 3, Shkup, 1994.
- Haki Ymeri, *Një përkitje ndërgjuhësore ballkanike në fushë të prozodisë*, Shqyrtime albanologjike, Shkup, 1997, f. 43-50.
- Dr. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978.
- Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, 2008.
- Carlo Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 105-152.
- Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011.
- Mehmet Halimi, *Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985, f. 353-375.
- Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005.
- Mustafa Ibrahim, *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2007.
- Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.
- Оливера Јашар - Настева, *Влијанието на македонскиот јазик врз албанските и турските говори во Македонија*, Македонски јазик VIII, книга 2, Скопје, 1957.
- Оливера Јашар - Настева, *Албански зборови во македонските тајни јазици*, Македонски јазик IV, бр. 3, 4, 5-6, Скопје.
- Petro Janura, *Vrojtime gjuhësore (fonetike) dhe folklorike-etnografike te shqiptarët e Pollogut të Gostivarit*, Gostivarskiot kraj (makedonskiot, albanskiot i turskiot jазик), Gostivar, 1970.
- Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 81-152.
- Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.
- Qemal Murati, *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985.
- Qemal Murati, *Huazimet shqipe në maqedonishten*, Gjurmime albanologjike (SShF) 14-1984, Prishtinë, 1985.
- Qemal Murati, *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1990.
- Qemal Murati, *Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*, Fan Noli, Tiranë, 1993.
- Qemal Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.
- Qemal Murati, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*, Logos-A, Shkup, 2003.
- Qemal Murati, *Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë*, Albas, 2004.

- Qemal Murati, *Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptare-maqedonase*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2007.
- Qemal Murati, *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2008.
- Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, 2008.
- Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327-352 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Remzi Nesimi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.
- Sefedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.
- Sefedin Haruni, *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.
- Xhemaludin Idrizi, *Mikrotoponimet e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.
- Zeqirja Ibrahim, *Standardizimi administrativ i toponimeve shqiptare*, Scupi 1, ITKShSh, Shkup, 2012.
- Zeqirja Ibrahim, *Gjuha standarde shqipe – themel identitar i shqiptarëve të Maqedonisë*, Interlinearis (studime mbi gjuhën shqipe), ITKShSh, Shkup, 2014.
- Zeqirja Ibrahim, *Statusi i gjuhës shqipe në Maqedoni*, Scupi 22, ITKShSh, Shkup, 2018.
- Zeqir Kadriu, *Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë, 2002.
- Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996.
- Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997.

## 2. Formulimi i çështjes

Përgjithësisht është konstatuar se vazhdimësia tokësore e shtrirjes së shqiptarëve në Ballkan bashkëpërputhet me vazhdimësinë gjuhësore. Nga kjo pikëpamje, të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut në mënyrë të shkallëshkallshme gërshetohen me të folmet e Shqipërisë dhe të Kosovës. Bie fjala, pjesa më e madhe e të folmeve të Kumanovës i takojnë gegërishtes qendrore, por ka edhe fshatra të këtij qarku që i përkasin gegërishtes verilindore.

Nga ana tjetër, e folmja e Elez Hanit dhe e Kaçanikut i përket gegërishtes verilindore, por pak fshatra jugorë i takojnë gegërishtes qendrore. Po kështu, të folmet e Karadakut të Shkupit, që gjenden në zonën kufitare ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, siç janë fshatrat Bllacë dhe Tanushë, janë të folme të gegërishtes qendrore, por me plot elemente të kosovarishtes. Të folmet shqipe në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë së Veriut, duke filluar nga pjesa jugore e Strugës dhe që përfshijnë Ohrin, Manastirin, Prespën dhe Resnjën janë të folme toske.

Ky shkallëzim gjuhësor me zona kalimtare nga një tip të folmesh në tipin tjetër, që më së miri mund të pasqyrohet me izoglosa e jo me kufij të prerë dialektor është një dëshmi e fuqishme gjuhësore se shqiptarët e Maqedonisë së Veriut janë autoktonë dhe se me shekuj kanë jetuar e jetojnë aty. Kontinuiteti tokësor, etnik, historik e gjuhësor i shqiptarëve në Ballkan mohojnë bindshëm hipotezën e disa dashakqinjve të popullit tonë se kinse para dy-tre shekujsh paskësh pasur dyndje të mëdha popullsie nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut.

Me kalimin e viteve në studimet dialektore për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut hetohet një përparim cilësor dhe sasior. Megjithkëtë, vështruar nga pikëpamja e përgjithshme e studimeve dialektologjike shqiptare, mund të thuhet se ne kemi ngecur pak prapa. E kemi kaluar vetëm fazën e parë, ndërsa në të ardhmen na pret edhe realizimi i fazës së dytë.

### **3. Duhet zgjeruar dhe thelluar studimet**

Nuk duhen mohuar rezultatet e arritura deri më tani në përshkrimin e të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut, me këtë edhe ndihmesën e studiuesve të Maqedonisë së Veriut në fushën e dialektologjisë shqiptare. Me të dhënat e deritashme mund të merren njoftime të shkëputura nga të cilat fitohet një ide e përgjithshme për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, por nuk mund të përvijohen izoglosa të plota për to. Nëse jemi vetëkritik dhe nuk jemi të kënaqur me atë që kemi arritur, por gjithnjë duam të shtrojmë detyra të reja, mund të pohohet se studimet dialektologjike për të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut i karakterizojnë përshkrime kryesisht informative, pa një kriter a plan të caktuar studimi, pra kemi të bëjmë me një njohje të pjesshme dhe josistimore, me zgjedhje rasti nga vetë studiuesit.

Në të folmet që u përshkruan nuk u vëzhguan kudo të njëjtat dukuri gjuhësore, prandaj edhe është punë mjaft e vështirë që në sajë të tyre të përfitojmë një pasqyrë të qartë të gjendjes gjuhësore të këtyre të folmeve. Nuk jepen mundësi për krahasime dhe për të nxjerrë përfundime, e aq më pak për të nxjerrë izoglosa dialektore. Edhe në tekstet përgjithësuese të Dialektologjisë shqiptare (Jorgji Gjinari: i pari më 1963, i dyti më 1969, i treti më 1975, i katërti më 1988 dhe i pesti në bashkautorësi me Gjovalin Shkurtajn, më 1997, ribotuar më vitin 2000) hetohet një mungesë e të dhënave për këto të folme.

Sipas njohurive tona, edhe në punën madhore të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, për arsye objektive e subjektive, të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut janë lënë disi pas dore, përkatësisht është vjelë material dialektor vetëm në pak pika që është pandehur se janë përfaqësuese. Sipas gjithë gjasash, autorët e Atlasit janë ballafaquar me mungesë material burimor dhe të dhëna të nevojshme për këto të folme, aq sa disa

skica e monografi dialektore janë ende në dorëshkrim, por ka nga to që duhet marrë me rezervë.

Me krijimin e kushteve të volitshme për shkollimin edhe të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut në gjuhën amtare, si më të rëndësishme ndër to po përmendim: prej sivjet shkollimin e mesëm të detyrueshëm të të rinjve, hapjen e dy universiteteve në Tetovë, themelimin e Institutit për Trashëgimi Kulturor të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut si dhe disa parakushteve të tjera që do të ishte mirë të siguroheshin, si të hapet një Institut Albanologjik dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve do të kemi një zgjerim, thellim dhe profesionalizëm më të madh edhe në studimet dialektore.

Mendojmë se në të ardhmen duhet të shtrohen detyra të tjera më të mëdha: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, por duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm më të madh si dhe me metoda bashkëkohore. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt, te ne sidomos me maqedonishten.

Do të ishte e udhës në Maqedoninë e Veriut të themelojmë një fonotekë, kartotekë dhe një laborator të fonetikës eksperimentale. Këto punë madhore kërkojnë përkrahjen e organeve shtetërore, bashkërendimin e gjuhëtarëve të Maqedonisë së Veriut dhe bashkëpunimin e specialistëve dhe institucioneve arsimore e shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.

#### **4. Përfundim**

Studimet për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut duhet zgjeruar e thelluar. Duhet vjelë pasuria e pashtershme gjuhësore, e veçmas ajo leksikore e frazeologjike. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt, te ne sidomos me maqedonishten.

Do të ishte e udhës në Maqedoninë e Veriut të themelojmë një fonotekë, kartotekë dhe një laborator të fonetikës eksperimentale. Duhet hartuar edhe një atlas dialektologjik të të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve

## 9. SISTEMI I ZANOREVE NË TË FOLMEN SHQIPE TË REKËS SË EPËRME<sup>153</sup>

### Shkurtime

Reka e Epërme e qarkut të Gostivarit paraqet një të folme shqipe shumë ruajtëse në fushën e fonetikës, të morfologjisë e të leksikut. Por, nga ana tjetër, ajo ka kryer disa zhvillime gjuhësore që nuk i gjejmë në asnjë të folme tjetër përreth e më gjerë. Me këtë artikull do të bëjmë fjalë për sistemin vokalik të të folmes shqipe të Rekës së Epërme. Kjo e folme shqipe, dallohet mjaft nga të folmet e tjera përreth si në inventarin e fonemave zanore, ashtu edhe në ndërrimet që pësojnë ato gjatë përdorimit në pozita të caktuara fonetike. Karakteristike sidomos janë mungesa e hundorësisë së zanoreve, buzorëzimi i shpeshtë i zanores hundore [ã] të mbarë gëgerishtes në [o] të hundorëzuar etj.

**Fjalët kyçe:** e folme, zanore, dukuri, risi, ruajtje

Studimet e të folmeve tona kanë vlerë të madhe për njohjen e larmisë gjuhësore të shqipes, historisë së gjuhës dhe folësve të asaj gjuhe, marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera në kontakt si dhe për shqipen standarde në përgjithësi. Dialektet janë burime më autentike për studimin e së kaluarës dhe të tashmes së një gjuhe, ndërsa dialektologjia paraqet mjetin më të sigurt të gjuhësisë bashkëkohore.

Në dialektologjinë shqiptare janë arritur rezultate të lakmueshme. Janë përshkruar pothuajse të gjitha të folmet në Shqipëri e Kosovë, ndërsa nuk mungojnë edhe studimet për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Preshevë e Bujanovc si dhe për të folmet e diasporës shqipe. Çdonjëra nga to ka vlerë të madhe.

Banorët e Rekës së Epërme edhe në të kaluarën por edhe tani shtegtojnë me familje e grupe-grupe në vende të ndryshme të Maqedonisë së Veriut, si në qytetet Gostivar, Dibër, Tetovë, Shkup, Veles e gjetiu, në fshatrat: Koritë, Sedllarevë, Gurgurnicë (komuna e Tetovës), në disa fshatra të Karshiakës së Shkupit (Gerçecin, Nerezin, Sveta Petkën, Çiflikun, Patishka Rekën), Jabollçishtë e Epërme dhe Jabollçishtë e Poshtme e Velesit etj.<sup>154</sup>

Deri më tani studimi më i plotë për të folmen e Rekës është monografia e kolegut Sejfedin Haruni “E folmja shqipe e Rekës së Epërme

<sup>153</sup> Asllan Hamiti, *Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme*, Konferenca Shkencore “Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës” (përmbledhje kumtesash), Gostivar – Shkup, 2014, f. 55-64.

<sup>154</sup> Sejfedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994, f. 8.

të Gostivarit”, Shkup, 1994. Për të folmet e rekasve që jetojnë në komunën e Tetovës ka bërë fjalë prof. Fadil Sulejmani, e folmja e rekasve që jetojnë në katundet e Shkupit është përfshirë në monografinë e prof. Haki Ymerit, “E folmja shqipe e Karshiakës”,<sup>155</sup> ndërsa për të folmen e rekasve të Prilepit ka shkruar kolegu Mustafa Ibrahim.

Gjatë punës sonë për të shtjelluar sistemin e zanoreve të të folmes së Rekës së Epërme kemi konsultuar studimet e sapopërmendura për këtë të folme, monografi për të folmet e tjera, veçmas për të folmet e gegërishtes qendrore, si dhe material të vjelë dialektor nëpërmjet studentëve dhe në kontaktet e drejtpërdrejta me rekas të katundeve të Shkupit.

Reka e Epërme nga njëra anë paraqet një të folme shqipe shumë ruajtëse në fushën e fonetikës, të morfologjisë e të leksikut. Por, nga ana tjetër, ajo ka kryer disa zhvillime gjuhësore që nuk i gjejmë në asnjë të folme tjetër përreth e më gjerë. E folmja e Rekës së Epërme të Gostivarit dallohet nga të folmet e tjera shqipe përreth, si nga të folmet e Tetovës, Pollogut, Dibërës, Kërçovës etj. Ajo përbën një izoglosë më vete që karakterizohet me dukuri ruajtëse (arkaike) që vështirë se mund t’ia gjejmë shqen askund tjetër.

Në sistemin e zanoreve kjo e folme dallohet për disa dukuri.

1. Nuk ka zanore hundore, por vetëm zanore gojore.
2. Ka gjatësi zanoresh të tipit fonologjik, si edhe të folmet e tjera geqe.
3. Nuk ka fonemë zanore /ë/ në rrokje të theksuar, ndërsa në rrokje të patheksuar ajo ka denduri të vogël përdorimi, shpeshherë nuk shqiptohet fare ose këmbëhet me ndonjë zanore tjetër.
4. E ruan zanoren buzore /y/.
5. Nuk i diftongon zanoret e ngritjes së lartë /i, u/ në rrokje të theksuar.
6. Në dallim nga të folmet e tjera të gegërishtes qendrore si dhe të gjitha të folmet e tjera shqipe, e folmja e Rekës së Epërme ka një shkallë shumë të lartë këmbimi ndërmjet zanoresh.

Do të shpjegojmë shkurtimisht këto tipare gjuhësore:

### **1. E folmja e Rekës së Epërme nuk ka fonema zanore hundore**

Prania e hundorësisë së zanoreve është vërtetuar në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës, Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit, të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit, të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Gollakut, të Ferizajt, të Gjilanit, të Kaçanikut etj.

Përgjithësisht, në të folmen e skajshme të etnisë: të Preshevës, të Bujanovcit, të Ulqinit, të Llapit e Gollakut si dhe në të folmet lindore të

<sup>155</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997.

gegërishtes qendrore, veçmas ato të Maqedonisë së Veriut: të rrethit të Tetovës, Gostivarit, Dibrës, Prilepit, Krushevës, Rekës së Epërme, Kërçovës e të folmet gege të Strugës, hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, përkatësisht aty më nuk mund të gjejmë çifte minimale fjalësh me kundërvënie zanore gojore me zanoren hundore përkatëse.

Të folmet gege në çështjen e hundorësisë së zanoreve gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Nga punimet dialektore që na kanë rënë në dorë, kemi fituar përshtypjen se të folmet e nëndialektit jugor të gegërishtes po shkojnë drejt çhundorëzimit dhe në këtë proces prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, ku hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, ndërsa gjatësia e tipit fonologjik ende ruhet (sidomos në saje të mosshqiptimit të [ë]-së fundore).

## 2. Nga pikëpamja fonologjike e folmja e Rekës së Epërme njih dy seri zanorësh të theksuara: zanore të shkurtra ~ zanore të gjata, ashtu si edhe të folmet e tjera gege

Për nga gjatësia, toskërishtja ka një seri fonemash zanore, ndërsa gegërishtja ka dy: zanore të shkurtra dhe zanore të gjata. Në toskërishte zanoret kanë *gjatësi fonetike* (që varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, siç e ka edhe gjuha standarde), ndërsa gegërishtja ka *gjatësi fonologjike* (që nuk varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, por gjatësia ka karakter të qëndrueshëm dhe shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore).

Kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë) në disa çifte minimale fjalësh shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore. P.sh. shkurtësia në kundërvënie me gjatësinë e zanores ka funksion kuptimor (semantik): *maz* ~ *ma:z* “mëz – ajkë”, *kos* ~ *ko:s* “kos – kosë”, *shpat* ~ *shpa:t* “shpat – shpatë”; bën dallimin e gjinisë mashkullore nga ajo femërore: *pqak* ~ *pqa:k* “plak – plakë”, *kunat* ~ *kuna:t* “kunat – kunatë”; dallon numrin njëjës nga numri shumë: *fyshek* ~ *fyshe:k* “fyshek – fyshekë”, *oxhak* ~ *oxha:k* “oxhak – oxhakë”, *dollap* ~ *dollap* “dollap – dollapë.”

## 3. E folmja e Rekës së Epërme nuk ka fonemë zanore /ë/ në rrokje të theksuar, ndërsa në rrokje të patheksuar kjo zanore ka denduri të vogël përdorimi, shpeshherë nuk shqiptohet fare ose këmbëhet me ndonjë zanore tjetër

Proceset gjuhësore në rrjedhë të kohës të të dy dialekteve të shqipes kanë sjellë për pasojë që të folmet toske në inventarin e fonemave zanore të theksuara të kenë fonemën /ë/, ndërsa në të folmet e gegërishtes kjo fonemë të mungojë, sepse në vend të saj kanë /ã/ ose /ê/ hundore.



Me fjalë të tjera, zanorja /ë/ në Jug ka përdorim shumë të dendur, në rrokje të theksuar e të patheksuar, në çdo pozitë të fjalës (në fund, në mes e në fillim), ndërsa në Veri ajo dëgjohet vetëm në rrokje të patheksuar me përndarje të kufizuar, meqë nuk përdoret as në fillim e as në fund, por vetëm në mes të fjalës.

E folmja shqipe e Rekës së Epërme lidhur me përdorimin e /ë/-së nuk bën ndonjë përjashtim nga të folmet e tjera gege. Fjalët shqiptohen pa /ë/ fundore, si *mi:r* (< mirë), *gja:th* (< djathë), *va:jz* (< vajzë), *gra:t* (< gratë), *shu:m* (< shumë), *ka:n* (< kanë), *aru:sh* (< arushë), *bgje:shk* (< bjeshkë), *mo:ll* (< mollë), *fu:sh* (< fushë), *do:r* (< dorë) etj.

Për lehtësim shqiptimi [ë]-ja në pozitë të patheksuar elidohet edhe në parafjalën *në* (< n'), nyjen dhe pjesëzën *të* (t'), si: *n'shpe:ll* (< në shpellë), *n'kullos* (< në kullosë), *n'katunt* (< në katund), *n'xhamit* (< në xhami); *t'zita* (< të ziera), *t'ftoftit* (< të ftohtit), *t'fort* (< të fortë), *kur t'vi* (< kur të vi), *t'shkojne* (< të shkojë), *t'je:t* (< të jetë), *t'py:s* (< të pyes), *t'hypim* (< të hyjmë), *t'fjen n'shpi* (< të flejnë në shtëpi) etj.

Shpeshherë [ë]-ja bie edhe në mes të fjalës, si: *ktu* (< këtu), *kta* (< këta), *ksaj* (< kësaj), *kpute* (< këpute); *kshtu* (< kështu); *vlla, vllai* (< vëlla), *lsho:jm* (< lëshojmë), *mirpo* (< mirëpo) etj.

Si edhe në të folmet e tjera, ndonjëherë bie jo vetëm [ë]-ja, por bashkë me të edhe tingujt e tjerë të rrokjes së patheksuar në mes apo në fund të fjalës, si: *shpi* (shtëpi), *bi* (< bijë); *fmi, fmia* (< fëmijë, fëmija), *thrrasin* (< thërrasin) etj.

#### 4. E ruan zanoren buzore /y/

Grupi i të folmeve të gegërishtes qendrore që përfshin Krujën, Matin, Mirditën, Lurën, Lumën, Peshkopinë, Dibrën, Gostivarin, Tetovën, Kërçovën, Prilepin, Krushevën, të folmet gege të Strugës, Shkupin e Kumanovën kanë zhvilluar disa risi (inovacione) fonetike, si: diftongimin e zanoreve të theksuara [i, u] në pozicione të caktuara fonetike; zhbuzorëzimin e [y]-së në [i] e më pas shpërbërjen e saj në diftongje dytësore; qiellzorizimin e [g]-së në [gj] (*go:j* > *gjo:j*, *gisht* > *gjisht*, *gojë* > *gjo:j*, *gatuj* > *gjatu:j*, *magar* > *magjar* etj.).

Zanorja /y/ ruhet në të folmen e Rekës së Epërme, në të folmet shqipe të Prilepit e Krushevës (me dallim se në këto të folme /y/-ja shpeshherë diftongohet, bile edhe në pozitë nistore, në [ây]: *âyll* (< *yll*), *âymër* (< *ymër*), *sây* (< *sy*) etj.<sup>156</sup>

Ruajtjen e /y/-së mund ta dëshmojmë me shumë fjalë, si: *dy, syni, fryni, aty, dy, zhdryp* (< *zbrit*), *pyes, dylber, bylbyl, synet*, çobani *hypën* mbrenda (< *hyni, hyri brenda*), e ka *mbyttun, i py:tka* (< *i pyetka*), e ka *pyjtun*

<sup>156</sup> Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005, f. 78.

(< e ka pyetun), *u kthye kan* (< u kthye kan), *u rrukullyka* (< u rrokulliska), *ta fyti kryt* (< ta fus kryet), kan botun me *tybe* (< kan ba tybe, janë betuar) etj.

## 5. Nuk i diftongon zanoret e ngritjes së lartë /i, u/ në rrokje të theksuar

Përgjithësisht diftongimi ka përfshirë pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes qendrore. Nuk diftongohen zanoret e mbyllura [i, u] as në fshatrat shqipe të Krushevës: Presill, Nerovë dhe Alldance, ndërsa diftongohet në të folmet e tjera të Prilepit e të Krushevës (me përjashtim të të ardhurve nga Jabollçishta dhe Sjenica (Sanxhaku). Të folmet e disa fshatrave të Shkupit, përkatësisht fshatrat Gërçec, Nerez, Krushopek, Setapetkë, Jabollcë, Patishka Rekë, Černivor, Jabollçishtë e Poshtme dhe Jabollçishtë e Epërme nuk kemi diftongim dhe ruhet relativisht mirë [y]-ja.<sup>157</sup>

Përdoren me [i] të pashpërbërë fjalët *shpi, rri, rrit, nip, ti, trim* etj., të cilat në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore rëndom dalin në formë të diftonguar, si variante fonetike të fonemës /i/; si edhe me /u/ fjalët *aru:sh, shu:m, nuse* etj. Rastet me forma të diftonguara janë shumë të rralla, si *shtâi* (< shti).

## 6. Ka një shkallë shumë të lartë këmbimi ndërmjet zanoresh

E folmja e Rekës së Epërme ka një shkallë më të lartë këmbimi ndërmjet zanoresh sesa të folmet e tjera të gegërishtes qendrore dhe të folmet e tjera shqipe. Shndërrime më të shpeshta zanoresh janë:

a) **Buzorëzimi i plotë** i [a]-së në [o]: *jom* (< jam), *akshom* (< aksham), *thonun* (< thanun), *osht* (< ashtë), *tombël* (< tambël); *njo, nji* (< nja, ni), *nona* (< nana), *me dhombët* (< me dhambët), *ma hongri uki* (< ma hanger ujku), *e ka lonun* (< e ka lanun), *moz* (< maz, mëz), *kom* (< kam), *hon* (< han, ha), *ngron* (< ngran), *do boheshin* (< do të baheshin), *njoni* (< njani), *njonen* (< njanen), *jo:n* (< janë), *ho:n* (< hanë, hënë), *rona* (< rana), *zo:n* (< zanë, zënë), *kan lon* (< kanë lanë), *mo* (< ma), *flonz* (flanz), *mona* (< mana) etj.

b) **Zhbuzorëzimi** [o]-së në [a]: E folmja e Rekës së Epërme në sistemin zanor shquhet edhe për dukurinë fonetike të shndërrimit të [o]-së në [a]. Në të folmet e gegërishtes qendrore si dhe në të folmet e tjera shqipe kjo dukuri është shumë e rrallë, ndërsa në këtë të folme paraqitet shumë.

Në këtë areal gjuhësor pjesëzat *do + të* shkrihen në *da*, sipas tipit: *da marrësh, da vdese, da shkaj* (< do të shkoj) etj. Pjesëza *da* (< do të), përveç në të folmen e Rekës së Epërme del edhe në të folmet e Mallakastrës,<sup>158</sup> të

<sup>157</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997, f. 33-35.

<sup>158</sup> Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1998, f. 88.

Tuhinit të Kërçovës,<sup>159</sup> të Prilepit e të Krushevës,<sup>160</sup> e të Karshiakës.<sup>161</sup>

Me anë të përngjashmimit (asimilimit) ose të shpërngjashmimit (disimilimit) paravajtës a prapavajtës të tingujve [o]-ja këmbehet me [a]-në edhe në shumë fjalë të tjera, si: *aja* (< ajo), *a bu:rr* (< o burr), *shkan* (< shkon), ku *shkan* (< ku shkon), *t'shkajm* (< të shkojmë), e *parasiten* (< e porositën), *pa:sht* (< poshtë), *sante* (< sonte), *pqat* (< plot), *çaban* (< çoban, bari), *akolla* (< okolla), *zatni* (< zotni), *kalib* (< kolibe), *t'kindajsh* (< të këndosh), *a moter* (< oj motër), *ngja* (< ngjo, dëgjo, ngo) etj.

Të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut kanë tërhequr vëmendjen e disa studiuesve të huaj dhe vendës. Por, puna në studimet dialektore duhet vazhduar edhe më tej. Mbledhja dhe botimi i leksikut dialektor paraqet një nga detyrat e rëndësishme dhe të ngutshme të albanologjisë, sepse thesari leksikor gjithnjë e më shumë po bjerret a po zhduket, po humbin format dhe kuptimet e vjetra të fjalëve e një ditë mund të treten fare pa lënë gjurmë.

Pa mohuar rezultatet e arritura deri më tani në studimin e të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut, me këtë edhe ndihmesën e studiuesve të Maqedonisë së Veriut në fushën e dialektologjisë shqiptare, mendojmë se në të ardhmen duhet të shtrohen detyra të tjera më të mëdha: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, por duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm.

E folmja shqipe e Rekës së Epërme dallohet nga të gjitha të folmet e tjera shqipe si për ruajtjen e formave arkaike, ashtu edhe për inovacionet e saj. Ajo është një xhevahir i rrallë gjuhësor i shqipes. Si e tillë, studimi i pasurisë materiale e shpirtërore e rekasve duhet vazhduar edhe më tej.

### Literatura:

Bageri, Josif, *Kopësht malsori*, Sofje, 1910.

Basha, Naim, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

Beci, Bahri, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSH, SShSh, 1962/2, 1963/3.

Beci, Bahri, *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme*, Konferenca I e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965.

Beci, Bahri, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994.

Berani, Shaqir, *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988.

<sup>159</sup> Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 41.

<sup>160</sup> Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005, f. 152.

<sup>161</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997, f. 34.

- Gjinari, Jorgji, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1998.
- Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005; 2011.
- Hamiti, Asllan, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Haruni, Sefedin, *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.
- Haruni, Sejfedin, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.
- Ibrahimi, Mustafa, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005.
- Ibrahimi, Mustafa, *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2007.
- Murati, Qemal, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.
- Murati, Qemal, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*, Logos-A, Shkup, 2003.
- Murati, Qemal, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.
- Nesimi, Remzi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.
- Nesimi, Remzi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Nesimi, Remzi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.
- Qamili, Ajten, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)* (disertacioni doktorati në dorëshkrim), Shkup, 2012.
- Reçani, Fehim, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Sulejmani, Fadil, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Skok, Petar, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Tagliavini, Carlo, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Ymeri, Haki, *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore* (shikuar sipas së folmes shqipe të Markova-Rekës), Jehona 3, Shkup, 1994.
- Ymeri, Haki, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997.

## 10. MIKROTOPONIMET DHE ANTROPONIMET E KATUNDIT GOSHINCË TË KUMANOVËS

### Përmbledhje

Goshinca është katund malor i Karadakut i banuar vetëm me shqiptarë, që shtrihet në lartësi mbidetare prej 900 deri më 1.100 m, afër zonës kufitare të Maqedonisë së Veriut me Kosovën, rreth 27 km larg Kumanovës.

Fusha e onomastikës ofron dhe do të ofrojë brumë gjuhësor me peshë të madhe për studimin e historisë së shqiptarëve e të gjuhës shqipe.

Në këtë kumesë do të shqyrtojmë emrat e vendeve të vogla dhe emrat e njerëzve të këtij katundi. Do të përpiqemi të përcaktojmë etimologjinë e tyre si dhe të shpjegojmë ata nga pikëpamja fonetike-fonologjike, morfologjike e fjalëformuese, mbështetur në praktikën e deritashme. Në toponiminë e këtij fshati mënyra kryesore e emërtimit të vendeve të vogla ka karakter universal.

Nga analiza etimologjike e materialit mikroponimik të këtij katundi malor kemi konstatuar se mbizotërojnë emërvendet me prejardhje nga shqipja, të tipit *Ara La:rg, Lugi Shkozave, Rrezja Lugjeve, Kodra e Birave, Guri Bardh, Guri Shipes, Mullini Katunit, Kroi Ftoft, Lamna:jt* etj., ndërsa më pak mikrotoponime me etimologji joshqipe, si *Stanica, Stanet e Abazve, Vrella Nuhis*. Nga 96 mikrotoponime, vetëm 10-15 janë me etimologji joshqipe. Emërvendet e shumta me origjinë ilire-shqiptare janë edhe një dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë në rrjedhë të kohës. .

Emrat vetjakë të goshincasve mund të klasifikohen në dy grupe të mëdha: a) *emra me burim vendës* (ilire dhe shqiptarë: *Alban, Teuta,...*), që janë më të kufizuar dhe b) *emra me burim të huaj* (me burim fetar islamë: *Shefki, Hetem,...*), që janë më të shumtë.

**Fjalët çelës:** mikrotoponim, antroponim, etimologji, vazhdimësi, autoktoni

Hulumtimet onomastike janë të rëndësishme sidomos për studimin historik të tipareve kulturore e gjuhësore të popujve. Në mungesë të dokumenteve të shkruara, onomastika mbetet si “arkiv gojor” i historisë dhe i lashtësisë së kulturës shqiptare në hapësirën ballkanike. Emrat e vendeve dhe të njerëzve përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojnë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara. Në këtë vështrim, onomastika e një vendi duhet parë si një histori e pashkruar e popullit. Fusha e onomastikës ofron dhe do të ofrojë brumë gjuhësor me peshë të madhe për studimin e historisë së shqiptarëve e të gjuhës shqipe, si gjuhë e njërit prej popujve më të moçëm të Ballkanit, por e dëshmuar me shkrim relativisht vonë.

*Historia e trazuar e Ballkanit*, që karakterizohet me ndërrim të shpeshtë të pamjes etnike e fetare, me administrim në gjuhë të huaja etj., *pasqyrohet edhe në onomastikën e tij*. Rrjedhimisht, onomastika e Ballkanit është shumë e larmishme: aty gjejmë emra të përveçëm me etimologji ilire-shqiptare, trake, latine, greke, sllave, turke, vllehe e nga ndonjë gjuhë tjetër. Krahas këtyre, ka edhe emra me forma të ndryshuara gjatë shekujve, të përkthyer a të kalkuara, shpeshherë edhe të riemërtuara; emra me forma të përziera (hibride) nga dy e më tepër gjuhë etj.

Emrat e vendeve dhe emrat e familjeve për historinë e një populli janë arkiv i vërtetë i tij, i shtresuar palë- palë gjatë mijëvjeçarësh të ndryshëm. Toponimet (emrat e viseve), antroponimet (emrat e njerëzve) dhe patronimet (emrat familjarë) kanë një rëndësi të veçantë, sidomos për gjuhësinë dhe për etnologjinë shqiptare, për të dëshmuar vazhdimësinë ilire të popullit shqiptar. Rezultatet e arritura nga studimet onomastike arrijnë të ndriçojnë edhe periudhat e mugëta para shkrimit të shqipes, ndonjëherë edhe ato epoka për të cilat mungojnë të dhënat historike, etnografike, gjeografike, arkeologjike etj.

Në pjesën perëndimore të qytetit, rrëzë maleve të Karadakut shtrihet një numër i madh i fshatrave të banuara kryesisht me popullsi shqiptare. Malet e larta përreth dhe fusha e gjerë pjellore i japin një pamje të bukur dhe tërheqëse këtij rajoni.

Ky territor para ardhjes së sllavëve në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik, dihet mirë se i ka takuar Dardanisë e banuar nga fisi ilir Dardanët.

Katundi është ndër vendbanimet më të mëdha malore në këtë krahinë me shtëpi të tipit të dendur. Goshunca është vendbanim shqiptar i vjetër që në dokumentet arkivore e gjejmë të regjistruar që nga shekulli XIV (1381).

Sikur nga trevat e tjera të banuara me shqiptarë, edhe nga rajoni i Kumanovës ka pasur shpërngulje të mëdha të popullsisë. Më të vrullshme ishin shpërnguljet në Turqi në periudhën 1953-1968, por edhe pas luftës së armatosur në Maqedoni më vitin 2001, duke zbritur nga malësia në qytetet e afërta, veçmas në Kumanovë e në Shkup. Goshinca në vitin 1948 kishte 631 banorë, por edhe pas 40 vitesh, përkatësisht sipas regjistrimit të vitit 1994, numri i banorëve mbeti pothuajse i pandryshuar, 650 banorë. Më vonë pati migrim në masë të popullsisë dhe tani në katund kanë mbetur vetëm pak banorë rezidentë.

Nga zona e këtij katundi kemi arritur të shënojmë afro 100 toponime, përkatësisht 96 sosh:

- **Ara Larg** - arë që gjendet rreth 1 km larg fshatit.

- **Ara Beramit** - arë, pronë e Beramit (< Bajramit), emërtim sipas antroponimit Bajram.
- **Ara Dranafilit** - arë ku rritet shumë trëndafil i egër.
- **Ara Furrës** - tani vend, dikur arë ku kishte një furrë për të pjekur tullat dhe tjegullat.
- **Ara Kamerit** - një arë në pronësi të Kamberit.
- **Ara Agushit** - sipas emrit vetanak Agush.
- **Ara Madhe** - arë me sipërfaqe të madhe.
- **Ara Mretit** - arë që mbillej me bimë drithore për ta paguar haraçin (taksën) në kohën e perandorisë osmane. Siç dihet, haraçi është taksë e veçantë që jepte në të holla ose në natyrë popullsia jomuslimane gjatë kohës së pushtimit osman.
- **Ara Nurës** - ara e Nurës, pronë e Nurës < formë e cinguar e emrit Nuredin.
- **Ara Zahës** - arë, pronë e Zahës < Zahirit.
- **Arat e Bekteshve** - prona të familjes Bekteshi.
- **Arat e Idrizve** - prona të familjes Idrizi.
- **Arat e Zimerve** - prona të familjes Zymberi.
- **Batllaki Musajve** - vend moçalik i familjes Musaj.
- **Çafa Lugit Shelxhes** - luginë në mal që kishte pamje si të qafës, i pasur me dru shelgjesh.
- **Gropa Maxhupve** - vend ku në të kaluarën romët kanë prerë dhe pjekur tulla. Në të folmen e kësaj treve llagapi maxhup (jevg) përdoret edhe sot me kuptim emërtimit të romëve.
- **Guri Ademit** - gur që ka marrë emrin sipas antroponimit Adem.
- **Guri Bardh** - kodër me gurë të bardhë.
- **Guri Gat** - shkëmb i gjatë, në formë të kepit.
- **Guri Keç** - gjendet në skaj të fshatit, ka formë të keqe, të parregullt.
- **Guri Misinit** - është një gur i madh, banorët e sotëm të këtij katundi nuk mbajnë mend kush ishte Misini.
- **Guri Perzhalit Mullinit** - gur i madh në bjeshkë, gjendej afër mullirit të djegur.
- **Guri Shipes** - shkëmb ku me shekuj kanë pasur folenë dy shqiponja.
- **Guri Zi** - shkëmb në mal që ka ngjyrë të zezë.
- **Gurra** - burim që gjendet afër lagjes Llukarë.
- **Gurt e Kerçës** - një kurriz gurësh të ashpër, të thepisur.
- **Gurzina** - vend guror.
- **Kodra Birave** - vend guror me shumë vrime të mëdha.
- **Kodra Rekve** - vend në bjeshkë, pronë e lagjes Rekaj.
- **Kopilaça** - mal i shpeshtë, i dendur. Banorët e Karadakut e kanë quajtur këtë vend malor kështu për shkak se aty paskan lindur e jetuar disa kopila. Siç dihet, fjala *kopil* ka kuptimin fëmijë mashkull i lindur jashtë martese. Kjo topolekseme është mjaft e përhapur në

gjithë Ballkanin. Në gjuhët sllave del me rrjedhoja të shumta, si kopil (mashkull), kopilicë (femër), Kopila:ç (vend kopilash).

- **Koçinat** - vend dhishë (cjav që ka një bri të thyer).
- **Kroni Babxhishit** - burim që e kishte rregulluar një babagjysh (babai i ndonjë vajze të martuar në Goshincë) i lagjes së Hasanajve.
- **Kroni Katunit** - krua prej ku janë furnizuar me ujë të pijshëm shumica e katundarëve.
- **Kroni Murtezit** - krua i Murtezit e i familjes së tij.
- **Kroni Shahes** - burim që e ka ndërtuar një grua me emrin Shahide.
- **Ku Ka Cof Konora** - vend në bjeshkë ku ka ngordhë një dhi, që mbante këmbanë në qafë.
- **Lamnajt** - vend ku goshincasit kanë pasë lamët (lëmët), ku kanë bërë shirjen e drithërave.
- **Lisi n'Kodër** - një lis i madh që gjendej në një kodër, si edhe kodra e lisit.
- **Livadhi Demloshes** - emërtim sipas emrit Adem dhe apelativit *loshë*, ku përdoret edhe si mbiemër familjar shqiptar Loshi/Lloshi.
- **Livadhi Karamanit** - livadh që gjendet në mes të malit Kopilaçë, që është emërtuar sipas apelativit karaman.
- **Livadhi Rrash** - sipas konfiguracionit të tokës që kishte livadhi, livadh i rrafshët, i sheshtë.
- **Livadhi Tafilit** - livadh që gjendet në pjesën e epërme të fshatit, ishte pronë e Tafilit.
- **Llazov** - rrah, rrugë e hapur në mal, shteg, kapërcyell.
- **Lugi Fâirit** - lug me shumë fier.
- **Lugi Gropave** - lugajë me vende të ulëta të tokës, me gropa.
- **Lugi Mollës** - lugajë e pasur me molla.
- **Lugi Pernarit** - vend malor ku rritet një lloj druri i quajtur *përnar* (lloj dushku me trung dy- tre metra të lartë dhe me gjethe të vogla me gjemba anëse e gjithmonë të gjelbra).
- **Lugi Shelxhes** - lugajë ku janë rritur shëlgjet.
- **Lugi Shkozave** - luginë e pasur me dru shkoze.
- **Lugi Thanës** - lugajë e pasur me dru thane (thana është shkurre, me dru të fortë e me gjethe të ashpra, që bën kokrra të kuqe e me shije të athët).
- **Lugi Therrës** - lëndinë e mbushur me shkurre e ferra të ndryshme.
- **Lugi Xhan** - luginë e gjerë.
- **Maja** - është kodra më e lartë në Llukarë (mëhallë e Goshincës), maja më e lartë e bjeshkës.
- **Meraja** - kullotë e përbashkët e fshatit, djerrinë, livadh.
- **Mullini Bekteshit** - mulli i familjes Bekteshi.



- **Mullini Katunit** - mulli i përbashkët për të gjithë fshatarët, aty bluanin gjithë katundi.
- Në të folmen e kësaj treve përdoret leksema *cof*, *coftinë* = ngordh, ngordhësirë.
- **Pemët** - vend që gjendet në afërsi të lagjes së Hazizve dhe i pasur me trupa të pemëve: mollë, qersh dhe dardha.
- Përdoret edhe si antroponim mesjetar shqiptar *Stepan/i*, i cili në gjysmën e parë të shek. XV shfaqet në anën e Novëbërdës si *Stepan Bili* dhe në Karaçicë të Drenicës –*Stepani* i biri i Arbanasit.
- **Plemja Selamit** - plevicë, kasolle ku Selami mbante ushqimin e bagëtive gjatë dimrit.
- **Prroi Llugave** - përrua i thatë me shkurre të ndryshme.
- **Pusat** - vend në mal me disa pusa.
- **Pusi Shqerrave** - vend ku blegtorët i lanin shtjerrat, qengjat para qethjes. Forma e emrit shqerrë është përfutur nga forma shtjerrë, nëpërnjet qiellzorëzimit të grupit bashkëtingëllor [tj] në [q].
- **Reka Madhe** - vend ku takohen (bashkohen) përroi i Goshincës dhe përroi i Brezës, pra Lum i Madh.
- **Roga Cungit Zi** - djerrinë ku ka patur një cung të djegur. Emri *cung* edhe te banorët e këtij katundi ka kuptimin si edhe në shqipen standarde: pjesa e trungut a e kërcellit, që mbetet në tokë kur presim një dru a një bimë me kërcell të trashë; kërcu, kërcëp.
- **Roga Demirit** - lëndinë me bar e një faqe mali, pronë e Demirit.
- **Roga Ga:t** - sipas gjatësisë që kishte kjo lëndinë mes dy faqeve të malit.
- **Roga Hasanit** - lëndinë me bar në mes të pyllit, ishte pronë e Hasanit. Fjala *rogë* kuptohet si lëndinë me bar në mes të pyllit, lirishtë; vend i zhveshur në mes të pyllit; lëndinë me bar në një faqe mali.
- **Roga Madhe** - lëndinë me një sipërfaqe të madhe.
- **Roga Nermeme** - lëndinë me bar mes dy anëve të malit, rogë e ndërmjetme.
- **Rrafsha** - tokë e punueshme që është e rrafshët.
- **Rrafshat e Durrës** - vend i rrafshët në bjeshkë, pronë e familjes Durra.
- **Rrahishte** - fjala *rrah* në shqipen ka kuptimin tokë buke a kullotë, që hapet në pyll duke prerë drurët e shkurret ose duke i djegur. Mikrotoponimi *Rrahishte* duhet të jetë krijuar nga rrënja *rrah* + prapashtesa *ishte* > rrahishte.
- **Rrasat e Xhemës** - vend ku Xhemaili kishte nxjerrë rrasa gurësh për ta mbuluar shtëpinë. Dihet se dikur çatitë e shtëpive i mbulonin me rrasa gurësh e shumë më vonë me tjegulla.
- **Rrethi Shkallës** - vend guror në formë të shkallëve rrethore.

- **Rrezja Lugjeve** - vend që e kapin rrezet e diellit dhe gjendet pranë disa përrenjve.
- **Rrumullaket** - vend në kodër në formë të rrumbullakët.
- **Shpati Llukarit** - vend malor në rrëzë të Llukarës.
- **Shpella Kaurit** - shpellë ku në kohën e sundimit Osman është strehuar një sllav, kaurr – emër përbuzës për sllavët.
- **Stanet e Dinve** – tëbanat e familjes së Dinajve.
- **Stanet e Hazizve** - tëbanat e lagjes së Hazizve (Azizve).
- **Stanet e Murtezve** - tëbanat e lagjes së Murtezve. Kasolle e vogël që ngrenë barinj të në stanet ku bjeshkojnë; vatha e dhenve gjatë verimit të tyre në bjeshkë; bun; kasolle e familjes Murtezi.
- **Stanet e Selmanve** - vend ku i ka mbajtur bagëtitë familja Selmani. Edhe në të folmen e Goshincës emri *stan* e ka kuptimin: vend me vathë e me kasolle për bagëtitë, për barinj të për bulmetin, i ngritur në mal për verë ose në vërrin për dimër.
- **Stani Ademit** - vend i ngritur në mal për verë ose në vërrin për dimër larg shtëpive ku mbante Ademi bagëtinë.
- **Stanica** - vend në bjeshkë, postbllok ku në kohën e mbretërisë Jugosllave ishin të stacionuar xhandarmëria serbe. Fjala *stani:c* (< stanicë) është sllavizëm që ka përhapje të gjerë në gjithë të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë e Preshevë, Bujanovc ka kuptimin stacion (autobusi, treni), po edhe pikë a postbllok policor.
- **Stepanc** - vend i gjërë fushor pa drunj, me bimësi të varfër barishtore dhe klimë të thatë.
- **Te barakat** - në këtë vend më parë banonin pylltarët, që ruanin pyllin dhe kujdeseshin për të, kujdestar a rojë të malit Kopilaçë; kurse sot në këtë vend gjendet karakolla e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në Fjalorin Elektronik Shpjegues fjala *barakë* shpjegohet me kuptimin “ndërtesë e thjeshtë njëkatëshe, zakonisht e bërë me dërrasa ose me lëndë të tjera të lehta, që shërben si fjetore, si dyqan, si depo, për zyra etj.”
- **Te Brīja** - konfiguracion tokësor i thepisur e i gjatë në afërsi të fshatit; i dalë e i dallueshëm mbi sipërfaqen e tokës si brinjët e kafshëve të dobëta, që janë jo të majme, që janë asht e lëkurë.
- **Te Laj Po:sht** - burim që ka qenë poshtë lagjes së Rekejve.
- **Te Laj Senit** - Në FESH fjala *cem* m. sh. ka kuptimin “përrua malor me ujë shumë të ftohtë e të kulluar. Cema e kroje.” Ky mikrotoponim i ruajtur deri më sot në këtë formë *Sen*, në rasën gjinore *Sen-it*; ka shumë të ngjarë të jetë përfutur me ndërrime fonetike nga forma e mëparshme *Cem* në *Sen* nëpërmjet ndërrimit të [c] > [s] dhe të [m] > [n]: Cem > Sen. Ndërrimet e tilla të tingujve janë të njohur jo vetëm në të folmet e kësaj krahine, por edhe në mbarë shqipen dialektore.

- **Te Xhollt** - vend në afërsi të fshatit, ku i kanë kripur bagëtitë. Edhe në këtë të folme, si edhe në FESH fjala *gjollë* (në Goshincë: xho:ll, gjollë) ka kuptimin “rrasë ku vihet kripa për ta ngrënë bagëtia; vend i thatë e gurishtë, ku shpien zakonisht bagëtinë për t'i dhënë kripë”.
- **Tërlla Ajetit** - vathë e Ajetit, aty ku e mbante Ajeti bagëtinë. Emri *tërll* është sllavizëm (трл-а) i përhapur në të gjitha të folmet shqipe në ish-Jugosllavi. Në FESH fjala *vathë* shpjegohet me kuptimin: “vend i rrethuar me gardh në një shesh të hapët, ku rrinë bagëtia në verë; vend i rrethuar me lesa në një arë, ku mbajnë dhentë natën për ta plehëruar; tufa e dhenve a e bagëtive të gardhuara në një vend të tillë”.
- **Therrat** - vend afër lagjes së Selmanve, më herët kishte qenë lëndinë me ferra të ndryshme, tani është bërë tokë e pjellore.
- **Tupani** - tupan ka kuptimin daulle, lodër. Ky mikrotoponim përdoret për të emërtuar një lëndinë në maje të kodrës, midis Goshincës e mjaft afër fshatit Stançiq (ky katund malor gjendet në Karadakun e Gjilanit, Kosovë, shumë afër kufirit Kosovë – Maqedoni e Veriut. Banorët e Stançiqit shquheshin për valltarë të mirë. Këtu shpesh kanë rënë tupanat dhe kanë vallëzuar burrat e dy fshatrave (të Goshincës e të Stançiqit).
- **Vija Hajrës** - hulli uji që është emërtuar sipas emrit vetjak Hajredin.
- **Vrella** - burim me shumë ujë që del nga toka me vrull, me gurgullimë ku janë furnizuar me ujë të pijshëm një pjesë e fshatit.
- **Vrella Nuhi** - livadh i familjes Nuhiu, që në të ka një burim të fuqishëm uji. Tani me këtë mikrotoponim nënkuptohet si burimi ashtu edhe livadhi.
- **Vrella Qahilit** - burim me sasi të madhe uji që e ka hapur Qahili.

Dukuri e përgjithshme për të gjitha gjuhët e botës është se toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe burojnë kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativa).

Në toponiminë shqiptare, përfshirë edhe në atë të rajonit të Kumanovës e të Goshincës, mënyra kryesore e emërtimit të viseve ka karakter universal. Aty dallohen:

1) Emërtime vendesh që shprehin ngjyrën, përbërjen e tokës dhe sipas ndonjë specifike tjetër: *Guri Bardh, Rrumllakët, Rrethi Shkallës, Kroj Ftoft, Lugi Gropave, Livadhi Rrafsh*.

2) Toponime që përmbajnë emra të bimëve, drunjve, shkurreve dhe kulturave bimore që rriten ose janë rritur në të kaluarën: *Roga Cungit Zi, Lugi Thanës, Lugi Therrës, Lugi Mollës, Therra, Lugi Fajrit, Pemët, Livadhet, Ara Tranafililit* etj.

3) Toponime që përmbajnë emra shpezësh a kafshësh, si: *Guri Shipes, Pusi Shqerrave*.

4) Sipas antroponimeve e patronimeve: *Roga Demirit, Tërlla Ajetit, Livadhi Gjurës, Guri Ademit, Plemja Selamit, Mullini Bekteshit, Kroi Murtezit, Kroni Shahës, Ara Nurës, Vija Hajrës, Vrella Qahilit, Roga Hasanit, Stani Ademit, Ara Agushit, Stanet e Selmanve, Stanet e Demirve* etj.

5) Sipas emrit të objekteve të ndërtuara në ato vende, shumica të shkatërruara tërësisht duke mos lënë asnjë gjurmë, pos emrit që ruan ai vend edhe sot e kësaj dite: *Gropa Maxhupve* (tokë argjilore ku në të kaluarën disa romë kanë prerë dhe pjekur tulla e tjegulla), *Ara Furrës* (vend ku në të kaluarën fshatarët piqnin tulla dhe tjegulla), *Rrasat e Xhemës* (vend ku Xhemaili në të kaluarën kishte nxjerrë rrasa guri për ta mbuluar shtëpinë), *Stanica* (postbllok ku në kohën e mbretërisë jugosllave ishin stacionuar xhandarmëria serbe), *Te Barakat* (në këtë vend më parë banonin pylltarët, rojtarët e malit Kopilaçë, kurse sot kemi karakollën e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut), *Shpella Kaurrit* (shpellë në të cilën në kohën e perandorisë osmane është fshehur për një kohë një sllav) etj.

### **Etimologjia e mikrotoponimeve**

Nga vëzhgimi etimologjik e mikrotoponimeve të katundit Goshincë të Kumanovës kemi konstatuar se mbizotërojnë emërvendet me prejardhje nga shqipja, të tipit *Ara La:rg, Lugi Shkozave, Rrezja Lugjeve, Kodra Birave, Guri Bardh, Guri Shipes, Mullini Katunit, Kroi Ftoft, Lamna:jt* etj., ndërsa më pak mikrotoponime me etimologji joshqipe, si fjalët sllave stanicë - *Stanica, stan* - shqip tëban: *Stanet e Abazve, e Murtezve, e Dinve, e Hazizve; barakë - Te Barakat, vrellë - shq. burim: Vrella Nuhi:s, Vrella Qahilit; pleme (plevicë): Plemja Selamit, batllak - moçal: Batllaki Musajve; tërll/a - vathë: Tërlla Ajetit; përzhalit, përzhit - skuq, fërgoj, djeg, shkrumoj: Guri Perzhalit Mullinit; orientale: meraj: Meraja.*

Nga 96 mikrotoponime, vetëm 10-15 janë me etimologji joshqipe. Emërvendet e shumta (nga 96), 80 sosh me origjinë ilire-shqiptare janë edhe një dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë në rrjedhë të kohës.

### **Mënyra e fjalëformimit të mikrotoponimeve**

Sipas mënyrës së fjalëformimit këtu dallojmë emra të parmë dhe emra të prejardhur.

*Toponime të parmë* (rrënjorë) janë: *Mera-ja, Rreth-i, Maj-a, Pemë-t, Therr-at, Gurr-a, Tupan, Lam-naja, Livadh-et, Rrez-ja, Vrell-a, Rrafsh-a, Lug-i, Pus-at* etj.

*Toponime të prejardhura*, me prapashtesim: - ina: *Gurzina*; - ishte: *Rrahishte*; -icë: *Stranica*; -llak: *Batllak*; -ov: *Llaz-ov* etj.

## Struktura gramatikore e mikrotoponimeve

Emërtimet me togfjalësha në mikrotoponiminë e Goshincës, si edhe në treva të tjera, janë të rëndomtë. Kjo formë e ndërtimit mbizotëron krahasuar me ndërtimin me fjalë të parme dhe të prejardhura. Më të shpeshta janë mikrotiponimet **emër + përcaktor**, që mund të jenë:

a) **emër + emër personal** në rasën gjinore: që të dy elementet e togfjalëshit janë në njëjës in e shquar, me çrast emri i dytë në rasën gjinore shënon pronarin: *Roga Demirit, Tërlla Ajetit, Livadhi Gjurës, Guri Ademit, Guri Misimit, Plemja Selamit, Mullini Bekteshit, Kroi Murtezit, Ara Zahës, Ara Nurës, Kroni Babxhishit, Vija Hajrës, Roga Hasanit, Ara Beramit, Livadhi Karamanit* etj.

Përveç këtyre emërtimeve në numrin njëjës, gjejmë edhe emërvende në shumës, si *Stanet e Selmanve, Arat e Bekteshve, Arat e Idrizve, Batllaki Musajve* etj.

b) **emër + mbiemër** që tregon ngjyrën, madhësinë, formën madhësi, pozitë, largësi ose ndonjë veçori tjetër, si: *Livadhi Rrafsh, Lugi Fâirit, Lugi Gropave, Lugi Xha:n, Lugi Therrës, Pusi Shqerrave, Reka Madhe, Roga Cungit Zi, Kroi Ftoft, Ara Furrës, Guri Ba:rdh, Gropa Maxhupve, Lisi n’Kodër, Guri Ga:t, Guri Keç, Ara Madhe, Guri Shipes, Kodra Birave, Lugi Mollës, Roga Madhe, Ara Larg* etj.

c) I pranishëm është edhe konstrukti me parafjalën **te + emër**: *Te Brija, Te Xholli, Te Barakat* etj.

## Tiparet fonetike të mikrotoponimeve

Nga pikëpamja fonetike, në toponiminë e Goshincës na dalin këto veçori:

Zanorja e theksuar /i/ si në të folmen ashtu edhe në toponiminë e hershme të këtij fshati (< Lugi i Fierit), është diftonguar në [âi]: *Lugi Fâirit*, ndërsa në toponimet më të vonshme të burimit sllav, si te *Stanica* /i/-ja ruhet e padiftonguar.

Zhbuzorëzimi i /y/- së në /i/ është dukuri mjaft e përhapur në të folmet e gegërishtes qendrore. Kjo hetohet në të folmen dhe në toponiminë e Goshincës, si p.sh.: *Kroni Babxhishit* (< Kroni i Babgjyshit, Kroni i Babagjyshit).

Përdorimi i shumëdrdhëses /rr/: *Rrahishte, Rrafsha, Pusi Shqerrave, Lugi Therrës, Rrezja lugjeve, Shpella Kaurrit, Përroi Llugave* etj.

Për shkak të ekonomizimit dhe lehtësimit të shqiptimit, në mbarë leksikon toponomastik të rajonit të Kumanovës shfaqet elizioni, përkatësisht mosqiptimi i nyjave të përparme *i* dhe *e* të emrave në rasën gjinore e të mbiemrave, sipas tipit *Lugi Mollës* (< Lugi i Mollës), *Guri Shipes* (< Guri i Shqipes, Shqiponjës), *Ara Larg* (< Ara e Largët), *Roga Madhe* (< Roga e Madhe) etj.

Dukuri e përgjithshme fonetike e gegërishtes veriore është afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh]. Kjo shprehi nyjëtimore shfaqet edhe në em;rvendet e vogla të Goshincës, si *Guri Keç* (< Guri i Keq), *Lugi Shelçës* (< Lugi i Shelqës), *Kroni Babxhishit* (< Kroni i Babgjyshit), *Lugi Xhã:n* (< Lugi i Gjãnë, i gjerë).

Grupi [je] përngjashmohet në [e], si *Roga Nermeme* (< Roga e Ndërmjetme, Ndërmjeme).

Grupi i bashkëtingëlloreve [mb, nd] përngjashmohen në [m, n]: *Ara Mretit* (< Ara e Mbretit), *Rrumllakët* (< Rrumbullakët), *Kroni Katunit* (< Kroni i Katundit), *Ara Kamerit* (< Ara e Kamberit), *Arat e Zimerve* (< Arat e Zymberve).

Në dallim nga shumica e të folmeve të gegërishtes qendrore që [g]-në e qiellzorëzojnë në [gj], në toponiminë e fshatit në fjalë /g/-ja ruhet si e tillë, si duket nën ndikimin e të folmeve të gegërishtes verilindore (kosovarishtes), meqë kufizohet me fshatrat e Kosovës, kanë pasur kontakte të shpeshta si dhe martesë të shumta midis goshincasve dhe fshatrave të afërta të Kosovës. Sipas gjithë gjasash, marrje e dhënie martesore si dhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë kanë ndikuar të ruhet [g]-ja e paqiellzorëzuar edhe në mikrotoponimi, si *Guri Shipes*, *Guri Ademit*, *Guri Keç*, *Guri Gat*, *Guri Bardh*, *Guri Zi*, *Gurzina* (përgjithësisht në gegërishten qendrore *gjuri*, *i gjat*, *gjurzi:n*).

### Antroponimet e fshatit Goshincë

Përgjithësisht, emrat vetjakë të shqiptarëve mund të klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- a) *emra me burim vendës* (ilirë dhe shqiptarë) dhe
- b) *emra me burim të huaj* (kryesisht me burim fetar).

Emri personal dhe i ndonjë vendi është vënë dhe sot e kësaj dite vihet varësisht nga dëshira dhe shija e njeriut, nga besimi fetar, nga mënyra dhe kushtet e jetesës etj. Banorët e Goshincës u përkasin katër fiseve: Krasniq, Gash, Kryezi e Thaç. Nga vëzhgimi etimologjik i emrave vetjakë të goshincasve mund të nxirret përfundimi se ata janë kryesisht të burimit oriental, që lidhen me përkatësinë fetare islame të banorëve, si *Pajazit*, *Arif*, *Memet*, *Hamdi*, *Selman*, *Xhavit*, *Nevzat*, *Ramadan*, *Sinan*, *Osman*, *Ramiz*, *Abedin*, *Talat*, *Shaban*, *Destan*, *Miftar*, *Musa*; *Razie*, *Zarie*, *Fetie*, *Hamide*, *Shefie*, *Mukadeze*, *Sadbere*, *Redife*, *Nurie*, *Zaide*...

Emrat kombëtarë shqiptarë kanë filluar të përdoren më vonë ndër goshincasit, si *Agim*, *Afrim*, *Afërditë*, *Agon*, *Arlind*, *Ardit*, *Bashkim*, *Bekim*, *Betim*, *Besë*, *Bletë*, *Bukurie*, *Driton*, *Ermirë*, *Fatbardhë*, *Fatlum,-e*, *Fatmir*, *Fatos*, *Florie*, *Fisnik*, *Flamur*, *Lirie*, *Meritë*, *Mirditë*, *Urim*, *Uran*, *Valon*, *Vegim*, *Valdet* etj., por pagëzimi i fëmijëve me emra islamë nuk është i rrallë edhe sot e kësaj dite.

Toponimet dhe patronimet për nga prejardhja dhe struktura gjuhësore kanë lidhshmëri të mëdha. Disa emra njerëzish janë vënë në bazë të emrit të vendit dhe anasjelltas, ka raste kur sipas emrit të njeriut është emërtuar vendi. Nga emrat vetjakë dhe format e tyre të ndryshme janë përfutur shumë mbiemra ose emra familjarë. Shumica e prapashtesave janë të përbashkëta, sepse një numër i madh i tyre dalin tek emrat e vendeve, të njerëzve, të grupit etnik, të fiseve etj.

Përveç trajtave të plota, emrat vetjakë në mbarë shqipen shpeshherë përdoren edhe në formën e dytë të cinguar, për shkaqe përkëdhelie dhe për arsye të tjera. Përkëdhelia gjen shprehje të gjerë në marrëdhëniet e prindërve me fëmijët, përgjithësisht të të rriturve me të vegjlit si dhe në mjediset intime, miqësore e shoqërore. Kudo ka pasur (e ka deri sot) një bigëzim formash: zyrtare të shkruara dhe jozyrtare gojore. Trajtat e dyta gojore, që ndonjëherë janë bërë edhe zyrtare, krijohen:

a) për të shmangur emrat e gjatë ose të vështirë për t'u shqiptuar, si *Dan* nga Ramadan, *Taf* nga Mustafa, Mustafë; *Mirt* nga Murtez, *Smajl/Is* nga Ismail, *Re:xh* nga Rexhep, *Fa:t* nga Fatmire apo Fatime; *Shahe* nga Hanumshahe, Shahadije etj.;

b) nga nevoja për të mënjanuar dy emra vetjakë të njëjtë brenda familjes a rrethit të afërm familjar, sidomos kur emrat përsëriteshin nga babai, nëna, gjyshi, gjyshja etj. te pasardhësit (edhe sot besohet se kur nëna lind shumë vajza, duhet njëerës t'ia vejë emrin e vet, që pastaj të lindë djalë, p.sh. e ëma *Fahrie* - bija *Fehrie*; e ëma *Fekrie* - bija *Fikrie*);

c) Dallimi i emrit të fëmijës nga gjyshi ose vënia e ndonjë emri të përçudshëm a të rrallë që ta mbrojë fëmijën nga "syri i keq", si *Nuzi*, *Ajez* etj.

### Literatura:

Baliu, Begzad: *Onomastika e Kosovës* (ndërmjet miteve dhe identiteteve), Prishtinë, 2008.

Doçi, dr. Rexhep: *Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I*, Prishtinë, 1990.

Hamiti, Asllan - Sopaj, Nehas: *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup, 2004.

Idrizi, Xhemaludin: *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.

Ismaili, Mustafa: *Goshinca e Kumanovës* (monografi), Shkup, 1998.

Murati, dr. Qemal: *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Tetovë, 2008.

Shkurtaj, Gjovalin: *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001.

## 11. MIKROTOPONIMET E KATUNDIT BREZË TË MALIT TË ZI TË SHKUPIT

### Shkurtime

Në këtë kumtesë do të shqyrtojmë emrat e vendeve të vogla të fshatit Brezë. Do të përpiqemi të përcaktojmë etimologjinë e tyre si dhe të shpjegojmë ata nga pikëpamja fonetike-fonologjike, morfologjike e fjalëformuese, mbështetur në praktikën e deritashme të shtjellimit. Në toponiminë e këtij fshati mënyra kryesore e emërimit të vendeve të vogla ka karakter universal.

Breza është fshat tipik malor i Malit të Zi të Shkupit, i banuar vetëm me shqiptarë, që shtrihet mbi majat më të larta të Karadakut, afër zonës kufitare të Maqedonisë së Veriut me Kosovën, rreth 40 km larg Shkupit e Kumanovës, por më afër Vitisë, në lartësi mbidetare prej 1.000 deri më 1.650 m.

Përgjithësisht kemi konstatuar se në këtë zonë malore mbizotërojnë emërvendet me prejardhje nga shqipja, të tipit *Ara Nga:t, Ara Madhe, Kroni Katanit, Lugi Mollës, Rrafshina, Guri Zi, Pusi Shqerrave, Mali Shpesh, Lisi Njom* etj., ndërsa më pak mikrotoponime me etimologji joshqipe, si *Stanica, Stanet e Selmanve*. Nga 123 mikrotoponime, vetëm pak sosh janë me etimologji joshqipe. Emërvendet e shumta me origjinë ilire-shqiptare janë edhe një dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë në rrjedhë të kohës.

**Fjalët çelës:** mikrotoponim, etimologji, vazhdimësi, autoktoni

Karadaku është i pasur me bimë barishtore. Përveç barit që përgjithësisht e mbulon këtë krahinë, rritet shumë fieri, hithrat, luleshtrydhja, çaji i malit, kamomili etj. Nga drunjtë rritet ahur, bunge, qarri, shkoza, dëllinja, mështekna, frashri, lajthia, thana etj.

Në pyjet e Karadakut jeton dhelpra, ujku, derri i egër, lepuri, ketri, vjedulla, dreri, ariu etj. Nga shpezët shihen pula e egër, mullizeza, laraska, skifteri, shqiponja, dallëndyshja, qyqja, huti, gjeli i egër, pupëza, turreci, qukapiku, pëllumbi, trumcaku etj.

Klima e ashpër malore kushtëzon ndërtimin e shtëpive të tipit të mbyllur, kryesisht të ndërtuara me gurë. Brenda shtëpisë ose përbri saj shpeshherë kemi edhe oda, ahur, plevicë, garazh ose ndonjë objekt tjetër shoqëruar.

Brendësia e shtëpive të dikurshme të fshatrave malore, sidomos e fshatrave Brezë, Malinë e Tanushë është e enterieri i shtëpive të moçme, tradicionale shqiptare. Oxhaku është elementi më i rëndësishëm i brendisë së shtëpisë. Në oda gjejmë dërrasa të mbështetura brinjazi në faqe të murit,



që përdoren si dollap, raftet etj., që shërbejnë për të vënë dhe ruajtur enë të amvisërisë, si gjyma, gota, ibrikë, filxhanë, xhezve, tabaka, ndonjë enë zbukurimi ose edhe diçka të varur në mur, e që të gjitha, përveç anës praktike për përdorim, kanë edhe funksion estetik.

Pranë shtëpive që kanë zënë pozicione të ndryshme në oborr, ndërtohen edhe objekte të tjera bujqësore e blegtorale, si hambar, plevicë (krahinore: pleme), kosh, kotec, garazh ose edhe ndonjë objekt tjetër. Oborret zakonisht janë të rrethuara me material ndërtimor që gjendet në vendin përkatës, më shpesh me gurë e më rrallë me blloqe.

Në të ushqyerit shfrytëzohet çdo gjë që natyra ua dhuron dhe që mund ta sigurojnë nga veprimtaria e tyre themelore - bujqësia e blegtoria. Buka e grurit është ushqimi kryesor dhe themelor i tyre. Konsumohen edhe gatesa të ndryshme nga brumi. Ushqimi plotësohet edhe me mish kafshësh e shpeshësh shtëpiakë, ndonjëherë edhe me mish gjahu, kryesisht mish lepuri, qumësht dhe bulmet. Vend të rëndësishëm në ushqimin e banorëve të Karadakut të Shkupit zë fasulja, patatja dhe orizi. Nga kulturat kopshtare hahen shumë domatet dhe specat. Nga perimet në tryezën e karadakasve servohet shpesh shalqiri, pjepja e luleshtrydhet, ndërsa nga pemët kultivohet e hahet molla, kumbulla, dardha, rrushi etj.

Marrë në përgjithësi, me sundimin pesëshekullor të perandorisë Osmane në Maqedoninë e Veriut, edhe te shqiptarët e Karadakut të Shkupit mbizotëron kultura orientale e kuzhinës. Për shkak të kushteve të vështira për jetesë, migrimi fshat - qytet, apo migrimi nga fshatrat malore në fshatrat fushore është shumë i madh. Valë të tilla të lëvizjes së popullatës nga vendet e larta në vende të rrafshita ka pasur qëmoti, por këto lëvizje u intensifikuan sidomos pas Luftës së Dytë Botërore dhe nuk kanë të ndalur edhe sot.

Breza (maqedonisht: *Бреца/Breca*) është fshat tipik malor me lartësi mbidetare 1.651 metra, 40 km larg Shkupit e Kumanovës. Ajo shtrihet në malet e Karadakut, shumë afër kufirit që ndan Maqedoninë e Veriut me Kosovën, në koordinatat 42° 13' 38" në veri dhe 21° 27' 41" në lindje. I përket tipit të fshatrave me shtëpi të shpërndara.

Vlen të përmendet se ky fshat shtrihet në tri kodra, në sipërfaqe të përgjithshme prej 47.3 km<sup>2</sup>, që ndoshta është edhe fshati me territor më të madh në tërë Maqedoninë e Veriut. Kufizohet me disa fshatra: me Tanushën, me Debelldehun, me Buzovikun, me Lubishten, me Letnicën që gjenden në Kosovë; me Goshincën, me Gllazhnjen, ky i fundit që u mbulua nga ujrat e pendës së Gllazhnjes; Presnicën, pjesë e fshatit Gllazhnje, me Strimën që i takojnë komunës së Kumanovës; me Lubotenin e Shkupit, me Lubancën, Brodecin, Pobožhjen dhe Kuçevishten, fshatra këto me popullatë maqedonase e serbe.

Malina dikur ka qenë mëhallë e fshatit Brezë, por tani ajo llogaritet si fshat më vete. Kjo ndarje si dy fshatra më vete shënohet edhe në

dokumentet personale (certifikatë të lindjes, letërnjoftim, pasaportë). Edhe banorët e këtyre vendbanimeve e bëjnë dallimin: njëri thotë unë jam i Brezës (jam pi Breze), ndërsa tjetri thotë unë jam i Malinës (jam pi Maline). Në pikëpamje të veçorive gjuhësore, këto dy fshatra i takojnë një të folmeje të vetme, meqë nuk kanë ndonjë dallim gjuhësor.

Pas luftës së vitit 2001, fshatrat Brezë, Malinë e Tanushë thuajse u zbrazën plotësisht. Shumë fshatarë lanë shtëpitë e tokat për të shpëtuar familjet dhe u dyndën në Haraçinë, Hasanbeg, Inxhikovë (fshatra të qarkut të Shkupit), Kumanovë e Gjilan; disa edhe u strehuan në fshatrat e Vitisë e të Letnicës. Edhe sot e kësaj dite ka refugjatë nga Breza (që ikën për të shpëtuar jetën nga konflikti i armatosur më vitin 2001), që ende jetojnë në ndonjë nga shtëpitë e Letnicës (fshat afër Vitisë) në Kosovë dhe nuk janë kthyer ende në vendlindje. Disa banorë të këtyre vendeve malore, edhe pse kanë ndërtuar shtëpi në katundet më afër qyteteve ose në Shkup, nuk i kanë shkëputur plotësisht lidhjet me vendlindjen. Ndonjë prej tyre shkon herë pas here në katund për të punuar tokën, ndokush e kalon verën larg tymit, zhurmës, stresit e mjedisit të ndotur të qytetit, në natyrën e pastër e të paprekur të kësaj malësie. Por, përgjithësisht numri i banorëve të përhershëm në katundet malore të Karadakut të Shkupit, në Brezë, Malinë e Tanushë është shumë i vogël.

Shpërngulja e popullsisë shqiptare ka qenë dhe është e vrullshme jo vetëm nga fshatrat e izoluara malore, por edhe nga fshatrat kodrinore-malore. Shumë banorë të kësaj zone malore tani në jetojnë në Shkup e në fshatrat përreth: Hasanbeg (maq. Singeliq, Çento), Haraçinë, Orllancë, Mojançë; në Kumanovë e në zona të tjera të Maqedonisë së Veriut. Jo pak shqiptarë nga Karadaku i Shkupit punojnë e jetojnë në shtetet e Evropës e të botës, shumë kanë migruar edhe në Turqi.<sup>162</sup>

Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2002, Breza kishte 569 banorë dhe 65 shtëpi. Banorët thonë se para vitit 1945 katundi kishte 400 shtëpi me 4.000 banorë. Popullata e këtij vendi, sikurse edhe shumë të tjerë të Karadakut, kanë migruar në Shkup, Turqi dhe në shtetet e Evropës.

Shumica e brezjanëve janë të fisit Berishë, por ka edhe të fisit Kryezi. Banorët që ende jetojnë në këtë katund kryesisht merren me blegtori e bujqësi. Ata ruajnë dhen dhe kafshë të tjera. Kjo zonë malore është e njohur për kultivimin e patateve shumë cilësore, më të mirat që bëhen në këtë krahinë.

Me shpopullimin e këtij fshati, vdekjen e plakave e të pleqve; të rinjtë më nuk do të mbajnë mend emrat e vendeve të vogla të kësaj zone malore. Ato mund të humbasin përgjithmonë. Pikërisht, ky qe edhe motivi kryesor për të regjistruar, shtjelluar e renditur në formën e një fjalorthi 123

<sup>162</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014, f. 25.

mikrotoponime që arritëm t'i dëgjonim nga goja e pleqve të këtij fshati. Shpresojmë se kështu së paku do të mund të shpëtojmë nga zhdukja pa lënë gjurmë forma e tyre gjuhësore:

- **Ara Baki:s** - arë, pronë e Bakiut.
- **Ara e Musave** - arë që është pronë e familjes Musa.
- **Ara Jonuzit** - pronë e Jonuzit.
- **Ara Kuçe** - arë që ka dhe të kuq.
- **Ara Madhe** - arë me sipërfaqe të madhe.
- **Ara Nga:t** - arë që gjendet afër shtëpisë së dikujt.
- **Ara Ramushit** - pronë e Ramushit, tokë shumë pjellore.
- **Ara Tranafililit** - arë me trëndafila të egër përreth saj.
- **Arat e Masllanve** - prona të familjes së madhe të Masllanve.
- **Arat e Mulijve** - pronë e fisit të Brezjanëve, Mulije.
- **Drrasa Kuçe** - një lis shumë i madh e i lartë në malin e Brezës, me ngjyrë të kuqe që është dalluar qysh prej së largu.
- **Dushki Arës Zenanit** - dushku i familjes Zenuni paska qenë më i miri në atë rrethinë. Mund të ketë qenë fillimisht arë e familjes Zenuni e më pas në të të jetë rritur dushku.
- **Dushki Kadri:s** - mal me dushk, pronë e Kadriut.
- **Godeni Karaxhës** - livadh, kodër ku në stinën e verës dilnin në piknik shumë anëtarë të familjes Karaxha.
- **Godeni Lopve** - livadh ku të gjithë katundarët (pa dallim fisi e familjeje) kullotnin lopët, po edhe bagëti të tjera.
- **Gropa Idrizit** - gropë sipas emrit personal Idriz.
- **Gropa Katanit** - gropa që gjendej afër xhamisë së fshatit, gropa e katundit (fonetikiqsh e përfutur nëpërmjet disa fazave zhvillimi: katúnd > katâun > katáun > katá:n).
- **Guri Ba:rdh** - kodër me gur të bardhë.
- **Guri Bafqarit** - gurë që ka marrë emrin sipas emrit vetjak Bafqar < Baftjar.
- **Guri Ga:t** - gurë me gjatësi të madhe.
- **Guri Kepës** - gurë i thepisur, me kepa, me maje që gjendet në një kodër. Fjalën *i kepët* mb. Fjalori shpjegues i shqipes e përkufizon me kuptimin "i thepisur, me majë të mprehtë ose me maja të thepisura; me kepa (për një shkëmb, vend shkëmbor ose gur). Shkëmb (gur) i kepët. Vend i kepët".
- **Guri Keç** - gurë me formë jo të rregullt, me formë jo të mire.
- **Guri Kuç** - gurë me ngjyrë të kuqe.
- **Guri Sadikit** - gurë që ka marrë emrin sipas njeriut të quajtur Sadik.
- **Guri Saçipit** - gurë që ndodhej në pronën (arën) e Saqipit.
- **Guri Zi** - gurë i madh me ngjyrë të zezë.
- **Gurt e Shpe:sh** - kodër me përplot gur.

- **Gjurzina** - vend me shumë gur (gur > me qiellzorëzim: gjur > shumësi: gjur+zi > + prapashtesa -na = gjurzina).
- **Karaula** - vend ku qëndronte roja, patrulla, vendrojë. Duhet të jetë përfutur nga fjala turke karakoll-i *m.* – rojë, patrullë), *arm.* Ndërtesë e thjeshtë dhe e ngushtë, e ngritur si kullë me mur ose prej dërrase, ku qëndronte roja që ruante kufirin, hyrjen në një repart ushtarak etj.; roja vetë; trupa e rojës.<sup>163</sup>
- **Kaurri vetëm** - kjo ka marrë emrin për shkak se në një kodër të Brezës paska jetuar i vetëm një “kaurr”, pra sllav (maqedonas ose serb). Leksema *kaurr* përdoret si emër përbuzës (pezhorativ) për sllavët.
- **Kepi Bullit** - një kep afër mullirit të katundit, i quajtur kështu sipas buallit. Në Fjalorin shpjegues të shqipes fjala *kep* *m.* sh. jepet me kuptimin e parmë (themelor): shkëmb i madh dhe i thepisur, me majë ose me disa maja të mprehta; pjesa me majë e një guri, maja e një shkëmbi ose e një mali shkëmbor.
- **Kika** - kodra më e lartë në Brezë, kodra me lartësi mbidetare më të madhe në rrethinën e Brezës e të Malinës. FESH jep këtë shpjegim për kuptimin themelor për fjalën *kikë* *f.* sh.: “1. maja e mprehtë e një mali; maja e gjilpërës ose e një sendi tjetër; maja më e sipërme, maja më e lartë e diçkaje; kulm. *Kika e malit. Kika e gjilpërës. Mbaron me kikë.*”
- **Kodra Ametit** - kodër ku i kullotnin bagëtinë, e emërtuar sipas emrit vetjak Ahmet.
- **Kodra Birave** - vend shkëmbor, kodër me shumë vrima të dukshme.
- **Kodra Loshe** - kodër ku jetonte familja Loshe nga edhe e ka marrë emrin.
- **Kodra Nurdinit** - kodër që është emrtuar sipas emrit personal Nuredin.
- **Kodra Pleçve** - vend malor ku kanë jetuar dy pleq.
- **Kopilaça** - banorët e krahinës së Karadakut e kanë quajtur këtë vend malor kështu për shkak se aty paska jetuar dikush që ka bërë e ka rritur kopila. Fjala *kopil* ka kuptimin fëmijë mashkull i lindur jashtë martese. Mal i shpeshtë, i dendur; topolekseme e përhapur në gjithë Ballkanin. Në gjuhët sllave del me rrjedhoja të shumta, si *kopil* (mashkull), *kopilicë* (femër), *Kopila:ç* (vend *kopilash*).
- **Kroni Abazit** - krua që gjendej në pronën e Abazit.
- **Kroni Katanit** - kroi i katundit, krua në fillim të katundit (fonetikiqsh e përfutur: *katúnd* > *katâun* > *katáun* > *katá:n*).
- **Kroni Murteзит** - krua i Murteзитit.
- **Kroni Pajazitit** - krua i një njeriu të quajtur Pajazit.
- **Laki Baçit** - fjala *baç* këtu emërton njeriun që merret me përpunimin e bulmetit, bulmetorin. Ky vend është përcaktuar kështu për shkak se aty

---

<sup>163</sup> Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 373.

është përpunuar bulmeti, veçmas djathi, nga një pronar dhensh që ka pasur rreth 12.000 dele, bulmetor.

- **Lama Hasanit** - tani një vend me sipërfaqe të rrafshët, dikur lëmë, pronë e Hasanit.
- **Leçe** - livadh me sipërfaqe të madhe e me shumë laqe, kthesa të ashpra, të vështira për t'u kaluar. *Lak* - shumësi *leqe* në shqipen ka kuptimin qafë mali a kodre e harkuar; vend me shumë të përpjeta e të tatëpjeta njëra pas tjetrës (FESH).
- **Lisi Madh** - vend ku kishte një lis të madh lis të madh.
- **Lisi n'Kodër** - kodër ku gjendej një lis i madh.
- **Lisi Njo:m** - lis që kishte ngjyrë të gjelbërt, që dukej më i njomë sesa lisat e tjerë.
- **Livadhi Madh** - livadh me sipërfaqe të madhe.
- **Livadhi Ramës** - pronë e Ramës.
- **Livadhi Shkive** - livadh ku kanë jetuar disa sllavë (shkije) që pastaj kanë shkuar diku tjetër. Emri përbuzës në njëjës *shka*: e në shumës *shkie* përdoret te të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë për sllavët.
- **Lugi Bafqarit** - është quajtur sipas emrit të këtij personi, Bafqarit < Baftjarit.
- **Lugi Ga:t** - lug i bukur dhe i gjatë diku rreth një mijë metra
- **Lugi Kikës** - lugajë me ferra qëgjendet afër afër kodrës më të lartë në Brezë, Kikës.
- **Lugi Mollës** - luginë me molla.
- **Lugi Qerli:s** - është quajtur sipas emrit vetjak Qerli.
- **Lugi Shkozave** - luginë i pasur me dru shkoze, mjaft e përhapur në malet e Brezës.
- **Lugi Thanës** - lug në mal ku rritet shumë thana.
- **Lugi Therrës** - luginë me ferra.
- **Lumna:jt** - vend ku brezjanët dhe gushicasit kanë bërë shirjen e drithërave. Kjo formë shumësi të shquar është përfutur nga njëjësi *la:m* (*lamë*), *lamna:j*, *lamnajt*, *lumnajt*. Siç dihet, semantika themelore e emrit *lëmë* (gegërisht *lamë*, *la:m*) është: "1. Shesh i vogël, zakonisht i shtruar me rrasa guri dhe me një strumbullar në mes, ku shihen të lashtat me kuaj; vendi ku mblidhen duajt e të lashtave dhe shihen me makinë" (FESH). Në krahinën e Karadakut *lamët* (lëmët) bëheshin rëndom afër shtëpive dhe çdo shtëpi kishte lamën e vet. Gropohej (gërryhej) vendi në formë rrethore, në mes vinin një strumbullar, por nuk shtrohej me gurë. Të çarat (plasaritjet) e tokës lyheshin me bajga bagëtish për të mos hyrë në to drithi (gruri).
- **Mali Shpe:sh** - mal shumë i dendur e i vështirë për të kaluar nëpër të.
- **Mullini Bekteshve** - pronë e familjes Bekteshi.
- **Mullini Darsve** - pronë e familjes Darsi.

- **Mullini Hoxhve** - mulli në pronëai të familjes Hoxha.
- **Mullini Nezirit** - pronë e Nezirit.
- **Mullini Ramës** - mulli në pronësi të Ramës.
- **Pira Kuqe** - vend me lake shumë të vështira, aq sa për t'u kaluar këto njerëzit janë lodhur, djersitur e sigurisht edhe skuqur.
- **Plemja Selamit** - kasolle, plevicë ku mbante Selami ushqimin e bagëtisë
- **Presllap** - pjesë më e ulët e Maleve të Karadakut midis dy lartësive, ultësirë. Në Fjalorin shpjegues të maqedonishtes (me shpjegime në serbo-kroatishte), Makedonska kniga, Shkup, 1986, f. 989 fjala *преслан* (presllap) jepet me kuptimin “pjesë më e ulët e malit midis dy lartësive, maq. превал, превалец); serbisht: presedlina, presedao”.
- **Prroi Stamenkit** - sipas mbamendjes së katundarëve në afërsi të këtij përroi ka jetuar një serb i quajtur Stamenko; përrua ku ka pirë ujë Stamenki.
- **Pusat** - vend malor me disa pusa.
- **Pusi Lopve** - pus ku punin ujë lopët.
- **Pusi Shqerrave** - vend ku fshatarët i lanin dhentë e qengjat para qethjes.
- **Reka Breza Moçme** - përrua që vjen nga Goshinca e kalon nëpër Brezë.
- **Reka Gurit Zi** - përrua që buron nga Guri i Zi.
- **Reka Madhe** - lum i madh, bigëzim lumi ku takohen përroi i Gushincës dhe përroi i Brezës.
- **Roga Demirit** - lëndinë, në pronësi të Demirit.
- **Roga Hasanit** - lëndinë në pyll me sipërfaqe të madhe.
- **Roga Hasanit** - lëndinë me bar në mes të pyllit, lirishtë; vend i zhveshur në mes të pyllit; lëndinë me bar në një faqe mali që ishte pronë e Hasanit.
- **Rosen** - quhet një kodër ku duhet të kenë jetuar disa rosa të egra.
- **Rrafshat e Durës** - vend i rrafshët në bjëshkë, pronë e familjes Dura, Durra.
- **Rrafshi Epërt** - rrafshinë mbi rrafshet e tjera ku kanë jetuar disa familje.
- **Rrasa e Ngul** - rrasa e ngulur, pjesë e një mali, banorët nuk dinë të shpjegojnë pse quhet kështu.
- **Rrezja Lugjeve** - vend i pjerrët që formon lugun e që e rrezaton shumë dielli.
- **Sokollovac** - kodra më e lartë, e emërtuar sipas emrit të shpendit “sokol”, pra vend ku jetonin sokolat. Edhe brezjanët fjalën “sokol” e përdorin në kuptimin: shpend grabitqar me sqep të kthyer dhe me krahë e thonj të fuqishëm; petrit.
- **Stanet e Bushve** - stanet e familjes Bushi, të vendosura në një lëndinë në pjesën e majtë të Gurit të Zi.
- **Stanet e Hoxhve** - stane, pronë e familjes Hoxha që mendohet se janë ndër më të vjetrat në këtë malësi.

- **Stanet e Kalloshve** - stane të mëdha, me shumë dhen e prodhim të madh të djathit.
- **Stanet e Murtezve** - vend me stane të familjes Murtezi.
- **Stanet e Selmanve** - vend ku ka ruajtur bagëtinë familja e Selmanve. Fjala *stan* ka kuptimin: vend me vathë e me kasolle për bagëtitë, për barinjtë e për bulmetin, i ngritur në mal për verë ose në vërri për dimër; kasolle e vogël që ngrenë barinjtë në stanet ku bjeshkojnë; vatha e dhenve gjatë verimit të tyre në bjeshkë; bun; kasolle, tëbanë. Tëbanat e Selmanve.
- **Stani Hajrizit** - tëbani i Hajrizit.
- **Stani Kurtishit** - tëban në livadh, pronë e Familjes Kurtishi.
- **Stani Masllanve** - tëban i pozicionuar në livadh, pronë e familjes së Masllanëve. Thuhet se këta ishin ndër familjet më të ashpra (të egra) të kësaj zone. Thuhet se nëse ndonjë dele hynte në pronën e Masllanve, ata e konsideronin si pronë të tyre dhe nuk ia kthenin më pronarit të mëparshëm.
- **Stani Nezirit** - tëbani i Nezirit, tëbani në pronësi të Nezirit.
- **Stani Rupanve** - tëban, pronë e Familjes së Rupanve.
- **Stani Zenunit** - tëban, pronë e familjes Zenuni, që tani jetojnë në një lagje në Hasanbeg të Shkupit.
- **Stanica** - quhet një vend në bjeshkë ku në kohën e mbretërisë Jugosllave ishin stacionuar ushtarë serbë, pikë ushtarake, stacion xhandarmërie (ushtrie e policie) që kishin malltretuar shumë fshatarë. Fjala *stacion-i m.* (lat. *statio* – qëndrim, bazë) kuptohet si vendndalim, vendqëndrim, ndërsa në formën *stanicë* ka hyrë nga sllavishtja.
- **Stepanc** - fjala *stepanc* rrjedh nga “stepë” f. sh. *gjeogr.* me kuptimin: vend i gjerë fushor e pa drunj, me bimësi të varfër barishtore dhe klimë të thatë, ku shpeshherë burrat e brezës tuboheshin për piknik, e aheng, ndonjëherë të shoqëruar edhe me shitblerjen e mallrave.
- **Shpati Osoj** - lëndinë ku kullotnin kafshët, shpati përfundonte te mulliri i familjes së Mulijve.
- **Shpella Gurit Zi** - shpellë që gjendet në afërsi të Gurit të Zi.
- **Shpella Kaurrit** - shpellë ku në kohën e sundimit osman është fshehur një jomusliman, i krishterë, një sllav.
- **Shpella te Kalaja** - shpellë në afërsi të kalasë së Brezës, në pronën e familjes së Durrve.
- **Te Barakat** - dikur vendqëndrim i pylltarëve të Kopilaqës, kurse sot në këtë vend gjendet karakolla e ARM-së.
- **Te Brŭja** - vend në afërsi të fshatit.
- **Te Çeshma** - çezme me shumë ujë të ftohtë, vendi te çezma ku katundarët furnizoheshin me ujë të pijshëm.
- **Te Prroni Monit** - te përroi i manit, përrua ku në afërsi të tij ka pasur një man.

- **Te Shpella Mehashit** - në këtë shpellë paska pasur shumë gjarpërinj, si vendstrehim sidomos dimrit.
- **Te Zhedeni Feratit** - fjala zheden – sllavizëm: ka kuptimin i, e etur; vend që e zë dielli mirë e që nuk e rreh era; vend me diell e ngrohtësi, shullë. Këtu emërton një tatëpjetë të madhe, vend ku janë mbytur tre djem të Feratit. Banorët ende mbajnë mend se tre djemt e Feratit gjatë kohës së dimrit me shumë borë kanë dalë për të kërkuar ushqim për bagëtinë. Rrëshqitja e befasishme e borës (moçava, llava) ka mbuluar të tre djemtë, duke shkaktuar edhe vdekjen e tyre. Vetëm pas tri ditësh kërkimi të fshatarëve i kanë gjetur kufomat e tyre.
- **Tupani** - lendenë në maje të kodrës, në kufi me fshatin Stançiq që i përket Kosovës. Katundarët e Stançiqit njiheshin për valltarë të mirë. Këtu shpesh kanë rënë tupanat dhe kanë vallazuar burrat e katundeve përreth.
- **Thanat** - vend i pasur me thana. Siç shpjegojnë fshatarët, jo vetëm banorët e fshatit, por edhe kalimtarët janë furnizuar me thanat e këtij vendi si ushqim i mundshëm gjatë rrugës së gjatë e të mundimshme nëpër bjeshkët e kësaj zone për të ushëtuar nga një katund në tjetrin apo në qytetet më të afërta.
- **Therrat** - vend me ferra afër lendenës së Selmanve, tani tokë e punueshme.
- **Vija Izetit** – rremë e vogël uji, një rrjedhë me pak ujë, që paska kaluar nëpër pronën tokësore të Izetit, prej nga edhe e mori emrin “Vija Izetit”.
- **Vija Madhe** - rrjedhë me më shumë ujë sesa hullitë e tjera me ujë.
- **Vija Sabitit** - rremë uji që shkonte nëpër arën e Sabitit.
- **Vija Vogël** - hulli, rremë e vogël me pak ujë.
- **Vrella Kadri:s** - ky njeri (Kadria) qenka kujdesur për pastrimin a mirëmbajtjen e këtij burimi.
- **Vrella Mulijve** - vrellë quhet një burim natyror me shumë ujë prej ku furnizoheshin me ujë një pjesë e fshatit. Në rastin tonë burim uji që gjendej në livadhin e familjes Muliu.
- **Vrella Çahilit** - burim i vrullshëm uji që e ka hapur Qahili.
- **Zabeli Ametit** - pronë e Ahmetit.
- **Zabeli Hisenit** - një zabel, pronë e Hisenit. Zebel quhet pylli i vogël e i dendur a pjesë pylli e ndarë me vete, korije; vend me drurë e me shkurre të dendura.
- **Zabeli Zenës** - kodrinë, pronë e Zenës, e familjes Zenuni.
- **Zabeli Zenunit** - zabel në pronësi të Ramizit.
- **Zgjardhi Naipit** - vend i rrethuar me gardh (zgardh, zgjardh) ku Naipi e ka ruajtur kopenë e dhenve. Gardhi është thurimë e bërë me purteka, me thupra a me driza rreth e përçark një kopshti, një are, një oborri etj.



Dukuri e përgjithshme për të gjitha gjuhët e botës është se toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe burojnë kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativa).

Në toponiminë shqiptare, përfshirë edhe në atë të Brezës e përgjithësisht të rajonit të Malit të Zi të Shkupit, mënyra kryesore e emërtimit të viseve ka karakter universal. Aty dallohen:

1) Emërtime vendesh që shprehin ngjyrën, përbërjen e tokës dhe sipas ndonjë specifike tjetër: *Ara Kuqe, Guri Zi, Guri Bardh, Guri Kuq, Lugi Gat, Lisi Madh, Vija Vogël, Vija Madhe, Roga Madhe, Rrafshi Epërt, Gurt e Shpe:sh, Mali Shpe:sh* etj.

2) Toponime që përmbajnë emra të bimëve, drunjve, shkurreve dhe kulturave bimore që rriten ose janë rritur në të kaluarën: *Ara Tranafil, Lugi Therrës, Lugi Mollës, Lugi Thanës, Lugi Shkozave, Thanat, Therrat* etj.

3) Toponime që përmbajnë emra kafshësh, si: *Pusi Shqerrave, Pusi Lopve, Kepi Bullit, Godeni Lopve*.

4) Sipas antroponimeve e patronimeve: *Ara e Baki:s, Lama Hasanit, Lugi Bafqarit, Mullini Ramës, Plemja Selamit, Roga Hasanit, Stanet e Selmanve* etj.

5) Sipas emrit të objekteve të ndërtuara në ato vende, shumica të shkatërruara tërësisht duke mos lënë asnjë gjurmë, pos emrit që ruan ai vend edhe sot e kësaj dite: *Stanica* (postbllok ku në kohën e mbretërisë jugosllave ishin stacionuar xhandarmëria serbe), *Te Barakat* (në këtë vend më parë banonin pylltarët, rojtarët e malit Kopilaçë, kurse sot kemi karakollën e ARM-së), *Shpella Kaurrit* (shpellë në të cilën në kohën e perandorisë osmane është fshehur për një kohë një sllav) etj.

### **Etimologjia e toponimeve**

Si për emërvendet e vogla të katundit Goshincë, ashtu edhe për ato të Brezës kemi konstatuar se për nga etimologjia mbizotërojnë emërvendet me prejardhje nga shqipja, të tipit *Ara Nga:t, Ara Madhe, Ara Kuqe, Guri Zi, Lugi Ga:t, Guri Ba:rdh, Vija Vogël, Gurt e Shpe:sh, Livadhi Madh, Mali Shpe:sh, Rrafshi Ep:rt, Gropa Katanit, Kodra Birave, Kodra Pleqve, Lumnajt (Lamnajt), Te Prroi Monit, Pusi Shqerrave, Mullini Ramës* etj., ndërsa më pak mikrotoponime me etimologji joshqipe, si fjalët sllave stanicë - *Stanica, stan* - shqip *tëban: Stanet e Selmanve, e Kalloshve, e Hoxhve, e Bushve; Stani i Zenunit, i Kurtishit, i Rupanve, i Masllanve, i Nezirit, i Hajrizit; barakë - Te Barakat; vrellë - shq. burim: Vrella Kadri:s, Vrella Qahilit, Vrella Mulijve; reka - lum: Reka Madhe; zheden - i, e etur; përcëllimë, djegie, thatësirë: Te Zhedeni Feratit; orientale: karaulë - shq. vend ku qëndronte roja, patrulla, vendrojtë.*

Nga 123 mikrotoponime të Brezës që kemi arritur t'i regjistrujmë, vetëm pak sosh janë me etimologji joshqipe. Përkatësisht, në mikrotoponiminë e kësaj zone gjejmë vetëm pak fjalë sllave, si *vrellë, stan,*

*stanicë* ose turqizimave *karaxhë, karullë* që kanë depërtuar në leksikun e përgjithshëm të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Emërvendet e shumta me origjinë ilire-shqiptare janë edhe një dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë në rrjedhë të kohës.

### Mënyra e fjalëformimit të mikrotoponimeve

Sipas mënyrës së fjalëformimit këtu dallojmë emra të parmë, të cilët mbizotërojnë dhe emra të prejardhur.

*Toponime të parmë* (rrënjorë): *Leqe, Than-at, Therr-at, Tupan-i, Lam-naja, Vrell- a, Rrafsh- i, Lug- i, Rek-a, Kod-ra, Zabel-i, Dushk-i, Grop-a, Ar-a, Rog-a, Pus-i, Vi-ja, Prro-n-i, Mulli-ni* etj.

*Toponime të prejardhura*, me prapashtesim: -na: *Gjur-zi-na*; -icë: *Stan-ica*; -anc: *Stepanc*, -ovac: *Sokollovac*, -oll: *Karakoll* etj.

### Struktura gramatikore e toponimeve

Emërtimet me togfjalësha në mikrotoponiminë e fshatit Brezë, si edhe në treva të tjera, janë të rëndomtë. Kjo formë e ndërtimit mbizotëron krahasuar me ndërtimin me fjalë të parme dhe të prejardhura. Më të shpeshta janë mikrotiponimet **emër + përcaktor**, që mund të jenë:

a) **emër + emër personal** në rasën gjinore: që të dy elementet e togfjalëshit janë në njëjës in e shquar, me çrast emri i dytë në rasën gjinore shënon pronarin: *Mullini Ramës, Ara e Baki:s, Lama Hasanit, Lugi Bafqarit, Plemja Selamit, Vrella Kadris, Vrella Qahilit, Shpella Kaurrit, Zabeli Zenës, Vija Sabitit, Kroni Abazit, Guri Sadikit* etj.

Përveç këtyre emërtimeve në numrin njëjës, gjejmë edhe emërvende në shumës, si *Stanet e Selmanve, e Kalloshve, e Masllanve, e Hoxhve, e Bushve; Arat e Bekteshve, Arat e Masllanve, e Idrizve; Vrella Mulijve, Batllaki Musajve* etj.

b) **emër + emër** i përgjithshëm në gjinore: *Gropa Katanit* (Gropa e Katundit), *Kodra Pleqve* (Kodra e Pleqve), *Kodra Birave* (Kodra e Birave), *Laki Baçit* (Laki i Baçit).

c) **emër + emër kafshësh** në rasën gjinore në shumës: *Pusi Shqerrave, Pusi Lopve, Godeni Lopve* dhe një emër toponimi në njëjës: *Kepi Bullit*.

ç) **emër + mbiemër** që tregon ngjyrën, madhësinë, formën madhësi, pozitë, largësi ose ndonjë veçori tjetër, si: *Ara Nga:t, Ara Madhe, Ara Kuqe, Guri Zi, Guri Ga:t, Guri Bardh, Guri Keq, Guri Kuq, Gurt e Shpesh, Livadhi Madh, Lisi Madh, Mali Shpe:sh, Reka Madhe, Roga Madhe, Rrafshi Epërt, Vija Madhe, Vija Vogël* etj.

d) I pranishëm është edhe konstrukti me parafjalën **te + emër**: *Te Çeshma, Te Prroi Monit, Te Barakat, Te Zhedeni Feratit, Te Brîja* etj.

dh) Një dukuri e rrallë në toponiminë shqiptare është struktura emërtuese me tre emra, përkatësisht me një emër në rasën emërore njëjës dhe dy emra të tjerë në rasën gjinore. Në mikrotoponiminë e Brezës kemi dëgjuar një grup të tillë emëror me tre emra të njëpasnjëshëm: *Dushki Arës Zenunit* (Dushku i Arës së Zenunit) si dhe konstruktin me dy emra + një mbiemër: *Reka Breza Moçme* (Reka e Brezës së Moçme).

### Tiparet fonetike-fonologjike të toponimeve

Nga pikëpamja fonetike e fonologjike në toponiminë e Brezës na dalin këto veçori:

Nga monografia për të folmen shqipe të Karadakut të Shkupt,<sup>164</sup> areal gjuhësor ku bën pjesë edhe Breza, është konstatuar se kjo i përket të folmes më skajore që shtrihet në verilindje të gegërishtes qendrore, në kufi me të folmet e gegërishtes verilindore (kosovarishtes). Në këtë izoglosë janë të pranishme katër inovacionet fonetike të gegërishtes qendrore, përkatësisht diftongimi i zanoreve të mbyllura të theksuara /í, ú/, zh buzorëzimi i [y]-së në [i], qiellzorëzimi i [g]-së në [gj], afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh].

Duhet thënë se në të folmen e këtij katundi përveç fjalëve me formë të diftonguar, dëgjohej edhe forma të padiftonguara, si *mullëi* dhe *mulli*; *kusâi* - *kusi*; *sêi* - *si* 'sy', *temcêi* - *tepsi*; *katâun* - *katu:n*, *katan*; *fortâun* - *fortu:n*, *ftâurk* - *ftu:rk* etj. Në toponiminë e këtij fshati përgjithësisht përdoren forma fjalësh të padiftonguara: *Mullini Ramës*, *Nezirit*, *Hoxhve*, *Darsve*, *Bekteshve* (Mullini), si edhe tek emrat e me burim sllav: *Stanica*. Në mikrotoponimin *Kroni Katanit* emri i dytë në rasën gjinore *Katan-it* është përfutur nëpërmjet diftongimit të /ú/-së së theksuar në [âu] e në fazat e mëvonshme monoftongimit të shkallëshkallshëm në rrjedhë të kohës në zanoren /a/. Pra, këtu duhet të kishim pasur këtë zhvillim fonetik: nga zanore e mirëfilltë e theksuar /ú/ në diftong /âu/ e më pas në diftongoidin /a<sup>u</sup>/ > /a<sup>ë</sup>/, që në fund të ketë përfunduar në zanoren e mirëfilltë të theksuar /á/ e me shpërngjashmimin e grupit bashkëtingëllor [mb] në [m], përkatësisht në disa faza zhvillimi: *katúnd* > *katâund* > *katâun* > *kata<sup>u</sup>n* > *kata<sup>ë</sup>n* > *katán*.<sup>165</sup>

Gjatësia dhe hundorësia e zanoreve kanë lënë gjurmë edhe në toponiminë e Brezës, si në emrat: *Guri Ga:t*, *Ara Nga:t*, *Ara e Baki:s*, *Gurt e Shpe:sh*, *Lumna:jt* (Lamna:jt), *Lugi Qerli:s*, *Mali Shpe:sh*; *Te brîja*, *Gjurzîna* etj. Përdorimi i shumëdridhëses /rr/: *Drrasa Kuqe*, *Therrat*, *Te Prroi Madh*, *Shpella Kaurrit*, *Rrafshi Epërt*, *Prroi Stamenkit* etj.

<sup>164</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.

<sup>165</sup> Asllan Hamiti, *Prirja e monoftongimit të diftongjeve dytësore te folësit e gegërishtes qendrore*, Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë-Shkup, 23-28 shtator 2009, f. 59-64.

Në dallim nga shumica e të folmeve të gegërishtes qendrore, përfshirë edhe të folmet shqipe të Malit të Zi të Shkupit, e në të edhe të folmen e Brezës, bashkëtingëllorja prapagjuhore /g/ nuk qiellzorëzohet në /gj/ në format e emërvendeve të vogla. Aty i gjejmë format: *Lugi Gat*, *Lugi Mollës*, *Lugi Thanës*, *Lugi Therrës*, *Guri Keq*, *Guri Kuq* etj., si duket nën ndikimin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Këtu kemi dëgjuar e regjistruar vetëm dy mikrotoponime: *Gjurzina* dhe *Zgjardhi*, në përbërjen e të cilëve gjejmë [gj] të përfutur nga qiellzorëzimi i [g]-së.

Për shkak të ekonomizimit dhe lehtësimit të shqiptimit, në mbarë leksikon toponomastik të rajonit të Karadakut shfaqet elizioni, përkatësisht mosqiptimi i nyjave të përparme *i* dhe *e* të emrave në rasën gjinore e të mbiemrave, por edhe i [ë]-së së patheksuar në fjalët shërbyese, sipas tipit *Zabeli Zenës* (< Zabeli i Zejnës), *Pusi Lopve* (< Pusi i Lopëve), *Mullini Nezirit* (< Mullini i Nezirit), *Mali Shpe:sh* (< Mali i Shpeshë), *Lisi n’Kodër* (< Lisi në Kodër), *Lisi Njom* (< Lisi i Njomë), *Kodra Pleqve* (< Kodra e Pleqve), *Shpella Gurit Zi* (< Shpella e Gurit të Zi) etj.

### Literatura:

Baliu, Begzad: *Onomastika e Kosovës* (ndërmjet miteve dhe identiteteve), Prishtinë, 2008.

Hamiti, Asllan – Sopaj, Nehas: *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup, 2004.

Hamiti, Asllan: *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.

Hamiti, Asllan: *Mikrotoponimet dhe antroponimet e fshatit Goshincë*, Instituti Alb-Shkenca, Takimi VI Vjetor Ndërkombëtar, Prishtinë, 1-4 shtator 2011;

Hamiti, Asllan: *Prirja e monoftongimit të diftongjeve dytësore të folësit të gegërishtes qendrore*, Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë-Shkup, 23-28 shtator 2009.

Hamiti, Asllan: *Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoni – dëshmi e autoktonisë*, “Scupi”, Vëllimi V, 2014, Shkup, 2014.

Idrizi, Xhemaludin: *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.

Ismaili, Mustafa: *Goshinca e Kumanovës* (monografi), Shkup, 1998.


Murati, dr. Qemal: *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Tetovë, 2008.

*Речник на македонскиот јазик со српскохрватски толкувања* (редактор Блаже Конески), Македонска книга, Скопје, 1986

Shkurtaç, Gjovalin: *Onomastikë dhe etnolingistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001.

## 12. E FOLMJA DHE MIKROTOPONIMET E KATUNDIT GODEN TË GJILANIT

Fshati Goden shtrihet në Karadakun e Gjilanit,<sup>166</sup> në Republikën e Kosovës, në anën e majtë të lumit dhe të rrugës, që kalon nga vendkalimi kufitar Bellanoc-Stançiq për në Gjilan, që gjendet në kufi me Republikën e Maqedonisë Veriore. Në përgjithësi, me kalimin e kohës, sikurse pjesa dërmuese e banorëve të Karadakut të Gjilanit, edhe banorët e Godenit, për shkak të kushteve të vështira ekonomike, zhvillimit të dobët të infrastrukturës dhe të kurbetit si plagë e rëndë e popullit shqiptar dhe të largësisë deri në Gjilan 20 km, u shpërngulën dhe u vendosën nëpër vende të ndryshme në Republikën e Kosovës (më së shumti në Ferizaj), në Maqedoni (në Shkup), në Shqipëri, Turqi e gjetiu.<sup>167</sup>



*Fshati Goden në hartën topografike të Kosovës*

Sipas mbamendjes së të moshuarve që ende janë gjallë, fshati Goden i Vogël është themeluar mjaft herët, përkatësisht gjatë sundimit osman, i ndarë nga Godeni, fshat në komunën e Vitisë. Në fillim quhej Godeni i Fushës së Madhe, ndërsa më vonë u quajt Godeni i Vogël, i njohur si mëhallë e vendbanim më vete me emrin Vërçovicë.

<sup>166</sup> Në këtë katund kam lindur edhe unë.

<sup>167</sup> Raif Hamiti, *Godeni i Gjilanit (monografi)*, Intergraf, Ferizaj, 2019, f. 13-32.

Siç dihet, fisi i njohur Dradan ka banuar gjithë territorin që shtrihet në trekëndëshin Nish – Sofje – Shkup. Por, në rrjedhë të kohës nën politikën shoveniste sllave të shfarosjes, shtrirja e shqiptarëve si pasardhës ilirë, u ngushtua. Si dëshmi onomastike se një pjesë e shqiptarëve të kësaj zone, bashkë edhe me stërgjiyshërit tanë, u dyndën nga pjesa veriore mund të na shërbejë edhe emri i fshatit Dunav, prej nga më pas u formua edhe mëhalla jonë Vërçovë.

Është krejt e natyrshme që emri i katundit Dunav të lidhet me emrin e lumit që në gjuhët sllave quhet po me të njëjtin emër, pra Dunav (në gjuhët e tjara, gjermanisht: Donau, sllovakisht: Dunaj, hungarisht: Duna, rumanisht: Dunărea, kroatish: Dunav, serbisht: Дунав, ukrainisht: Дунай) që është lumi i dytë më i gjatë në Evropë pas lumit Vollga.

Rrjeshimisht, stërgjiyshërit tanë duhet të kenë jetuar në afërsi të lumit Danub (në serbisht Dunav) e më pas të jenë larguar me dhunë e të jenë vendosur në Karadakun e Gjilanit.<sup>168</sup> Pra, etimologjia e emrit të fshatit Dunav shpjegohet vetëm me emrin e lumit Dunav (Danub).

Më vitin 1850 nga fshati Dunav u shpërngulën vëllezërit Agushi, Hamiti, Ramadani, Ajeti dhe Azemi. Agushi, Hamiti dhe Ramadani u vendosën në një vend të pabanuar deri atëherë, jo larg nga fshati i tyre i lindjes, në Vërçovicë për të filluar një jetë të re, duke u vendosur afër një burimi uji, që e shndërruan në krua me ujë të ftohtë, në një vend të ri malor, me kushte të mira për bujqësi, blegtori dhe pemëtari. Më vonë në Vërçovicë do të vijnë edhe një familje nga fshati Sefer - Avdilovit. Sipas njohurive tona, Azemi u vendos në fshatin Selishtë, ndërsa Ajeti vendoset në afërsi të Llokmes, në mëhallën e Drumaxhinjve.

Agushi, Hamiti dhe Ramadani vendin e kishin blerë nga Maliç Vërnakolla, ndërsa më vonë fillojnë të blejnë edhe pjesë pas pjesë, duke çelë toka të reja si dhe duke mbjellë dhe shartuar pemë të llojllojshme.

Shpërngulja u bë për shkaqe ngatërrese. Siç tregojnë pleqtë, më vitin 1850 fshati Kokaj kishin dasmë, kështu që dasmorët shkojnë në fshatin Zllakuçan për ta marrë nusen. Krushqit kalojnë nëpër fshatin Dunav, ndërsa kur kthehen, duke kaluar nëpër pjesën e poshtme të fshatit gjuajnë me pushkë. Banorët vendës me këtë rast irritohen, u dalin përpara dhe zënka verbale u përshkallëzua në konflikt fizik, përfshirë edhe armë zjarri, me ç'rast një dasmor mbetet i vrarë dhe dy të plagosur. Krushqit largohen duke e lënë nusen në vendin e ngjarjes. Dy gra të moshuara vendase e marrin nusen, e hipin në kalë, e dërgojnë në fshatin Kokaj dhe ua

<sup>168</sup> Lumi Danub (sll. Dunav) është lumi i vetëm në Evropë që rrjedh në kahjen nga perëndimi në lindje. Buron nga Mali Shvarcvald të Gjermanisë dhe derdhet në Detin e Zi. Ka gjatësi prej 2.859 km dhe kalon nëpër Gjermani, Austri, Sllovakia, Hungari, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Moldavi dhe Ukrainë. Përshkon disa qytete të mëdha të Evropës: Vienën, Bratisllavën, Budapestin dhe Beogradin.



*Godeni (mëhalla e Vërçovicës) sot*

dorëzojnë familjes së burrit. Pas këtij rasti, fillon procesi i pajtimit me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Pleqnarët konstatojnë, mes tjerash, se fajtorë janë vrasësit, por edhe dasmorët njëkohësisht për krisma pushkësh në vend të huaj, ndaj si kompromis vendosin që Agushi, Hamiti, Ramadani, Ajeti dhe Azemi të shpërngulen nga fshati Dunav në ndonjë vend tjetër. Pas këtij rasti, u vendosën në vendbanimin e ri, në afërsi të fshatit Goden, i cili edhe më parë quhej Vërçovicë, vend malor që shërbente si mriiz për mriizimin e dhenve, gjegjësisht, për pushimin e dhenve nën hije gjatë verës kur bënte vapë.

Siç u përmend edhe më parë, vendbanimi i ri ishte i përshtatshëm për jetesë, kishte ujë të ftohtë të mjaftueshëm për fshatin, toka ishte pjellore, kishte kullota dhe në të dy anët e fshatit rrjedhin dy përroje, që krijojnë kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë. Mbollën lloj-lloj pemësh, sidomos kumbulla, dardha, mollë, qershi, vojsa etj. dhe kështu fshati u bë vend mjaft i përshtatshëm për jetesë. Kultivoheshin pemë të llojeve të ndryshme, që nga qershitë në stinën e pranverës, ata kishin pemë gjatë tërë verës, gjatë vjeshtës, por edhe për dimër; meqë i ruanin nëpër tavanet e tyre, ashtu që kishin me bollëk gjatë tërë dimrit. Përveç bujqësisë dhe blegtorisë, fshatarët merreshin edhe me bletari e pylltari.

Banorët e fshatit Goden, të mëhallëve të tjera të vendosura më parë (Fusha e Madhe) gjithnjë kishin raporte të mira me ne, në dasma dhe në vdekje përherë kanë qenë së bashku, asnjëherë nuk kanë pas mosmarrëveshje ndërmjet veti, ndaj llogariteshin si pjesë e fshatit të njëjtë.

Dasmat dhe ceremonitë mortore i bënin së bashku. Në shenjë afërsie nuk kemi pasur martesë ndërmjet veti dhe i thoshin kushëri njëri-tjetrit.

Më vitin 1905 kroatët një pjesë të tokës ua shesin fshatarëve të Llokmës të ardhur nga Depca, ndërsa më vitin 1910 pjesën tjetër ua shesin një familjeje të fshatit Dunav. Nga Depca në Llokme u vendos Brahimi me familje, i cili ishte nip i Avdi Dunavit.

Për sa i përket pozitës gjeografike të fshatit, gjegjësisht të mëhallës sonë, vlen të theksohet se ajo gjendet përafërsisht në largësi 18 km nga Gjilani dhe bën pjesë në fshatrat e Karadakut të Gjilanit, në lartësi mbidetare afër 800 m. Banorët e fshatit, për t'u furnizuar me gjëra të ndryshme të nevojshme familjare, të cilat ata nuk i kanë prodhuar vetë, duhej të furnizoheshin nga Gjilani, Presheva, Kumanova, apo nga Vitia, që të gjitha këto qytete ishin (e janë) larg.

Nga rruga Gjilan – Bellanovc, Godeni gjendet afër 2 km larg saj, e cila i lidhte Gjilanin me Kumanovën, por vlen të theksohet se të gjitha rrugët që çojnë për Goden e nga Godeni për fshatra e qytete të tjera kanë qenë shumë të vështira për qarkullim, pra rrugë malore të pashtruara, të ngushta e me plot kthesa, tatëpjeta e teposhtëza.

Për të përmirësuar sado pak këtë izolim të këtij katundi, nga viti 1957-58 fshatarët e çelën një rrugë që mund të kalohej në këmbë, me kuaj e gomarë si dhe me qerre kafshësh (rëndom me qe) që shpie nga fshati Isufaj deri në fshatin tonë. Kjo rrugë u ndërtua me vetiniciativë të fshatarëve dhe me vegla dore, me kazma, shata dhe lopata, gjegjësisht atëherë nuk kishin as karroca (kolica) për bartjen e dheut. Gjatësinë e rrugës që duhej hapur e kanë ndarë në pjesë sipas fuqisë punëtore për çdo familje. Megjithatë, edhe pas ndërtimit të kësaj rruge, nuk u zgjodh problemi i qarkullimit të banorëve, për shkak se shiu, bora dhe shembjet e dheut shpeshherë rrugën e bënin të pakalueshme.

Fshati ishte i paelektrifikuar, nuk kishte as shkollë, as ambulancë e as shitore. Fëmijët e ndiqnin shkollimin në fshatin Pidiç, i cili gjendet afër 6 km larg, në ciklin e ulët deri në klasën e katërt, ndërsa pas mbarimit të klasës së katërt në ciklin e lartë, prej klasës së pestë deri në të tetën, shkollimin duhej ta vazhdonin në fshatin Shurdhan, edhe 2 km më larg (pra 8 km larg). Shkollimi për shkak të largësisë deri në shkollë, në fillim deri kah viti 1956 vijohej në fshatin Pidiç nga nxënësit dhe nxënëset e Vërçovicës. Megjithatë, më vonë u hap edhe cikli i latë në fshatin Shurdhan, por tani më, në shkollë shkonin vetëm nxënësit e gjinisë mashkullore, ndërsa vajzat mbeteshin analfabete.

Të gjithë fshatarët ishin të përkatësisë etnike shqiptare dhe të besimit islam. Ndërkaq xhaminë më të afërt e kishin në fshatin Pidiç dhe namazin e xhumasë e bënin në xhaminë e Pidiçit.



Martesat kryesisht i bënin me fshatrat: Stubëll e Ulët, Selishtë, Kurexh, Sefer, Stançiq, Dunav dhe Depce. Shumica e martesave janë bërë me ndërrime (marrje dhe dhënie) ose me pagesë (në mall ose në para).

### **E folmja e Godenit**

Gjuha e ruajtur në gojën e popullit është një enciklopedi e gjithë jetës së popullit tonë. Thëniet e gdhendura të kanuneve, krijimtaria gojore popullore janë shfaqje e mirëfilltë e përpunimit stilistik të shqipes.

Gjuha jeton përmes dialekteve, që janë limfa e jetës së saj. Kjo e vërtetë megjithatë shpesh harrohet dhe dialektet shihen si një shfaqje „historike“ dhe e tepërt, që njeriut modern nuk i duhet. Sidomos në kohën tonë të globalizimit dhe masmediave, dialektet shumëkund janë në tkurrje dhe shuarje të plotë. Në rast se, në globin tonë çdo dy javë shuhet një gjuhë, sikundër e nxirrte një studim amerikan i para disa muajve, dialektet ndoshta mund të treshen dita-ditës. E prapëseprapë askush nuk mund të thotë se ka rënë kambana e dialekteve ose të folmeve të veçanta dhe se njeriu modern nuk do t'i rikthehet edhe në këtë pikë asaj çka i kanë lënë trashëgim shekujt.

Me sa duket është një tharm i fortë që s'ka për të vdekur asnjëherë. Aq më shumë kur njerëzit ta kuptojnë dalëngadalë se përdorimi i një dialekti nuk tregon as prapambetje e as injorancë, por mbart jetë dhe ngrohtësi njerëzore si shumë pak tjetër gjë e kësaj bote (Ardian Klosi).

Njohja dhe studimi i imët i dialekteve janë themelore për të gjitha studimet gjuhësore: për fonetikën e fonologjinë, për morfologjinë, për sintaksën, historinë e gjuhës dhe, pa dyshim për semasiologjinë, leksikologjinë dhe frazeologjinë e gjuhës.

Dialektet dhe të folmet e gjalla përbëjnë dëshmi të rëndësishme, që kanë peshë apo vlerë të krahasueshme me vlerën që kanë bimët për botanistin, objektet dhe veshjet (kostumet) popullore për etnografin, si këngët e vallet për folkloristin, si dokumentet arkivore e kronikat e drejtpërdrejta për historianin. Të dhënat e dialekteve janë të rëndësishme sepse në to na jepet një pamje autentike e të folmeve apo e dialekteve nëpërmjet të folurit të rrjedhshëm e të gjallë, ashtu siç rron në gojën e njerëzve të rëndomtë, pa ndonjë përpunim e tëhollim libror.

Kërkime dhe studime dialektologjike janë bërë edhe për të folmet shqipe në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Është mbledhur material dialektor pothuaj në të gjithë territorin ku flitet shqipja, por puna e vjeljes së materialit dialektor dhe e studimit të të folmeve nuk duhet ndërprerë. Kërkimet dialektore në Kosovë janë organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës së pari nën drejtimin e Idriz Ajetit e më pas edhe nga studiues të tjerë. Për të folmet e Kosovës është vjelë material burimor, janë botuar jo

pak fjalorë të këtyre të folmeve, monografi të veçanta dhe skica dialektore si dhe studime të tjera gjuhësore me vlerë nga Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli, Hilmi Agani, Mehdi Bardhi, Latif Mulaku, Mehmet Halimi, Imri Badallaj, Fadil Raka, Mehmet Ahmetaj, Abdullah Zymberi, Shaqir Berani, Ragip Mulaku, Zijadin Munishi, Tafil Kelmendi, Bahtijar Kryeziu, Shefkije Islamaj, Qemal Murati, Naim Berisha, Sejdi Gashi, Naser Pajaziti, Mehmet Topalli, Adem Hajdaraj, Ismet Lecaj, Bajram Mehmetaj, Bislim Pireva, Vediha Topçiu, Sidorela Doli - Kryeziu etj.

E folmja e fshatit Goden i përket dialektit të gegësishtes, nëndialektit të gegërishtes veriore, grupit të të folmeve të gegërishtes verilindore (kosovarishtes).

Të folmet lindore të gegërishtes veriore shtrihen nga Novi Pazari në Veri e deri në Kumanovë e Malet e Sharrit në jug; nga Shala e Shoshi në perëndim deri në Jabllanicë, Bujanovc e Preshevë në lindje. Brenda kufijve të sotëm të Shqipërisë në grupin e gegërishtes verilindore bëjnë pjesë të folmet e Nikaj-Mërkurit, të Krasniqes, të Gashit, të Bytyçit të rrethit të Tropojës, të Hasit të Kukësit dhe e folmja e Pukës. Por, pjesa më e madhe e të folmeve të këtij grupi shtrihen në Kosovë, Bujanovc e Preshevë. Andaj, grupi i të folmeve të gegërishtes verilindore shpeshherë emërtohet edhe me kosovarishte.

Në formë më të përmbledhur mund të thuhet se gegërishtja verilindore flitet në pjesën verilindore të Shqipërisë (në krahinën e Nikaj-Mërturit, në Krasniqe, në Gash e Bytyq të Tropojës, në Pukë e Kukës), në gjithë Kosovën si dhe në Preshevë e në Bujanovc.<sup>169</sup>

### **Ndër tipare të përbashkëta të gegërishtes verilindore me mbarë të folmet e gegërishtes merren:**

1. Kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat zanore të theksuara gojore në pak raste si këto: *hã:n* "hënë -a" ~ *ha:n* "ata hanë" (çiftet minimale që dëshmojnë këtë dukuri ndryshojnë nga një e folme në tjetrën). Por, duhet thënë se shkalla e hundorësisë së zanoreve po zvogëlohet, kanë mbetur vetëm pak çifte minimale fjalësh me kundërvënien gojore ~ hundore, d.m.th. hundorësia po defonologjizohet. Zanoret me timbër hundor po shndërrohen në variante krahinore me kushtëzim pozicional të të njëjtës fonemë.
2. Ka serinë e zanoreve të shkurtra dhe serinë e zanoreve të gjata, si fonema më vete për shkak të kundërvënies fonologjike, përkatësisht funksionit kuptimdallues, por edhe më shpesh funksionit gramatikor, në rastet si *kõs* "kos-i" ~ *ko:s* "kos-a"; *plãk*

<sup>169</sup> Asllan Hamiti - Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UIShM, Shkup, 2014, f. 197-198.

- “plak-u” ~ *pla:k* “plaka”, *shök* “shoku” ~ *sho:k* “shokë-t”, *lejlek* ~ *lejle:k* “lejlek (njëjës) ~ lejlekë (shumës)” etj.
3. Ruajtja e /n/-së ndërzanore të shqipes së moçme, përkundër rotacizmit në toskërishten në periudhën paraletrare, si *sÿni* “syri”, *pëni* “peri”, *bãna* “bëra”, *hãna* “hëna”, *lakna* “lakra” etj.
  4. Mungesa e fonemës /ë/ të theksuar (meqë në vend të saj historikisht mbarë shqipja ka pasur, gegërishtja e ka ruajtur /ã/-në ose /ẽ/-në hundore), si dhe përdorimi i kufizuar i [ë]-së së patheksuar ([ë]-në në gegërishte asnjëherë nuk e dëgjojmë as në fillim e as në fund të fjalës, ndërsa rrallë në mes të fjalës).
  5. Përdorimi i togut *vo* në fillim të fjalës: *voj*, *vorr*, *i vokt*, *votër* (në toskërishte kemi grupin *va*: vaj, var, i vakët, vatër) etj.
  6. Shumica e të folmeve gege (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej gjuhës letrare, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më në jug) për faktin se përemrat dëftorë shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *çeky* ‘ja ky’, *çekjo* ‘ja kjo’, *çekta* ‘ja këta’, *çaj* ‘ja ai’, *çajo* ‘ja ajo’, *çata* ‘ja ata’, *çeto* ‘ja ato’ etj., sesa në formën me shtritje në të dy dialektet *ky*, *kjo*, *këta*, *këto*, *ai*, *ajo*, *ata*, *ato*. Me forma të këtilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) ‘ja’ dhe një përemër dëftor *ky*: *çe+ky*, *çe+kjo* ‘ja+ky, ja kjo’... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem.* - *Çeky është gjali jem.* ‘Ky është djali im. – Ja, ky është djali im’. *Ajo a:r është ma e mira.* - *Çajo a:r është ma e mira.* ‘Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.’
  7. Ruajtja e paskajores e tipit *me* + pjesore e reduktuar gege: *me ba*;, *me punu*;, *me msu*;, *me lidh*, *me hec*, *me dal*... Paskajores gege toskërishtja i përgjigjet me lidhoren (të bëj, të punoj, të mësoj, të lidh, të ec, të dal ... ose me formën toske *për të* + pjesoren e foljes: për të bërë, për të punuar, për të mësuar, për të lidhur, për të ecur, për të dalur...).
  8. Po e përsërisim konstatimin se: në të gjitha të folmet e gegërishtes ekzistojnë edhe dy, vende-vende edhe tri, forma të mbipërbëra (folja ndihmëse ‘kam’ + pas + pjesorja e foljes): **e kryera e dytë** (*kam pas punu*;, *ki/ke pas da:l*, *ka pas shku*;, ...), **e kryera e plotë e dytë** (*kisha/kishna pas punu*;, *kishe pas da:l*, *kish pas shku*;, ...), por edhe **e kryera e tejshkuar e dytë** (*pata pas punu*;, *pate pas da:l*, *pat pas shku*;, ...).
  9. E shohim të arsyeshme të themi këtu edhe një herë se të folmet e gegërishtes kanë **pjesore të reduktuar** (të cunguar, të shkurtuar, pa mbaresa), ndërsa të folmet e toskërishtes kanë pjesore të plota, me njërën nga mbaresat -ë, -rë, -në, -ur, -uar; khs. pjesoret toske e

gege: (kam) vjelë/vjelur - *vje:l*, mbjellë/mbjellur - *mbje:ll*, marrë/marrur - *ma:rr*; thënë/thënur - *thã:n*, bërë - *bã:*, dhënë/dhënur - *dhã:n*, lënë/lënur - *lã:n*; vrarë - *vra:*, larë - *la:*, fshirë - *fshî:*, blerë - *ble:*; lidhur - *li:dh*, pjekur - *pje:k*, kullotur - *kullo:t*; lexuar - *lexu:*, mësuar - *msu:*, punuar - *punu:* etj.

Në përcaktimin e tipareve karakteristike (dalluese) që e veçojnë një grup të folmesh nga grupet e tjera, disa veçori kanë *vlerë absolute* (ato që kanë përhapje në të gjitha të folmet e atij areali), ndërsa ndonjë veçori gjuhësore ka *vlerë relative* (ai tipar që nuk përfshin të gjitha të folmet e atij grupi, por pjesën më të madhe të tij).

**Për tipare dalluese (absolute e relative) të të folmeve të gegërishtes verilindore (kosovarishtes), përfshirë edhe të folmen e Godenit, janë pranuar:**

10. Prania e fonemës /k/ në një grup fjalësh që në të folmet e tjera dalin me fonemën /q/, si: (jam) *ken, kan* "(kam) qenë", *keshi* "qeshi", *kime* "qime", *ke:p* "qepë", *kelb* "qelb", *kofsha* "qofsha", *kie* "qe", *kerr* "qerre" etj.
11. Grupet e vjetra konsonantike *kl, gl* janë reduktuar, duke mbetur vetëm elementet e para: *kl > k*, kurse *gl > g*, si në fjalët: klaj > *kaj*, klumësht > *ku:sht* "qumësht > hirrë"; gluha > *guha* "gjuha", glishti > *gishti* "gishti", gluni > *guni* "gjuri", i glatë > *iga:t* "i gjatë" etj.
12. Afrikatizimi i plotë i bashkëtingëlloreve mesgjuhore qiellzore mbylltore /q, gj/ në paragjuhoret afrikate /ç, xh/: qafë > *çaf*, qen > *çen*; gjumë > *xhu:m*, gjashtë > *xha:sht* si në mbarë Kosovën edhe në të folmen e fashtit Goden. Në inventarin konsonantik të të folmeve të Kosovës, përfshirë edhe Godenin, mungojnë tërësisht bashkëtingëlloret mesgjuhore /q, gj/; meqë të gjitha janë afrikatizuar në /ç, xh/.
13. Togjet e vjetra të shqipes *ae, oe* në këtë të folme si edhe në gjithë grupin e gegërishtes verilindore janë monoftonguar në /a:/, /o:/ të gjatë (është ruajtur zanorja e parë, ndërsa e dyta ka rënë). Kjo shpjegohet me faktin se zanorja e parë ka qenë e theksuar dhe në rrjedhë të kohës ajo është ruajtur mirë, ndërsa zanorja e patheksuar e togut është shqiptuar si më e shkurtër deri sa tani më nuk dëgjohet fare. Ky proces fonetik ka zgjatur me shekuj, duke kaluar nëpër disa faza të ndërmjetme, si: (ti) *tháe > tháe > tháe > tháe > thá* "ti the", *páe > pa:* "pe", *ráe > ra:* "re, rënë"; *vóe > vo:* "vezë, ve", *dróe > dro:* "droje, frikë". Si rregull, nga tkurrja e dy zanoreve përftohet një zanore e gjatë: Në rastin tonë *áe > a:* (a të gjatë), ndërsa *óe > o:* (o të gjatë).
14. Togjet e zanoreve *ue, ie, ye* në të folmen e Godenit si dhe shumicën e të folmeve të gegërishtes verilindore për lehtësi shqiptimi

- monoftongohen në zanoren e parë të togut, por në disa të folme edhe ruhen, andaj kemi dysi formash: *grue - gru.*; *thue - thu.*; *prue - prru.*; *diell - di:ll*, *qiell - ç:i:ll*, *miell - mi:ll*, *dye - dy:r*, *fyell - fy:ll* etj. Prirja për monoftongimin e grupeve të zanoreve *ue*, *ie*, *ye* është më e shprehur kur këto gjenden në trup të fjalës sesa në fund të fjalës.
15. Zanorja [ã] hundore në Goden ruhet e pabuzorëzuar, si në fjalët *nãna*, *bãna*, *hãna* etj.
16. Marrë në përgjithësi, grupet *mb*, *nd*, *ng* janë përngjashmuar (asimiluar) në *m*, *n*, *η*: *mbret* > *mret*, *mbaj* > *maj*, *dhamb* > *dham*; *nderoj* > *neroj*, *ndihmoj* > *ni:moj*, *ndreq* > *nreç*, *kuvendoj* > *kuvenoj*, *vend* > *ven*; *ngarkoj* > *ηarkoj*, *ngat* > *ηat*, *ngusht* > *ηusht*, *deng* > *denj* etj.
17. Emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me *-k*, *-g* ose *-h* shquhen me mbaresën *-i*: *miki*, *plaki*, *bregi*, *krahi*. Në pak të folme të gegërishtes, në të gjitha të folmet toske si dhe në shqipen standarde emrat e tillë shquarsinë e bëjnë me mbaresën *-u*: *bung-u*, *breg-u*, *prag-u* etj.
18. E pakryera është sigmatike: un *punojsha*/*punojshna*, ti *punojshe*, aj *punojke*; na *punojshmi* / *punojshëm*, ju *punojshi* / *punojshni*, ata *punojshin*. Tipike është formimi i vetës së parë njëjës të së pakryerës së dëftores së foljeve në diatezën veprorë me anë të mbaresës *-shna* (*-jshna*) dhe në vetën e tretë me anë të mbaresës *-(j)ke*: un *dalshna*, *msojshna*; aj *dalke*, *msojke*.
19. Një dukuri tjetër që do vërejtur në fushën e foljeve është se në Goden dhe në të folmet verilindore në përgjithësi është mjaft e përhapur trajta e së kryerës së formuar me të tashmen e foljes **jam** + *pjesore* në vend të **kam** + *pjesore*, sipas tipit *jam shkue*, *jam ka:n*, *jam ardh* “kam shkuar, kam qenë, kam ardhur” që shpjegohet si ndikim i sllavishtes. Sipas akad. Rexhep Ismajlit në të folmen e Preshevës kjo dukuri s’ka qitur krye deri tash, pra *kom shkue*; *kom ardh*, *kom i:k* etj., por te folja *me qenë* është bërë kjo (thuhet *jam ko:n*), ndoshta për shkak të njësimi tingullor të formave *kom* dhe *kon* (kom kon). Në disa të folme të gegërishtes qendrore kemi *kam ka:n* “kam qenë”. Sipas këtij gjuhëtari të shquar, kjo dhe disa arsye të tjera nga realiteti gjuhësor dialektologjik na shtyjnë të mendojmë se nuk mundet çdo gjë nga specifika e dialektit të shpjegohet vetëm me ndikimin e gjuhëve fqinje.<sup>170</sup>

## Mikrotoponimet

<sup>170</sup> Asllan Hamiti - Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UIShM, Shkup, 2014, f. 198-201.

Karadaku është i pasur me bimë barishtore. Përveç barit që përgjithësisht e mbulon këtë krahinë, rritet shumë fieri, hithrat, luleshtrydhja, çaji i malit, kamomili etj. Nga drunjtë rritet ahu, bingu, qarri, shkoza, dëllinja, mëshstekna, frashri, lajthia, thana etj.

Në pyjet e Karadakut jetojnë dhelpra, ujku, derri i egër, lepuri, ketri, vjedulla etj. Nga shpezët vërehen pula e egër, mullizeza, laraska, skifteri, shqiponja, dallëndyshja, qyqja, huti, gjeli i egër, pupëza, turreci, qukapiku, pëllumbi, trumcaku etj.

Klima e ashpër malore kushtëzon ndërtimin e shtëpive të tipit të mbyllur, kryesisht të ndërtuara me gurë. Brenda shtëpisë ose përbri saj shpeshherë kemi edhe oda, ahur, plevicë, garazh ose ndonjë objekt tjetër shoqërues.

Brendësia e shtëpive të dikurshme të fshatrave malore është e ngjashme me enterierin e shtëpive të moçme, tradicionale shqiptare. Oxhaku është elementi më i rëndësishëm i brendisë së shtëpisë. Në oda gjejmë dërrasa të mbështetura brinjazi në faqe të murit, që përdoren si dollap, rafte etj., që shërbejnë për të vënë dhe ruajtur enë të amvisërisë, si gjyma, gota, ibrikë, filxhanë, xhezve, tabaka, ndonjë enë zbukurimi ose edhe diçka të varur në mur, e që të gjitha, përveç anës praktike për përdorim, kanë edhe funksion estetik.

Pranë shtëpive që kanë zënë pozicione të ndryshme në oborr, ndërtohen edhe objekte të tjera bujqësore e blegtorale, si hambar, pleme, kosh, kotec ose edhe ndonjë objekt tjetër.

Në të ushqyerit shfrytëzohet çdo gjë që natyra ua dhuron dhe që mund ta sigurojnë nga veprimtaria e tyre themelore - bujqësia e blegtoria. Dikur buka e misrit, e më vonë buka e grurit ishte ushqimi kryesor dhe themelor i tyre. Konsumohen edhe gatesa të ndryshme nga brumi. Ushqimi plotësohet edhe me mish kafshësh e shpesësh shtëpiakë, ndonjëherë edhe me mish gjahu, kryesisht mish lepuri, qumësht dhe bulmet. Vend të rëndësishëm në ushqimin e banorëve të Godenit zë fasulja, patatja dhe orizi. Nga kulturat kopshtare hahen shumë domatet dhe specat, ndërsa nga pemët kultivohet e hahet qershia, molla, kumbulla, dardha, vojsa etj.

Marrë në përgjithësi, me sundimin pesëshkullor të perandorisë Osmane në Kosovë, edhe te shqiptarët e Karadakut të Gjilanit mbizotëron kultura orientale e kuzhinës.

Me shpopullimin e këtij fshati, vdekjen e plakave e të pleqve të rinjtë më nuk do të mbajnë mend emrat e vendeve të vogla të kësaj zone malore. Ato mund të humbasin përgjithmonë. Pikërisht, ky qe edhe motivi kryesor për të regjistruar, shtjelluar e renditur në formën e një fjalorthi mikrotoponime që arritëm t'i dëgjonim nga goja e pleqve të këtij fshati. Shpresojmë se kështu së paku do të mund të shpëtojmë nga zhdukja pa lënë gjurmë forma e tyre gjuhësore:

Po japim disa mikrotoponime në e afër fshatit Goden që i dinë ende banorët që janë gjallë:

- **Ahishta** – mal me dru ahu
- **Ara Ademit** – arë që duhet të ketë qenë në pronësi të Ademit
- **Ara Ajetit** - arë që duhet të ketë qenë në pronësi të Ajetit
- **Ara Re** - vend me drunj që është shndërruar në tokë të punës vonë
- **Ara Sherifit** – arë, pronë e Sherifit
- **Buñishti** – pjesë mali me dru bungu
- **Gashtica** – pronë e fisit Gashi
- **Guri Zi** - gurë i madh me ngjyrë të zezë që gjendet larg Godenit, në afërsi të fshatit Brezë të Karadakut të Shkupit, Maqedoni e Veriut
- **Hala Tafës** – nevojtoare e dikurshme e Tafës (Mustafës). Në FESH fjala *hale f. sh. bised.* shpjegohet se ka kuptimin nevojtoare
- **Hija** – vend ku e kaplon shumë hija
- **Kllaçet** – vend moçalik. *Kllaçë f. sh.* 1. Gropë e vogël me baltë e me ujë në mes të udhës ose në një vend tjetër, që krijohet pas shiut, pas shkrirjes së borës, nga gjurmët e kafshëve etj. Kaloi nëpër kllaça. 2. Batak; ligatë (FESH).
- **Kodra Bojës** – kodër që ndryshon ngjyrën varësisht nga kushtet klimatike
- **Kodra Ga:t** – kodër që ka formë të zgjatur
- **Kodra Madhe** – kodër e lartë, më e madhja me sipërfaqe afër fshatit
- **Kodra Shku:rt** – sipas pamjes është një kodër e shkurtër
- **Korrizi** - kodër e thepisur në formë kurrizi
- **Lejthishta** – vend ku rriten shumë lajthitë
- **Lisi Bletës** – lis në zbrazëtirën e të cilit jetonin bletët
- **Lisi me Bari** – lis në trupin e të cilit është rritur edhe bari
- **Livadh i Hutit** – livadh ku rregullisht ka jetuar ndonjë hut
- **Lugi Firit** – lug me plot fier. Në FESH shkruan: *fier m. bot.* Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të hollë, me gjethe të gjelbra e të dhëmbëzuara në trajtën e një puple, pa lule, e cila rritet nëpër pyje e në toka të varfra e të thata dhe përdoret zakonisht për t'ua shtruar bagëtive, për të mbuluar kasollet etj. Në Karadak fieri është përdorur jo vetëm për të mbuluar shtëpitë, kasollet, plevicat etj., por fier kanë shtruar edhe për të ndejtur ose fjetur mbi të.
- **Lugi Dafinës** – lug ku është rritur dafina. Kuptimin themelor të emrit *dafinë f. sh.* FESH e jep me përkufizimin: 1. *bot.* Dru a shkurre që rritet në vendet mesdhetare, me gjethe gjithmonë të gjelbra e me erë të këndshme, që bën kokrra të vogla me ngjyrë të errët.

- **Lugi Mjedrave** – lug ku janë rritur mjedrat. Në FESH lexojmë: *mjedër f. sh. 1. bot.* Shkurre deri një metër e lartë, me kërcell zakonisht me gjemba të hollë, që lidh kokrra të kuqe, të ëmbla e me erë të mirë, të ngjashme me ato të manaferrës; fryti i kësaj shkurreje.
- **Lugi Spicave** – lug prej ku e kanë marrë drurin për përpunim e spicave. Fjala *spic-a* këtu e ka kuptimin secili nga drunjat që lidhin bucelën me rrethin e rrotës së qerres, të karrocës etj.; rreze. *Spicat e rrotës.*
- **Karaulla** – vend ku qëndronte roja, patrulla, vendrojtë afër fshtrave Brezë e Goshincë. Duhet të jetë përfutur nga fjala turke karakoll-i *m.* – rojë, patrullë), *arm.* Ndërtesë e thjeshtë dhe e ngushtë, e ngritur si kullë me mur ose prej dërrase, ku qëndronte roja që ruante kufirin, hyrjen në një repart ushtarak etj.; roja vetë; trupa e rojës.<sup>171</sup>
- **Kopilaça** – mal larg Godenit, por që e dinë këtë emër edhe fshatarët e këtij katundi. Banorët e Brezës e të Goshincës e kanë quajtur këtë vend malor kështu për shkak se aty paskan jetuar dikush që ka bërë kopila. Mal i shpeshtë, topoleksemë e përhapur në gjithë Ballkanin. Në gjuhët sllave del me rrjedhoja të shumta, si kopil (mashkull), kopilicë (femër), Kopilaç (vend kopilash).
- **Mrizi** – vend ku ka mrizuar bagëtia. *Mriz m. sh.* “vend i freskët e me hije ku kalojnë vapën bagëtia, mërzim; hije; koha e vapës me të madhe gjatë ditës, mesdita (FESH).
- **Plepishta** – vend ku është rritur plepi
- **Prroni Gashticës** – përrua i fisit Gash
- **Prroni Shullanit** – përrua që gjendet afër Kodrës së Shullanit. FESH fjalën *shullë m. sh.* e shpjegon si “vend që e zë dielli mirë e që nuk e rreh era.”
- **Resula** – mal në pronësi të Resultit
- **Roga Kadës** – lëndinë e Kadishes (në formë të cunguar Kadës)
- **Roga Çikave** – lëndinë ku shpeshherë janë mbledhur vajzat. Në Goden çikë = vajzë.
- **Rovina** – vend me llagëme, hendeqe. Fjala *rov* në sllavishte do të thotë llagëm, hendek. Ky mikrotoponim është formuar me sllavizmin *rov* + prapashtesën *-ina* = *rov+ina* > Rovina.
- **Rrashi** – pjesë e rrafshët që gjendet afër shtëpive të dikurshme të familjeve Hamiti dhe pronë e tyre, rrafsh
- **Rreze** – vend me shumë diell
- **Shpati** – kodrinë e pjerrët

---

<sup>171</sup> Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 373.



- **Shullāni** – vend që e kap dielli nga mëngjesi e deri në mbrëmje (ky emër rrjesh nga latinishtja ‘solinum’ – vend rrezesh të diellit, vend me shumë diell
- **Te Gurinat** – vend me shumë gur; gur > shumësi: guri + prapashtesa e shumësit në trajtën e shquar -na-t = gurinat, me parafjalën te).
- **Te Humza** – vend me një lloj dheu që quhet humus
- **Te Lloçi** – vend me shumë lagështi, me baltë
- **Tek La:jn Petka** - përrua ku dikur gratë kanë larë tesha (petka)
- **Trolli** – vend i dedikuar për të ndërtuar shtëpi
- **Tuma Madhe** – pjesë e madhe e ngritur e tokës
- **Tuma Vogël** – pjesë e vogël e ngritur e tokës
- **Tupani** - lendinë në maje të kodrës, në kufi me fshatin Stançiç që i përket Kosovës. Katundarët e Stançiçit njiheshin për valltarë të mirë. Këtu shpesh kanë rënë tupanat dhe kanë vallazuar burrat e fshatrave përreth.
- **Vidhat** – vend me llojin e drurit vidh. *Vidh m. sh. bot.* 1. Dru i lartë që rritet nëpër pyje, me trung të drejtë, me kurorë të gjerë, me gjethe vezake të mprehta në majë, me lëvore në ngjyrë të kuqërremtë, që ka lëndë të fortë dhe përdoret në ndërtim e për mobilie (FESH).
- **Zabeli Bajrës** – një zabel, pronë e Bajrës. Në Fjalorin shpjegues të shqipës fjala *zabel m. sh.* përkufizohet se është “pyll i vogël e i dendur a pjesë pylli e ndarë më vete, koriye; vend me drurë e me shkurre të dendura.”
- **Zharina** – vend i ngrohtë, me diell, ku gjithnjë bën vapë. Fjala zhar është sllavizëm që ka kuptimin gacë, zjarr. Pra, këtu kemi *zhar+ina* > Zharina.

Dukuri e përgjithshme për të gjitha gjuhët e botës është se toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe burojnë kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativa).

Në toponiminë shqiptare, përfshirë edhe në atë të Godenit e përgjithësisht të rajonit të Karadikut, mënyra kryesore e emërtimit të viseve ka karakter universal. Aty dallohen:

1) Emërtime vendesh që shprehin ngjyrën, përbërjen e tokës dhe sipas ndonjë specifike tjetër: *Kodra Bojës, Guri Zi, Te Humza, Te Lloçi, Tuma Madhe, Tuma Vogël, Kodra Madhe, Kodra Ga:t, Rovina, Shpati, Shullāni, Te Gurinat, Zharina, Kllaçet* etj.

2) Mikrotoponime që përmbajnë emra të bimëve, drunjve, shkurreve dhe kulturave bimore që rriten ose janë rritur në të kaluarën: *Vidhat, Bungisht, Ahishta, Lugi Mjdrave, Lugi Firit, Lajthishta* etj.

3) Sipas antroponimeve e patronimeve: *Ara Ademit, Ara Ajetit, Ara Sherifit, Hala Tafës, Prroni Gashticës, Resula, Zabeli Bajrës* etj.

4) Toponime që përmbajnë emra kafshësh, si: *Lisi Bletës, Livadhi Hutit*.

### Etimologjia e toponimeve

Konstatimi i përgjithshëm është se mbizotërojnë emërvendet me prejardhje nga shqipja, të tipit *Ara Ademit, Ara Ajetit, Ara Re, Ara Sherifit, Bungishti, Guri Zi, Hija, Korrizi, Kodra Madhe, Rreze, Shpati, Rrafshi, Prroni Gashticës*; ndërsa fare pak mikrotoponime me etimologji joshqipe, si fjalët sllave *Kllaçi, Rovina, Zharina, Zabeli*; me prejarshje nga turqishtja, si *Karull, Kopilaç* ose latine: *Shullāni* (nga solinum). **Emërvendet e shumta me origjinë ilire-shqiptare janë edhe një dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë në rrjedhë të kohës.**

### Mënyra e fjalëformimit të mikrotoponimeve

Sipas mënyrës së fjalëformimit këtu dallojmë emra të parmë, të cilët mbizotërojnë dhe emra të prejardhur.

*Toponime të parmë* (rrënjorë): *Mrizi, Rrafshi, Shpati, Rreze, Vidhat, Shullani, Trolli, Lugi, Reka, Kodra, Zabeli, Ara, Roga, Prroni* etj.

*Toponime të prejardhura*, me prapashtesim: -ishtë: *Ahisht, Plepi-isht*; -inë: *Rovi:n* etj.

### Struktura gramatikore e mikrotoponimeve

Emërtimet me togfjalësha në mikrotoponiminë e fshatit Goden, si edhe në treva të tjera, janë të rëndomtë. Kjo formë e ndërtimit mbizotëron krahasuar me ndërtimin me fjalë të parme dhe të prejardhura. Më të shpeshta janë mikrotiponimet **emër + përcaktor**, që mund të jenë:

a) **emër + emër personal** në rasën gjinore: që të dy elementet e togfjalëshit janë në njëjës in e shquar, me çrast emri i dytë në rasën gjinore shënon pronarin: *Ara Ademit, Ara Ajetit, Ara Sherifit, Hala Tafës, Roga Kadës, Zabeli Bajrës* etj.

b) emër + emër i përgjithshëm në gjinore: *Lugi Firit, Lugi Dafinës, Lugi Mjedrave, Lugi Spicave, Tuma Madhe, Tuma Vogël, Roga Çikave*.

c) **emër + emër kafshësh** në rasën gjinore në shumës: *Lisi Bletës, Livadhi Hutit*.

c) **emër + mbiemër** që tregon ngjyrën, madhësinë, formën madhësi, pozitë, largësi ose ndonjë veçori tjetër, si: *Kodra Bojës, Kodra Madhe, Kodra Shkurt, Ara Re* etj.

ç) I pranishëm është edhe konstrukti me parafjalën **te + emër**: *Te Gurinat, Te Lloçi, Te Humza* etj.

## Tiparet fonetike-fonologjike të toponimeve

Nga pikëpamja fonetike e fonologjike në toponiminë e fshatit Goden na dalin këto veçori:

Gjatësia dhe hundorësia e zanoreve kanë lënë gjurmë edhe në toponiminë e Godenit, si në emrat: *Kodra Ga:t* (< *Kodra e Gatë, Kodra e Gjatë, Kodra e Glatë*), *Shullã,-ni, Tek La:jn Petka* etj.

Përdorimi i shumëdridhëses /rr/: *Rreze, Rrashi, Prroni Gashticës, Prroni Shullãnit* etj.

Nga mikrotoponimi *Bunisht-i* arijmë të nxjerrim si përfundim se në të folmen e Godenit, si dhe të mbarë gegërishtes verilindore (kosovarishtes) grupi i bashkëtingëlloreve [ng] është përngjashmuar (asimiluar), më saktësisht është shkruar në [ŋ].

Grupi [fsh] është përngjashmuar (asimiluar) në [sh]. Kjo dukuri fonetike dëshmohej te emri *Rrash-i* (< *Rrafshi*).

Për shkak të ekonomizimit dhe lehtësimit të shqiptimit, në mbarë leksikon toponomastik të rajonit të Karadakut shfaqet elizioni, përkatësisht mosshqiptimi i nyjave të përparme *i* dhe *e* të emrave në rasën gjinore e të mbiemrave, por edhe i [ë]-së së patheksuar në fjalët shërbyese, sipas tipit *Prroni Gashticës* (< *Prroni i Gashticës*), *Prroni Shullanit* (< *Prroni i Shullanit*), *Roga Kadës* (< *Roga e Kadës*), *Roga Çikave* (< *Roga e Çikave*), *Tuma Madhe* (< *Tuma e Madhe*), *Tuma Vogël* (< *Tuma e Vogël*), *Zabeli Bajrës* (< *Zabeli i Bajrës*) etj.

## ANEGDOTA

### Gajlet e huja<sup>172</sup>

Kishin pas shku: do t'Kosovës me krenu: nifar pune n'Shqipni. Qaty përmi Shkodër tu shku: udhës zateten me ni çik qe po i grahke ni magari. Këtyne burrave ju duk se e kish ngarku: shumë magarin edhe po i tho:n:

- Pse be çikë e ke ngarku: kaç shumë magarin? Koka ba me tu dhi:mt.
- Nuk asht magar, jav kthej çika.
- E çka asht pra, - keshën krent e Kosovës.
- Asht shërbyesi i shpi:s.
- Po kujna i thoni ju magar? Ju gut njanit prej burrave.
- Çatyne çë i ba:jn gajlet e huja, - jav kthej çika.

*Rrëfeu: Efi Agushi, më 6 nëntor 2008<sup>173</sup> nga f. Goden i Gjilanit, me shkollë filllore, 73 vjeç.*

<sup>172</sup> Raif Hamiti, *Godeni i Gjilanit (monografi)*, Intergraf, Ferizaj, 2019, f. 139-140.

<sup>173</sup> Efi Agushi lindi më 03. 06. 1944 në fshatin Goden. Shkollën filllore e mbaroi në fshatin Pidiç dhe Shurdhan. Më 1968 (në moshën 24 vjeçe) shkoi në Gjenevë të

### **E pa:sh boll viran e nuk e dita që po ma kthen kaç ra:n**

Çohen e shko:jn do t'katunit to:n n'Zhegër, me ni t'pame. U ka:n fukarallëk i madh n'at ko:h n'Karadak. I pari çu u prijke ish ka:n Hamit Godeni. Krejt pantollet i kish pa:s me harrna. Kur hi:n aty, po ju japin ngushllime. Ni plak musafir, çu pijke duhan me cigarllak çelibari, i vet:

- Prej kah jeni?
- Prej Karadaki, prej Godenve.
- Ka pa:s burra t'mi:r n'Karadak – po thot plaki.
- Po, Valla, Po - ja kthen Hamiti. “Bile tu ardh n't'pame, i ram kah vorret. Edhe na vetën. Ku po shkoni? U kallxu:m çu po shko:jm n'Zhegër për me pa:”. Shkoni, shkoni, na tha:n, se besa nuk ja:n as ata burra ma t'mir se ju.

Masi ishin çu, k'ta ta:nt, ai plaki kish pas tha:n:

- “E pa:së boll viran, e nuk e dita se po me kthen kaç ra:n”.

*Rrëfeu: Efi Agushi, më 13 mars 2017 nga f. Goden i Gjilanit, me shkollë filllore, 73 vjeç.*

### **Mem pa cullak trishtohesh**

A ka:n nifar Dulla i Kurexhve. Fort keç i ka pas pu:nt, fukarallëk. Ni dit do gra t'kojshive po e vesin.

- Qysh je, o aga Dull?
- Po viran be bi, viran – ja kthen Dulla.
- Kshtu mir po dukesh - pe nçuc njana.
- Po Valla – po mem pa cullak trishtohesh, - ja kthen Dulla. Tu menu çe ish ba krejt asht e lkurë. Grat çera ja krisën gazit.<sup>174</sup>

*Rrëfeu: Efi Agushi, më 13 mars 2017 nga f. Goden i Gjilanit, me shkollë filllore, 73 vjeç.*

### **Literatura:**

Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UISHM, Shkup, 2014.

Hamiti, Raif, *Godeni i Gjilanit (monografi)*, Intergraf, Ferizaj, 2019.

Informator, Elfi Agushi, Ferizaj, 2017.

Ndreca, Mikel, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Rilindja, Prishtinë, 1986.

Qendra rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjilan, *Trashëgimia kulturore e rajonit të Gjilanit*, Gjilan, 2018.

---

Zvicrës, ku punoi dhe u mor me veprimtari patriotike. Tani është në pension dhe jeton herë në Ferizaj e herë në Gjenevë të Zvicrës.

<sup>174</sup> *Trashëgimia kulturore e rajonit të Gjilanit*, Qendra rajonale për Trashëgimi Kulturore, Gjilan, 2018.

### 13. TOPONIMIA DHE MIKROTOPONIMIA SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT - DËSHMI E AUTOKTONISË<sup>175</sup>

Shpeshherë është thënë e po thuhet jo rrallë se: shqiptarët në Maqedoninë e sotme nuk janë vendës, por kolonë të ardhur pas shekullit XVI me dyndje të herëpashershme në shekujt XVII, XVIII, XIX e deri në shekullin XX. Edhe në Enciklopedinë Maqedonase, në zërin për shqiptarët lihet të kuptohet se shqiptarët nuk kanë qenë të pranishëm në viset e sotme të Maqedonisë as në Antikitët, as në Mesjetë.

Në tribunën shkencore që bashkorganizuan Instituti i Gjuhës Maqedonase “Kërste Misirkov” dhe Katedra e Maqedonishtes së Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup në temë “Standardizimi i emrave gjeografikë në Republikën e Maqedonisë”, Shkup, 2004<sup>176</sup> u tha e u përsërit disa herë se: me versionin në shqip të Ligjit për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 55, 16 gusht 2004 po bëhet përkthimi, çmaqedonizimi dhe albanizimi i emrave gjeografikë në Maqedoni (Институт, 2004: 18-20). Në këtë drejtim, shkohet edhe më larg duke thënë se: toponimia e Maqedonisë me shekuj është krijuar dhe formuar nga maqedonasit. Së këndejmi, na duket se është krejtësisht e natyrshme që në kuadrin e toponimisë maqedonase të veprojë tradita maqedonase (Станковска - Миовски, 2004: 22). Përveç tjerash, thuhet edhe se po mohohet tradita ekzistuese maqedonase dhe po ndërrohet toponima maqedonase, d.m.th. po albanizohet. Përkthimi ka përfshirë, para së gjithash, emrat e vendbanimeve si dhe emrat e tjerë gjeografikë aq shumë saqë jo vetëm që çënon, por krijon destruksion të përgjithshëm të sistemit toponimik maqedonas në planin gjuhësor, etnik dhe komunikues (Станковска - Миовски, 2004: 24-27).<sup>177</sup> Përkundër shqiptarëve, turqit kanë qenë këtu 500 vjet, por nuk kanë bërë riemërtimin e ojkonimeve, bile as të mikrotoponimeve... (Стаматоски, 2004: 103). Në kumtimin e vet një pjesëmarrës propozoi që gjatë transkriptimit të toponimeve gjithnjë të ruhet forma maqedonase (Јачева - Улчар, 2004: 49-58).

<sup>175</sup> Kumtesë imja e lexuar dhe e botuar, *Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoni – dëshmi e autoktonisë*, Scupi V, ITShKSh, Shkup, 2014, f. 101-124.

<sup>176</sup> Институт за македонски јазик “Крсте Мисирков” - Скопје, Јазикот наш денешен - книга 11, *Стандардизацијата на географските имиња во Република Македонија*, Зборник на трудови од трибината одржана на 30 септември 2004 година, Скопје, 2004.

<sup>177</sup> “... барањата за рамноправност и во рамките на употребата на топонимите, односно на географските имиња, а што во основа се сведува на барање за промена на македонскиот топонимски систем, односно за негова албанизација”.

Në një kumtesë tjetër për gjoja depërtimin e dhunshëm të elementit shqiptar në Maqedoni (në aspektin gjuhësor), me paragjykim, që kurrë nuk e ka shënuar historia, thuhet se “ekspansioni më i madh - ekspansioni i furishëm, shkatërrimtar dhe gjakatar (dyndjet në lindje dhe në jug) kanë ndodhur nga fundi i shekullit XVII dhe në shekujt XVIII-XIX... Jeta e popullatës ortodokse maqedonase në kushtet e terrorit të paparë që vazhdimisht e kanë ushtruar shqiptarët gjatë ekspansionit të tyre në lindje, qe vështirësuar tej mase, jo vetëm për shkak të torturës dhe shfarosjes që ushtronin ekspansionistët, por edhe për shkak të tagrave të shumta që mbliidhte pushteti turk... (Пеев, 2004: 31-41).”

Një pjesëmarrës në diskutimin e tij jep disa të dhëna të rëndësishme e interesante: “në Republikën e Maqedonisë ka afër 1800 vendbanime. Në shkencë është vërtetuar se 90% e këtyre emërve kanë etimologji maqedonase, përkatësisht sllave, ndërsa vetëm 10% kanë burim gjuhësh të tjera, nga substrati (kryesisht iliro-trakas), turqishtja si dhe disa emra të trashëguar nga administrimi serb në Maqedoni... Më duket shumë interesante që në ojkonimi, edhe krahas bashkëjetesës me shqiptarët në disa vende në Maqedoni, vetëm një - Qafa, në qarkun e Gostivarit është me prejardhje nga shqipja. Kjo është formë shqipe, sipas greqishtes *Gjavato* ‘kalim, shteg’, siç e ka edhe maqedonishtja ‘премин’. Do të thotë, (shqiptarët) nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi, nëse paskan jetuar këtu, ose, siç thonë se me shekuj Maqedonia Perëndimore paskësh qenë e tyre... (Стамароски, 2004: 102-108)”.

Mbështetjen kryesore për të mohuar vazhdimësinë ilire - shqiptare, rrjedhimisht edhe autoktoninë e shqiptarëve në Ballkan, përfshirë edhe autoktoninë e shqiptarëve në Maqedoni, përpiqen ta gjejnë në përhapjen e dendur të toponimeve sllave në Gadishullin Ballkanik. Të dhënat historike e studimet toponomastike dëshmojnë se toponimet sllave, të cilat sot janë të përhapura jo vetëm në viset shqiptare të Maqedonisë, por edhe në mbarë Gadishullin Ballkanik, nuk ndeshen në shekujt e hershëm mesjetarë. Ato në burimet dokumentare dalin më vonë, përkatësisht pas shekullit XI e këtej (Frashëri, 2009: 9-10).

Në artikullin analitik me peshë “E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit”, botuar në gazetën Shqip të 09-10 dhjetorit 2009, historiani i njohur shqiptar, prof. Kristo Frashëri flet bindshëm për gabime metodike dhe faktologjike të rënda të Enciklopedisë.

Gabimi i parë i palejueshëm për historianët, madje edhe për mësuesit e shkollave të mesme, është “shkelja e parimit më elementar të metodologjisë shkencore të historiografisë, e cila kërkon që ngjarjet historike të shihen në kohë dhe në hapësirë përkatëse. Është pikërisht ky gabim që vihet re në zërin “shqiptarët e Maqedonisë” në Enciklopedinë maqedonase. Në bazë të këtij parimi, Maqedonia antike nuk duhet të

identifikohet as për nga shtrirja gjeografike, as për nga etnikoni i banorëve me Republikën e Maqedonisë së ditëve tona. Para së gjithash meqë shtrirja gjeografike e Maqedonisë, gjatë shekujve nuk ka qenë kurdoherë e njëjtë. Kohë pas kohe, kufijtë e saj territorialë kanë pësuar luhatje. Madje, ka pasur raste kur emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur krejtësisht jashtë kufijve të sotshëm të saj... Është e vërtetë se herë pas here emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur, por zhvendosja ka ndodhur kryesisht drejt lindjes deri në Selanik e përtej dhe asnjëherë drejt veriut, në kurriz të provincës së Dardanisë... Si përfundim, nuk është e drejtë orvatja e disa historianëve, të cilët kur ngjarje që kanë ndodhur në brezin jugor të Dardanisë antike i përfshijnë si ngjarje që i takojnë Maqedonisë antike dhe mesjetare (Frashëri, 2009: 9-10).

Kur flet për strukturën etnike të Maqedonisë në shekullin VI, në pragun e dyndjeve sllave, prof. Kristo Frashëri thotë: “Para se sllavët të vendoseshin në Gadishullin Ballkanik, pra para Mesjetës së hershme, maqedonët e sotshëm, si pjesëtarë të etnive sllave, banonin në stepat e Ruisë. Nuk dimë të ketë historianë që ta kenë ndriçuar parahistorinë e sllavëve, pra historinë kur ata jetonin në atdheun e tyre të hershëm, e cila është ende thellësisht e errët. Në fakt, etnogjeneza e maqedonëve të sotshëm fillon me dyndjet e tyre nga stepat ruse dhe me ngulitjen e tyre në trevat ballkanike. Pra, fillon kur ata u bënë fqinj me popullatat ilire, të cilat banonin në Gadishullin Ballkanik që nga agimi i historisë e këtej. Megjithatë, procesi i formimit të etnisë maqedone apo i paraardhësve të tyre bullgaro-sllavëve nuk u krye menjëherë pas vendosjes së tyre në Gadishullin Ballkanik. Ai pushton shekujt e Mesjetës së hershme” (Frashëri, 2009: 9-10).

Një varg dijetarësh të shquar: historianë, arkeologë e gjuhëtarë shqiptarë e të huaj kanë sjellë një sërë argumentesh historike dhe gjuhësore për origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Disa nga argumentet e vazhdimësisë ilire - shqiptare dhe e autoktonisë, tani më të njohura botërisht janë këto:

1. Shqiptarët banojnë sot në një pjesë të trojeve, ku në periudhën antike kanë banuar popullsi ilire; nga ana tjetër, në burimet historike nuk njihet ndonjë emigrim i shqiptarëve nga vise të tjera në trojet e sotme. Sipas Eqrem Çabejt, vendbanimi i sotëm i shqiptarëve nuk është një trevë ekspansioni, po një trevë restriksioni, përfundim i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë.
2. Një pjesë e elementeve gjuhësore: emra vendesh, fisesh, emra njerëzish, glosa, etj., që janë njohur si ilire, gjejnë shpjegim me anë të gjuhës shqipe.
3. Format e toponimeve të lashta të trojeve ilire shqiptare, të krahasuara me format përgjegjëse të sotme, provojnë se ato janë

zhvilluar sipas rregullave të fonetikës historike të shqipes, d.m.th. kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse.

4. Marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten tregojnë se shqipja është formuar dhe është zhvilluar në fqinjësi me këto dy gjuhë këtu në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.
5. Të dhënat arkeologjike dhe ato të kulturës materiale e shpirtërore, dëshmojnë se ka vijimësi kulturore nga ilirët antikë te shqiptarët e sotëm.

Studimet onomastike shqiptare dëshmojnë se shumë toponime (emra qytetesh, malesh e lumenjsh) të Ballkanit, përfshirë edhe territorin e sotëm të Maqedonisë së Veriut janë të lidhura me shtresën ilire, si **Shkup** (nga forma e lashtë Skupi), **Mali Sharr** (Skardus Mons), **Vardar** (Bardouarios, Bardaros, Bardarion, Bardarus, Bardarum, Bardal, Vardarus, Vardar, nga bard, bardh, bardhar 'lumë i bardhë'), Kërçova në antikë njihet si **Uscana**, Hyskana, Uskana, **Dibër** (Deborus), **Shtip** (Astibos), emra njerëzish e vendbanimesh **Bardus**, **Bardhovec**, **Bardovc** (nga bardh) etj.

Onomastika shqiptare ka arritur në përfundim se edhe tek emrat e mbiemrat e njerëzve shihen përputhje të ilirishtes me shqipen. Ka analogji emrash ilirë, si **Bardus**, **Barduli**, **Bardyllis** me të shqipes **Bardhyl** (që të gjithë përmbajnë fjalën 'bardh'; ilir. **Dasius**, **Dassius**, **Dasimus** - shq. **Dash-i**; ilir. **Bato** - shq. **Bato**; ilir. **Lacius** - shq. **Laç-i**; fisi ilir në Shqipëri të Mesme **Taulantët** - shq. emër personal **Taulant**; emri i ilirëve - shq. emër njeriu **Ilir**; emri i mbretëreshës **Teuta** - shq. emër femre **Teuta**; emri i fisit ilir **Dardan** - shq. emër njeriu **Dardan**, -e dhe emër lagjeje **Dardani**.


Emra vendesh, mëhallësh e njerëzish me rrënjën **Alb-**, **Arb-**, **Arn-**, **Arv-**, si **Albincë**, **Allbanaic**; **Arbnesh**, **Arbëresh**, **Arbër**, **Arbën**, **Arben**; **Arbinovë**, **Arbanashko**, **Arbanasi**, **Arbino**, **Arnaut**, **Arnavud**, **Arbasanci**, **Arvati**; **Arnaudov**, **Arnaqi**, **Arbanash**, **Arbanas** dëgjohen dendur në truallin e Ballkanit, përfshirë edhe gjithë Maqedoninë.



Të dhënat historike dëshmojnë se fise ilire që në shekujt V-VI para erës sonë kanë banuar pjesën më të madhe të territorit të Maqedonisë së sotme. Dihet mirëfilli se **Enkelejtë** ishin banorë të trevës së liqenit Lihnid (liqeni i Ohrit), **Linkestët** ilirë përreth Manastirit, **Deriopët** në rrethinën e Prilepit, **Dasaretët**, një nga fiset e mëdha të Ilirisë Jugore, banorë të krahinës Dasaretia, që përfshinte edhe pjesën perëndimore të liqenit Ohrit. **Dardanët** me qendër në Shkup, jetonin në pjesën veriore të Maqedonisë, në gjithë Kosovën, përkatësisht në një territor të gjerë, në trekëndëshin Shkup - Nish - Sofje. **Paionët** ishin një grup fisesh ilire që banonin në luginën e sipërme të Aksiosit (Vardari) dhe degëve të tij, duke u shtrirë në Lindje deri te lugina e Strymonit (Struma) në kufi me fise trake, në Perëndim në kufi me dardanët, penestët dhe dasaretët e Ilirisë.

Ndihmesë të madhe për gjuhësinë shqiptare, veçmas për onomastikën, duke e mbrojtur origjinën ilire të shqiptarëve, kanë dhënë Norbert Jokli, Xylanderi, Miklosichi, Johan G. fon Hahni, Holger Pedersen, G. Vajgandi, Petar Skoku, Herman Hirti, Konstatin Jereçeku, Albert Thumbi,


Meyeri, Vaclav Cimohovski, Paul Kreçmeri, Konstatin Jireçeku, Petar Skoku, Radoslav Katiçiqi, Karlo Tagliavini etj. Nga studiuesit shqiptarë për çështje të onomastikës shquhen prof. Eqrem Çabej, Mahir Domi, Kolë Luka, Palok Daka, Aleksandër Xhuvani, Shaban Demiraj, Gjovalin Shkurtaj, Seit Mansaku, Xhelal Ylli, Xhevat Lloshi (Shqipëri); Aleksandër Stipçeviq (arbnesh i Zarës), Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Shefki Sejdiu, Rexhep Doçi, Skender Gashi, Baftjar Kryeziu, Begzad Baliu (Kosovë), Desnickaja (albanologe ruse); Qemal Murati, Xhemaludin Idrizi, Mustafa Ibrahim, Izmit Durmishi, Asllan



Hamiti (Maqedoni e Veriut), Ruzhdi Ushaku (Mal të Zi), Zef Valentini (Itali), Fatos Rrapaj (Çamëri), Jusuf Shpuza por edhe një numër i madh gjuhëtarësh të tjerë, të cilët në përshkrimet dialektore të të folmeve, kanë shpjeguar edhe emrat e vendeve e të njerëzve që i takojnë atij areali.

**Të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut si dëshmi për vjetërsinë e shqiptarëve në këto troje.** Autoktonia e shqiptarëve, banimi e tyre që nga lashtësia në tokat e Ballkanit, pavarësisht kufijve të sotëm shtetërorë, përkatësisht vazhdimësia etnike dhe gjuhësore jona gjen mbështetje të fuqishme edhe në të dhënat e dialektologjisë. Të folmet shqipe brenda territorit të Shqipërisë, ato të Kosovës, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut përbëjnë një tërësi të pandërprerë me tipare gjuhësore të shkallëshkallshme. Dihet mirëfilli se të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, nga të folmet më veriore: të folmet e Kumanovës dhe të Karadakut të Shkupit e deri në të folmet e Strugës i takojnë gegërishtes qendrore. Pra, në të folmet lindore të gegërishtes qendrore përfshihen Kumanova me rrethinë, Shkupi, Tetova, Prilepi, Krusheva, Velesi, Kërçova, Gostivari, Dibra dhe pjesa veriore e qarkut të Strugës. Siç dihet, të folme shqipe në Maqedoninë e Veriut, të folmet lindore të gegërishtes qendrore, kanë simotrat e tyre: të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore, që shtrihen pa ndërprerje dhe kanë po të njëjtat tipare gjuhësore me të folmet e Shqipërisë, përkatësisht ato të Fushë-Krujës, të Krujës, të Malësisë së Madhe, të Matit, të Mirditës, të Lumës, të Peshkopisë. Siç dihet, të folmet që sapo u përmendën përbëjnë një izoglosë, një tërësi dialektore, pra janë shumë homogjene: i takojnë dialektit të gegërishtes, nëndialektit të gegërishtes jugore dhe grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore.

Siç dihet, në të folmet e gegërishtes qendrore, në dallim nga të



folmet e tjera shqipe e joshqipe në Ballkan, janë zhvilluar disa risi (inovacione) fonetike: diftongimi i zanoreve /í/ dhe /ú/ të theksuara, zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/, qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] dhe evoluimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] në shkallë të ndryshme qiellzorëzimi. Çmojmë si të dobishme në këtë rast për lexuesit të japim pak shpjegime për këto inovacione fonetike

karakteristike për të folmet e gegërishtes qendrore:

a) Diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara. Në pozitë të theksuar, /í/-ja shpërbëhet në variante diftongjesh [âi], [êi], [êi], [ôi]: *shpí* > *shpâi*, *shpêi*, *shpêi*, *shpôi*; /y/-ja është zhbuzorëzuar në /i/ dhe më vonë ka pësuar të njëjtën rrugë zhvillimi, është diftonguar si edhe /i/-ja parësore: *sy* > *si* > *sâi*, *sêi*, *sêi*, *sôi*; ndërsa /ú/-ja shpërbëhet në diftongjet [âu], [ôu], [êu], sipas tipit nuse > *nâuse*, *nôuse*, *nêuse* e në shumë fjalë të tjera.

Nga monografite dhe skicat dialektore mund të nxirret si përfundim se në gegërishten qendrore në pozita të caktuara fonetike në formë të diftonguar përdoren jo pak fjalë shqipe, huazime latine, greke si dhe huazime të hershme sllave e turke. Përgjithësisht, huazimet e vonshme sllave shqiptohen të padiftonguara, si *raki*, *bollni:c* < *bollnica* 'spital', *stani:c* < *stanica* 'stacion', *grani:c* < *granica* 'kufi', *stoli:c* < *stolica* 'karrige' etj. Edhe te huazimet turke kemi forma të dyfishta, të padiftonguara, si *jeshil*, *katil*, *pestil*, *gjigjim*, *sifir*, *bitis*, *kurtalis*, *terezi* etj. dhe të diftonguara, si *xhamâi*, *munaîik*, *paîarllâik*, *begenâis*, *iqindâi*, *askerllâik*, *temcâi*, *çivâi*, *axhamâi*, *saballâik* etj. Edhe toponimet anase shqiptohen në formë të diftonguar, si p.sh. në Karadakun e Shkupit: *Haraçâin* 'Haraçinë', *Grushâin* 'Grushinë', *Traçêic* 'Straçinë' etj. Mbizotëron mendimi se diftongimi është dukuri e hershme, që ka vepruar në fillim të shekullit XV. Shpërbërja (diftongimi) e zanoreve përputhet plotësisht me shtrirjen hapësinore të principatës së Kastriotëve (1370-1468), d.m.th. gegërishtja qendrore shtrihet brenda kufijve të principatës së Kastriotëve.

b) Zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/. Fonema /y/ në të folmet e gegërishtes qendrore përgjithësisht zhbuzorëzohet në /i/: *dy* > *di*, *yll* > *ill*, *dry* > *dri* etj. dhe kur ka kushte të njëjta me /i/-në, diftongohet sipas tipit *sy* > *si* > *sâi* etj.

c) Edhe qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] është dukuri fonetike mjaft e përhapur në gjithë arealin e gegërishtes qendrore. Në shumë të folme të gegërishtes qendrore në shumicën e fjalëve ku të folmet e tjera kanë prapagjuhoren [g], ato kanë qiellzoren mbylltore [gj], si në fjalët: *gjisht* 'gisht', *gjur* 'gurë', *gjo:j* 'gojë', *gjardh* 'gardh', *pagjuj* 'paguaj', *zagjar* 'zagar', *megjëll* 'mjegull', *magjar* 'gomar', *argjat* 'argat', *burgj* 'burg', *lu:gj* 'lugë', *pragj* 'prag', *degj* 'degë', *largj* 'larg', *frâigj* 'frikë' etj.

ç) Evoluimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] në izoglosën e gegërishtes qendrore dallon nga të folmet e tjera shqipe, meqë përgjithësisht në të folmet e tjera shqipe këto grupe ruhen si të tilla, ndërsa në gegërishten qendrore qiellzorëzohen (palatalizohen) në shkallë të ndryshme, deri në qiellzore të mirëfillta. Grupi [pl] është zhvilluar në [pj, pq, q]; sipas tipit *plak* > *pjak*, *pqak* > *qak*; *bl* > *ble:t*, *bgje:t*, *gje:t*; *flutur* > *fjutër* > *qutër* etj.

Pikat skajore e të folmeve veriore të gegërishtes qendrore në Maqedoninë e Veriut janë fshatrat e Kumanovës, ndërsa pikat jugore



gjenden në Strugë. Disa fshatra në veri të Kumanovës i takojnë gegërishtes verilindore (kosovarishtes). Qyteti i Strugës i takon të folmeve kalimtare, ndërsa pjesa perëndimore e rrethit Strugës, Prespa, Manastiri i përkasin të folmeve të toskërishtes veriore, që ka tipare të njëjta e vijimësi tokësore me të folmet e tjera toske të Shqipërisë (Skrapar, Opar, Gorë, Pogradec, Korçë, Devoll, Myzeqe, Mallakastër, Vlorë, Mifol, Selenicë, Berat, Fier, Përmet, Kavajë, Tepelenë). Pra, degëzimi dialektor i shqipes nuk përputhet me kufijtë e sotëm shtetërorë, por dëshmon se historikisht kemi pasur e kemi vazhdimësi

gjuhësore, etnike e territoriale.

Rrjedhimisht, faktet gjuhësore të shtrirjes dialektore të shqipes në Ballkan dëshmojnë se nuk ka pasur shpërngulje të mëdha shqiptarësh nga një zonë në tjetrën, as nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut, meqë nuk kemi përzierje gjuhësore, por izoglosa me unitet, me vijimësi, me vazhdimësi dialektore e kalueshmëri të shkallëshkallshme. Për hir të së vërtetës, duhet pranuar se njerëzit e familjet kanë lëvizur gjithnjë e do të lëvizin përherë nga një vend në tjetrin brenda krahinës, por edhe jashtë saj, qoftë edhe brenda Ballkanit, Evropës e botës nga luftrat, dhuna apo për të kërkuar kushte më të mira jetese ose për arsye të tjera. Në këtë pikëpamje, janë të njohura botërisht lëvizjet fshat - qytet, zona më pak të zhvilluara drejt më të zhvilluarave etj. Në këtë kuptim, edhe te shqiptarët ka pasur lëvizje të pjesshme brenda territorit të ish-Jugosllavisë, brenda Ballkanit, Evropës e botës, por asnjëherë nuk ka pasur uzurpime terriroresh me dhunë (luftë) e as dyndje me prapavijë politike.

Fakti që të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut kanë marrë pjesë drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të natyrshme në zhvillimin historik të strukturës dialektore të shqipes, është një provë tjetër e rëndësishme e vjetërsisë së popullsisë shqiptare të Maqedonisë në këto territore. Kjo dëshmohet në monografitë dialektore për të folmet shqipe si dhe në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe (Atlasi I, II; Napoli, 2007, 2008).

Leksiku onomastik varet nga veçoritë e gjuhës konkrete dhe nga veçoritë e jetës vendore të popullatës, që lidhen me kulturën, me natyrën,

me klimën, me kontaktet etj. Gadishulli ilirik (emër i lashtë i Ballkanit), kufizohet nga të tria anët me detra: me Adriatikun në perëndim, Mesdheun në jug dhe Detin e Zi në lindje. Në veri për kufi ka Danubin, por përfshin edhe tokat rumune. Këtu, në një truall relativisht të vogël kanë jetuar dhe jetojnë popuj të ndryshëm. Të dhënat arkeologjike, historike, etnologjike, antropologjike dhe gjuhësore dëshmojnë se Ballkani ka qenë i banuar edhe para ardhjes së fiseve indoevropiane (si pellazgët në jug, që u shkrinë, por gjithsesi kanë lënë gjurmë). Popullimi i hershëm i këtij gadishulli është mundësuar edhe nga pozicioni i tij geografik si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël. Kjo u ka dhënë shkas gjithashtu dyndjeve të herëpashërshme të popujve dhe fiseve të ndryshme, që, edhe kur janë asimiluar nga banorët më të hershëm, apo edhe kur kanë qëndruar për një kohë në Ballkan, prapë kanë lënë gjurmë në kulturën materiale e shpirtërore në këtë gadishull, veçmas në onomastikë.

Aty nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë para erës së re, nga djepi i përbashkët indoevropian u dyndën valë-valë për në jug një popullsi e madhe. Kështu, në jug të Ballkanit kanë jetuar helenët (grekët), në qendër maqedonët e lashtë, në perëndim ilirët, në lindje trakasit (paraardhësit e rumunëve). Gjurmë kanë lënë edhe keltët me dyndjet e tyre në Ballkan (aty nga shek. III para erës sonë), gotët (vizigotët në shek. IV të erës sonë). U krijuan perandori të fuqishme që shtrinë ndikimin e tyre jo vetëm në Ballkan (fjalë turke me kuptimin 'mal'), por edhe më gjerë nëpër Evropë e botë. Të tilla qenë perandoria Romake, Bizantine, Osmane etj.

Të dhënat historike tregojnë se që nga shekulli II para erës sonë, pas shumë luftërave të përgjakshme, Iliria u nënshtua nga perandoria Romake (megjithëqë pati kryengritjeve të shpeshta). Në vitin 395 ajo u nda në dy pjesë: në perandorinë Romake të Perëndimit, me Romën kryeqytet dhe në perandorinë Lindore, e quajtur perandori Bizantine me qendër Konstandinopojën (Stambollin e sotëm). Pjesa më e madhe e provincave të atëhershme Ilire (Prevali, Dardania, Epiri i Ri dhe Epiri i Vjetër) gati 10 shekuj (që nga shekulli IV deri në shek. XIV) ishin nën sundimin bizantin. Krishterimi hodhi rrënjë në viset e Ilirisë qysh në shekujt e parë të erës sonë, ndërsa ortodoksizmi u përhap në kohën e sundimit bizantin.

Nga shekulli VI-VII të erës sonë me ardhjen e sllavëve u ndryshua shumë pamja etnike e gjuhësore e Ballkanit, u asimiluan protobullgarët (fise trakase) në bullgarë si dhe një numër i madh banorësh të tjerë. Në shekujt IX-X (në kohën e car Simeonit e car Samuelit) mbretëria bullgare u shtri edhe në tokat shqiptare, ndonëse ato llogariteshin si provincë bizantine. Pas disfatës së fundit që pësuan forcat bullgare afër Beratit (më 1018), u rivendos pushteti bizantin në trevat shqiptare. Nga shek. XIV Ballkani pushtohet nga osmanët dhe me këtë përhapet feja islame. Sundimi i tyre zgjati deri në gjysmën e parë të shek. XX.

Pas shpërbërjes së Perandorisë Turke, në Ballkan formohen shumë shtete, por një pjesë e madhe e popullatave të ndryshme mbeten jashtë kufijve shtetërorë kombëtarë. *Gjendja kaotike e konfliktit të gjithëve kundër të gjithëve*, që mbretëroi një kohë të gjatë, do të vazhdojë edhe në luftërat Ballkanike, në ato Botërore e pastaj edhe në ato Jugosllave.

*Këto gërshetime civilizimesh të ndryshme:* me fqinjësi shumëshekullore, me dyndje, me zhvendosje të brendshme popullore, me luftra të përgjakshme, urrejtje e mostolerancë, me egoizëm e prirje për të shlyer gjurmët e ekzistimit të tjetrit, me asimilime popujsh; me mbizotërim herë të njërit e herë të tjetrit (shpeshherë edhe të atij që nuk banonte në Ballkan); me paganizëm, politeizëm e monoteizëm (me përhapje më të madhe të tri besimeve: krishterizmit, ortodoksizmit e islamizmit) dhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë *pasqyrohen edhe sot në kulturën materiale e shpirtërore të popujve të Ballkanit; në gjuhët e tyre, sidomos në fushën e leksikut, duke përfshirë edhe emrat gjeografikë, emrat e njerëzve, të bimëve, të kafshëve, të sendeve, të objekteve etj.* (Hamiti – Sopaj, 2004: 126-127).

*Kjo histori e trazuar e Ballkanit*, që karakterizohet me ndërrim të shpeshtë të pamjes etnike e fetare, me administrim në gjuhë të huaja etj., *pasqyrohet edhe në onomastikën e tij.* Rrjedhimisht, onomastika e Ballkanit është shumë e larmishme: aty gjejmë emra të përveçëm me etimologji ilire-shqiptare, trake, latine, greke, sllave, turke, vllehe e nga ndonjë gjuhë tjetër. Krahas këtyre, ka edhe emra me forma të ndryshuara gjatë shekujve, të përkthyer a të kalkuara, shpeshherë edhe të riemërtuara; emra me forma të përziera (hibride) nga dy e më tepër gjuhë etj.

Për shkak të tretjes apo të mosnjohjes së gjuhëve të vjetra (në mungesë të dokumenteve të shkruara, por me gjurmë onomastike), për shkak të dallimit të ligjërive të përgjithshme gjuhësore me ato onomastike..., etimologjia e një sasive toponimesh e antroponimesh ballkanike deri më sot kanë mbetur e ndoshta edhe në të ardhmen do të mbeten të pazbërthyeshme e të pashpjegueshme.

Përzierjet etnike kudo në Ballkan janë rezultat i proceseve historike shumëshekullore. Shtetet e sotme Ballkanike janë të reja dhe etnikisht nuk janë homogjene. Historia e asnjërit prej popujve ballkanikë nuk mund të mbyllet në suaza të shteteve përkatëse. Me një histori ballkanike përplot ngjarje e kthesa, ku tani thuhet asnjë gurë më nuk mund ta gesh në vendin e vet, arsyetohet edhe laramania etimologjike e emrave të vendeve dhe të njerëzve në tërë truallin e Gadishullit Ballkanik. Nuk ka vend dhe popull në Ballkan që në fushën e onomastikës të mos ketë shtresëzime të llojllojshme civilizimesh të ndryshme. Pikërisht në këto shtresa të krijuara nëpër mote shpeshherë thyhen shtizat edhe në qarqet shkencore, sepse qasjet e tyre janë të llojllojshme: disa pikëmbështetje për të arsyetuar tezat e veta kanë shtresën e re, disa atë të mesjetës e disa shtresën antike. Mirëpo, dihet se jo vetëm në trojet e ish Jugosllavisë ku ka shqiptarë, por edhe në truallin

brenda kufijve të Shqipërisë, përveç toponimeve me etimologji shqipe, të cilat mbizotërojnë, gjejmë edhe emra me etimologji gjuhësh të ndryshme: latine, greke, sllave, turke, vllehe, ndonëse ndonjë edhe me prejardhje të pashpjegueshme deri më sot.

Toponimia në shumë vise të Gadishullit Ballkanik ruan deri më sot karakterin e vjetër ilir. Shqiptarët janë të vetmit që kanë ruajtur emrat ilirë, emrat e vendbanimeve, madje edhe emrat e njerëzve. Shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve. Përveç argumenteve historike, gjeografike, antropologjike etj., këtë e dëshmojnë edhe zbulimet arkeologjike dhe faktet gjuhësore, sepse emrat ilirë shpjegohen vetëm me anë të shqipes. Krahasimi i formave të lashta ilire të emrave të vendeve dhe të njerëzve me format përgjegjëse të shqipes së sotme, vërtetojnë se ato janë zhvilluar me rregullat e fonologjisë dhe të gramatikës historike të shqipes.

Analiza e fakteve të shumta të gjuhës shqipe, dëshmon se stërgjyshërit e shqiptarëve në lashtësi kanë qenë fqinjët veriorë dhe veri-perëndimorë të grekëve të vjetër dhe të nënshtruarit e hershëm të Perandorisë Romake. Si rrjedhim, mendimi i mbrojtur nga një varg dijetarësh që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve jugorë, gjen një mbështetje të fuqishme në dëshmitë e shumta të gjuhës shqipe, e cila është zhvilluar nëpërmjet evolucionit të një a disa dielekteve, që fliteshin në lashtësi pikërisht në trevat e Ilirisë Jugore (Hamiti – Sopaj, 2004: 130).

Nëse vështrohet Gadishulli Ilirik (më vonë i riemërtuar në Gadishull Ballkanik) në dritën e toponimisë, do të vërehet se shumë emra vendesh u takojnë disa periudhave kohore: antikës, mesjetës dhe kohës së re; përkastësisht disa shtresimeve etno-kulturore dhe gjuhësore (paraindoevropiane, indoevropiane, ilire, protoshqiptare e shqiptare, latine, romane e vllehe, greke, sllave, turke etj.

Pushtuesit kanë lënë pra gjurmët e tyre edhe në emrat e vendeve, që, sado u përpoqën t'i eliminojnë gjurmët e tyre edhe emrat e vendeve iliro-shqiptarë, ato nuk u zhdukën krejtësisht. Sot, ndjehet nevoja e mbledhjes, regjistrimit, studimit dhe e standardizimit të toponimisë shqiptare, përfshirë edhe toponiminë e Maqedonisë. Për këtë punë të ngutshme interdisiplinare duhet një bashkërendim i onomasiologëve, dialektologëve, standardologëve, gjeografëve, historianëve dhe i arkeologëve (Sejdiu, 2002: 112-113).

Nga monografitë përshkruese për të folmet shqipe në Maqedoni si dhe nga studimet për toponiminë e mikrotoponiminë e Maqedonisë mund të nxirret një konstatim i përgjithshëm se: Maqedonia mbushullon me emërvende shqipe, krahas me ato të burimit të huaj: pellazgjik, latin, grek, turk, sllav etj.

Sipas analizës së bërë në *Mikrotoponiminë e Karshiakës së Shkupit* në vendbanimet me popullsi shqiptare numri më i madh i mikrotoponimeve është i gurrës shqipe, ndërsa në ato të banuara me popullsi maqedonase i asaj sllave (Idrizi, 2003: 14).

Numri më i madh i emërvendeve në Pollogun e Epërm të Gostivarit, sipas kolegut Izmit Durmishi, është me origjinë shqipe, por nuk mungojnë edhe ato me etimologji sllave, turke dhe gjuhësh të tjera (Durmishi, 2008: 53).

Autoktonia e shqiptarëve në trojet e Maqedonisë së Veriut dëshmohej edhe më bindshëm me mikrotoponimi. Fjala vjen, nga 100 mikrotoponime të fshatit Goshincë të Kumanovës, mbi 90 sosh kanë etimologji shqipe... Edhe në vendbanimet shqiptare të Karadakut të Shkupit mbizotërojnë mikrotoponimet me burim nga gjuha shqipe. Tipike janë emërtimet: *Gjuri Zi, Kepi Shipës, Kepi Selvajës, Kepi Bollës, Kepi Madh, Kepi Dullës, Kepi n'Dushk, Kepi Borës, Kepi Kuç, Shpella Arashës, Kodra Holl, Kodra Furrës, Livadhi Madh, Livadhi n'Lak, Livadhi Isenit, Ara Madhe, Ara n'Prrae, Ara n'Kodër, Mali Ashit, Mali Shpesh, Kroi Bardh, Kroi Ftoft, Kroi Mullajnit, Lisi n'Kodër, Kama Draçoit* etj. (Hamiti, 2011).

Edhe mikrotoponimia e vendbanimeve shqiptare në zonën e Prilepit, të Krushevës dhe të Velesit, sipas kolegut Mustafa Ibrahimit na del kryesisht me etimologji shqipe: nga 2057 njësi toponomastike (oronime, hidronime si dhe emra të tjerë vendesh të vogla) 1308 janë shqipe (63.6%), 382 (18.5%) sllave, 297 (4.4%) turke, 25 (1.2%) greke, 8 (0.4%) arumune, 12 fjalë latine (0.6%) dhe 23 (2.8%) topoleksema me etimologji gjuhësh të tjera (Ibrahimit, 2010: 230).

Në Fjalorin toponomastik të tërthoreve shqiptare të Maqedonisë, dr. Qemal Murati me të drejtë konstaton se: toponomastika - emrat gjeografikë të vendeve, është quajtur me të drejtë "gjuha e tokës", arkeologji pa lopatë dhe arkiv i vërtetë historie (Murati, 2008: 5). Toponomastika shqiptare përbën mbase dokumentin më kryesor që vërteton autoktonitetin e popullit shqiptar në vendbanimin e tij të sotëm, d.m.th. faktin që shqiptarët janë vendës në këto anë që nga kohët më të lashta të historisë, pa ndërprerje (Çabej: 1975, V). Lënda e pasur e tërthoreve shqiptare të Maqedonisë me 4.200 topoleksema na dëshmon se shqiptarët në Maqedoni nuk janë të djeshëm - sikundër janë përpjekur t'i paraqesin kështu onomasticientët maqedonas, sepse vetë emërtesa toponomastike ata i gjen në këtë anë shumë kohë para ardhjes së sllavëve (Murati, 2008: 6).

Secila gjuhë në botë ka tiparet e saja dhe gjatë zhvillimit historik krijojnë sistem të mëvetësishëm dhe të dallueshëm nga gjuhët e tjera. Edhe në fushën e onomastikës, gjuha shqipe si çdo gjuhë tjetër në botë ka rregullat e saja gjuhësore, të cilat nuk mund të ndryshohen e të bastardohen. Emrat e vendeve paraqesin një sistem më vete, si



mikrosistem që përfshihen në një sistem më të madh - makrosistem. Çdo çrregullim i mikrosistemit gjuhësor ndikon edhe në çrregullimin e makrosistemit.

Në gjuhë të ndryshme toponimet mund të kenë emërtime të ndryshme. Kjo dukuri, ekziston në çdo gjuhë dhe nuk duhet të kemi paragjykime, por duhet pranuar si çështje gjuhësore pa i dhënë konotacion politik. Toponimet nuk pranojnë forma të dhunshme e të imponuara administrative.

Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane dhe formon një grup më vete pasi që për nga veçoritë gjuhësore ka karakteristikat e saja dhe nuk përkon me gjuhët e tjera, sidomos në sistemin emëror.

Të gjithë emrat në gjuhën shqipe, pa përjashtim, kanë dy trajta: trajtën e shquar dhe trajtën e pashquar. Kjo domethënë se edhe emrat e vendbanimeve, varësisht nga situata, përdoren në trajtë të shquar ose në atë të pashquar, gjë që e dallon nga gjuhët e tjera, përfshirë këtu edhe maqedonishten.

Emrat në trajtën e shquar marrin mbaresa, si bie fjala **-i** ose **-u** për gjininë mashkullore, dhe **-a** ose **-ja** për gjininë femërore. Gjithashtu emrat në gjuhën shqipe kanë sistem rasor, pra lakohen nëpër pesë rasat dhe duke u lakuar, ata marrin edhe mbaresat rasore. E gjithë kjo ka të bëjë edhe me toponimet të cilat me shekuj janë përdorur dhe iu kanë përshtatur sistemit gramatikor të shqipes.

Të marrim një shembull: *Tetova* në gjuhën maqedonase quhet *Tetovo*, shikuar nga sistemi gramatikor i shqipes kjo do të ishte rasia emërore (nominativ). Sipas sistemit rasor të shqipes, ky emër është i gjinisë femërore në trajtën e pashquar që mbarojnë me **-o**. Këta emra në trajtën e shquar, në rasën emërore marrin mbaresën **-ja**. Pra do të kishim forma të panatyrshme *Tetovo - Tetovoja*. Në rasën gjinore do të ishte *i, e Tetovosë*, në dhanore *Tetovosë*, kallëzore - *Tetovonë* dhe në rrjedhore prej *Tetovosë*; në vend se në formën e shqipes që është *Tetovë - Tetova; i, e, Tetovës; Tetovës; Tetovën*, dhe prej *Tetovës*.

Ose të marrim një shembull tjetër: *Shkupi* në maqedonisht quhet *Skopje*, dhe sipas grupimit të emrave ky emër në shqip është në gjininë mashkullore, ndërsa në maqedonisht në gjininë femërore që në trajtën e shquar marrin mbaresën **-ja** dhe njëkohësisht bie zanorja **-e** fundore: *Skopja; i, e Skopjes; Skopjes; Skopjen; prej Skopjes* (në vend të *Shkup, Shkupi; i, e Shkupit, Shkupit, Shkupin, prej Shkupit*).

Pasi që emri kur ka funksionin e kryefjalës është edhe bartës i fjalisë, çdo fjalë tjetër i përshtatet në gjini, numër dhe rasë, çdo kalim prej një gjinie në tjetrën shkakton edhe çrregullime brenda në fjali dhe e dëmton sistemin e brendshëm dhe strukturën e fjalisë. Kjo njëkohësisht ndikon edhe në ndërrimin e vendit të theksit në fjalë, e vështirëson shqiptimin e fjalës dhe e humb bukurinë e të shprehurit.

Shqipja tanimë është gjuhë e standardizuar, me një traditë 550 vjeçare shkrimi, me një alfabet të njësuar para më shumë se 100 vjetësh, dhe si e tillë përdoret jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe në Maqedoni, në Serbi, Mal të Zi dhe në të gjitha vendet e botës. Çdo cenim i sistemit të saj, shkakton jo vetëm çrregullim strukturor, por vështirëson e pamundëson kuptueshmërinë ndërmjet pjesëtarëve të një populli. Dihet se para së gjithash gjuha është mjet komunikimi dhe me të duhet të merren vesh njerëzit. Dua të them se nëse bëjmë shkelje të rregullave gjuhësore, domosdo do të vijmë në situatë që shqiptarët të mos mund të kuptohen mes vete. Pra gjuha standarde shqipe është një, si për shqiptarët e Maqedonisë, ashtu edhe për ata të Shqipërisë, të Kosovës etj. dhe për gjithë shqipfolësit.

Nga ana tjetër, kjo nuk ka të bëjë vetëm me gjuhën shqipe. Dukuria e përdorimit të emrave të ndryshëm për vendbanimet e njëjta ekziston në të gjitha gjuhët, po edhe në maqedonisht, p.sh.: *Белград* në vend të formës në serbisht *Beograd*, *Солун* në vend të formës greke *Thesaloniki*, *Скадар* në vend të formës shqipe *Shkodër*, *Драч* (Durrës), *Австрија* (Austria), *Валона* (Vlorë), *Грција* (Hellada), *Данска* (Denmark), *Ерусалим* (Jerusalem), *Ирска* (Irland), *Лерин* (Florina), *Норвешка* (Norvege), *Полска* (Poloni), *Рим* (Roma), *Финска* (Finland), *Шведска* (Suedi), *Швајцарија* (Suiss, Svicerland, shq. Zvicër), *Шкотска* (Skotland), *Шпанија* (Espanja) etj. Ose, bie fjala, pse nuk pengon kur turqit thonë *Yskyp* në vend të *Skopje*, *Manastir* në vend të *Bitolla*, *Hingliz* për *Angli*, *Junanistan* për *Greqi*; serbët: *Skoplje* në vend të *Skopje*, *Njemačka* për *Gjermani*, *Nizozemska* për *Holandë*. Pse nuk zemërohen gjermanët kur francezët shtetin e tyre e quajnë *Allemagne*, anglezët – *Germany*, e ata vetë e quajnë *Deuçlland*. Holanda quhet *Nederland*, *Pays-Bas*, *Nizozemska* etj.

Një kohë të gjatë në qarqet maqedonase flitej rreth "unifikimit" të emrave gjeografikë në Maqedoni ku me shekuj jetojnë shqiptarët. Por, dihet se unifikimi a standardizimi bëhet vetëm në kaudrin e një gjuhe dhe kurrsesi nuk mund të dalë jashtë caqeve të asaj dhe të çënojë gjuhët e tjera, përkatësisht t'ua imponojë normat e veta. Pra, çështja e unifikimit apo e zëvendësimit të toponimeve shqipe e të tjera me ato maqedone është joshkencore, jopraktike, e papranueshme e me prapavijë politike. Shqipja, si çdo gjuhë tjetër e botës, ka sistemin e saj fonetik, gramatikor dhe leksikor. Prandaj, çdo prekje dhe çdo intervenim i jashtëm dhe i dhunshëm në cilindo rrafsh, lëndon gjuhën, e cila siç do të thoshte Sosyri "është sistem që njeh vetëm rendin e vet" (Sejdiu, 2002: 112-113).

Çdo ndërmarrje për eliminimin e trajtave të njëjës a të tjetrës gjuhë, thotë prof. Shefki Sejdiu, në veprën *Sprova etimologjike*, Prishtinë, 2002, f. 115, s'mund të quhej ndryshe pos padrejtësi dhe diskriminim ndaj asaj gjuhe që këto toponime i solli deri në format e tashme, duke i ruajtur nga stuhitë që i sillnin kohërat mbi qiellin e këtyre viseve shekuj me radhë.

.. Andaj, në përputhje me ligjet e secilës gjuhë dhe normave humane të çdo shoqërie të civilizuar, përdorimi paralel i toponimeve shqipe (nga albanofonët), maqedone (nga maqedonofonët) dhe atyre turke (nga turkofonët) nuk paraqesin as pengesë as vështirësi në komunikim, përkundrazi është begati dhe dëshmi e jetës së përbashkët shekullore të këtyre popujve në këto troje. Ky paralelizëm duhet të vazhdojë dhe nuk duhet prekur në asnjërin rrafsh të asnjërës gjuhë, duke e lënë këtë paralelizëm të gjallërojë natyrshëm, ashtu sikundër që vepron bota e civilizuar dhe gjuhësisht e njerëzish e ngritur (Sejdiu, 2002: 115).

Njeriu duhet të jetë i kthyer nga e ardhmja e me shpinë nga e kaluara. Pra, e kaluara në funksion të së tashmes. Historinë duhet lënë historianëve, onomastikën gjuhëtarëve. Detyrë e shkencës është të zbulojë, të argumentojë e të thotë të vërtetën për shoqërinë e botën që na rrethon, qoftë ajo e vërtetë e hidhur apo e këndshme. Ajo duhet thënë vetëm të vërtetën, nuk duhet të jetë nën ndikimin e politikës ditore. Rrjedhimisht, jo pak shqiptarë bashkë me maqedonasit dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera bashkëjetojnë me shekuj dhe janë banorë e shtatas të Maqedonisë. E drejtë e çdo kombi është t'i emërtojë gjërat, përfshirë edhe emrat gjeografikë, sipas natyrës së gjuhës së tij. Gjithë veprimtarinë tonë duhet mbështetur në frymën e respektimit të ndërsjellë të veçorive e të dallimeve kulturore, gjuhësore, fetare të tjetrit, të tolerancës, të mirëkuptimit, e përgjithësisht të orientimit tonë për një të ardhme të lumtur. Të mos jemi pre e urrejtjes, mohimit, egoizmit, miteve, stereotipeve, paragjyqimeve etj., por të punojmë për Evropë të bashkuar dhe të përgatitur për të mbijetuar në një botë të globalizuar.

### **Bibliografia:**

- Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe I, II* (2007, 2008), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë,, Vëllimi I, II; Napoli.
- Baliu, Begzad (2008), *Onomastika e Kosovës* (ndërmjet miteve dhe identiteteve), Prishtinë.
- Beci, Bahri (2013), *Shqiptarët e Maqedonisë, më të hershëm se sllavët*, www.Pashtriku.org, 20.04.2013.
- Çabej, dr. Eqrem (1975), *Studime gjuhësore V*, Prishtinë.
- Çabej, dr. Eqrem (1976), *Studime gjuhësore III*, Prishtinë.
- Durmishi, Izmit (2008), *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar.
- Doçi, dr. Rexhep (1990), *Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I*, Prishtinë.
- Frashëri, Kristo (2009), *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit*, gazeta "Shqip", 9-10. 12. 2009.

Hamiti – Sopaj (2004), *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup.

Hamiti, Asllan (2007), *Antroponimia e shqiptarëve të Maqedonisë dhe planifikimi gjuhësor*, Konferenca e parë Albanologjike, Ohër, 23-27 shtator 2007, f. 339-346.

Hamiti, Asllan (2011), *Mikrotoponimet dhe antroponimet e fshatit Goshincë*, Instituti Alb-Shkenca, Takimi VI Vjetor Ndërkombëtar, Prishtinë, 1-4 shtator 2011.

Институт за македонски јазик “Крсте Мисирков” – Скопје (2004), Јазикот наш денешен – книга 11, *Стандардизацијата на географските имиња во Република Македонија*, Зборник на трудови од трибината одржана на 30 септември 2004 година, Скопје.

Ibrahimi, Mustafa (2010), *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit*, Krushevës dhe Velesit, Intelingua, Shkup.

Idrizi, Xhemaludin (2003), *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup.

Ismaili, Mustafa (1998), *Goshinca e Kumanovës*, Shkup.

Murati, Qemal (1996), *Kërçova në traditat e saj të vjetra*, Shkup, 1996.

Murati, dr. Qemal (2008), *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Tetovë.

Selmani, Asllan (2000), *Gjeografia e Maqedonisë antike*, Kumanovë, 2000.

Sejdiu, Shefki (2002), *Sprova etimologjike*, Prishtinë.

Sulejmani, Fadil (1979), *Toponimia e Malësisë së Tetovës*, në *Onomastika e Kosovës*, Prishtinë.

Shkurtaç, Gjovalin (2001), *Onomastikë dhe etnolingistikë*, ShBLU, Tiranë.

Ymeri, Haki (1997), *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup.

---